



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2024 – Numri: 40

Tiranë – E hënë, 4 mars 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 10/2024, datë 8.2.2024	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për njohjen e së drejtës së ushtrimit të profesioneve të avokatit dhe ndërmjetësit në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.....
	4485
Dekret i Presidentit nr. 85, datë 26.2.2024	Për shpallje ligji.....
	4487
Ligj nr. 14/2024, datë 8.2.2024	Për miratimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë.....
	4487
Dekret i Presidentit nr. 86, datë 26.2.2024	Për shpallje ligji.....
	4515
Ligj nr. 15/2024, datë 8.2.2024	Për Strategjinë e Mbrojtjes së Mjedisit Detar të Republikës së Shqipërisë.....
	4515
Dekret i Presidentit nr. 87, datë 26.2.2024	Për shpallje ligji.....
	4524
Ligj nr. 16/2024, datë 8.2.2024	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”.....
	4525
Dekret i Presidentit nr. 88, datë 28.2.2024	Për shpallje ligji.....
	4538
Ligj nr. 17/2024, datë 15.2.2024	Për një shtesë në ligjin nr. 7651, datë 21.12.1992, “Për festat zyrtare e ditët përkujtimore”, i ndryshuar.....
	4538
Dekret i Presidentit nr. 89, datë 28.2.2024	Për shpallje ligji.....
	4539
Urdhër i ministrit të Mbrojtjes nr. 225, datë 20.2.2024	Për delegim kompetencash për ndjekjen e proceseve, lidhur me ushtrimin e përgjegjësisë së administrimit të pronave në Ministrinë e Mbrojtjes.....
	4539

Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut datë 30.1.2024	Çështja Vjola sh.p.k. dhe DE sh.p.k. kundër Shqipërisë (<i>kërkesa nr. 18076/12</i>).....	4539
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 1, datë 25.1.2024	Me objekt shfuqizimin e nenit 4, pikat 1, shkronja “c”, 2, shkronja “b”, 3, shkronja “b” dhe nenit 5, fjalë e parë, të ligjit nr. 60/2023, datë 21.7.2023, “Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë ‘Mjekësi e përgjithshme’ në institucionet publike të arsimit të lartë”, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Pezullimin e zbatimit të ligjit nr. 60/2023, datë 21.7.2023, “Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë ‘Mjekësi e përgjithshme’ në institucionet publike të arsimit të lartë”, deri në hyrjen në fuqi të vendimit të Gjykatës Kushtetuese.....	4543
Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat nr. 482, datë 19.6.2023	Për heqjen e plotë të zotësisë juridike për të vepruar të shtetasit Sokrat Jazi.....	4513
Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat nr. 289, datë 20.4.2022	Për heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Admir Kollçaku.....	4273
	Për shpalljen të zhdukur të shtetasve Ermal Banushi dhe Renald Banushi.....	4273



LIGJ
Nr. 10/2024

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS
PËR NJOHJEN E SË DREJTËS SË
USHTRIMIT TË PROFESIONEVE TË
AVOKATIT DHE NDËRMJETËSIT NË
ZGJIDHJEN E MOSMARRËVESHJEVE

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, 83, pika 1, dhe nenit 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës për njohjen e së drejtës së ushtrimit të profesioneve të avokatit dhe ndërmjetësit në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 8.2.2024.

Shpallur me dekretin nr.85, datë 26.2.2024,
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bajram Begaj.

MARRËVESHJE

NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS
SË KOSOVËS DHE
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
PËR NJOHJEN E SË DREJTËS SË
USHTRIMIT TË PROFESIONEVE TË
AVOKATIT DHE NDËRMJETËSIT NË
ZGJIDHJEN E MOSMARRËVESHJEVE
Qershor, 2023

Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë (këtu e në vijim “Palët”),

duke vlerësuar marrëdhëniet miqësore dhe bashkëpunimin ndërmjet dy vendeve;

duke njohur aspiratat e të dyja Palëve, për të zgjeruar dhe forcuar marrëdhëniet dypalëshe dhe bashkëpunimin në fushën e drejtësisë,

duke marrë në konsideratë qëllimin e krijimit të një hapësire të lirë ndërveprimi për njerëzit, idetë, kapitalet dhe fusha të tjera të përbashkëta, si dhe sigurimin e një perspektive më të mirë për shtetasit e të dyja vendeve;

duke pasur në vëmendje mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ligjshme të shtetasve të secilës Palë,

duke konsideruar prioritet të përbashkët zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimit reciprok në fushën e ushtrimit të profesioneve të avokatisë dhe ndërmjetësit në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve,

me qëllim për të thjeshtësuar procedurat për ushtrimin e profesioneve të avokatisë dhe ndërmjetësit në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve,

Bien dakord si vijon:

Neni 1
Qëllimi

Marrëveshja ka për qëllim njohjen e së drejtës së ushtrimit të profesioneve të avokatit dhe ndërmjetësit/ndërmjetësuesit (në tekstin e mëtejshëm: ndërmjetësit) në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, në territorin e Republikës së Kosovës, nga personi që e ka fituar këtë të drejtë në Republikën e Shqipërisë, si dhe anasjellas.



Neni 2

Objekti i Marrëveshjes

Marrëveshja ka si objekt përcaktimin e rregullave të zbatueshme në mundësimin e njohjes së të drejtës së ushtrimit të profesioneve të avokatit dhe ndërmjetësit në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në të dyja vendet, si dhe të të drejtave dhe detyrimeve që Palët marrin përsipër për arritjen e qëllimit, sipas nenit 1 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 3

E drejta e ushtrimit të profesionit të avokatit

Avokati që ka fituar të drejtën e ushtrimit të profesionit të avokatit në Republikën e Kosovës, në përputhje me legjislacionin e këtij vendi, ka të drejtën të ushtrojë këtë profesion në Republikën e Shqipërisë dhe anasjellas, në përputhje me parashikimet e nenit 5 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 4

E drejta e ushtrimit të profesionit të ndërmjetësit

Ndërmjetësi që ka fituar të drejtën e ushtrimit të profesionit të ndërmjetësit në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në Republikën e Kosovës, në përputhje me legjislacionin e këtij vendi, ka të drejtën të ushtrojë këtë profesion në Republikën e Shqipërisë dhe anasjellas, në përputhje me parashikimet e nenit 5 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 5

Kushtet për ushtrimin e profesionit

1. Avokati ose ndërmjetësi që kërkon të ushtrojë profesionin në vendin tjetër, sipas nenit 3 dhe 4 të kësaj Marrëveshjeje, duhet të vërtetojë se zotëron njohuri të mjaftueshme të së drejtës së zbatueshme në atë vend.

2. Për të vërtetuar zotërimin e njohurive, avokati ose ndërmjetësi zgjedh një nga alternativat e mëposhtme:

a) kalimin me sukses të një provimi për testimin e njohurive, të organizuar sipas marrëveshjes teknike të lidhur për këtë qëllim;

b) ndjekjen e një trajnimit të organizuar nga Dhomat, sipas marrëveshjes teknike të lidhur për

këtë qëllim;

c) ushtrimin e profesionit në mënyrë të rregullt dhe efektive, në bashkëpunim me, përkatësisht një studio avokatie ose ndërmjetës në territorin e vendit tjetër, për jo më pak se 6 muaj.

3. Avokati ose ndërmjetësi që kërkon të ushtrojë profesionin në vendin tjetër, sipas neneve 3 dhe 4 të kësaj Marrëveshjeje, vetëm në raste individuale, i njihet kjo e drejtë me miratimin e organit të parashikuar nga legjislacioni i vendit përkatës. Nëse legjislacioni nuk përmban parashikime në lidhje me rregullimin e kësaj të drejte, miratimi jepet nga Dhoma përkatëse.

Neni 6

Të drejtat dhe detyrimet e avokatëve dhe ndërmjetësve

Avokati dhe ndërmjetësi në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, të cilit i njihet e drejta e ushtrimit të profesionit në vendin tjetër, gëzon të gjitha të drejtat dhe merr përsipër të gjitha detyrimet, sipas legjislacionit të atij vendi.

Neni 7

Marrëveshjet teknike

1. Dhomat përkatëse të Palëve lidhin marrëveshje teknike për rregullimin e hollësishëm të çështjeve të mëposhtme:

a) anëtarësia, e drejta për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur në organet drejtuese të Dhomës/Odës, si dhe pagesa e kontributit të anëtarësisë;

b) deklarimi i të dhënave, të cilat sipas legjislacionit të vendit ku ushtron veprimtarinë duhet të deklarohen, si dhe çdo ndryshim i tyre;

c) sigurimi i përgjegjësisë profesionale;

ç) ndjekja e trajnimeve vazhduese;

d) procedimi disiplinor dhe masat disiplinore deri në heqjen e së drejtës për ushtrimin e profesionit në atë vend, si dhe mënyra e njoftimit të tyre;

dh) mënyra e njoftimit dhe komunikimit të pezullimit ose heqjes së titullit.

2. Marrëveshjet teknike, sipas pikës 1 të këtij neni, lidhen sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje.



Neni 8

Bashkëpunimi ndërmjet dhomave

1. Oda e Avokatëve të Kosovës dhe Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë bashkëpunojnë ngushtësisht për zbatimin e kësaj marrëveshjeje dhe për rritjen e kapaciteteve profesionale të avokatëve që ushtrojnë profesionin në të dy vendet, sipas marrëveshjeve teknike që lidhin ndërmjet tyre.

2. Oda e Ndërmjetësuesve dhe Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve bashkëpunojnë ngushtësisht për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe për rritjen e kapaciteteve profesionale të ndërmjetësve që ushtrojnë profesionin në të dyja vendet, sipas marrëveshjeve teknike që lidhin ndërmjet tyre.

Neni 9

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë ndërmjet Palëve lidhur me interpretimin dhe zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje zgjidhet ndërmjet rrugëve diplomatike ose nëpërmjet komunikimit të drejtpërdrejtë ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë së secilës Palë.

Neni 10

Hyrja në fuqi

1. Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë të pacaktuar kohore dhe hyn në fuqi ditën e marrjes së njoftimit të fundit pas përfundimit të procedurave të brendshme të secilës palë për hyrjen në fuqi të saj.

2. Palët marrin përsipër zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe fillojnë punën për hartimin e marrëveshjeve teknike nga data e hyrjes në fuqi të saj.

Neni 11

Ndryshimi dhe denoncimi i Marrëveshjes

1. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me shkrim, me pëlqimin e të dyja palëve nënshkruese.

2. Kjo Marrëveshje mund të denoncohet nga secila palë nënshkruese përmes rrugëve diplomatike. Në këtë rast, kjo Marrëveshje do të pushojë së ekzistuari 6 (gjashtë) muaj nga data e marrjes së njoftimit me shkrim për denoncimin e

saj.

Kjo marrëveshje nënshkruhet në _____, më _____.2023, në 2 (dy) tekste origjinale, në gjuhën shqipe.

Palët nënshkruese:

QEVERIA E REPUBLIKËS
SË KOSOVËS*Ministre e Drejtësisë*
Albulena HaxhiuKËSHILLIT I
MINISTRAVE I
REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Ministër i Drejtësisë
Ulsi Manja**DEKRET****Nr. 85, datë 26.2.2024****PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 10/2024, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës, për njohjen e së drejtës së ushtrimit të profesioneve të avokatit dhe ndërmjetësit në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Bajram Begaj**LIGJ****Nr. 14/2024****PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË SË
SIGURISË KOMBËTARE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**VENDOSI:**



Neni 1

Miratohet Strategjia e Sigurisë Kombëtare e Republikës së Shqipërisë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ligji nr. 103/2014, “Për miratimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë”, shfuqizohet.

Neni 3

Ngarkohet Këshilli i Ministrave për miratimin e akteve nënligjore të propozuara nga institucionet përgjegjëse për zbatimin e kësaj strategjie.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 8.2.2024.

Shpallur me dekreten nr. 86, datë 26.2.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

STRATEGJIA E SIGURISË KOMBËTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

1. HYRJJE

Strategjia e Sigurisë Kombëtare për periudhën e parashikuar 2023–2028, në vijim të Strategjisë së mëparshme të vitit 2014, synon të pasqyrojë në mënyrë sa më gjithëpërfshirëse sfidat dhe kërcënimet kryesore për sigurinë kombëtare të vendit tonë, si dhe të përfshijë përgjigjet institucionale ndaj tyre në harkun kohor 2023–2028.

Që prej vitit 2014 jemi ndeshur me një përkeqësim të dukshëm të sigurisë ndërkombëtare dhe të efekteve negative mbi sigurinë e Evropës, rajonit dhe të vendit tonë. Paralelisht ngjarje të tjera madhore, si: tërmeti i 26 nëntorit 2019 dhe pandemia globale SARS-CoV-2 e tre vjetëve të fundit, prekën ndjeshëm sigurinë e vendit tonë,

duke sjellë kosto njerëzore, ekonomike dhe sociale, duke evidentuar veçanërisht domosdoshmërinë e nxjerrjes së mësimave të duhura për përballimin efektiv të fenomeneve të tilla, si dhe përmirësimin e nevojshëm në dimensionet strukturale dhe organizative.

Ndërsa që prej 24 shkurtit 2022 po përballemi me ndryshime edhe më dramatike në panoramën e sigurisë ndërkombëtare, të cilat kanë vënë në pikëpyetje të gjithë arkitekturën e sigurisë evropiane që pas Luftës së Ftohtë. Agresioni i paprovokuar i Rusisë ndaj Ukrainës ka kthyer në Evropë luftën frontale duke sjellë një konfrontim të ashpër politiko-ushtarak, por edhe një polarizim të skajshëm mes vendeve demokratike dhe fuqive autoritare, disa prej të cilave po shfaqen gjithnjë e më tepër si rivale sistemike të vlerave demokratike. Gjithashtu, fuqizimi i autoritarizmit në shkallë globale, i shoqëruar me cenimin e demokracisë, po rrezikon zhbërjen e multilateralizmit, i cili ka karakterizuar marrëdhëniet ndërkombëtare që pas Luftës së Ftohtë.

Rendi ndërkombëtar i bazuar në rregulla është aktualisht i sfiduar nga përdorimi agresiv i forcës ushtarake për pushtim terroresh, ndërkohë që regjimi i kontrollit të armëve thuajse është zhbërë tërësisht. Krahas ndryshimeve gjeopolitike dhe kërcënimeve të shtuara të sigurisë, sfida të rëndësishme shfaqen dhe në hapësirën kibernetike, ku teknologjia mund të përdoret në çdo kohë si armë kundër qëndrueshmërisë sociale, ekonomike dhe politike. Kërcënimet e sigurisë bëhen dhe më sfiduese, për shkak të mungesës së një regjimi të kontrollit të armëve kibernetike.

Këto zhvillime negative kanë thelluar më tej rivalitetin gjeostrategjik të viteve të fundit dhe kanë përkeqësuar më tej problematikat ekzistuese ekonomiko-sociale në shkallë të gjerë, duke afektuar negativisht sferën energjetike në shkallë globale, duke sjellë tkurrje të ndjeshme të parashikimeve të rritjes ekonomike globale, shtim të inflacionit, si dhe rritje të lartë të çmimeve të lëndëve të para. Po ashtu, zhvillimet e lartpërmendura cenojnë rëndë sigurinë ushqimore, duke e bërë konkret rrezikun e një krize të rëndë ushqimore gjatë dy–tre vjetëve të ardhshëm, e cila, veçanërisht në vendet e varfra, mund të ketë efekte shpërthyes social–politike, me të gjitha pasojat negative të mundshme, përfshirë konflikte rajonale dhe valë të përtëritura emigracioni drejt Evropës.



Natyrshëm, këto efekte negative prekin edhe vendin tonë, por krahas tyre siguria e vendit është përballur, ndërkohë edhe me theksimin eksponencial të disa kërcënimeve të sofistikuar konkretisht si sulmet kibernetike në vitin e kaluar ndaj sistemeve tona *online*, apo aktivitetet e inteligjencës dhe ato influencuese për të rritur ndikimin politik dhe ekonomik të aktorëve globalë kundërshtarë të sistemit demokratik.

Situata aktuale ka krijuar në këtë mënyrë një akumulim sfidash dhe kërcënimesh, të cilat shtrihen nga dimensionin klasik i riaktualizimit të mbrojtjes ushtarake të territoreve, te terrorizmi dhe përdorimi i efekteve të teknologjive në zhvillim në formë dëmtuese/çorientuese e deri në ndryshime klimatike e rreziqe mjedisore. Si të tilla, ato sjellin me vete një paparashikueshmëri të lartë, si dhe vështirësi objektive për përballimin e tyre efektiv në nivel thjesht kombëtar.

2. INTERESAT STRATEGJIKË

Në nivelin global, interesat strategjike të Shqipërisë burojnë nga përkatësia e saj politike perëndimore, si vend anëtar i NATO-s, vend kandidat i Bashkimit Evropian, si dhe nga sistemi i saj politik demokratik. Kështu, interesat kryesorë strategjike të Shqipërisë janë mbrojtja dhe siguria e territorit të mbuluar nga klauzolat e Traktatit të Atlantikut të Veriut, rivendosja e paqes në kufijtë e territorit të BE-së, rivendosja dhe mirëfunksionimi i arkitekturës së sigurisë evropiane, lufta kundër terrorizmit, fuqizimi në shkallë globale i Demokracisë dhe Multilateralizmit, zgjidhja paqësore e mosmarrëveshjeve dhe e konflikteve mes shteteve, rivendosja e arkitekturës ndërkombëtare të kontrollit të armëve, angazhimi global kundër ndryshimeve klimatike, rritja e sigurisë energjetike dhe asaj ushqimore, përpjekjet e përbashkëta ndërkombëtare për të reduktuar problemet sociale në vendet e origjinës të valëve të emigracionit drejt Evropës si dhe forcimi i rolit dhe i angazhimit ndërkombëtar të Shqipërisë si faktor paqeje dhe stabiliteti.

Në nivelin rajonal, interesat strategjike të Shqipërisë burojnë nga përkatësia e saj politike perëndimore dhe natyrshëm janë dhe interesat e saj kombëtarë. Ata janë konsolidimi i mëtejshëm i paqes dhe i stabilitetit në rajon, konsolidimi dhe përsheptimi i perspektivës euroatlantike dhe evropiane të rajonit nëpërmjet zgjerimit të NATO-s dhe zgjerimit të BE-së, zgjidhja paqësore e

problematikave të bartura ndërshtetërore, përballimi efektiv i ndërhyrjeve dëmprurëse, keqdashëse dhe influencuese të palëve të treta, pengimi aktiv i përhapjes së mundshme të destabilizimit, si rrjedhojë e përkeqësimit të situatës së sigurisë evropiane, shndërrimi i rajonit në një treg të integruar nëpërmjet heqjes së barrierave dhe ndërtimit të infrastrukturave të përbashkëta për lëvizjen e lirë të njerëzve, ideve, mallrave dhe kapitaleve, thellimi i bashkëpunimit ekonomik dhe energjetik me interes të ndërsjellë, si dhe mbrojtja e pakicave kombëtare.

Në nivelin kombëtar, interesat strategjike të Shqipërisë natyrisht përkojnë me interesat e saj kombëtarë. Ato burojnë nga vlerat themelore të përcaktuara në Kushtetutë, nga përkatësia e saj politike dhe nga sistemi i saj politik demokratik. Në suazën e tyre janë integriteti territorial dhe sovraniteti i Republikës së Shqipërisë, siguria dhe mirëqenia e qytetarëve, si parakushte themelore për ekzistencën e shtetit me të gjitha funksionet e tij dhe të një shoqërie të qëndrueshme. Me rëndësi strategjike për Shqipërinë janë edhe përsheptimi i procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, forcimi i mbrojtjes kibernetike, përf forcimi i dimensionit të qëndrueshmërisë, me theks të veçantë në forcimin e mëtejshëm të aftësive për të parandaluar përpjekjet për depërtim ekonomiko-financiar të fuqive të huaja jomiqësore, si dhe ndërhyrjet e tyre keqdashëse, forcimi i sigurisë së infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme, rritja e sigurisë energjetike, asaj ushqimore dhe asaj shëndetësore. Gjithashtu, në këtë suazë janë dhe lufta kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, menaxhimi i duhur i fatkeqësive natyrore, intensifikimi i luftës kundër krimit të organizuar, dhe korrupsionit, përf forcimi i sundimit demokratik të ligjit, krijimi i një klime të favorshme për tërheqjen e investimeve të huaja të sigurta, si dhe zhvillimi arsimor dhe kulturor i vendit. Po ashtu, me rëndësi të veçantë është edukimi kombëtar që në kohë paqeje me vlerat e demokracisë, tolerancës etnike dhe fetare, si dhe ato integruuese e multikulturale¹. Në suazën e interesave strategjike të Shqipërisë vendoset dhe

¹ Në përputhje edhe me parashikimet e Konventës së Hagës “Mbi mbrojtjen e vlerave kulturele në rast konflikti të armatosur”, si dhe në protokollin dhe rregulloren mbi zbatimin e kësaj konvente, adoptuar nga Konferenca e UNESCO-s në Hagë më 14 maj 1954.



kontributi aktiv për konsolidimin e pavarësisë së Kosovës dhe mbështetja e rrugëtimit të saj drejt integritetit evropian dhe euroatlantik, si dhe përfshirja e saj në nismat rajonale si A-5 etj.

3. MJEDISI STRATEGJIK

Analiza e mjedisit strategjik të sigurisë, e shtjelluar në nivel global, rajonal dhe kombëtar, shërben për të përcaktuar përgjigjet institucionale të Republikës së Shqipërisë ndaj kërcënimeve për sigurinë e saj kombëtare në të tri nivelet dhe në harkun kohor 2023–2028.

Që prej fillimit të agresionit të paprovokuar të Rusisë ndaj Ukrainës, mjedisi strategjik i sigurisë paraqitet më i përkeqësuar i prej fundit të Luftës së Ftohtë. Koncepti i ri Strategjik i NATO-s, i aprovuar në korrik të vitit 2022, përcakton se tashmë ndodhemi në një kohë kritike për sigurinë, paqen dhe stabilitetin ndërkombëtar dhe se agresioni i Federatës Ruse kundër Ukrainës ka ndikuar në mënyrë domethënëse në stabilitetin e paqes dhe sigurisë në rajon. Koncepti strategjik i NATO-s nënvizon, gjithashtu, se janë shkelur normat dhe parimet që kontribuuan në një rend të qëndrueshëm dhe të parashikueshëm të sigurisë evropiane dhe se në kushtet aktuale nuk mund të përjashtohet mundësia e një sulmi kundër sovranitetit dhe integritetit territorial të territorit aleat. Koncepti strategjik i NATO-s shprehet, gjithashtu, se konkurrenca strategjike, paqëndrueshmëria e përhapur dhe krizat e përsëritura përcaktojnë mjedisin aktual të sigurisë, ndërkohë që kërcënimet me të cilat përballemi, siç është kërcënimi i vazhdueshëm i terrorizmit, kanë natyrë globale, të ndërlidhur e të paparashikueshme.

Edhe Kompasi Strategjik i BE-së, i aprovuar në vitin 2022, nënvizon se zona e BE-së është e rrethuar nga paqëndrueshmëria dhe konfliktet dhe përballlet me luftë në kufijtë e saj. Kompasi shprehet po ashtu se gjendemi përballë një përzierjeje të rrezikshme të agresionit të armatosur, aneksimit të paligjshëm, shteteve të brishta, fuqive revizioniste dhe regjimeve autoritare dhe se ky mjedis strategjik është një terren pjellor për kërcënime të shumta ndaj sigurisë evropiane, si: terrorizmi, ekstremizmi i dhunshëm dhe krimi i organizuar, konfliktet hibride dhe sulmet kibernetike, instrumentalizimi i emigrimit të parregullt, përhapja e armëve dhe dobësimi progresiv i arkitekturës së kontrollit të armëve.

Kjo situatë evidenton faktin që, me gjithë tendencën e qartë pozitive të konsolidimit, siguria e vendit tonë, si vend anëtar i NATO-s dhe si vend kandidat i Bashkimit Evropian, është e ndërvarur nga siguria e territorit të Aleancës Atlantike dhe atij të BE-së, duke bërë që zhvillimet në situatën e sigurisë ndërkombëtare të kenë përparësi në krahasim me rreziqet me natyrë të brendshme. Situata aktuale në mjedisin e sigurisë ka krijuar kështu një akumulim sfidash dhe kërcënimesh me paparashikueshmëri të lartë.

Paralelisht me shtimin e rreziqeve të lartpërmendura, Republika e Shqipërisë ka intensifikuar përpjekjet e saj për të rritur qoftë aftësitë ndaj përballimit të kërcënimeve me burim të brendshëm, qoftë ndaj atyre me burim të jashtëm nëpërmjet një ndërveprimi gjithnjë e më intensiv në fushën e sigurisë me NATO-n, Bashkimin Evropian, partnerët strategjikë, si edhe me organizatat e tjera ndërkombëtare.

a) Niveli global

Agresioni ushtarak i Federatës Ruse ndaj Ukrainës dhe lufta frontale tashmë njëvjeçare në kufijtë e territorit të mbuluar nga prerogativat e Traktatit të Atlantikut të Veriut, kanë sjellë një përplasje të mprehtë gjeopolitike mes vendeve demokratike dhe atyre autoritare, duke vënë seriozisht në diskutim të gjithë arkitekturën e sigurisë të pas Luftës së Ftohtë në Evropë dhe më gjerë. Konflikti në Ukrainë ka sjellë, gjithashtu, më afër se kurrë mundësinë e një përplasjeje të armatosur konvencionale mes Federatës Ruse dhe NATO-s, si edhe rrezikun e përshkallëzimit të kësaj përplasjeje në një konflikt bërthamor. Gjithashtu, lufta në Ukrainë ka cenuar dimensionin energjetik në shkallë globale, ka shkaktuar tkurje të ndjeshme të ekonomisë globale, rritje të lartë të çmimeve të lëndëve të para, si edhe ka cenuar rëndë sigurinë ushqimore. Në të njëjtën kohë, në arenën globale janë theksuar edhe veprimet dhe qëndrimet jokonstruktive dhe armiqësore të fuqive autoritare, si: Kina, Irani dhe Koreja e Veriut, të cilat kanë zgjedhur të rreshtohen në krah të Rusisë, duke e mbështetur atë politikisht dhe në rastin e Iranit dhe Koresë së Veriut edhe me mjete ushtarake.

Rendi global i pas Luftës së Ftohtë dhe, veçanërisht arkitektura e tij e sigurisë po kërcënohet nga qasja më agresive e fuqive autoritare me synime hegjemoniste dhe antidemokratike dhe përpjekjet e tyre intensive diplomatike, ushtarake, shërbimeve të



inteligjencës dhe hibride, për të kushtëzuar vendimmarrjen ndërkombëtare, sipas interesave të tyre gjeostrategjikë. Këta aktorë do të vijnë në paraqesin sfida dhe kërcënime të rëndësishme tradicionale, jotradicionale, hibride dhe asimetrike në sferën politike, ushtarake dhe ekonomike.

Zhbërja e arkitekturës së kontrollit të armëve, si rrjedhojë e shkeljeve të njëanshme të detyrimeve ndërkombëtare dhe tërheqjes nga marrëveshjet ndërkombëtare të armë-kontrollit, të cilat kanë bërë të mundur ruajtjen e sigurisë evropiane për dekada, rrezikon përhapjen e pakontrolluar të armëve të dëmtimit në masë, si ato bërthamore, biologjike e kimike, duke rritur kërcënimin për përdorimin e tyre për synime gjeopolitike si nga aktorë shtetërorë, ashtu dhe joshetërorë, në një masë më të ulët.

Terrorizmi, në të gjitha format dhe manifestimet e tij, i përcaktuar në Konceptin Strategjik të NATO-s si kërcënim asimetrik më i drejtpërdrejtë për sigurinë e vendeve të NATO-s, mbetet një kërcënim konstant krahas gamës së kërcënimeve asimetrike dhe hibride. Lindja e grupeve të reja terroriste apo i fraksioneve ekstremiste nga grupe të njohura, më synime zgjerim territori nën kontroll, aftësia e tyre për të përshtatur strategjinë, organizatën dhe mënyrat e veprimit, për të shfrytëzuar zona e rajone me vakum sigurie, apo për të plotësuar hapësirat e lëna pas nga paqëndrueshmëritë politike dhe konfliktet, vijon të përbëjë kërcënim për sigurinë ndërkombëtare.

Teknologjitë në zhvillim dhe çorientuese po sjellin në skenën e sigurisë ndërkombëtare kërcënime të reja, veçanërisht ato që lidhen me hapësirën kibernetike, manipulimin e të dhënave, keqpërdorimin e inteligjencës artificiale dhe përdorimin e saj për motive ushtarake dhe të sigurisë. Zhvillimi i programeve të avancuara për teknologji të dëmshme dhe çorientuese në mungesë të plotë të transparencës, nga aktorë të caktuar me synime mbizotërimi gjeopolitik, motive radikalizimi, aktiviteti terrorist dhe financim të këtyre aktiviteteve, si dhe aktiviteteve të tjera të paligjshme, rrezikon të kthehen në kërcënime potenciale për sigurinë, duke nxjerrë në pah rëndësinë e sigurisë energjetike dhe asaj kibernetike.

Këtyre kërcënimeve i shtohen ndryshimi i kushteve klimatike, të cilat kanë potencial të sjellin implikime të reja social-ekonomike për sigurinë. Ato po shkaktojnë një efekt zinxhir, i cili shkon nga

ngrohja globale dhe degradimi i mjedisit të rivaliteti për burime, emigracioni në rritje, përhapja e sëmundjeve dhe pandemieve me impakt global në sigurinë shëndetësore dhe atë ushqimore nëpërmjet pakësimit të burimeve jetike, si uji i pijshëm dhe rritja e forcës shkatërruese të fatkeqësive natyrore, çka ka sjellë si pasojë lëvizjet e pakontrolluara të njerëzve, si drejt zonave urbane ashtu dhe në emigracion. Kështu, ndryshimet klimatike po marrin një rol më të rëndësishëm në ndryshimin e mjedisit global gjeopolitik, duke shkaktuar paqëndrueshmëri dhe fërkim më të madh politik brenda dhe ndërmjet vendeve e duke ndikuar në efektshmërinë e aktorëve shtetërorë dhe ndërkombëtarë për menaxhimin e fatkeqësive natyrore dhe krizave humanitare. Gjithashtu, ato mund të ndikojnë në rritjen e konkurrencës dhe kërcënimeve ekzistuese, si dhe në balancat gjeopolitike.

Situata globale e sigurisë ka sjellë dhe rritje të emigracionit të pakontrolluar, duke sfiduar kapacitetet e qeverive në mbarë botën për menaxhimin e flukseve të emigracionit, të cilat sa vijnë e bëhen më të paparashikueshme. Ky fenomen ka shkaktuar tensionime politike të mprehta në vendet pritëse duke rrezikuar që t'i fraksionojë potencialisht shoqëritë, duke krijuar edhe kushte për rritjen e nominalizmave dhe ksenofobisë, shtimin e radikalizimit politik dhe fetar, por edhe marginalizimit të grupimeve për shkak të etnisë, kombësisë, përkatësisë fetare. Për më tepër, këto flukse mund të shfrytëzohen nga grupet apo organizatat kriminale për trafikun njerëzor, por edhe nga organizatat terroriste për lëvizje operativësh me synime aktivitetet terroriste.

Përdorimi i energjisë dhe i ushqimit si armë dhe mjet presioni nga ana e Federatës Ruse ka sjellë çrregullimin e tregjeve dhe çmimeve globale të hidrokarbureve dhe drithërave, duke konsoliduar një realitet të ri strategjik në Evropë. Sabotimi i gazsjellësve Nord Stream 1 dhe 2 në ujërat ndërkombëtare të Detit Baltik e ka bërë NATO-n dhe vendet e saj anëtare që t'i kushtojnë një vëmendje të shtuar ruajtjes së infrastrukturës kritike energjike dhe nënujore në territorin e vendeve aleate. Kalimi i gazsjellësit TAP në territorin e vendit tonë dhe në detin Adriatik merr një rëndësi të shtuar strategjike në kontekstin aktual. Në të njëjtën kohë, situata aktuale energjetike ka shtuar përpjekjet e diversifikimit të burimeve energjetike,



ndërkohë që në BE, veçanërisht po punohet për kalimin në përdorimin e energjisë së gjelbër, e cila kërkon edhe një transformim rrënjësor industrial.

Ky kalim gradual nga energjia me karbon në një energji të pastër do të ketë ndikim edhe në sjelljen e vendeve që po e përdorin apo synojnë ta përdorin energjinë si armë apo mjet presioni, duke u pakësuar atyre avantazhet politike, si edhe do të sjellë ndryshime në marrëdhëniet gjeopolitike rajonale dhe globale.

b) Niveli rajonal

Koncepti Strategjik i NATO-s thekson se vendet e Ballkanit Perëndimor përballen me kërcënime dhe sfida, mes të cilave ndërhyrjet dëmprurëse dhe keqdashëse të palëve të treta. Po ashtu, Kompasi Strategjik i BE-se thekson se siguria dhe stabiliteti në Ballkanin Perëndimor nuk janë ende të garantuara, edhe për shkak të rritjes së ndërhyrjeve të huaja, përfshirë fushatat e manipulimit të informacionit, si dhe për shkak të përhapjes së mundshme të destabilizimit nga përkeqësimi aktual i situatës së sigurisë evropiane.

Vendet e rajonit kanë bërë progres të dukshëm në drejtim të demokratizimit, zhvillimit ekonomik dhe bashkëjetesës paqësore. Marrëdhëniet midis vendeve të rajonit janë përmirësuar dhe bashkëpunimi ka njohur rritje cilësore dhe sasiore. Konsolidimi dhe institucionalizimi i perspektivës euroatlantike dhe evropiane, zgjerimi i NATO-s apo zgjerimi i pritshëm i BE-së në Ballkanin Perëndimor, kanë sjellë ndryshime rrënjësore pozitive në rajon, duke shërbyer si katalizatorë të reformave demokratike, të bashkëpunimit, të fqinjësisë së mirë dhe të procesit të pajtimit. Tashmë, rajoni në pjesën më të madhe të tij, krahasuar me vite më parë, ka vullnet gjithnjë në rritje, dhe tashmë synon të jetë në gjendje të prodhojë stabilitet të brendshëm rajonal, por edhe të kontribuojë për sigurinë e paqen edhe në hapësira gjeopolitike përtej tij. Në bashkëpunimin dypalësh dhe rajonal mbizotëron prirja drejt heqjes së barrierave përmes ndërtimit të infrastrukturave të përbashkëta për lëvizjen e lirë të njerëzve, ideve, mallrave dhe kapitaleve, duke synuar shndërrimin e rajonit në një treg të integruar, tërheqës dhe konkurrues për investimet e huaja. Vendet e rajonit kanë forcuar institucionet dhe mekanizmat e kundërvënies ndaj terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, uljes së ndikimit të proceseve radikalizuese, aktiviteteve të tjera të paligjshme, si

krimi i organizuar dhe bashkëpunimi mes tyre është thelluar dhe ka dhënë efekte pozitive në rritjen e kundërvënies.

Paralelisht, rajoni përballlet me synimet e aktorëve globalë dhe mbështetës të tyre rajonalë, të cilët përpiqen të lëvizin nga shinat orientimin euroatlantik të vendeve të rajonit, nëpërmjet mjeteve diplomatike, aktiviteteve të inteligjencës edhe atyre influencuese keqdashëse. Aktorë të huaj synojnë të shfrytëzojnë çështjet ndëretnike, të cilat synojnë të influencojnë zhvillimet e brendshme politike, të nxisin nacionalizma e ekstremizma, si edhe të amplifikojnë problematikat ekzistuese për synime dhe avantazhe gjeopolitike dhe gjeoekonomike. Po ashtu, rajoni vijon të përballlet me një sërë kërcënimesh të përbashkëta, siç janë ekzistenca e krimit të organizuar me lidhje rajonale e më gjerë, influenca të jashtme dhe faktorë të brendshëm që mundësojnë radikalizmin dhe tendenca të ekstremizmit të dhunshëm, cenim të marrëdhënieve ndëretnike, nivel i lartë korrupsioni, krim ekonomik i favorizuar edhe nga shkalla e informalitetit, situatë problematike ekonomike dhe sociale, tranzicion i zgjatur dhe kulturë demokratike e pakonsoliduar, problematika të bartura ndërshtetërore dhe retorikë nacionaliste e shtuar.

Pavarësisht vullneteve qeverisëse për të avancuar me proceset integruese, reformave në përmbushje të kriterëve, në situata të caktuara më rëndësi për vendimmarrjen për avancimin e proceseve integruese, ka përpjekje për shfrytëzim të problematikave të bartura historike, për t'i kushtëzuar, e për pasojë për t'i vonuar ato.

Rajoni vijon të mbetet një rrugë tranziti për krimin e organizuar me lidhje rajonale e ndërkombëtare dhe trafiqet e tij. Grupet kriminale nën ndikim të atyre ndërkombëtare kanë sofistikuar mënyrat e operimit, rritur kapacitetet financiare të gjeneruara nga aktiviteti kriminal. Në sofistikimin e mënyrave të operimit përfshihet edhe zhvendosja e veprimtarisë së grupeve kriminale në hapësirën kibernetike duke e shfrytëzuar për lehtësimin e koordinimit të operacioneve të tyre përmes komunikimeve digjitale, si dhe për rritjen e kapaciteteve financiare përmes krimit kibernetik.

Në vendet e rajonit nuk ka pasur akte terroriste, planet dhe synimet janë neutralizuar në kohë nga autoritetet ligjzbatuese, janë përforcuar masat kundër terrorizmit, zbatuar strategji efektive, reforma ligjore në luftën kundër terrorizmit dhe



forcuar bashkëpunimin rajonal e ndërkombëtar. Gjithsesi, një numër i lartë të kthyerve, individë e mbështetës të radikalizuar nga ideologjia e organizatave terroriste, propaganda *online* për aktivitete indoktrinuese e radikalizuese, influencat e huaja për radikalizim të komuniteteve drejt linjave fundamentaliste e radikale, përbëjnë kërcënim afatgjatë për sigurinë.

Rajoni është një nyjë e rëndësishme e linjës ballkanike të emigracionit të jashtëligjshëm, i cili synon vendet e Evropës, duke bërë që edhe grupet që merren me trafikimin e qenieve njerëzore të shtojnë aktivitetin e tyre në rajon. Mundësia e shfrytëzimit nga organizatat terroriste për të infiltruar operativë terroristë nuk është e përjashtuar dhe përbën kërcënim për sigurinë.

Vendet e rajonit kanë problematika të përbashkëta, ku nevoja për garantimin e sigurisë energjetike mbetet prioritet. Teknologjia e vjetërsuar, ndërvarësia, nevoja për diversifikim të burimeve, janë sfidat reale për garantimin e furnizimit me energji të sektorëve të ekonomisë. Gjithashtu, teknologjia e vjetërsuar dhe mungesa e investimeve për modernizimin e teknologjisë e bën këtë sektor më të cenueshëm edhe nga sulmet kibernetike potenciale. Diversifikimi i burimeve energjetike dhe minimizimi i varësisë nga importet, mbetet një nga prioritetet. Vendet e rajonit janë rruga e transportit të naftës dhe të gazsjellësve për në vendet perëndimore. Si konsumatorë, por edhe si pjesë e korridoreve të tranzitit, projektet energjetike rrisin bashkëveprimin e vendeve ballkanike, ndërkohë që mbartin edhe sfida të sigurisë kibernetike.

c) Niveli kombëtar

Në situatën aktuale të sigurisë ndërkombëtare, vendi ynë mbetet një aktor i rëndësishëm dhe i angazhuar në funksion të ruajtjes së paqes dhe të stabilitetit rajonal. Mjedisi i brendshëm i sigurisë i vendit tonë është i qëndrueshëm, pa rreziqe imediate që të çojnë në cenim të integritetit territorial të vendit apo cenim të rendit kushtetues.

Si vend me orientim të qartë gjeostrategjik perëndimor, vend anëtar i NATO-s dhe vend kandidat në BE, me kontribute pozitive në vendimmarrjet ndërkombëtare për çështje të sigurisë ndërkombëtare, paqes dhe stabilitetit, RSH-ja mbetet një vend me interes për aktorët globalë kundërshtarë të këtyre proceseve. Aktiviteti i tyre pritet të intensifikohet në kuadër të rritjes së

konfrontimit dhe qasjes agresive të shteteve kundërshtarë me synime gjeostrategjike në cenim të arkitekturës aktuale të sigurisë ndërkombëtare dhe asaj evropiane, por edhe qëndrimit dhe rolit aktiv dhe të qartë të Shqipërisë në koordinim me këta organizma. Ky aktivitet synon të ndikojë negativisht te sistemi ynë politik, të influencojë politikisht dhe ekonomikisht në vendimmarrjet e rëndësishme strategjike, të nxisë destabilitet, të ndikojë perceptimin publik sipas interesave të tyre, rrisë skepticizmin dhe pengojë përpjekjet e vendit në raport me proceset eurointegruese.

Informacioni i klasifikuar dhe sistemet e komunikimit të sigurt janë të ekspozuara ndaj rreziqeve dhe kërcënimeve të sigurisë nga aktorë të ndryshëm shtetërorë dhe joshetërorë. Veprimtaria e shërbimeve inteligjente të vendeve jo mike synon aksesin tek informacioni i klasifikuar “sekret shtetëror”, i NATO-s, BE-së dhe i shteteve të tjera me të cilat Republika e Shqipërisë ka nënshkruar Marrëveshje Sigurie, me qëllim cenimin e sigurisë kombëtare dhe dëmtimin e marrëdhënieve me aleatët.

Aktivitetet influencuese keqdashëse do të vijojnë me të gjitha format edhe nëpërmjet aktorëve të tretë për të formësuar mjedisin informativ, sipas interesave të tyre, pa përjashtuar përpjekje për ndërhyrje e influencim në proceset demokratike, mjet i përdorur tashmë në vendet e Bashkimit Evropian e më gjerë, për të cilën parlamenti i RSH-së ka miratuar edhe një rezolutë kundër ndërhyrjeve në proceset demokratike.

Sulmet kibernetike në shkallë të gjerë ndaj infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit nga aktorë keqdashës kibernetikë të sponsorizuar nga aktorë shtetërorë, si ato të vitit të kaluar me origjinë nga Irani, dëshmojnë se siguria kibernetike duhet të marrë përparësi, në kuadër edhe të zhvillimit të digjitalizimit të shërbimeve publike për qytetarët. Infrastrukturat ekzistuese kritike të informacionit dhe projektet në evoluim, përveç progresit pozitiv për garantimin cilësor të shërbimeve dhe reduktimin e hapësirave për korrupsion, mbeten terren i kërcënimit për sulme kibernetike nga aktorë shtetërorë e joshetërorë për llogari të tyre, të cilët kanë jo vetëm synimet, por edhe kapacitetet për t'i realizuar ato.

Aktorë shtetërorë ose jo me qëllime armiqësore mund të ndërmarrin sulme kibernetike, me synim dëmtimin, nxjerrjen jashtë funksionit, ndërprerjen e



shërbimeve për qytetarët, krijimin e kaosit dhe të panikut, për synime politike ose përfitime financiare. Kapacitetet kibernetike kërcënuese përdoren nga shtetet dhe shërbimet e inteligjencës kundërshtare si mjet i aktivitetit të tyre në momente të caktuara zhvillimesh të rëndësishme ndërkombëtare për të arritur interesat e tyre gjeopolitike. Sulmet kibernetike mund të përdoren edhe për motive spiunazhi kibernetik², për operacione informative, për arritjen e aksesit të synuar të paautorizuar, pasi kjo mundëson arritjen në kohë më të shkurtër të objektivave dhe mundësi më të ulëta për ekspozim dhe identifikim.

Siguria e infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme merr përparësi në kushtet e kërcënimeve kibernetike në rritje, por edhe për shkak se problematikat që lidhen me amortizimin e pajisjeve janë dobësi të cilat mund të shfrytëzohen nga terrorizmi dhe krimi i organizuar, duke amplifikuar dhe kërcënimet e tjera që lidhen me sigurinë e vendit.

Siguria energjetike tashmë nuk është vetëm një kërcënim global, por merr rëndësi parësore edhe në kërcënimet ndaj sigurisë kombëtare të RSH-së, që lidhet me disponueshmërinë e burimeve, pakësimin e burimeve hidrike, për shkak edhe të kushteve klimaterike, amortizimin e kapaciteteve ekzistuese, rritjen e nevojave të popullsisë për konsum. Për më tepër, çrregullimi i tregjeve globale, për shkak nevojës për tregje alternative për të ulur dhe evituar varësinë nga shtetet kundërshtare që përdorin edhe energjinë për motive presioni gjeopolitik do të ndikojnë në sigurinë energjetike. Në këto kushte, merr përparësi menaxhimi me efikasitet i infrastrukturës ekzistuese, rritja e masave mbrojtëse të sigurisë së kësaj infrastrukture nga sulme të mundshme kibernetike, të cilat mund të jenë akte sabotazhi me kapacitet për ta çuar vendin në krizë.

Aktivitetet influencuese keqdashëse, lajmet e rreme, dezinformimi, teoritë konspirative me qëllime influencuese kanë njohur rritje, me impakt në perceptimin publik ndaj efektivitetit të funksionimit të sistemit demokratik dhe sigurinë në tërësi. Realitetet ndërkombëtare dëshmojnë se kjo formë grumbullimi e shpërndarje informacioni/

dezinformacioni po ndikon në ekonomitë, kohezionin social, marrëdhëniet politike, proceset demokratike dhe sigurinë. Ndërveprueshmëria e shpejtë, audienca e gjerë ka bërë që ky mjet të përdoret me tendenca rritjeje dhe po sfidon besueshmërinë në informacionin e vërtetë, atë shkencor dhe efektshmërinë e qeverisjeve, krijojnë panik e kaos me impakt në sigurinë kombëtare.

Degradimi i mjedisit do të vijojë të përbëjë një kërcënim në rritje në raport me pamundësinë e parashikueshmërisë, impaktit njerëzor dhe ekonomik. Tërmetet, përmbytjet, zjarret masive, rrëshqitjet masive kanë dëshmuar tashmë për nga dimensionin kërcënimin në rritje dhe impaktin e ndjeshëm në sigurinë njerëzore dhe atë ekonomike dhe kanë sfiduar kapacitetet ekzistuese për menaxhimin e tyre. Dukuria globale e ndryshimit të klimës ndikon negativisht në ekuilibrat natyrorë të Shqipërisë. Si pasojë, vendi mund të përballet me temperatura të larta që kanë një ndikim domethënës në florën dhe faunën e ambientit tokësor dhe ujor, thatësira të zgjatura dhe përmbytje të mëdha me një rrezik të shtuar për digat dhe hidrovolet, me kosto të konsiderueshme për dimensionin njerëzor dhe ekonominë kombëtare. Republika e Shqipërisë është e prekur dhe rrezikohet nga erozioni kryesisht në ultësirën perëndimore, luginat e lumenjve të mëdhenj dhe bregdeti i Adriatikut, ku vija bazë e detit po përparon gjithnjë e më shumë. Gjithashtu, krimi mjedisor ndikon në degradimin e mëtejshëm të mjedisit, i cili sjell pasojë afatgjatë në territor, peizazhin urban, shëndetësi, bujqësi, blegtori, peshkim, si edhe në ekonominë e vendit në përgjithësi.

Shpërthimet pandemike dhe epidemike me natyrë mikrobiologjike, nga uji i pijshëm apo dhe nga lëndë të ndryshme kimike përbëjnë rrezik të lartë për sigurinë kombëtare. Pandemia SARS COV 2 gjatë 2020–2022 e vijim, H5N8 gjatë 2020–2021 në shpendë, janë ndër shpërthimet e fundit epidemike të cilat kanë prekur vendin tonë. Pandemia e shkaktuar nga COVID-19, dëshmoi dimensionin e impaktit në sigurinë shëndetësore, ekonomike. Sfidoi ndjeshëm infrastrukturën shëndetësore ekzistuese, dobësoi perceptimin publik në efektshmërinë e menaxhimit nga qeveritë, shkaktoi stres ekonomik, ankth te konsumatori dhe investitorët, rritje të papunësisë e për rrjedhojë të problematikave sociale. Ndikimi në

² Një akt i ndërmarrë në mënyrë të fshehtë ose nën pretendime false, që përdor kapacitete kibernetike për të grumbulluar informacion, me synimin e komunikimit dhe transmetimit të tyre një pale kundërshtare.



ekonomi i shtoi një dimension të ri edhe konkurrencës midis regjimeve autoritare dhe atyre demokratike. Pandemia COVID-19 dëshmoi se si një situatë me vëmendje kaq të madhe publike e ndërkombëtare mund të përdoret nga aktorët kundërshtarë për motive gjeopolitike.

Sipas vlerësimit strategjik të riskut të vitit 2019, janë vlerësuar me risk shumë të lartë dhe të lartë 7 fatkeqësi të mundshme: antibiotiko rezistenca, bllokimet nga dëbora dhe ortehtët, tërmetet, gripi sezonal, përmytjet dhe ndotja e ajrit dhe sëmundjet me burim ushqimor dhe ujë, gjithashtu me risk të moderuar janë edhe zjarret masive, meningokoku invaziv, etet hemorragjike, CCHF, gripi pandemik, SARS, gripi i shpendëve, TB dhe fruthi. Mbrojtja e popullatës nga efektet shëndetësore të pandemive dhe sëmundjeve infektive emergjente, si dhe kërcënimeve kimike, biologjike, radiologjike dhe bërthamore duhet, gjithashtu, të konsiderohet prioritet.

Terrorizmi dhe radikalizimi drejt ekstremizmit të dhunshëm, financimi i këtyre aktiviteteve, për shkak të influencave të jashtme dhe aktorëve dhe faktorëve të brendshëm e rajonalë do të vijojë të përbëjë rrezik për kohezionin dhe vlerat e shoqërisë shqiptare, si dhe për harmoninë e bashkëjetesës tradicionale mes besimeve fetare në vend. Edhe pse në vendin tonë nuk ka pasur akte terroriste, ato nuk janë të përjashtuara për shkak të nxitjes e koordinimit nga organizata terroriste, prezencës së LHT-së nga vendi dhe rajoni ende të rreshtuar pranë këtyre organizatave, por edhe mbështetësve të tyre, të cilët të indoktrinuar nga propaganda *online* mund të veprojnë si aktorë të vetmuar. Influenca e jashtme të linjave ekstremiste fetare vijojnë të influencojnë proceset radikalizuese në vend me synim futjen e virusit të ekstremizmit në komunitetet e paqta fetare në vend, cenimin e harmonisë dhe bashkëjetesës mes besimeve fetare.

Krimi i organizuar ende mbetet fenomen kompleks e dinamik, edhe pse është rritur ndjeshëm forca goditëse, janë forcuar kapacitetet kundërvënëse. Grupet/individët e përfshirë në krimin e organizuar, kryesisht në trafikun, prodhimin e lëndëve narkotike, pavarësisht goditjeve domethënëse të aktivitetit të tyre kriminal, pasurive dhe të ardhurave nga ky aktivitet, kanë treguar aftësi në adaptimin e mënyrave të veprimit në raport me kundërvënien. Të ardhurat e

aktiviteteve kriminale të siguruara ndër vite nga shkalla e informalitetit, pandëshkueshmëria apo ndëshkueshmëria e ulët, favorizuar nga korrupsioni në sistemin e drejtësisë, ka sjellë injektimin në ekonominë formale dhe informale të parave të gjeneruara nga aktiviteti kriminal, zhvendosjen e elementëve të spikatur të grupeve kriminale në vendet e Evropës, por edhe të prodhimit e origjinës së lëndëve narkotike. Gjithashtu, përdorimi i teknologjive të informacionet nga rrjetet kriminale, si dhe zhvendosja e aktiviteteve të tyre në hapësirën kibernetike e vështirëson mundësinë e gjurmimit të tyre për t'i vënë para drejtësisë, duke ndikuar për rrjedhojë në rritjen e pandëshkueshmërisë së tyre. Këta elementë të integruar tashmë në rrjete ndërkombëtare të krimit të organizuar vijojnë të nxisin e koordinojnë aktivitetin kriminal të grupeve dhe anëtarëve të tyre brenda vendit.

Siguria ekonomike lidhet kryesisht me pasojat e tërmetit dhe pandemisë, të cilat ndikuan në buxhetin e shtetit dedikuar për rritjen ekonomike. Siguria ekonomike mund të cenohet edhe nga përpjekjet e aktorëve globalë për të depërtuar në ekonomi për objektiva gjeoekonomikë e me synime për ta përdorur ekonominë si mjet presioni politik. Krimet në ekonomi, gjithashtu, pavarësisht reformave konkrete për uljen e informalitetit, rritjes së forcës goditëse të agjencive ligjzbatuese në luftën kundër këtyre fenomeneve, vijojnë të jenë prezente e me impakt për ekonominë e vendit dhe rritjen e qëndrueshme të saj, forcimin e institucioneve shtetërore dhe sundimin e ligjit. Mbeten faktor me rrezikshmëri për rritjen e qëndrueshme ekonomike, besueshmërinë dhe stabilitetin e sistemit financiar, ekonomik në vend. Krimet në ekonomi janë sofistikuar nga teknologjitë e reja financiare dhe përbëjnë shqetësim për shkak të ndikimit në ekonomi. Pastrimi i parave dhe i produktit kriminal është problematikë prezente e me tendencë të larta impakti për ekonominë e vendit dhe sundimin e ligjit.

Korrupsioni dhe perceptimi mbi nivelin e tij minon besimin e publikut te qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit, cenon zhvillimin e vendit, forcimin e institucioneve, rritjen e qëndrueshme ekonomike, si dhe mbetet faktor që ngadalëson dhe dëmton procesin e reformave, si dhe dekurajon investimet e brendshme e të huaja, të nevojshme për të krijuar mundësi punësimi për të gjithë.



Siguria publike mbetet e cenuar nga aktiviteti me natyrë kriminale, me përdorim të eksplozivëve, vrasësve me pagesë të drejtuara ndaj personit, kryesisht për motive të konflikteve personale, të interesave financiarë, konflikteve pronësore, të trafikëve të paligjshme dhe rivalitetit mes grupeve kriminale.

Problemet social-ekonomike janë faktori kryesor që nxit emigrimin e parregullt të shtetasve shqiptarë, numri i të cilëve ka njohur rritje. Lëvizja e lirë, gjithashtu, mundësitë që ofron tregu global, ka sjellë rritje të largimeve të shtetasve shqiptarë nga vendi, mes tyre një numër nga profesionet jetike dhe gjeneratat e arsimuara në vend.

Siguria ushqimore si element mjaft i rëndësishëm i sigurisë njerëzore, me ndikim në shëndetin e popullatës, merr një rëndësi të veçantë në kushtet e krizës ekonomike, kushteve klimaterike në ndryshim dhe pandemive. Etja për përfitime të shpejta financiare, moszbatimi i standardeve ka ndikuar në raste të cenimit të saj.

Emigracioni i jashtëligjshëm nëpër territorin e vendit tonë lidhet me rrugën ballkanike, e cila vijon të mbetet një linjë e rëndësishme që shkon drejt Europës dhe vendi ynë mbetet vend tranziti për kalimin e emigrantëve të paligjshëm. Vendi ynë nuk përjashtohet nga ndikimi i fluksit të emigracionit nga vendet e konfliktit, si një nyjë tranziti në linjën ballkanike.

Emigrimi i shtetasve shqiptarë me të cilin përballlet vendi ynë ka njohur rritje. Lëvizja e lirë dhe mundësitë që ofron tregu global, si edhe disa faktorë të tjerë kanë sjellë rritjen e numrit të shtetasve shqiptarë, të cilët largohen nga vendi, përshtirë ata nga profesionet jetike dhe shtresat e arsimuara. Problemet social-ekonomike mbeten faktori kryesor që nxit emigrimin e parregullt të shtetasve shqiptarë, numri i të cilëve ka njohur rritje, ndërkohë që kërkesat e tregut të punës vendës kanë nxitur dukurinë e re të plotësimit të nevojave me fuqi punëtore nga vende të treta. Një problem tjetër është edhe migrimi nga zonat rurale drejt zonave urbane, i cili ul forcën e punës dhe kapacitetet prodhuese, duke kthyer fermerët nga prodhues në konsumatorë të produkteve agroblegtorale, duke cenuar në këtë mënyrë garantimin e furnizimit me produkte ushqimore të popullatës dhe krijuar një varësi të shtuar nga importet e këtyre produkteve.

Rreziku i një agresioni ushtarak ndaj territorit të Shqipërisë konsiderohet i ulët, por situata aktuale e sigurisë ndërkombëtare në kufijtë e Aleancës Atlantike ka rritur mundësinë që një sulm ushtarak ndaj njërit prej vendeve aleatë të NATO-s ose ndaj vetë territorit të Shqipërisë, si dhe detyrimet që burojnë nga zbatimi i nenit 5 të Traktatit të Atlantikut të Veriut, ta përfshijnë Shqipërinë në një konflikt konvencional, i cili mund të përshkallëzohet nëpërmjet përdorimit të armëve të shkatërrimit në masë. Shqipëria nuk mbështet dhe as synon përdorimin e forcës ushtarake për motive agresioni ndaj një vendi tjetër.

4. ROLI NË RRTITJE I POLITIKËS SË JASHTME

Politika e jashtme e Republikës së Shqipërisë është një nga instrumentet më të rëndësishme të sigurisë së saj kombëtare. Mbrojtja e interesave kombëtarë kryhet vetëm me mjete diplomatike e angazhim konstruktiv demokratik, në respekt e zbatim të legjislationit ndërkombëtar dhe larg retorikave nxitëse e cenuese të bashkëjetesës demokratike të faktorit shqiptar në vendet e rajonit.

Në situatën aktuale të sigurisë ndërkombëtare, politika e jashtme e RSH-së synon të jetë edhe më aktive në përfaqësimin, mbrojtjen dhe promovimin e interesave kombëtarë, në forcimin e pozitës dhe rolit rajonal dhe ndërkombëtar të Shqipërisë, duke promovuar në të njëjtën kohë vlerat e paqes, demokracisë dhe të integritetit euroatlantik. Kjo politikë karakterizohet nga vijueshmëria dhe qëndrueshmëria e prioriteteve të saj. Mbrojtja e interesave kombëtarë dhe harmonizimi i tyre me ata të partnerëve kryesorë strategjikë të vendit, si: SHBA-të, Bashkimi Evropian etj., do të vijnë të përbëjë boshtin kryesor të veprimeve diplomatike, ku ruajtja e koherencës mes vendimeve politike dhe mbështetjes me bazë të gjerë nga opinioni publik përbën një element të domosdoshëm.

Sistemi ndërkombëtar në të cilin Republika e Shqipërisë synon të ndjekë interesat e saj bazohet në parimet e Kartës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Aktit Final të Helsinkit dhe në parimin e zgjidhjes paqësore të mosmarrëveshjeve dhe konflikteve mes shteteve. Përdorimi i forcës, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe në shërbim të rivendosjes së



paqes, stabilitetit, drejtësisë, dinjitetit njerëzor dhe të mirës së përbashkët, konsiderohet nga Shqipëria vetëm si një zgjedhje e fundit, kur janë shteruar të gjitha mjetet e tjera.

Duke pasur parasysh ndërvarësinë në rritje të shumë çështjeve që lidhen me sigurinë dhe interesat tanë kombëtarë, vendi ynë do të vijojë të jetë akoma më aktiv në fushën e diplomacisë shumëpalëshe, veçanërisht në organizatat ndërkombëtare apo rajonale, të cilat trajtojnë çështjet e sigurisë, në përputhje me sa ka dëshmuar gjatë viteve të fundit.

Republika e Shqipërisë për të parën herë kryesoi me sukses përgjatë vitit 2020 OSBE-në, ku arriti rezultate të prekshme dhe të vlerësuara edhe në fushën e sigurisë dhe të bashkëpunimit të organizatës. Ky sukses është duke vijuar edhe gjatë anëtarësimit jo të përhershëm në Këshillin e Sigurimit për periudhën 2022–2023, ku Shqipëria është shfaqur si një kontribuese serioze për paqen dhe stabilitetin ndërkombëtar.

Si anëtare e zgjedhur e Këshillit të Sigurimit të OKB-së për periudhën 2022–2023 për të parën herë Shqipëria është një mbështetëse aktive dhe e vendosur e Ukrainës. Si bashkëpunëmbajtëse me SHBA-të për Ukrainën dhe në bashkëpunim e koordinim të ngushtë me vendet e tjera perëndimore, Shqipëria ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në ngritjen e çështjes së llogaridhënies dhe krijimit të grupit të miqve për llogaridhënien në Ukrainë, si dhe për miratimin e disa rezolutave të rëndësishme mbi konfliktin aktual në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së.

Si një vend anëtar me vlera në NATO, vend kandidat në BE, anëtar i ECOSOC-së më herët, po ashtu i KDNJ-së, i UNDP/UNOPS/UNFPA, në Bordin Ekzekutiv të UNESCO-s, me angazhime konkrete në forcat paqeruajtëse ndërkombëtare, por edhe në mbrojtjen e klimës, në Agjendën 2030 të Zhvillimit të Qëndrueshëm etj., Shqipëria jo vetëm demonstroi vullnet politik për të pasur një botë të paqte e të sigurt, por kontribuon po ashtu edhe konkretisht me resurset e saj në këtë drejtim.

Bazuar në orientimin politik të saj të bashkëpunimit shumëpalësh, duke e konsideruar multilateralizmin si një instrument të rëndësishëm në dobi të ruajtjes dhe forcimit të paqes në botë, Republika e Shqipërisë do të vijojë të jetë kontribuese aktive në kuadër të veprimtarisë së OKB-së dhe agjencive të saj, si dhe organizatave të tjera ndërkombëtare e rajonale.

Në situatën aktuale të sigurisë ndërkombëtare, e cila ka bërë që NATO-ja ta kthejë fokusin e saj nga menaxhimi i krizave dhe operacionet jashtë zonës në mbrojtjen territoriale, Shqipëria e konsideron Aleancën Atlantike si gurin e themelit të sigurisë së përbashkët të vendeve anëtare, ndaj e sheh sigurinë e saj pazgjidhshmërisht të lidhur me sigurinë e territorit që mbulojnë prerogativat e Traktatit të Atlantikut të Veriut. Republika e Shqipërisë është pjesë aktive e vullnetit të palëkundur të NATO-s për të siguruar dhe mbrojtur çdo pëllëmbë të territorit aleat, duke kontribuar ushtarakisht në përf forcimin më të madh të NATO-s në lindje të territorit aleat që nga Lufta e Ftohtë. Në funksion të këtij misioni, Republika e Shqipërisë i ka dhënë përparësi rritjes në nivel kombëtar të buxhetit të mbrojtjes, duke kontribuar aktivisht në unitetin e Aleancës dhe në rëndësinë thelbësore të lidhjes Transatlantike, në mënyrë që NATO-ja të mbetet kolonë stabiliteti për gjeneratat e ardhshme.

Shqipëria mbështet gjithashtu përqasjen e NATO-s për një rol prej 360 gradësh në mbrojtjen dhe sigurinë e vendeve aleate, përfshirë rolin e intensifikuar të NATO-s në luftën kundër terrorizmit, si edhe forcimin e stabilitetit në dhe përreth zonës euroatlantike.

Shqipëria e ka plotësisht të qartë se gama e re e kërcënimeve nuk mund të përballohet vetëm me mjete ushtarake, prandaj në cilësinë e saj të dyfishtë, si vend anëtar i NATO-s dhe si vend kandidat në Bashkimin Evropian, favorizon intensifikimin e bashkëpunimit strategjik NATO-BE për përballimin e tyre. Një Bashkim Evropian më i fortë dhe më i aftë në siguri dhe mbrojtje, do të kontribuojë pozitivisht në sigurinë globale dhe transatlantike, duke qenë njëkohësisht plotësues i NATO-s, e cila mbetet themeli i mbrojtjes kolektive për anëtarët e saj.

Veçanërisht i rëndësishëm për Shqipërinë është bashkëpunimi midis NATO-s dhe BE-së lidhur me sigurinë në rajonin tonë, i cilësuar me rëndësi strategjike, si nga NATO-ja, ashtu edhe nga BE-ja, ku ky bashkëpunim materializohet në përpjekje të përbashkëta në mbështetje të paqes dhe stabilitetit në pjesë të ndryshme të tij, si në Kosovë dhe në Bosnjë dhe në Hercegovinë.

Anëtarësimi në Bashkimin Evropian është zgjedhja strategjike dhe objektivi më i rëndësishëm gjeostrategjik dhe politik i Republikës së Shqipërisë, i cili qëndron në thelb të politikës së brendshme



dhe të jashtme të saj. Standardet e Bashkimit Evropian dhe vlerat universale të promovuara prej tij përputhen plotësisht me aspiratat dhe idealet e popullit shqiptar. Dinjiteti njerëzor, liria, demokracia, sundimi i ligjit, respektimi i të drejtave të njeriut, përfshirë edhe pakicat kombëtare, janë vlera themelore evropiane që i përqafon, respekton dhe mbron edhe Republika e Shqipërisë. Këto parime janë themelet e një rendi politik e shoqëror të bazuar në rregulla, i cili sjell paqen sociale, respektimin e institucioneve demokratike dhe sundimin e ligjit. Prandaj, përparimi i preکشëm në sundimin e ligjit dhe reformat e bazuara në vlerat, rregullat dhe standardet evropiane janë thelbësore për Republikën e Shqipërisë në rrugën e saj drejt avancimit drejt BE-së dhe kushte *si ne qua non* për sigurinë individuale dhe për barazinë e secilit para ligjit.

Integrimi evropian i vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE mbetet një investim në paqe, stabilitet dhe prosperitet, me përfitime të ndërsjella. Ankori i përfundimtar i Ballkanit Perëndimor në familjen e vlerave që përfaqëson BE-ja është investimi më i mirë strategjik në të ardhmen e përbashkët. Rikthimi i luftës në Evropë, me agresionin e pajustificuar dhe të paprovokuar të Rusisë kundër Ukrainës, si dhe ndryshimet dhe sfidat e mëdha gjeopolitike, kanë vënë nën presion vizionin e përbashkët evropian dhe interesat jetikë të sigurisë dhe stabilitetit në një hapësirë më të gjerë evropiane. Siguria dhe stabiliteti në Ballkanin Perëndimor janë ende të brishta, edhe për shkak të rritjes së kërcënimeve të reja hibride dhe ndërhyrjeve të huaja, përfshirë fushatat e manipulimit të informacionit, si dhe të nevojës për një paketë më të plotë dhe bashkëkohore angazhimi të BE-së për partnerët në Ballkanin Perëndimor. Prandaj, përsheptimi dhe rienergizimi i procesit të zgjerimit është më urgjent se kurrë për një rol më të konsoliduar të BE-së në rajon, në raport edhe me interesa të tjerë, përfshirë ata sigurisë dhe të paqes.

Për të përballuar këto tendenca të rrezikshme, Republika e Shqipërisë mbështet rritjen e kapaciteteve autonome të sigurisë së BE-së. RSH-ja do të rrisë dialogun për sigurinë me partnerët euroatlantike dhe kapacitetin e saj për të kundërvepruar në solidaritet me ta, do të vijojë linjëzimin 100% të politikës së saj të jashtme me politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë së

BE-së, si edhe do të vijojë të kontribuojë në misionet civile dhe ushtarake të BE-së, duke e bërë Republikën e Shqipërisë jo vetëm përfituese, por edhe kontribuese të sigurisë.

Në planin dypalësh, politika e jashtme e Republikës së Shqipërisë reflekton synimin për forcimin e marrëdhënieve dypalëshe me interes të ndërsjellë me vendet e NATO-s, ato të BE-së, vendet fqinje, si dhe vendet e tjera demokratike në mbarë botën. Në thelb të marrëdhënieve dypalëshe mbetet fuqizimi dhe thellimi i marrëdhënieve dhe partneritetit me partnerët strategjikë dhe vendet aleate në Amerikën e Veriut dhe në Evropë, me të cilët Shqipëria përafron politikën e saj të jashtme dhe të sigurisë, duke qenë partnere e besueshme dhe faktor paqeje dhe stabiliteti në rajon dhe më gjerë. Një vend të veçantë zë intensifikimi i marrëdhënieve me vendet fqinje me të cilat Shqipëria ndan interesa të përbashkët për forcimin e mëtejshëm të paqes dhe stabilitetit në rajon, rrugëtimin euroatlantik të tij, thellimin e bashkëpunimit ekonomik me interes të ndërsjellë dhe mbrojtjen e pakicave kombëtare. Në këtë frymë, Republika e Shqipërisë promovon marrëdhënie të mira bilaterale, angazhohet për thellim të marrëdhënieve strategjike, pjesëmarrje aktive në organizata dhe nisma rajonale që i kontribuojnë integrimit euroatlantik të vendit.

Shqipëria është një aktor i rëndësishëm dhe proaktiv në rajonin e Ballkanit Perëndimor, i cilësuar me rëndësi strategjike nga NATO në Samitet e viteve të fundit dhe ka tashmë një përjasje të konsoliduar konstruktive dhe të përgjegjshme në politikën e saj rajonale, të mbështetur në parimet e fqinjësisë së mirë, perspektivën euroatlantike, bashkëpunimin gjithëpërfshirës, integrimin ekonomik rajonal, respektimin dhe përparimin e të drejtave të pakicave. Partneritetet strategjike në rajon dhe më gjerë, aktivitetet tri- dhe katërpalëshe, mbledhjet e përbashkëta të qeverive, si dhe iniciativat rajonale shënojnë instrumente të rëndësishme për një politikë të jashtme proaktive rajonale të Republikës së Shqipërisë. Duke konsideruar sfidat që lidhen me sigurinë kibernetike, Shqipëria e konsideron me rëndësi të veçantë promovimin e interesave kombëtarë në hapësirën kibernetike dhe zhvillimin e partneriteteve strategjike për forcimin e sigurisë kibernetike kombëtare edhe përmes diplomacisë kibernetike.



Konsolidimi dhe institucionalizimi i perspektivës euroatlantike dhe evropiane, zgjerimi i NATO-s apo zgjerimi i pritshëm i BE-së në Ballkanin Perëndimor kanë sjellë ndryshime rrënjësore pozitive në rajon, duke shërbyer si katalizatorë të reformave demokratike, të bashkëpunimit, të fqinjësisë së mirë dhe të procesit të pajtimit. Në bashkëpunimin dypalësh dhe rajonal mbizotëron prirja drejt heqjes së barrierave përmes ndërtimit të infrastrukturave të përbashkëta për lëvizjen e lirë të njerëzve, ideve, mallrave dhe kapitaleve, duke synuar shndërrimin e rajonit në një treg të integruar, tërheqës dhe konkurrues për investimet e huaja. Shqiptarët në rajon mbeten dhe do të fuqizohen më tej si një faktor stabilizues, konstruktiv, kontribues dhe koheziv, mbështetës të palëkundur të integritetit euroatlantik, duke kontribuar të zhvillojnë më tej marrëdhëniet ndërshtetërore edhe midis komuniteteve të ndryshme, si një angazhim drejt së ardhmes.

Paralelisht, rajoni përballët me tensione të brendshme politike, në disa raste të nxitura direkt nga aktorë të tretë, me synim rritjen e ndikimit të tyre dhe devijimin apo ngadalësimin e integritetit euroatlantik. Ndërhyrja e aktorëve të tretë, si edhe mospëmbushja e të drejtave të grupimeve të caktuara etnike, apo e pakicave kombëtare, si dhe nacionalizmi i skajshëm dhe ekzistenca e shoqërive të ndara, krahas mosmarrëveshjeve dhe problemeve të pazgjidhura ndërshtetërore, mund të shkaktojnë ende tensione dhe të gjenerojnë pasoja negative në marrëdhëniet dypalëshe, rajonale dhe shumëpalëshe.

Diaspora shqiptare, historike dhe e re, krahasuar me popullsinë në vendin e origjinës, është ndër më të mëdhatë në botë. Republika e Shqipërisë do të vijojë përpjekjet që të përmbushë detyrimin e saj kushtetues për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve shqiptare jashtë vendit, duke inkurajuar bashkëpunimin shtetëror me institucionet e shteteve pritëse, duke zbatuar marrëveshjet ndërkombëtare dhe duke përdorur të gjithë mekanizmat diplomatikë, politikë, ekonomikë, arsimorë apo komunikues. Nëpërmjet marrëdhënies me shqiptarët jashtë kufijve dhe mbështetjes për legjitimitetin e tyre, Republika e Shqipërisë kontribuon edhe në stabilitetin e rajonit dhe harmonizon marrëdhënien me fqinjët.

Me synimin për t'iu dhënë zgjidhje problemeve me të cilat ndeshet komuniteti shqiptar, do të

realizohen projekte madhore, të cilat i shërbejnë bashkëpunimit me komunitetet shqiptare në diasporë, si: digjitalizimi i plotë i shërbimeve konsullore, regjistrimi i popullsisë; votimi në diasporë; përmirësimi i kuadrit ligjor në raport me zhvillimet social-ekonomike të vendit; ruajtja e identitetit, gjuhës dhe kulturës me krijimin e qendrave kulturore, certifikimi i mësuesve për mësimin e gjuhës dhe kulturës shqiptare në diasporë, si dhe realizimi i emisioneve të posaçme televizive, arsimore dhe kulturore, të dedikuara për diasporën. Një tjetër synim i rëndësishëm lidhet me krijimin e strukturave institucionale për të realizuar “rikthimin e trurit”, tërheqjen e profesionistëve të diasporës për angazhime afatshkurtra dhe afatgjata, si dhe studentëve ekselentë shqiptarë, të cilët mund të jenë një forcë kontribuese për vendin e origjinës.

5. PËRFORCIMI I DIMENSIONIT TË QËNDRUESHMËRISË

Në përputhje me situatën aktuale të sigurisë ndërkombëtare, kërcënimet e shtuara dhe angazhimet e saj si vend i NATO-s, Shqipëria do t'i kushtojë përparësi përf forcimit të mëtejshëm të dimensionit të qëndrueshmërisë kombëtare si pjesë edhe e qëndrueshmërisë kolektive të NATO-s. Ky dimension i rëndësishëm, i cili bazohet në nenin 3 të Traktatit të Atlantikut të Veriut, është përcaktuar nga NATO-ja si aftësia e një shteti për të rezistuar, rikuperuar dhe për të vazhduar ofrimin e shërbimeve pas një goditjeje të madhe, si: fatkeqësi natyrore, dështim i infrastrukturës kritike ose një sulm hibrid ose të armatosur. Sipas Aleancës Atlantike, ky dimension i rëndësishëm shtjellohet nëpërmjet sigurimit të vazhdimësisë së qeverisë dhe shërbimeve kritike, furnizimit të qëndrueshëm me energji, aftësisë për të trajtuar në mënyrë efektive lëvizjen e pakontrolluar të njerëzve, sigurimin e rezervave të qëndrueshme ushqimore, aftësisë për të përballuar kriza shëndetësore, sistemeve të qëndrueshme të komunikimit dhe sistemeve të qëndrueshme të transportit civil.

Mbrojtja e infrastrukturës kritike përbëhet nga veprimet e ndërmarra për të parandaluar, rritur qëndrueshmërinë ose zbutur rreziqet që vijnë nga dobësitë e aseteve të infrastrukturës kritike, ndërsa rritja e qëndrueshmërisë mundësohet përmes analizës, vlerësimit të riskut dhe aftësisë për të reaguar ndaj kërcënimeve të mundshme të saj.

Garantimi i furnizimit me ushqime, ilaçe, mallra të tjera thelbësore dhe produkte emergjente janë



vendimtare për sektorin shtetëror, por edhe për shoqërinë në kohë krize apo lufte.

Qasja jonë kombëtare në drejtim të rritjes së qëndrueshmërisë duhet të udhëhiqet nga tri elemente thelbësore:

- Kuptimi: krijimi i një tabloje më të qartë të rreziqeve dhe dobësive;

- Mbrojtja: forcimi i qëndrueshmërisë dhe mbrojtjes së infrastrukturave, përfshirë infrastrukturën e informacionit dhe informacionin në tërësi, njerëzve dhe institucioneve;

- Reagimi: zhvillimi dhe vendosja e aftësive dhe procedurave për të penguar, menaxhuar dhe reduktuar rreziqet e mundshme.

Duke pasur parasysh gamën e lartpërmendur të këtij dimensionit të rëndësishëm, Shqipëria ka emëruar së fundmi një pikë Kontakti Kombëtar për Qëndrueshmërinë në NATO, konkretisht ministrin e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, i cili do të jetë koordinatori midis aktorëve të brendshëm dhe Komitetit të Qëndrueshmërisë në NATO, në nivel politik. Në këtë këndvështrim, është domosdoshmëri alokimi i burimeve të nevojshme financiare për rritjen e kapaciteteve dhe mallrave rezervë materiale të shtetit, për të mundur ndërhyrjen me sukses, në mënyrë operative, për mbrojtjen e popullsisë, të ekonomisë dhe mbrojtjen e vendit, në situata të gjendjes së jashtëzakonshme, gjendjes së emergjencës civile, veprimeve terroriste dhe veprimeve ushtarake. Çdo sektor duhet të përcaktojë listën e mallrave dhe shërbimeve thelbësore të rëndësishme për reagimin në nivel sektorial ndaj kërcënimit.

Rritja e nivelit të sigurisë së mbrojtjes së popullsisë dhe infrastrukturës kritike

Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, përveç rolit të tyre parësor që buron nga misioni kushtetues për ruajtjen e pavarësisë, sovranitetit dhe integritetit territorial të RSH-së, kontributit në kuadër të mbrojtjes kolektive të Aleancës, pjesëmarrjes në misione dhe operacione të drejtuara nga NATO-ja, Bashkimi Evropian dhe Kombet e Bashkuara, si dhe mbështetjen në përballimin e emergjencave civile, gjithashtu, ofrojnë burimet e tyre për institucionet e tjera të sigurisë kombëtare për përballimin e kërcënimeve të karakterit virtual dhe ato hibride.

Shqipëria, në drejtim të fuqizimit të menaxhimit të sistemeve ekzistuese të infrastrukturës kritike, ka

tashmë të miratuar dokumentin e parë të saj të vlerësimit të riskut në nivel qendror, Strategjinë Kombëtare të Zvogëlimit të Riskut nga Fatkeqësitë 2023–2030 dhe Planin Kombëtar të Emergjencave Civile.

6. AVANCIMI DHE ZHVILLIMI I SISTEMIT TË SIGURISË DHE MBROJTJES

Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, si një prej elementeve kryesore të Fuqisë Kombëtare, konceptohen, ndërtohen dhe përdoren edhe si një forcë e NATO-s. Në kushtet e ndryshimeve në mjedisin e sigurisë ndërkombëtar, rajonal dhe të brendshëm, Forcat e Armatosura do të zhvillohen duke u përqendruar te sigurimi i kapaciteteve të nevojshme luftarake për forcat e luftimit, të mbështetjes me luftim dhe të mbështetjes me shërbim të luftimit, sistemeve e pajisjeve, mbrojtjes kibernetike dhe rritjen e fuqisë njerëzore, në mënyrë të pavarur, ose në bashkëpunim me aleatët, si dhe kapaciteteve infrastrukturore në dispozicion të Aleancës deri në aktivizimin e mekanizmit të mbrojtjes kolektive të Aleancës.

Bazuar në rreziqet, kërcënimet dhe kërkesat për kapacitetet e domosdoshme për përmbushjen e misionit, Forcat e Armatosura do të rriten në sasi e cilësi, duke krijuar kapacitetet dhe aftësitë për adresimin e kërcënimeve nëpërmjet realizimit të këtyre objektivave:

- Angazhimi i vazhdueshëm i Forcave të Armatosura në misionet e drejtuara nga NATO/OKB/BE dhe koalicione, si dhe harmonizimi i një pjese të planeve kombëtare të mbrojtjes me ato të Aleancës;

- Hartimi i Strategjisë së re Ushtarake të RSH-së dhe hartimi i Planit Afatgjatë të Zhvillimit të Forcave të Armatosura, si reflektim i nevojave të krijuara nga ndryshimet në mjedisin e ri strategjik;

- Përmirësimi i kuadrit ligjor për të mundur zbatimin e plotë të detyrimeve kombëtare që rrjedhin nga parimi i mbrojtjes kolektive i Traktatit të Atlantikut të Veriut, garantimin e infrastrukturës aeroportuale, të aftë për të mbështetur nevojat dhe kërkesat operacionale të Aleancës, si dhe të përmirësimit të vijueshëm të funksionimit të Forcave të Armatosura;

- Krijimi, zhvillimi dhe modernizimi me kapacitete të reja luftarake dhe infrastrukturës ushtarake me ritmin e zhvillimeve teknologjike bashkëkohore, si dhe përfshirja e komponentit



rezervist si pjesë e integruar e strukturës së Forcave të Armatosura. Ky komponent, përveçse do të rrisë aftësitë dhe kapacitetet e Forcave të Armatosura, do të forcojë edhe lidhjen midis Forcave të Armatosura dhe publikut;

- Angazhim i vazhdueshëm në shërbim të qytetarëve dhe në mbështetje të autoriteteve civile për përballimin e emergjencave dhe kontrollin e territorit.

Buxheti i mbrojtjes, në përbushje të angazhimit të kryetarëve të vendeve të NATO-s do të rritet gradualisht deri në vitin 2024 duke arritur 2% e PBB-së dhe pas këtij viti do të ketë synimin e të qenit të nivelit minimal, ku të paktën 20% e buxhetit të mbrojtjes do të shpenzohet për modernizimin e pajisjeve të rëndësishme ushtarake.

Sigurimi i burimeve të mbrojtjes dhe rritja numerike dhe cilësore e kapaciteteve njerëzore të Forcave të Armatosura do të mundësojë përbushjen e detyrimeve në gjithë spektrin e angazhimeve në kuadër kombëtar dhe atyre të Aleancës, si dhe realizimin e objektivave të mësipërm.

7. AVANCIMI DHE ZHVILLIMI I KAPACITETEVE SHTETËRORE PËR MBROJTJE KUNDËR KËRCËNIMEVE HIBRIDE

Vitet e fundit shpejtësia, shkalla dhe intensiteti i kërcënimeve hibride janë rritur ndjeshëm. Përgatitja për të parandaluar, kundërshtuar dhe për t'iu përgjigjur sulmeve hibride mbetet një prioritet për Shqipërinë si vend anëtar i NATO-s, si dhe kandidat për Bashkimin Evropian. Aktivitetet hibride janë ndër sfidat më të mëdha për sigurinë tonë dhe për integritetin e institucioneve tona demokratike. Teknikat hibride mund të ndikojnë si në sferën ushtarake, ashtu edhe në atë civile, duke dëmtuar interesat tanë dhe duke rrezikuar kohezionin tonë.

Përdorimi i taktikave hibride nuk është i ri, përdorimi i propagandës dhe dezinformimit është po aq i vjetër sa vetë konfliktet. Kërcënimet hibride kombinojnë mjete ushtarake dhe joushtarake, si dhe mjete të fshehta dhe të hapura, duke përfshirë dezinformimin, sulmet kibernetike, presionin ekonomik, si dhe zhvendosjen e grupeve të parregullta ushtarake, me qëllim destabilizimin e shoqërisë. Kërcënimet kibernetike dhe hibride, që shfaqen në formën e dezinformimit, sulmeve kibernetike, presionit ekonomik, kanë si qëllim

çorientimin dhe destabilizimin e shtetit dhe shoqërisë dhe e bëjnë të domosdoshme marrjen e masave për parandalimin dhe mbrojtjen ndaj tyre, duke pasur një qasje ndërinstitucionale të strukturave që kontribuojnë në mbrojtjen e sigurisë kombëtare.

Qasja jonë kombëtare në drejtim të kërcënimeve hibride duhet të udhëhiqet nga këto tri elemente thelbësore:

- Kuptimi: krijimi i një tabloje më të qartë të kërcënimeve dhe dobësive.

- Mbrojtja: forcimi i qëndrueshmërisë dhe mbrojtjen e informacionit, njerëzve, institucioneve dhe infrastrukturës nga kërcënimet hibride dhe veprimtaria armiqësore ndaj vendit.

- Reagimi: zhvillimi dhe vendosja e aftësive dhe procedurave për të penguar, menaxhuar dhe reduktuar rreziqet e mundshme.

8. SIGURIA DHE MBROJTJA KIBERNETIKE

Qasja e përgjithshme globale drejt digjitalizimit dhe automatizimit të proceseve të punës duhet të shkojë paralelisht me investimin në mbrojtje kibernetike. Kjo qasje shoqërohet në mënyrë të natyrshme me rritjen e mundshme të rrezikut ndaj sulmeve kibernetike.

Sulmet dhe krimet kibernetike tejkalojnë kufijtë fizikë, duke u bërë pjesë e sfidave të rëndësishme globale në fushën e sigurisë. Autorët kanë një profil transnacional dhe gjithmonë e më shumë të përfshirë në aktivitete të tjera kriminale, të tilla si: terrorizmi, trafikimi, pastrimi i parave, vjedhje nëpërmjet sistemeve, mashtrime etj. Këto aktivitete ndikojnë në rritjen e kriminalitetit dhe përhapjen e dhunës në komunitetet tona duke rrezikuar sigurinë publike dhe cenuar aspekte të tjera social-ekonomike. Po ashtu, ato cenojnë shtetin e së drejtës, nxitin korrupsionin, duke nxitur dhe veprimtari armiqësore ndaj shtetit në raste të caktuara.

Rrjedhimisht, këto kërkojnë një kornizë strategjike vizionare, të mirëpërcaktuar dhe gjithëpërfshirëse për të adresuar natyrën dinamike dhe gjithnjë në zhvillim të kërcënimeve kibernetike me synim garantimin e sigurisë kibernetike kombëtare. Në këtë kontekst, përcaktohen pesë shtylla kryesore për të mundësuar një qasje holistike të tilla si: parandalimi, menaxhimi dhe përgjigjja ndaj kërcënimeve kibernetike përmes përmirësimit të teknikave, procedurave dhe



standardeve të sigurisë; ndërtimi i kapaciteteve përmes edukimit dhe ndërgjegjësimit; përmirësimi i teknologjisë në vazhdimësi; garantimi i sigurisë në internet për fëmijët dhe të rinjtë; forcimi i partneritetit publik dhe privat në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, duke zhvilluar diplomacinë kibernetike.

Si një strategji proaktive, gjithnjë e më shumë vlerësohet rëndësia e investimit publik dhe privat në teknologji, të cilat të jenë në përputhje me standardet më bashkëkohore të sigurisë kibernetike.

Teknologjia është mjaft e rëndësishme për të realizuar dhe mbrojtur interesat kombëtarë, si dhe fituar avantazhe strategjike në hapësirën gjeopolitike për arritjen e objektivave për të ardhmen e sigurt të vendit përmes forcimit të sigurisë, ekonomisë dhe demokracisë. Siguria kibernetike është pjesë thelbësore e sigurisë kombëtare dhe për këtë Shqipëria është e përkushtuar që të rrisë sigurinë kibernetike të infrastrukturave të saj të informacionit nëpërmjet forcimit të kapaciteteve dhe bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar, duke u bashkuar në këtë qasje me vendet e tjera demokratike.

Ndërhyrjet e paautorizuara nga sulme kibernetike në sistemet digjitale, vjedhja e informacionit, si dhe çdo aktivitet keqdashës në hapësirën kibernetike, por dhe çdo përpjekje tjetër për të shkatërruar apo dobësuar rrjetet dhe sistemet tona të informacionit, do të mund të minimizohen, duke rritur investimet në këtë fushë, kontrollat mbi infrastrukturën dhe shërbimet, si dhe burimet e hetimit.

Në të njëjtën kohë, synohet forcimi i bashkëpunimit me aleatët dhe partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë në ekspertizën teknike dhe rritjen e kapaciteteve njerëzore, pajisjen me teknologji të avancuar duke përmirësuar veprimtarinë parandaluese dhe përballuar përpjekjet që mund të bëhen për të cenuar sistemet tona teknologjike publike apo private. Gjithashtu, synohet forcimi i mekanizmave të kontrollit dhe hetimit, si dhe ndjekjes së prirjeve kriminale të tilla, për të parandaluar kërcënimin e sigurisë kombëtare.

Sigurimi i infrastrukturës tonë kritike është domosdoshmëri duke promovuar dhe garantuar sigurinë bazë kibernetike për sektorët kritikë dhe sigurimin e vazhdimësisë së tyre. Prioritet konsiderohet edhe mbrojtja e investimeve në këto infrastruktura dhe forcimi i qëndrueshmërisë së

tyre përmes parandalimit, detektimit, kundërpërgjigjes, atribuimit dhe marrjes së masave mbrojtëse ndaj aktiviteteve të aktorëve keqdashës në hapësirën kibernetike.

Objektiva të rëndësishme janë edhe përmirësimi i kuadrit ligjor e rregullator, si dhe përmirësimi i bashkëpunimit ndërinstitucional.

Është e nevojshme të zhvillohen mekanizmat për rritjen e standardeve për infrastrukturën kritike për të përmirësuar me shpejtësi fleksibilitetin dhe qëndrueshmërinë kibernetike, si dhe ndërtimin e aftësive ndërinstitucionale për të pasur implementim sa më të sigurt të infrastrukturave dhe sistemeve digjitale, për të monitoruar në mënyrë të vazhdueshme të gjitha aktivitetet e dyshimta, si dhe për të reaguar me shpejtësi ndaj çdo sulmi. Si një shoqëri e hapur, Shqipëria ka një interes të qartë në forcimin e normave që zbusin kërcënimet kibernetike dhe rrisin stabilitetin në hapësirën kibernetike.

Përmes masave të ndërmarra synohet rritja e kapaciteteve njerëzore dhe institucionale për të bërë të mundur më pas mbrojtjen e infrastrukturave dhe sistemeve digjitale ndaj sulmeve kibernetike nga aktorët shtetërorë dhe joshetërorë. Rritja dhe forcimi i këtyre kapaciteteve, gjithashtu, bën të mundur që të kemi një përgjigje me vendosmëri dhe duke përdorur të gjitha mjetet e përshtatshme kombëtare ndaj akteve armiqësore në hapësirën kibernetike, duke përfshirë ato që cenojnë ose dobësojnë funksionet jetike të shtetit ose infrastrukturën kritike kombëtare.

Njëkohësisht, angazhohemi për të përmbushur detyrimet kombëtare për një sjellje të përgjegjshme të shtetit në hapësirën kibernetike, sipas kuadrit të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, sipas të cilit ligji ndërkombëtar zbatohet në internet, ashtu siç zbatohet edhe jashtë tij.

Gjithashtu, kërcënimet ndaj sigurisë së sistemeve dhe rrjeteve kompjuterike të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura është real, për rrjedhojë FA-të do të sigurojnë kapacitete për mbrojtje kibernetike, duke ofruar moscenimin e rrjeteve dhe sistemeve. Objektivi është garantimi i hapësirës kibernetike në të gjithë aktivitetin e MM-së dhe FA-së, nëpërmjet zhvillimit të kapaciteteve për sigurinë kibernetike, konsolidimit të aftësive mbrojtëse, rritjes së vetëdijes e profesionalizmit, si dhe fuqizimit të bashkëpunimit dhe të koordinimit me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare.



9. EMERGJENCAT CIVILE

Ngjarjet e viteve të fundit kanë treguar se ekziston një nevojë urgjente për të forcuar gatishmërinë ndaj fatkeqësive dhe aftësitë e menaxhimit të riskut, për të miratuar sisteme dhe procedura të përshtatshme reagimi dhe për të përmirësuar kapacitetin institucional për koordinimin dhe menaxhimin e reduktimit të risqeve nga fatkeqësitë për bashkëveprimin midis niveleve publike të qeverisë, si dhe me aktorët privatë dhe ata të shoqërisë civile. Prioritet është parandalimi i degradimit mjedisor dhe reduktimi i pasojave të ndryshimeve klimatike, duke menaxhuar me efektivitet basenet ujore, shtuar sipërfaqet pyjore, trajtuar në mënyrë të integruar mbetjet urbane, si dhe duke bashkëpunuar me shoqërinë civile për ndërgjegjësimin e opinionit publik për ruajtjen e mjedisit dhe garantimi i sigurisë së digave të rezervuarëve.

Sistemi i mbrojtjes civile u ridimensionua përmes ngritjes dhe funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, e cila është autoriteti përgjegjës për koordinimin, bashkëpunimin, hartimin dhe harmonizimin e procedurave për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Është përmirësuar kuadri i zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë nëpërmjet identifikimit, vlerësimit periodik të riskut dhe monitorimit të tij, duke zbutur pasojat negative të fatkeqësive, si edhe krijimit të bazës së të dhënave të humbjeve nga emergjencat natyrore dhe fatkeqësitë. Me miratimin e Strategjisë Kombëtare të Vlerësimit të Riskut, e cila ka hyrë në fuqi në shkurt 2023, do të implementohen prioritetet strategjike të evidentuara nga çdo institucion përgjegjës, siç është edhe hartimi i ligjit për infrastrukturën kritike konform me ligjet dhe direktivat e BE-së.

Plotësimi i kriterëve të lartpërmendura krijoi kushtet që Shqipëria të jetë një shtet pjesëmarrës në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile Evropiane. Si anëtare me të drejta të plota e saj, Shqipëria jo vetëm që do të jetë në gjendje të marrë mbështetje të menjëhershme, por, gjithashtu, mund të dërgojë ndihmë në vendet e goditura nga një fatkeqësi nëpërmjet Mekanizmit, duke çuar në një reagim më të fortë dhe më të koordinuar ndaj krizave në Evropë dhe në pjesën tjetër të botës.

Ky sistem, qëllimin strategjik do ta ketë të masat parandaluese dhe ato rehabilituese në infrastrukturë, bashkëpunimin midis strukturave ushtarake dhe civile, ngritjen dhe funksionalizimin e strukturave të mbrojtjes civile në nivel qendror dhe vendor, bashkëpunimin dhe ndërveprimin me strukturat homologe rajonale në drejtim të mbështetjes së ndërsjellë, në kuadër të mbrojtjes civile, si dhe rritjen e rolit ndërkombëtar të Republikës së Shqipërisë në fushën e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, nëpërmjet rolit më të madh dhe më aktiv të saj dhe përmbushjes së kontributeve ndërkombëtare, si dhe bashkëpunimi ndërinstitucional në kuadër të asistencës së procedurave përkatëse.

10. FORCIMI I MËTEJSHËM I PUNËS SË SHËRBIMEVE INTELIGJENTE

Ndryshimi i mjedisit strategjik drejt një bote komplekse dhe të pasigurt, ku kërcënimet po bëhen gjithnjë e më komplekse dhe ndërlydhura, e vë komunitetin e inteligjencës në vend përballë sfidave të reja në orientimin dhe mbështetjen e vendimmarrjes strategjike për përballjen e këtyre kërcënimeve. Natyra transnacionale dhe e sofistikuar e kërcënimeve e bën të domosdoshëm thellimin e bashkëpunimit mes tyre, me agjencitë ligjzbatuese në vend dhe partnerët e aleatët ndërkombëtarë.

Komuniteti i Inteligjencës duhet të forcojë kapacitetet në funksion të paralajmërimit të efekteve strategjike për sigurinë kombëtare dhe të përshtatë strukturat në raport me natyrën e kërcënimeve. Ky komunitet duhet të promovojë e identifikojë praktikën e funksionet më të mira për krijimin e një kulture të vazhdueshme bashkëpunimi dhe partneriteti. Përmbushja e misionit ligjor të këtij komuniteti kërkon përgjegjshmëri e përpjekje për të ndarë në mënyrën e duhur njohuritë, informacionet dhe aftësitë në të gjithë kufijtë organizativë, duke përdorur në mënyrë efektive burimet në dispozicion. Përveç kësaj, komuniteti duhet të bëjë investime strategjike afatgjata për të zhvilluar profesionalizmin dhe për të përmirësuar kapacitetet në raport me natyrën e re të kërcënimeve. Për arritjen e këtyre objektivave, Komuniteti i Inteligjencës duhet:

- të zhvillojë e të adoptojë vazhdimisht proceset për një sistem inteligjence dinamik, që orienton vendimmarrjen strategjike me vlerësime e parashikime mbi kërcënimet ndaj sigurisë



kombëtare, sipas misionit ligjor dhe fushës së përgjegjësisë;

- të zgjerojë e thellojë njohuritë strategjike mbi ambientin strategjik, në funksion të informimit mbi trendet në zhvillim, mundësitë e kërcënimit në zona përgjegjësie dhe interesi, me qëllim maksimalizimin e avantazhit të vendimmarrjes dhe rritjen e kontributit në organizma ndërkombëtarë;

- të rrisë ndërveprimin mes komunitetit brenda vendit dhe bashkëpunimin mes tij dhe agjencive të zbatimit të ligjit për rritjen e kundërvënies sipas misionit ligjor;

- të forcojë partneritetet ekzistuese me aleatë e partnerë dhe të zhvillojë të reja, në funksion të nevojave të misionit dhe në përputhje me përcaktimet ligjore;

- të zhvillojë e të implementojë aftësi dhe kapacitete të reja në raport me trendin dhe natyrën e kërcënimeve ndaj sigurisë kombëtare;

- të avancojë përpjekjet për mbrojtjen e informacionit, infrastrukturës, personelit të vet dhe të zhvillojë një qasje dinamike për vlerësimin e vazhdueshëm të praktikave të përbashkëta të sigurisë e standardeve, për forcimin e sigurisë së infrastrukturës së komunitetit;

- të bazohet në punën dhe strategjitë e tij zhvillimore të ky dokument strategjik.

11. ÇËSHTJET E FUQIZIMIT TË SEKTORIT TË SIGURISË – AGJENCITË LIGJZBATUESE DHE TË SIGURISË SË INFORMACIONIT

Siguria e informacionit

Për aplikimin dhe zbatimin e standardeve më të mira në disiplinat e sigurisë së informacionit të klasifikuar, Republika e Shqipërisë do të zhvillojë një sistem efektiv për të garantuar mbrojtjen e këtij informacioni dhe të sistemeve të komunikimit të sigurt, përmes rishikimit të legjislacionit në fuqi, modernizimit, fuqizimit teknologjik dhe aftësimit të kapaciteteve; edukimit të sigurisë dhe bashkëveprimit ndërinstitucional e atij ndërkombëtar.

Vëmendje e shtuar do t'i kushtohet miratimit të listës kombëtare të produkteve, që ofrojnë garanci për sigurinë e informacionit të klasifikuar, si dhe identifikimit dhe kontrollit të “influcës së huaj” me origjinë nga vende jo mike, përmes zotërimit të pronësisë tek operatorët ekonomikë që angazhohen në marrëdhënie kontraktuale, në kuadrin e prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe

të sigurisë që përmbajnë informacion të klasifikuar.

Lufta kundër krimit të organizuar: Lufta e vazhdueshme dhe e pakompromis ndaj tij përbën një nga prioritetet kryesore për qeverinë shqiptare, por dhe kriter kyç në procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në BE. Vizioni dhe përpjekjet e vazhdueshme do të synojnë garantimin e një mjedisi të sigurt për zhvillimin e vendit dhe shoqërisë nga kërcënimi i krimit të organizuar, duke siguruar jetën e individit, sipërmarrjen e lirë dhe respektimin e ligjshmërisë në tërësi në vend.

Për këtë qëllim, do të punohet për ngritjen dhe fuqizimin e kapaciteteve të nevojshme institucionale, zhvillimin e sistemeve, teknologjisë, inteligjencës dhe analizës. Veçanërisht do të punohet për rritjen e kapaciteteve investiguese kundër krimit të organizuar dhe krimit ekonomik e financiar, krimit kibernetik dhe drogës, duke rimodeluar, duke profilizuar dhe duke rritur profesionalizmin e strukturave të posaçme në Policinë e Shtetit, në përputhje me kërkesat dhe standardet evropiane dhe të Europolit.

Për këtë do të vijojë dhe do të intensifikohet bashkëpunimi mes agjencive ligjzbatuese në vend dhe me partnerët rajonalë dhe ndërkombëtarë.

Një nga objektivat strategjikë për goditjen e krimit të organizuar do të jetë gjurmimi, sekuestrimi, konfiskimi i financave dhe aseteve të grupeve kriminale, duke e dobësuar atë, si dhe duke i kthyer këto asete të komuniteti dhe duke forcuar qëndrueshmërinë e institucioneve.

Migracioni: Vijon të jetë një fenomen me ndikim të konsiderueshëm në zhvillimin social dhe ekonomik të Shqipërisë dhe mirëqeverisja e tij është një objektiv madhor dhe një kriter për anëtarësimin e vendit në Bashkimin Evropian. Shqipëria vijon të jetë një vend i origjinës së migrantëve ekonomikë, por edhe vend tranzit dhe i destinacionit për migrantët ekonomikë, azilkërkuesit dhe refugjatët që vijnë kryesisht nga vendet e treta.

Në frymën e proceseve globale të migracionit dhe të integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian do të ofrohet një përgjigje gjithëpërfshirëse ndaj sfidave dhe mundësive të migracionit. Në këtë drejtim, përpjekjet e institucioneve do të jenë për hartimin dhe për menaxhimin e politikave efektive në fushën e migracionit, të cilat të adresojnë dhe menaxhojnë problematikat dhe sfidat që lindin nga lëvizjet



migratore drejt Shqipërisë dhe prej saj, si dhe rritjen e ndikimit të migracionit për zhvillimin e vendit dhe shoqërisë shqiptare.

Përpyekjet kryesore në drejtim të mirëqeverisjes së migracionin kanë të bëjnë me:

- parandalimin e plotë të fenomenit të emigrimit të parregullt të shtetasve shqiptarë dhe keqpërdorimin e regjimit pa viza në zonën Shengen dhe BE;

- trajtimin efektiv të flukseve të përziera migratore që vijnë nga zonat e konfliktit;

- forcimin e mekanizmit të riintegrit, me qëllim garantimin e një kthimi të qëndrueshëm të shtetasve shqiptarë përmes ofrimit të mbështetjes;

- ndikimin e migrimit në zhvillimin e vendit përmes promovimit të investimeve njerëzore dhe financiare të shqiptarëve që janë jashtë vendit për vendin;

- forcimin e strukturave të menaxhimit të migracionit dhe politikave të imigracionit në drejtim të integritit të imigrantëve, në përputhje me të drejtat dhe standardet ndërkombëtare.

Përmirësimi i sigurisë kufitare: Një ndër drejtimet e rëndësishme për kontrollin dhe për menaxhimin e migracionit të parregullt do të mbetet përmirësimi i sigurisë kufitare përgjatë vijës së kufirit shtetëror dhe menaxhimi i integruar i qarkullimit kufitar. Për garantimin dhe rritjen e sigurisë kufitare do të punohet për zhvillimin e shërbimeve në kufi përmes projekteve teknologjike; parandalimin e krimit ndërkufitar dhe trafikeve të paligjshme; bashkëpunimit me FRONTEX dhe me fqinjët.

Terrorizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm: Shqipëria është ndër vendet e renditura e para në koalicionin kundër terrorizmit. Përgjatë viteve ka përmirësuar legjislacionin, si dhe ka ngritur kapacitete të reja të specializuara për të adresuar këtë fenomen. Shqipëria është pjesëmarrëse aktive në përpjekjet e koordinuara të partnerëve të saj strategjikë SHBA dhe BE kundër terrorizmit. Që prej vitit 2014 ajo është anëtare e Koalicionit Global kundër Shtetit Islamik dhe ka ratifikuar një sërë konventash dhe rezolutash në këtë drejtim. Gjatë viteve të fundit Shqipëria ka bërë progres në masat parandaluese kundër terrorizmit, radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, rritjen e kapaciteteve të agjencive ligjzatuese dhe zhvillimin e politikave efektive në këtë fushë.

Bazuar në studimet dhe raportet e riskut rezulton se kërcënimi real prej terrorizmit në Shqipëri është në nivel “të ulët”. Shqipëria është prekur nga fenomeni i pjesëmarrjes së luftëtarëve terroristë, zhvendosur së bashku me familjet e tyre në zonat në konflikt. Aktualisht, evidentohen akoma shumë shtetas shqiptarë, kryesisht gra dhe fëmijë, të strehuar në qendrat e pritjes për t’u riatdhesuar, të cilët do t’u nënshtrohen programeve rehabilituese dhe riintegruese dhe monitorimit të vazhdueshëm nga strukturat përkatëse. Megjithatë, zhvillimet e kohëve të fundit, si ato në Lindjen e Mesme, në Afrikën e Veriut, sulmet e organizatave të terrorit ndërkombëtar të ISIS, Al Kaedës apo të tjerë, e kanë çuar në një nivel tërësisht të ri sfidën kundër terrorizmit dhe financimit të terrorizmit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Nuk përjashtohet mundësia e aktivizimit të tyre duke marrë në konsideratë zhvillimet aktuale në konfliktin sirian (humbja e territoreve dhe kontrollit të ISIL/DAESH).

Masat parandaluese përmes qasjes soft do të konsistojnë në hartimin e një programi komunikimi strategjik për të kultivuar respektin ndaj të drejtave të njeriut; rritjes së përpjekjeve të institucioneve arsimore dhe shoqërisë civile për edukimin dhe trajtimin e shkaqeve themelore dhe efekteve të stereotipeve, paragjytimeve dhe diskriminimit shoqëror me bazë ideologjike; trajtimit të të gjitha formave të ekstremizmit të dhunshëm, duke u orientuar nga parimet e qëndresës së komunitetit dhe dialogut gjithëpërfshirës dhe mbështetjes së komuniteteve pritëse në veçanti për risocializimin e qëndrueshëm të të rikthyerve.

Në këtë kontekst, do të tregohet vëmendje e shtuar për të vënë në jetë politika efikase shtetërore edhe për riatdhesimin, rehabilitimin dhe riintegrimin e qytetarëve shqiptarë dhe familjarëve të tyre. Konsolidimi i kapaciteteve të strukturave të inteligjencës, përdorimi i platformave dhe teknologjive për shkëmbimin në kohë dhe të sigurt të informacionit, kryerja e analizave të përbashkëta të vlerësimit të riskut nga institucionet dhe agjencitë ligjzatuese, rritja e kapaciteteve të hetimit dhe zbulimit veçanërisht të financimit të terrorizmit, rritja e kapaciteteve reaguese dhe gatishmërisë së institucioneve për të vepruar shpejt dhe për të minimizuar pasojat e akteve potenciale terroriste, mbrojtja e infrastrukturës kritike në vend, rritja e kapaciteteve për të monitoruar dhe kontrolluar



transportin e mallrave, veçanërisht armëve dhe lëndëve të rrezikshme CBRN, si dhe personave në pikat e kalimit kufitar dhe në territor, do të jenë disa nga aspektet kryesore për minimizimin e kërcënimit nga aktet terroriste. Një vëmendje e shtuar do t'i kushtohet luftës për parandalimin e financimit të terrorizmit, përmes forcimit të kuadrit ligjor për vënien në jetë të masave shtrënguese ndërkombëtare kundër terrorizmit, si edhe rritjes së efikasitetit të strukturave ligjzbatuese në drejtëm të hetimit dhe procedimit të rasteve të dyshuara.

12. SIGURIA ENERGJETIKE

Në zbatim të Strategjisë Kombëtare të Energjisë, miratuar me VKM-në nr. 480/2018, dhe referuar rekomandimit të BE-së, në vitin 2021 u miratua Plani Kombëtar i Energjisë dhe Klimës (NECP) 2020–2030. Ky plan plotëson Strategjinë Kombëtare të Energjisë dhe vendos objektiva të rinj dhe më ambicioze për eficiencën e energjisë, përdorimin të burimeve të rinovueshme të energjisë dhe dekarbonizimit. Plani Kombëtar i Energjisë dhe Klimës parashikon objektivat dhe masat e mëposhtme për eficiencën e energjisë dhe burimet e rinovueshme deri në vitin 2030:

“Kontributet në shkarkimin e GES-ve -18,7% (*reduktimi në raport me WEM*).

“Eficienca e energjisë -8,4% (*reduktimi i konsumit final në raport me WEM*).

“Pjesa që zë energjia e rinovueshme në kërkesën finale për energji është 54.4%.

Ligji për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme, i miratuar së fundmi në Kuvendin e Shqipërisë, përcakton objektivat kombëtarë detyrues dhe detyrimet raportuese për kontributin e energjisë nga burimet e rinovueshme të energjisë në konsumin bruto final të energjisë, rregullat për informacionin, statistikën, certifikimin, për mekanizmat e bashkëpunimit, për mbështetjen, rregullat që lidhen me aksesin dhe funksionimin e rrjeteve për burimet e rinovueshme të energjisë dhe lidhjen e tyre me rrjetin elektrik, rregullat për dhënie, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë e prodhuar nga burimet e rinovueshme, burimet, si dhe rregullat për integrimin e vetëprodhuesve dhe komuniteteve të energjisë së rinovueshme në sektorin e energjisë elektrike.

Prodhimi i energjisë elektrike: Energjia në Shqipëri prodhohet 100% nga burimet e rinovueshme (99% nga HEC-et dhe 1% nga FV),

duke llogaritur një nga pjesët më të larta të energjisë së rinovueshme në përzierjen e energjisë midis vendeve në botë. Kapaciteti total i prodhimit të energjisë elektrike i instaluar në Shqipëri deri më 31 dhjetor 2022 është 2614 mw. Ky kapacitet ka pasur një nivel rritjeje në vitin 2022 prej rreth 9 mw, krahasuar me vitin 2021. Kapaciteti total i prodhimit të energjisë elektrike i shoqërisë publike KESH sh.a. është 1448 mw dhe përbën rreth 55.4% të kapacitetit total të instaluar në vendin tonë. Kapaciteti total i instaluar i prodhuesve të tjerë të energjisë elektrike është 1166 mw dhe përbën rreth 44.6% të kapacitetit total të instaluar në vendin tonë. Numri i prodhuesve të pavarur të energjisë elektrike, të cilët në vitin 2022 prodhuan rreth 45% të totalit të prodhimit vendës, po rritet çdo vit, duke rritur kështu rëndësinë e këtyre prodhuesve në treg, që është një hap i rëndësishëm për liberalizimin e tregut të energjisë elektrike në vendin tonë.

Kapaciteti i instaluar i objekteve gjeneruese të lidhur me rrjetin e transmetimit gjatë vitit 2022 është rreth 2,266 mw dhe prodhimi neto i tyre ka rezultuar të jetë 6,149,229 mwh. Kapaciteti i instaluar i prodhuesve të energjisë elektrike të lidhur me rrjetin e shpërndarjes përgjatë vitit 2022 është përafërsisht 348 mw dhe prodhimi neto i tyre rezultoi 853,414 mwh.

Duke qenë e ndjeshme ndaj kushteve hidrologjike dhe e pamjaftueshme për të plotësuar nevojat e saj për furnizim me energji, Shqipëria është një importues neto i energjisë elektrike. Varësia nga importet e energjisë përbën 20–30% të kërkesës për energji dhe garantimi i sigurisë së furnizimit me energji elektrike është një sfidë. Sistemi duhet të mbështetet në prodhimin vendës dhe të jetë i përbalueshëm për konsumatorët duke krijuar ndikim në uljen e varfërisë.

Në përgjigje të krizës së vazhdueshme energjetike dhe për të parandaluar rritjen e çmimeve në vend dhe për të garantuar energjinë e pandërprerë, në tetor 2021 qeveria e Shqipërisë shpalli gjendjen e jashtëzakonshme në furnizimin me energji elektrike, e cila zgjati deri më 30 qershor 2023. Për të garantuar prodhimin e energjisë elektrike, qeveria e Shqipërisë ka kontraktuar që nga shtatori 2022 dy anije termocentrale me naftë për të operuar nga zona e Vlorës. Anijet do të kenë një kapacitet gjenerues të energjisë elektrike të vlerësuar në 100–114 mw. Kjo do të shërbejë deri



në 15% të nevojës së përgjithshme të konsumit të Shqipërisë.

Me hyrjen në funksion, ALPEX (*Albanian Power Exchange*) do të ndryshojë marrëdhëniet ndërmjet pjesëmarrësve të tregut, duke shmangur marrëdhëniet dypalëshe mes tyre. Synimi është të kemi një treg që prodhon, transmeton dhe konsumon energji elektrike në mënyrë efikase, si dhe një treg që çon në fitime më të larta, të organizuar sipas modelit të BE-së, i cili udhëhiqet nga parimet e transparencës, mosdiskriminimit dhe të qëndrueshëm në afatgjatë, bazuar në çmimin konkurrues, me synim integrimin e mëtejshëm në tregun më të gjerë rajonal dhe në fund të brendshëm të energjisë në BE. ALPEX do të jetë funksional për të dy vendet: Shqipëri dhe Kosovë, pas një marrëveshjeje të nënshkruar për ofruesin e shërbimeve. Krijimi i këtij tregu do të përmirësojë sigurinë e furnizimit me energji elektrike për të dyja vendet (Shqipëri dhe Kosovë), me pritshmëri që të ndikojë ndjeshëm në rritjen e konkurrencës duke sjellë uljen e çmimit të energjisë elektrike në tregun me pakicë.

Vitet e fundit në vendin tonë janë instaluar impiante të prodhimit të energjisë elektrike nga centralet fotovoltaike, të cilat ndikojnë në diversifikimin e burimeve të prodhimit të energjisë elektrike, kapaciteti total i instaluar i tyre është 23 mw dhe prodhimi total rezulton 5092 mwh.

Në bazë të kuadrit strategjik të Strategjisë Kombëtare të Energjisë (2018–2030), Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës (2020–2030), dhe pikëpamjes së qeverisë për zhvillimin e sektorit të energjisë duke rritur kapacitetet prodhuese nëpërmjet diversifikimit të burimeve, investimet në fushën e burimeve të rinovueshme të energjisë janë në vazhdim e sipër përmes iniciativave private dhe proceseve konkurruese.

Ka përfunduar procedura e tenderit për ndërtimin e një impianti fotovoltaike në Rema-Karavasta (afër zonës së Lushnjës) me fuqi të instaluar 140 mw, ku 70 mw, si pjesë e masave mbështetëse dhe 70 mw do të jenë në tregun e lirë. APP-ja është nënshkruar në vitin 2020 dhe është në zbatim. Aktualisht, ofertuesi në përputhje me lejet e marra ka nisur fazën e ndërtimit.

Ka përfunduar procedura e tenderit për ndërtimin e Uzinës PV Spitalla, në zonën e Spitallës, rrethi i Durrësit, me një kapacitet të instaluar 100 mw (70 mw, si pjesë e Masave

Mbështetëse dhe një shtesë prej 30 mw për t'u tregtuar në tregun e lirë. Ofertuesi është në fazën e marrjes së lejeve në përputhje me dispozitat e kontratave të nënshkruara në qershor 2021.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka shpallur një proces konkurrues për gjeneratorët e energjisë elektrike me erë me kapacitet të instaluar nga 10 mw në 75 mw. Nëpërmjet kësaj procedure tenderimi, Ministria do të përzgjedhë projektet me kapacitet total prej 100 mw, të cilat do të përfitojnë nga masat mbështetëse. Autoriteti kontraktor më vonë mund të vendosë të rrisë kapacitetin total të tenderuar deri në 150 mw. Procesi është në vazhdim.

Përprojekjet e vazhdueshme për të diversifikuar prodhimin e energjisë elektrike me burime të tjera të rinovueshme vazhdojnë. Një impiant diellor fotovoltaike me një kapacitet të vlerësuar prej 5.2 mw në pronësi të Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) dhe dy HEC-e të vogla me kapacitet rreth 5 mw iu shtuan kapaciteteve vendëse të prodhimit të energjisë.

Gjithashtu, në përputhje me urdhrin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, kompania ose një klient familjar mund të instalojë një kapacitet total deri në 500 kwp për vetëprodhimin e energjisë elektrike nga dielli. Kapaciteti total i instaluar sot është rreth 100 mw.

Ndërtimi i hidrocentralit të Skavicës është një hap i rëndësishëm drejt rritjes së sigurisë energjetike, reduktimit të importit të energjisë elektrike dhe rritjes së eficiencës dhe prodhimit të energjisë nga hidrocentralet e tjerë të kaskadës së lumit Drin. Hidrocentrali i Skavicës, si tri hidrocentralet e tjera në kaskadën e lumit Drin, do të operohet nga Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH). Ligji nr. 38/2021 parashikon procedurën e veçantë për negocimin e ekzekutimit dhe miratimin e kontratës me “Bechtel International, Inc” ose filialet e saj për projektimin dhe ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës.

Gjatë vitit 2022, ERE (Autoriteti Rregullator Kombëtar) ka proceduar me miratimin e disa akteve nënligjore, të cilat kanë ndikuar si në mundësinë e ndërtimit të rrjeteve të transmetimit dhe shpërndarjes në sektorin e gazit. Për të përmbushur strategjinë e MIE-n me Alb gaz dhe KESH, është e nevojshme të arrihet brenda një afati të shkurtër dhe afatmesëm:

“i. TEC Vlorë;



“ii. ngritja e një terminali për shpërndarjen e gazit natyror të lëngshëm; si dhe

“iii. ndërtimi i një gazsjellësi natyror nga terminali i Vlorës në Fier.

Ka një angazhim shumëdimensional për të mundësuar furnizimin me gaz të TEC-it të Vlorës. Futja e LNG-së në çdo formë në zonën e Vlorës dhe ndërtimi i gazsjellësit Fier–Vlorë do të shërbejnë për zhvillimin e sektorit të gazit në Shqipëri. Kjo do të rrisë fizibilitetin e sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit, duke përdorur lidhjen dykahëshe të pikës së daljes së TAP-it.

13. REFORMA NË DREJTËSI DHE LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT

Jetësimi i Reformës në Drejtësi nëpërmjet vënies në funksion të plotë të gjithë arkitekturës së re institucionale në sistemin e drejtësisë ishte domosdoshmëri në një shtet të së drejtës të orientuar drejt shërbimit të hapur, të paanshëm, transparent, profesional, eficient dhe të aksesueshëm për të gjithë.

Kuadri ligjor i kësaj reforme, cikli i ngritjes së institucioneve të reja të drejtësisë, si dhe pajisja e tyre me kapacitetet e nevojshme infrastrukturore dhe njerëzore për jetësimin e prioriteteve strategjike synojnë projektimin në sistemin tonë të drejtësisë drejt standardeve më të mira evropiane me një vizion gjithëpërfshirës për rikthimin e besimit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë. Përpos sfidave të shumta për implementimin e kësaj reforme, në një periudhë shumë të shkurtër, krahas miratimit të legjislacionit përkatës, është krijuar një strukturë e qëndrueshme institucionale, e cila ka dëshmuar rezultate të prekshme dhe cilësore për të konkretizuar efektin transformues të ndryshimeve të thella kushtetuese, ligjore dhe institucionale. Reforma, nuk do të ishte esenciale pa ngritjen dhe funksionimin e institucioneve të reja të drejtësisë si Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, të cilat vijojnë të përmbushin objektivat e tyre për një sistem drejtësie të pavarur, profesional dhe me integritet të lartë.

Korrupsioni është kërcënim për demokracinë, mirëqeverisjen, konkurrencën e ndershme, zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, shoqëror dhe politik të një vendi. Qeveria shqiptare ka dhe do të vazhdojë të ketë një vullnet të palëkundur në luftën kundër korrupsionit përmes aksioneve paran-

daluese, masave ndëshkuese dhe aktiviteteve ndërgjegjëse. Lufta kundër korrupsionit nuk përbën vetëm një prioritet për qeverinë shqiptare, por është edhe një nga 5 prioritetet kyçe që Bashkimi Evropian ka vendosur për Shqipërinë në rrugëtimin e saj të integritetit në familjen evropiane. Referuar progresraportit të Komisionit Evropian për vitin 2022, Shqipëria ka një lloj përgatitje në luftën kundër korrupsionit. Pavarësisht këtij progresi, shtimit të përpjekjeve dhe angazhimit politik në luftën kundër korrupsionit, kjo e fundit mbetet një fushë që përbën shqetësim serioz. Janë arritur rezultate të prekshme në luftën kundër krimit të organizuar, duke përfshirë rritjen e bashkëpunimit me shtetet anëtare të BE-së dhe Europolin - një kusht për IGC-në e parë, e cila vazhdon të përmbushet. Po kështu, parandalimi dhe ndëshkimi i korrupsionit është një detyrim që rrjedh nga aderimi i Shqipërisë në instrumentet ndërkombëtare për luftën kundër korrupsionit, si: Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, Konventa Penale e Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit, Konventa Civile e Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit etj.

Arkitektura e re gjithëpërfshirëse institucionale për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, tashmë e jetësuar në përbërje nga Prokuroria e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Byroja Kombëtare e Hetimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë dhe Gjykata e Posaçme e Apelit për Gjykimin e Çështjeve të Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, ka forcuar mekanizmat e hetimit dhe gjykimin të korrupsionit të nivelit të lartë dhe krimit të organizuar, duke krijuar rezultate hetimi dhe dënimi me synimin për të goditur korrupsionin në të gjitha dimensionet e tij. Procesi i zbatimit të një sistemi të plotë dhe të mirëduar të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve po vijon me ritme të shpejta dhe të kënaqshme, i cili po sjell një transformim të vazhdueshëm të sistemit gjyqësor shqiptar, bazuar në një sistem vlerësimi të aftësive profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve, vlerësim të integritetit dhe pastërtisë së figurës me synimin e plotë për kthimin dhe rritjen e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë dhe sigurimin e pavarësisë së gjyqësorit për një shtet të fortë të së drejtës. Zgjatja e mandatit të organeve të Vettingut, do të thellojë rezultatet për të përfunduar me sukses dhe kaluar në filtër të gjithë trupën e gjyqtarëve dhe prokurorëve.



Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2021–2025 dhe Plani i saj i Veprimit (dhjetor 2021) pasqyrojnë fazën e dytë të Reformës në Drejtësi, duke synuar gjatë periudhës së shtrirjes konsolidimin e kuadrit institucional, zbatimin e politikave moderne evropiane në drejtësinë penale, përmirësimin e infrastrukturës së sistemit të drejtësisë dhe mundësi të reja për teknologjinë e informacionit, përfshi zgjidhje inovative elektronike, që mbështesin një rritje thelbësore të efikasitetit dhe transparencës në sistemin e drejtësisë. Faza e tretë, e cila shtrihet 4–5 vjet (deri në 2030), konsiderohet si faza e fundit e reformave madhore, do të synojë: 1. të eliminojë *backlog*-un; 2. rritjen e cilësisë së shërbimeve; dhe 3. ofrimin e një drejtësie në nivelin dhe standardet e BE-së.

Lufta kundër korrupsionit është, gjithashtu, një nga prioritetet e Programit Drejtues të Këshillit të Ministrave, miratuar me VKM-në nr. 68/2021, “Për miratimin e përbërjes dhe programit politik të Këshillit të Ministrave”. Në këtë program ky prioritet parashikohet të realizohet nëpërmjet modernizimit të shërbimeve, konsolidimit të infrastrukturës digjitale, vazhdimin të reformave për forcimin e shtetit ligjor, si dhe forcimit të kapaciteteve institucionale kundër korrupsionit.

Lidhur me modernizimin e shërbimeve dhe konsolidimin e infrastrukturës digjitale, në seksionet “Modernizimi për zhvillim” dhe “Shoqëria digjitale”, programi parashikon ambicien e qeverisë shqiptare për të siguruar ofrimin digjital të të gjitha shërbimeve të mundshme për qytetarët, si dhe për rritjen e cilësisë së shërbimit, si një instrument i rëndësishëm dhe i pazëvendësueshëm për parandalimin e korrupsionit. Ndërsa, në drejtim të vazhdimin të reformave dhe forcimit të kapaciteteve institucionale kundër korrupsionit, programi parashikon objektivin e qeverisë për rritjen e aksesit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë nëpërmjet digjitalizimit të sistemit, si dhe zgjerimin dhe fuqizimin e Rrjetit të Koordinatorëve Kundër Korrupsionit.

Gjithashtu, me qëllim riorganizimin e strukturave antikorrupsion, një nga prioritetet e qeverisë është krijimi i Agjencisë kundër Korrupsionit. Misioni i kësaj Agjencie do të jetë parandalimi dhe lufta kundër korrupsionit në administratën publike, nëpërmjet hartimit të politikave, programeve dhe projekteve në fushën e antikorrupsionit, si dhe ndjekjes dhe hetimit

administrativ të rasteve të dyshuara për praktika korruptive.

Angazhimi i politikëbërësve drejt një agjende kombëtare antikorrupsion dhe drejt përmirësimit të kuadrit institucional dhe legjislativ në fushën e antikorrupsionit është parësor. Gjithashtu, ekziston nevoja për të forcuar vlerësimin e rreziqeve dhe dobësive ndaj korrupsionit si dhe efektivitetin e mekanizmave për parandalimin. Lufta ndaj korrupsionit përbën një qasje horizontale, e cila përfshin sektorë si transparenca, prokurimet publike, shërbimet elektronike, inspektimet dhe kontrollet financiare në administratën publike, integritetin e autoriteteve publike qendrore dhe vendore, bashkëpunimin e autoriteteve ligjzbatuese, si edhe ndërgjegjësimin dhe edukimin e publikut kundër korrupsionit.

Edukimi kundër korrupsionit mbetet një prioritet madhor. Zbatimi i kuadrit ligjor nga ana e punonjësve të institucioneve publike të ngrihet në nivelin e praktikave më të mira ndërkombëtare në këtë fushë.

Struktura e Specializuar Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK), e përbërë nga Prokuroria e Posaçme dhe Byroja Kombëtare e Hetimit, është funksionale. SPAK-u ka zhvilluar procese gjyqësore dhe hetime financiare në disa çështje të nivelit të lartë. Janë shpallur disa dënime të formës së prerë për zyrtarë të lartë. Vlerësimi kalimtar i anëtarëve të gjyqësorit vazhdon të sjellë rezultate në luftën kundër korrupsionit brenda gjyqësorit. Rritja e numrit të dënimeve të formës së prerë për zyrtarë të lartë mbetet një prioritet i rëndësishëm për të trajtuar më tej kulturën e pandëshkueshmërisë. Zbatimi i Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit në përgjithësi është në rrugën e duhur. Vetingu i anëtarëve të drejtësisë ka sjellë rezultate në luftën kundër korrupsionit. Sfidat për të ardhmen në luftën ndaj korrupsionit, duke përfshirë edhe rekomandimet e raporteve ndërkombëtare në fushën e antikorrupsionit janë:

- vazhdimi i forcimit të luftës kundër korrupsionit; progres i mëtejshëm drejt krijimit të një historie solide të hetimeve, ndjekjes penale dhe gjykimit të rasteve të korrupsionit, sekuestrimin dhe konfiskimin/rikthyerjen e aseteve kriminale që rezultojnë nga veprat e lidhura me korrupsionin;

- të sigurojë që struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK),



Prokuroria e Posaçme dhe Byroja Kombëtare e Hetimit, si dhe gjykatat e SPAK-ut të trajtojnë efektivisht korrupsionin e nivelit të lartë; të sigurojë burime, aftësi dhe bashkëpunim të përshtatshëm ndërmjet këtyre strukturave të reja dhe subjekteve të tjera prokuroriale dhe gjyqësore;

- të sigurojë që procedurat penale të nisin në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike kundër gjyqtarëve dhe prokurorëve të akuzuar për sjellje kriminale gjatë procesit të rivlerësimit;

- adresimi efektiv i rekomandimeve të GRECO-s dhe zbatimi i planit të veprimit përkatës brenda kornizës kohore.

14. FORCIMI I MËTEJSHME I ADMINISTRATËS PUBLIKE

Krijimi i institucioneve të qëndrueshme dhe një shërbimi civil modern, profesional dhe të depolitizuar vijojnë të jenë komponentë të rëndësishëm të reformës në administratën publike, si një nga prioritetet kyç të qeverisë shqiptare në procesin e integritetit evropian.

Si rezultat i implementimit të Strategjisë Ndërsëktoriale të Reformës në Administratën Publike dhe Planit të saj të Veprimit 2015–2022, janë shënuar arritje të rëndësishme në drejtim të reformimit të shërbimit civil.

Prioriteti dhe sfida më e afërt është hartimi i strategjisë së re të reformës në administratën publike.

Gjithashtu, në drejtim të konsolidimit të institucioneve publike dhe shërbimit civil, përpjekjet tona në vijim do të fokusohen në:

- rritjen e performancës institucionale të administratës publike, përmirësimin e mekanizmave të llogaridhënies dhe menaxhimit e performancës së bazuar në rezultate;

- rritjen e atraktivitetit të administratës publike, duke siguruar një paketë shpërblimi të drejtë dhe konkurruese përmes zbatimit të reformës së pagave;

- zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të rekrutimit në shërbimin civil të bazuar në meritë;

- përmirësimin e legjislacionit të shërbimit civil dhe unifikimin e praktikave të menaxhimit të burimeve njerëzore në të gjithë institucionet e administratës publike përfshirë pushtetin vendor;

- zhvillimin e kapaciteteve institucionale, veçanërisht përballë sfidave të shtuara me çeljen e negociatave për anëtarësimin në BE, përmes programeve efikase të trajnimit të ofruara nga

ASPA.

15. SIGURIA SHËNDETËSORE

Qeveria e Shqipërisë me një përgjigje efektive ndaj pandemisë COVID-19 me kujdes social dhe shëndetësor, duke mbrojtur grupet me risk të lartë, mbajtjen nën kontroll dhe zvogëlimin e rrezikut të përhapjes së mëtejshme të virusit; ofrimin e shërbimeve të tjera të domosdoshme të kujdesit shëndetësor, përtej rasteve të paraqitura me COVID-19, për të gjitha grup-moshat e popullsisë, duke përfshirë të moshuarit, mbrojtjen dhe përfshirjen sociale të familjeve e fëmijëve, përmes zvogëlimit të pasojave të krizës për shkak të pandemisë; vazhdimin e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror në tërësi; ofrimin në mënyrë të pandërprerë të shërbimeve mbështetëse të specializuara për fëmijët dhe familjet e prekuara nga dhuna dhe abuzimi.

Në këtë kuadër, koordinimi i të gjitha aktiviteteve të përgjigjes në nivele të ndryshme të sistemit shëndetësor dhe jo vetëm, si dhe integrimi i aktiviteteve me të gjithë sektorët dhe partnerët e tjerë të interesuar përbën një qasje gjithëinstitucionale: duke fuqizuar politikat, procedurat dhe kapacitetet për të parandaluar epidemitë, pandemitë dhe emergjencat; duke siguruar gatishmëri kombëtare dhe rajonale për reagimin e koordinuar ndaj emergjencave shëndetësore; duke fuqizuar sigurinë ushqimore, biologjike dhe biokimike, radioaktive bazuar në standardet ndërkombëtare; duke fuqizuar sistemin e mbikëqyrjes në tërësi, nga përgjigjja apo reagimi në kohë ndaj emergjencave deri tek komunikimi i riskut; si dhe duke përmirësuar dhe forcuar kujdesin shëndetësor për impaktin në shëndetin mendor.

16. SIGURIMI I USHQIMIT DHE STAN-DARDET

Siguria ushqimore lidhet ngushtësisht me aksesin fizik të popullatës në ushqimet bazë, garantimin e zinxhirit të furnizimit në kohë dhe sigurimin e nivelit më të lartë të mbrojtjes së shëndetit të popullatës dhe interesit e konsumatorëve.

Situata aktuale e sigurisë ndërkombëtare solli çrregullimin e tregjeve agroushqimore dhe rritjen e menjëhershme të çmimeve të produkteve ushqimore bazë në treg. Po kështu, u rritën çmimet e imputeve bujqësore, të cilat sigurohen tërësisht nga importi, si dhe çmimi i naftës. Situata e krijuar



solli fokusimin e qeverisë në gjetjen e mekanizmave për të subvencionuar dhe mbështetur sektorin e bujqësisë në vend me prioritet sigurimin e nevojave të popullatës me produktet bazë ushqimore.

Nëpërmjet akteve normative u rrit sasia e mbështetjes për fermerët në Skemën Kombëtare për vitin 2022 në 5.1 miliardë lekë, nga e cila përfituan rreth 48 mijë fermerë. Krahas mbështetjes me naftë falas për bujqësinë në një sipërfaqe prej rreth 126 mijë ha për rreth 35 mijë fermerë, mbështetja kryesore përfshiu sektorin e blegtorisë, kultivimin e perimeve në serra, si dhe kultivimin e grurit, të mbjellë në vjeshtën e vitit të kaluar. Prodhimi i drithërave për vitin 2022 shënoi një rritje të lehtë krahasuar me vitin 2021, ndërsa i patateve dhe i fasuleve ishte thuajse në të njëjtën tregues. Ndërsa të dhënat e importeve tregojnë se sasia e drithërave të importuar është ulur, ndërsa sasia e importuar e produkteve të bulmetit ka qenë e njëjtë me vitin e mëparshëm.

MBZHR-ja, në funksion të mbrojtjes së konsumatorit për vitin 2022, ka përgatitur programet e kontrollit të sëmundjeve zoonotike. Gjatë vitit 2022 janë monitoruar fermat mbi 5 krerë e lart, krahasimisht me fermat 10 krerë e lart që janë gjurmuar në vitet paraardhëse. Për kontrollin e tuberkulozit në gjedh është zbatuar programi afatgjatë, i cili konsiston në gjurmimin e kafshëve të llojit gjedh me turbekulinë bovine dhe aviare. Gjithashtu, ka vazhduar kontrolli i sëmundjes së tërbimit nëpërmjet vaksinimit të dhelprave të kuqe nga ajri me mbështetjen e BE-në.

Gjithashtu, edhe për vitin 2023 është planifikuar të hartohen dhe zbatohen programet e kontrollit të sëmundjeve së brucelozës në të imta, brucelozës në gjedh, tuberkulozit, plasjes, kontrolli i sëmundjes së tërbimit, nëpërmjet vaksinimit të dhelprave të kuqe nga ajri me mbështetjen e BE-së, si dhe programi i mbikëqyrjes për detektimin e hershëm të sëmundjes së influencës aviare.

Një pjesë e mirë e këtyre çështjeve dhe masave nga MBZHR-ja janë përfshirë edhe në strategjinë kombëtare të bujqësisë, zhvillimit rural dhe peshkimit 2021–2027 të miratuar me VKM-në nr. 460, datë 29.6.2022, “Për miratimin e strategjisë së bujqësisë, zhvillimit rural dhe peshkimit, 2021–2027, si dhe VKM-në nr. 366, datë 16.6.2023, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Sigurisë Ushqimore 2023–2027”.

Siguria ushqimore është, gjithashtu, një tjetër element shumë i rëndësishëm me ndikim në shëndetin e popullatës. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU) është institucioni përgjegjës për kontrollin në të gjithë territorin e vendit mbi sigurinë ushqimore dhe mbrojtjen e konsumatorit në të gjitha fazat e zinxhirit: importimit, prodhimit, përpunimit, magazinimit dhe tregtimit të produkteve ushqimore, ushqimeve për kafshë, inputeve bujqësore dhe veprimtarive prodhuese të duhan-cigareve, si dhe sigurinë e shëndetit të kafshëve në pikat kufitare, në zbatim të kërkesave të legjislacionit në fuqi. Forcimi i kapaciteteve të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit nëpërmjet rritjes së cilësisë së inspektimeve në fushën e ushqimit, ushqimit për kafshë dhe inputeve bujqësore, si dhe bashkëpunimin me institucionet e tjera ligjzbatuese për të forcuar kontrollin ndaj subjekteve që ushtrojnë aktivitete antiligjore që cenojnë sigurinë ushqimore, me qëllim garantimin e ushqimit me standardet e kërkuara dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve.

17. FORCIMI I KOHEZIONIT SHOQËROR DHE IDENTITETIT KOMBËTAR

Kohezioni shoqëror është faktor vendimtar i sigurisë kombëtare. Vendi ynë ka një popullsi në masë më të madhe homogjene dhe, gjithashtu, mbrojtja dhe garantimi i të drejtave të pakicave kombëtare ka njohur arritje të qëndrueshme nëpërmjet një kuadri ligjor përkatës, si dhe masave e programe konkrete.

Megjithatë, e kaluara diktatoriale ka lënë ende gjurmë në organizimin e brendshëm shoqëror, duke ndikuar në rrjedhën e zhvillimit normal demokratik, politik, social, ekonomik dhe duke ndikuar në avancimin e mëtejshme të vlerave të solidaritetit shoqëror, tolerancës dhe multikulturalizmit. Për këtë arsye përkrahja për shtresat apo grupet shoqërore të paprivileguara duhet të qëndrojnë në themel të politikave sociale, në mënyrë që të ndërtohet një shoqëri e drejtë dhe solidare, çka i shërben konsolidimit të mëtejshëm të sigurisë së vendit. Në këtë kuadër duhet përfunduar procesi i dëshmipërblimit ekonomik dhe moral i të përndjekurve politikë të diktaturës komuniste, me qëllim integrimin e plotë të kësaj shtrese në shoqëri. Gjithashtu, në drejtim të përmirësimit të kohezionit social duhet të punohet në drejtim të vënies në jetë të politikave gjithëpërfshirëse, për sa i përket arsimimit dhe punësimit për grupet e



margjinalizuara dhe individët me nevoja të posaçme. Krahas kësaj vendi ynë duhet të vijojë punën në drejtim të avancimit të agjendës së barazisë gjinore, fuqizimit ekonomik, parandalimit të dhunës me bazë gjinore, si dhe rritjes së pjesëmarrjes së grave në jetën politike, shoqërore dhe ekonomike të Shqipërisë.

Në lidhje me mirëqenien, rritjen e kohezionit social dhe mbrojtjen për gratë, fëmijët, të moshuarit dhe grupet e cënueshme, nëpërmjet mbështetjes social-ekonomike janë ndërmarrë hapa dhe reforma për të luftuar pasigurinë, për shkak të dhunës, përfshirë edhe dhunën *online*.

Zbatimi i instrumenteve ndërkombëtare të ratifikuara dhe zhvillimi i qëndrueshëm janë në themel të strategjive dhe mbështetjes sociale-ekonomike në kushtet e COVID-19 për këto grupe. Gjithashtu, është kryer menaxhimi i rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje gjatë fatkeqësisë natyrore COVID-19 dhe në vazhdimësi.

Mbrojtja gjatë fatkeqësive natyrore, në veçanti gjatë tërmetit 2019 dhe pandemisë COVID-19 duhet të ofrojë akses të barabartë si në ndihmën humanitare, ashtu dhe në mbrojtjen e të drejtave të njeriut duke marrë në konsideratë gjininë, dhunën me bazë gjinore, mbrojtjen e fëmijëve, moshën dhe aftësinë e kufizuar.

18. ZHVILLIMI I NJË SISTEMI ARSIMOR CILËSOR

Sistemi arsimor cilësor është baza për zhvillimin shoqëror dhe rritjen ekonomike. Mirarsimimi i brezave ndikon në kohezionin e shoqërisë, garanton ruajtjen dhe përcimin e vlerave kombëtare, kontribuon në rritjen e ndërgjegjes qytetare, përgjegjshmërisë qytetare dhe në konsolidimin e institucioneve publike dhe proceseve të politikëbërjes.

Dokument i kryesor strategjik që adreson dhe mbulon me detaje politikën, qëllimet dhe angazhimet konkrete në fushën e arsimit është Strategjia Kombëtare për Arsimin (SKA) 2021–2026, dokument i cili është në koherencë të plotë me objektivat strategjike të kornizës evropiane për bashkëpunim midis vendeve të Bashkimit Evropian në fushën e arsimit dhe të formimit. Vizioni i strategjisë miratuar me VKM-në nr. 621, datë 22.10.2021, synon një sistem arsimor cilësor i bazuar në parimet e gjithëpërfshirjes, ndërkohë që prioritet do të jetë sigurimi i arsimit cilësor për të gjitha nivelet e arsimit dhe kërkimit shkencor, duke

përmirësuar kushtet e mësimdhënies e mësimnxënies e duke siguruar kushte të barabarta për pjesëmarrje, me synim plotësimin e standardeve evropiane.

Ndryshimet e vazhdueshme të zhvillimit ekonomik dhe fenomenet e ndryshme globale apo lokale kërkojnë fuqizimin jo vetëm të kapaciteteve infrastrukturore, por mbi të gjitha fuqizimin e kapaciteteve njerëzore. Pandemia e shkaktuar nga COVID-19 shkaktoi një krizë në sektorë të ndryshëm, ku arsimi ishte një nga sektorët më të prekur dhe përballimi i situatës kërkoj një angazhim të madh. Fuqizimi i kapaciteteve të komponentit njerëzor është baza për të rritur edhe sigurinë kombëtare.

Edukimi gjithëpërfshirës vlerësohet si një komponent bazë për edukimin qytetar në kuadrin e formimit të zhvillimit personal, gjithashtu edhe në kuadrin e përballimit të situatave kritike, siç janë fatkeqësitë natyrore, sulmet kibernetike, terrorizmi, kërcënimet territoriale etj. që cenojnë sigurinë kombëtare të vendit tonë.

Sistemi arsimor shqiptar do të jetë i sinkronizuar me kërkesat dhe pritshmëritë e ekonomisë, dhe sfidat e sigurisë dhe do të sigurohet fuqi punëtore e gatshme për të konkurruar në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar. Kërcënimet e reja në rritje të sigurisë kibernetike kanë rritur nevojën për ekspertë të specializuar në këtë fushë, duke nxjerrë në pah domosdoshmërinë e përditësimit të kurrikulave universitare për programet ekzistuese në fushën e teknologjisë së informacionit, si dhe nevojën e krijimit të programeve të reja për të plotësuar nevojat në nivel kombëtar. Investimi në fushën e dijës dhe kërkimit shkencor në fushën e sigurisë vlerësohet si një objektiv strategjik me përfitime afatgjata për sigurinë kombëtare.

Zhvillimi i kompetencës digjitale nëpërmjet shfrytëzimit më të mirë të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për mësimdhënie dhe të nxënë luan rol vendimtar në ditët e sotme kur siguria mund të kërcënohet papritmas. Teknologjia e informacionit dhe e komunikimit (TIK) mund të ketë ndikim pozitiv në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, në shtimin e motivimit dhe përmirësimin e performancës së nxënësve dhe studentëve. Në rastin e situatave të paparashikueshme siç janë pandemia ose fatkeqësitë natyrore, TIK-u ofron mundësi për organizimin e mësimin në distancë,



ndërkaq, në situata normale, teknologjia mund të shfrytëzohet për avancimin e procesit mësimor në shkolla dhe auditore. Paralelisht kjo duhet të lidhet edhe me ndërgjegjësimin për sigurinë në internet, mbrojtjen e të dhënave personale, mbi privatësinë, dhe problemet e mbrojtjes së fëmijëve *online*.

Konsolidimi i mjediseve të sigurta dhe miqësore për fëmijët në shkollë, nëpërmjet hartimit dhe miratimit të planit të veprimit për shkolla të sigurta, krijimi i sistemit për identifikimin, parandalimin dhe raportimin e dhunës, bullizmit, ekstremizmit të dhunshëm dhe minimizimit të gjuhës së urrejtjes në shkolla, përfaqëson një tjetër objektiv që lidhet me sigurinë në arsim. Gjithashtu, mbrojtja e fëmijëve në internet përbën një objektiv të rëndësishëm për të garantuar sigurinë e fëmijëve në nivel kombëtar. MAS-i, në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë, do të vazhdojë programet për ndërhyrjet që sjellin përmirësimin e klimës në shkollë, si parakusht për parandalimin e dhunës.

Nisur nga përvoja e projektit me Këshillin e Evropës për parandalimin e bullizmit dhe radikalizmit dhe projektit për forcimin e edukimit për qytetari demokratike që është në proces, po vijohet që këto përvoja të shtrihen në të gjitha shkollat, duke krijuar shkolla demokratike dhe miqësore.

Parandalimi i krimit kibernetik dhe bullizmit të rinjve në formë kibernetike është, gjithashtu, një prioritet i veçantë i ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Rinisë 2022–2029, dhe veçanërisht objektivit specifik 3.1, *“Mbrojtja, mbështetja dhe siguria e të rejave dhe të rinjve, veçanërisht e atyre në situatë rreziku, në vendin ku jetojnë dhe hapësirën digjitale”*.

Në zbatim të VKM-së nr. 930, datë 18.11.2015, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe planit të veprimit”, që nga viti shkollor 2019–2021 në bashkëpunim me Qendrën e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (Qendra CVE), MAS ka punuar për rritjen e kapaciteteve në mjediset shkollore për të identifikuar praninë e ekstremizmit të dhunshëm, si dhe për përmirësimin e njohurive të kapaciteteve (mësues, drejtues, shërbimi psikosocial, oficerët e sigurisë) për të parandaluar dhe luftuar ekstremizmin e dhunshëm. Në çdo institucion arsimor parauniversitar ka një mësues koordinator të parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm, si dhe është punuar në drejtim të

konsolidimit të rrjetit të mësuesve koordinatorë për parandalimin e ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm në arsimin parauniversitar. Në institucionet arsimore janë hartuar planet vjetore për parandalimin dhe luftën kundër bullizmit, ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm.

MAS-i në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme synon rritjen e sigurisë nëpërmjet ndërveprimit dhe parandalimit përmes marrëveshjes së nënshkruar mes palëve, e cila kërkon të krijojë një qasje të re nëpërmjet projektit “Shkolla të sigurta - Oficerët e sigurisë në shkolla”. Për vitin shkollor 2021–2022 në institucionet arsimore publike ofruan shërbimin 150 oficerë sigurie. Për vitin shkollor 2022–2023 u shtuan edhe 70 oficerë sigurie në institucionet arsimore.

19. ZHVILLIMI KULTUROR

Gjuha shqipe përfaqëson elementin themelor të identitetit tonë kombëtar. Ajo është lidhja bashkuese e të gjithë shqiptarëve në rajon dhe në botë. Gjuha shqipe krijon një hapësirë të gjerë kulturore, shoqërore dhe ekonomike, me potencial të lartë për të prodhuar siguri dhe stabilitet për rajonin dhe me gjerë. Në kushtet e globalizmit dhe përhapjes së teknologjive të reja të komunikimit, gjuha shqipe, ashtu si gjuhët e tjera, përballet në vijimësi me hyrjen e frazeologjive dhe terminologji të reja të lidhura me dukuritë e reja teknologjike dhe sociale në aspektin global. Ky proces i pashmangshëm nënvizon domosdoshmërinë e ngritjes së mekanizmave akademikë mbikëqyrës dhe analizues të ecurisë së gjuhës shqipe me synim ndërhyrjet e mirëmenduara për ruajtjen, homologimin, zhvillimin e saj harmonik, si dhe për promovimin e gjuhës dhe kulturës shqiptare në botë.

Për sa i përket veçanërisht gjuhës shqipe, sfidë aktuale e sektorit është hartimi i një kuadri ligjor, strategjik e institucional, në mbrojtjen dhe përmirësimin e statusit të saj përmes:

- Reformave ligjore për mbrojtjen e gjuhës shqipe (të folur dhe të shkruar, dialekteve dhe nëndialekteve të saj, folklorit letrar etj.);

- Krijimit të klimës së përshtatshme dhe nxitjes së diskutimit konstruktiv për ruajtjen, mbrojtjen, transmetimin dhe popullarizimin e pasurisë gjuhësore të trashëguar, duke përfshirë këtu edhe mbrojtjen e kultivimit të gjuhëve të pakicave;

- Ruajtjes dhe forcimit të identitetit kombëtar nëpërmjet ruajtjes së trashëgimisë kulturore



jomateriale, si dhe gjuhës shqipe, si vektor të transmetimit të kësaj trashëgimie;

- Mbajtjes gjallë të traditave dhe gjuhës shqipe në diasporë, nëpërmjet organizimit të Ditëve Kombëtare, por edhe publikimit të regjistrit të elementeve të TJM *online*, rritjes së vazhdueshme të prezencës së informacionit shqip në *web* etj.

Shoqëria shqiptare ka një trashëgimi kulturore, historike, arkeologjike dhe etnografike të pasur, e cila përbën një vlerë të pazëvendësueshme shpirtërore dhe identitare të kombit. Mbrojtja dhe ruajtja e kësaj trashëgimie kulturore, historike, arkeologjike dhe etnografike të Shqipërisë do të kryhet në funksion të interesave kombëtare nëpërmjet zbatimit të politikave të posaçme ndërsektoriale. Duke pasur parasysh rolin udhëheqës të UNESCO-s në mbrojtjen e kulturës dhe promovimin e pluralizmit kulturor (Rezoluta 38.C48 e Konferencës së Përgjithshme të UNESCO), vendi ynë do të intensifikojë bashkëpunimin me UNESCO, Bashkimin Evropian dhe Këshillin e Evropës dhe organizma të tjerë ndërkombëtarë, në funksion të ruajtjes së pasurive kulturore dhe diversitetit, si mjet për zhvillim dhe paqe.

Me rëndësi të veçantë është parandalimi, mbrojtja, përgjigjja efektive ndaj fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera në pasuritë kulturore dhe muzeore në funksion të ruajtjes, rehabilitimit dhe rimëkëmbjes, si dhe parandalimit të trafikimit të paligjshëm të tyre. Ky objektivi do të arrihet nëpërmjet masave si më poshtë:

- struktura organizative të dedikuara dhe koordinim ndërinstitucional në rast të fatkeqësive natyrore;

- plan-veprimi për emergjencat civile për trashëgiminë kulturore dhe muzetë në nivel kombëtar dhe rajonal;

- protokolle të emergjencave civile në institucionet përgjegjëse për trashëgiminë kulturore me procedura standarde për mënyrat e veprimit në rastet e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera;

- hartimi i një databaze të integruar të vlerësimit të riskut për pasuritë kulturore dhe muzeore (hartëzimi i riskut);

- dokumentimi, inventarizimi dhe digjitalizimi i trashëgimisë kulturore dhe muzeore;

- forcimi i kapaciteteve të autoriteteve përgjegjëse ndërinstitucionale në funksion të

parandalimit, zvogëlimit të riskut për pasuritë kulturore dhe muzeore dhe trafikimit të paligjshëm të tyre, si dhe përgjigjes efektive në rastet e fatkeqësive natyrore;

- edukimi, sensibilizimi i opinionit publik dhe nxitja e iniciativave vullnetare për parandalimin e risqeve dhe ruajtjes së pasurive kulturore në rast të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera.

Objektivi i rëndësishëm i ruajtjes, mbrojtjes dhe vlerësimit të trashëgimisë kulturore dhe historike, në funksion të interesave kombëtarë, ruajtjes së kujtesës dhe identitetit kombëtar si mjete për zhvillim dhe paqe, synohet të arrihet nëpërmjet zbatimit të masave si më poshtë:

- dokumentimi, inventarizimi dhe digjitalizimi i pasurive kulturore materiale, jomateriale, si dhe pasurive muzeore në kohë paqe;

- programe edukuese, ndërgjegjësuere dhe promovuese për rëndësinë e ruajtjes dhe e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore në kohë paqe;

- rritja dhe përmirësimi i kapaciteteve të strukturave përgjegjëse të sistemit të trashëgimisë kulturore dhe grupeve vullnetare në kohë paqe për përballimin e situatave në rast konflikti të armatosura;

- struktura drejtuese të dedikuara dhe koordinim ndërinstitucional, në rast të konflikteve të armatosura;

- plan-veprimi ndërinstitucional për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe zhvendosjen e pasurive kulturore të luajtshme dhe muzeore bazuar në dokumentet guidë të UNESCO-s³, Bashkimit Evropian, Këshillit të Evropës dhe institucioneve/organizmave të tjerë ndërkombëtarë⁴;

- Integrimi në rregulloret aktuale ushtarake të dispozitave për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe muzeore dhe parandalimin e trafikimit të paligjshëm bazuar në dokumente guidë të UNESCO-s⁵;

³ Managing Disaster Risks for World Heritage, “Endangered Heritage Emergency Evacuation of Heritage Collections”, Reducing Disasters Risks at World Heritage Properties, Konventa e Hagës “Mbi mbrojtjen e vlerave kulturore në rast konflikti të armatosur”, si dhe në protokollin dhe rregulloren mbi zbatimin e kësaj konvente, adoptuar nga Konferenca e UNESCO-s në Hagë më 14 maj 1954”.

⁴ ICOMOS, ICCROM, ICOM

⁵ Protection of Cultural Property, Military Manual.



- Bashkëpunimi dhe koordinimi ndërmjet Forcave të Armatosura, mbrojtjes civile dhe autoriteteve përgjegjëse për trashëgiminë kulturore;

- Përfshirja e mbrojtjes së pasurisë kulturore në aksionet dhe përgjigjen humanitare.

Do të forcohen, gjithashtu, kapacitetet e administratës publike përgjegjëse për trashëgiminë kulturore për parandalimin, zbutjen dhe rikuperimin e dëmeve në pasuritë kulturore në raste të fatkeqësive natyrore apo konflikteve të mundshme të armatosura.

20. ZBATIMI DHE PËRGJEGJËSITË

Strategjia e Sigurisë Kombëtare zbatohet nga sistemi i sigurisë kombëtare, autoritetet e të cilit përcaktohen nga Kushtetuta dhe ligjet e vendit. Zbatimi i suksesshëm i kësaj Strategjie do të realizohet përmes një procesi gjithëpërfshirës, që angazhon të gjithë aktorët dhe faktorët e tjerë të shoqërisë që kanë mundësi dhe kapacitete për të kontribuar në shërbim të sigurisë. Përgjegjësinë kryesore institucionale për zbatimin e SSK-së e ka Këshilli i Ministrave, institucionet në varësi të tij dhe ministrinë e linjës.

Brenda 6 (gjashtë) muajve nga miratimi i SSK-së, institucionet përgjegjëse ngarkohen me detyrën për të hartuar strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale, në zbatim të kësaj Strategjie. Kryeministri i paraqet Kuvendit të RSH-së dhe Presidentit të Republikës një raport të përvitshëm për gjendjen e sigurisë kombëtare. Monitorimi i zbatimit të Strategjisë bëhet nga Kuvendi i RSH-së nëpërmjet instrumenteve të kontrollit që i jep Kushtetuta dhe ligjet e vendit.

SSK-ja do të rishikohet, si rregull, pas 5 (pesë) vjetësh, në varësi të zhvillimeve të sigurisë brenda dhe jashtë vendit.

DEKRET

Nr. 86, datë 26.2.2024

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 14/2024, “Për miratimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Bajram Begaj

LIGJ

Nr. 15/2024

PËR STRATEGJINË E MBROJTJES SË MJEDISIT DETAR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË⁶

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi i ligjit

Qëllimi i këtij ligji është arritja dhe ruajtja e statusit të mirë mjedisor të ujërave detare të detit Mesdhe, të cilat janë nën sovranitetin e Republikës së Shqipërisë.

⁶ Ky ligj është përafëruar pjesërisht me direktivën 2008/56/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 17 qershor 2008 “Për krijimin e kuadrit të veprimit të komunitetit në fushën e politikave mjedisore detare (Direktiva Kuadër e Strategjisë Detare), e ndryshuar”. Numri CELEX 32008L0056, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, nr. 164, datë 25.6.2008, f. 19–40.



Neni 2 Objekti i ligjit

Objekti i këtij ligji është hartimi dhe zbatimi i Strategjisë së Mbrojtjes së Mjedisit Detar të Republikës së Shqipërisë me synim:

- a) mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit detar;
- b) parandalimin e përkeqësimit të mjedisit detar;
- c) restaurimin e ekosistemeve detare, që janë prekur negativisht; si dhe
- ç) parandalimin dhe uljen e hedhjeve në mjedisin detar, me qëllim eliminimin gradual të ndotjes, siç përcaktohet në pikën 6 të nenit 4 të këtij ligji, për të siguruar që nuk ka ndikime apo rreziqe të rëndësishme ndaj biodiversitetit detar, ekosistemeve detare, shëndetit të njeriut apo përdorimet e ligjshme të detit.

Neni 3 Fusha e zbatimit të ligjit

1. Dispozitat e këtij ligji zbatohen në të gjitha ujërat detare, siç përcaktohet në nenin 4 të këtij ligji, duke marrë parasysh ndikimet ndërkuftare në cilësinë e mjedisit detar të shteteve të tjera me të cilat Republika e Shqipërisë ndan sovranitetin e saj mbi ujërat detare të nënrajoneve I dhe II.

2. Dispozitat e këtij ligji zbatohen nga organet përgjegjëse për menaxhimin e burimeve ujore, për hartimin e zbatimin e politikave për turizmin detar, për zonat e mbrojtura detare, për biodiversitetin dhe monitorimin e ujërave detare.

3. Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen për aktivitetet, qëllimi i vetëm i të cilave është mbrojtja ose siguria kombëtare. Autoritetet kompetente do të përpiqen të sigurojnë që këto aktivitete të kryhen në një mënyrë që është në përputhje, për aq sa është e arsyeshme dhe praktike, me objektivat e këtij ligji.

Neni 4 Përkufizime

Për qëllimet e këtij ligji zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

1. “Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore” është organi përgjegjës për menaxhimin e integruar të burimeve ujore sipas legjislacionit për burimet ujore.

2. “Bashkëpunimi rajonal” është bashkëpunimi dhe koordinimi i veprimtarive ndërmjet shteteve që ndajnë sovranitetin mbi detin Adriatik dhe detin Jon, kur është e mundur, me vendet e rajonit detar mesdhetar dhe nënrajoneve detare I e II, me qëllim zhvillimin dhe zbatimin e strategjive për mbrojtjen e mjedisit detar.

3. “Elementet e kriterëve” janë elementet përbërëse të një ekosistemi, veçanërisht elementet e tij biologjike (speciet, habitatet dhe bashkësitë e tyre) apo aspektet e presioneve në mjedisin detar (biologjik, fizik, substancat, mbeturinat biologjike e fizike, si dhe energjia), të cilat vlerësohen nën secilin kriter.

4. “Konventa rajonale e detit” është Konventa për Mbrojtjen e Mjedisit Detar dhe Zonës Bregdetare të Detit Mesdhe, përfshirë protokollet e ratifikuara, Konventa e Barcelonës e vitit 1976.

5. “Kriteret” janë karakteristikat dalluese teknike që janë të lidhura ngushtë me karakteristikat cilësore.

6. “Ndotje” është futja e drejtpërdrejtë ose tërthorazi në mjedisin detar, si pasojë e veprimtarisë njerëzore, e substancave dhe e energjisë, përfshirë zhurmat në ujërat detare të shkaktuara nga dora e njeriut, si dhe nga veprimtaria industriale, bujqësore, agropërpunuese, urbane dhe e trafikut detar, gjë që sjell apo ka gjasa të sjellë si pasojë ndikime të dëmshme, të tilla si: dëmtimi i gjallesave dhe i ekosistemeve detare, përfshirë humbjen e biodiversitetit, rreziqet ndaj shëndetit të njeriut, pengesat ndaj veprimtarive detare, përfshirë peshkimin, turizmin dhe përdorime të tjera të ligjshme të detit, dëmtimi i cilësisë për përdorimin e ujit të detit dhe zvogëlimi i pajisjeve ose, në përgjithësi, dëmtimi i përdorimit të qëndrueshëm të mallrave dhe të shërbimeve detare.

7. “Nënrajonet detare” janë nënrajonet deti Adriatik (nënrajoni I) dhe deti Jon e deti i Mesdheut Qendror (nënrajoni II), pjesë përbërëse të rajonit detar të Mesdheut nën sovranitetin shqiptar.

8. “Nënndarjet e nënrajoneve detare” janë nënndarjet e bëra me qëllim zbatimin e këtij ligji.

9. “Objektiv mjedisor” është gjendja cilësore ose sasiore e synuar e përbërësve të ndryshëm të ujërave detare në nënrajonet detare I dhe II, si dhe e presioneve e ndikimeve mbi to. Objektivat mjedisorë përcaktohen në përputhje me nenin 10 të këtij ligji.



10. “Rajon detar” është deti Mesdhe (Mesdheu).

11. “Lloj i huaj” është një kafshë, bimë apo mikroorganizëm, që ndodhet jashtë shtrirjes natyrore dhe potencialit të përhapjes dhe përfshin çdo pjesë ose gamet, që mund të mbijetojë dhe të riprodhohet.

12. “Lloj i huaj invaziv” është një lloj i huaj, që zë vend në ekosisteme, habitate ose peizazhe a që vepron si një faktor ndryshimi dhe kërcënon mjedisin, shëndetin e njeriut ose zhvillimin e qëndrueshëm.

13. “Status mjedisor” është gjendja e përgjithshme e mjedisit në ujërat detare, duke marrë parasysh strukturën, funksionin dhe proceset e ekosistemeve detare përbërëse, së bashku me faktorët natyrorë fiziografikë, gjeografikë, biologjikë, gjeologjikë dhe klimatikë, si dhe kushtet fizike, akustike dhe kimike, përfshirë ato që rezultojnë nga veprimtaria njerëzore brenda ose jashtë zonës në fjalë.

14. “Status i mirë mjedisor” është statusi mjedisor i ujërave detare, ekologjikisht të larmishme dhe dinamike, i cili është i pastër, i shëndetshëm dhe produktiv brenda kushteve të tij të brendshme, ndërsa përdorimi i mjedisit të tij detar është në një nivel të qëndrueshëm, duke mbrojtur kështu potencialin për t’u përdorur nga brezat aktualë dhe të ardhshëm, ku përfshihen:

a) struktura, funksionet dhe proceset e ekosistemeve detare përbërëse, së bashku me faktorët e lidhur fizikë, gjeografikë, biologjikë, kimikë, gjeologjikë dhe klimatikë, që lejojnë që këto ekosisteme të funksionojnë plotësisht dhe të ruajnë qëndrueshmërinë e tyre ndaj ndryshimeve mjedisore të shkaktuara nga dora e njeriut. Speciet detare dhe habitatet janë të mbrojtura, rënia e biodiversitetit e shkaktuar nga dora e njeriut është parandaluar dhe përbërësit e ndryshëm biologjikë funksionojnë në ekuilibër;

b) vetitë hidromorfologjike, fizike dhe kimike të ekosistemeve, përfshirë ato veti që rezultojnë nga veprimtaria njerëzore në zonën në fjalë, që mbështesin ekosistemet. Prurjet antropogjene të substancave dhe energjisë, përfshirë zhurmën në mjedisin detar nuk shkaktojnë efekte të ndotjes;

c) statusi i mirë mjedisor, në nivelin e nënrajoneve detare I dhe II, përcaktohet në bazë të karakteristikave cilësore të përcaktuara në këtë ligj. Do të aplikohet një menaxhim i orientuar në përshtatje me bazat e ekosistemit, me qëllim

arritjen e statusit të mirë mjedisor.

15. “Strategjia për mbrojtjen e mjedisit detar” është strategjia që do të hartohet dhe zbatohet në lidhje me nënrajonet I dhe II në Republikën e Shqipërisë në përputhje me nenin 5 të këtij ligji.

16. “Ujëra detare” janë:

a) ujërat, shtrati i detit dhe nëntoka në anën e detit të vijës bazë, nga e cila matet shtrirja e ujërave territoriale, duke u shtrirë deri në kufijtë e zonës ku Republika e Shqipërisë ushtron të drejtat e sovranitetit, në përputhje me konventën e OKB-së për të Drejtën e Detit (UNCLOS, 1982);

b) ujërat bregdetare, shtrati i detit dhe nëntoka e tyre në përputhje me përkufizimin e përcaktuar në legjislacionin për burimet ujore, për aq sa aspektet e veçanta të statusit mjedisor të mjedisit detar nuk trajtohen prej tij apo nga një legjislacion tjetër.

17. “Vlera prag” është një vlerë ose varg vlerash që bëjnë të mundur vlerësimin e nivelit të cilësisë së arritur për një kriter të veçantë, duke kontribuar kështu në vlerësimin e nivelit të arritur të statusit të mirë mjedisor.

KREU II

HARTIMI DHE ZBATIMI I STRATEGJISË SË MBROJTJES SË MJEDISIT DETAR

Neni 5

Strategjia e Mbrojtjes së Mjedisit Detar të Republikës së Shqipërisë

1. Strategjia e Mbrojtjes së Mjedisit Detar të Republikës së Shqipërisë hartohet sipas fazave të mëposhtme:

a) faza përgatitore, e cila përbëhet nga:

i. vlerësimi fillestar i statusit aktual mjedisor të ujërave detare të nënrajoneve detare I e II dhe ndikimit mjedisor të veprimtarisë njerëzore mbi to në përputhje me nenin 8 të këtij ligji;

ii. përcaktimi i statusit të mirë mjedisor të ujërave detare në përputhje me nenin 9 të këtij ligji;

iii. përcaktimi i objektivave mjedisore dhe i treguesve të lidhur me to për ujërat detare në përputhje me nenin 10 të këtij ligji;

iv. hartimi dhe zbatimi i programit të monitorimit për vlerësimin e vazhdueshëm e përditësimin e rregullt të objektivave në përputhje me nenin 11 të këtij ligji;

v. publikimi i raporteve dhe raportimi i tyre në përputhje me nenet 15 e 16 të këtij ligji.



b) faza e përcaktimit të programit të masave, që do të merren për të arritur ose për të ruajtur statusin e mirë mjedisor të ujërave detare të Republikës së Shqipërisë, sipas nenit 12 të këtij ligji, i cili duhet të përfshijë:

i. identifikimin e masave që do të merren dhe afatet për realizimin e tyre, me qëllim arritjen ose ruajtjen e një statusi të mirë mjedisor të ujërave detare të Republikës së Shqipërisë;

ii. identifikimin e përjashtimeve nga detyrimi për të arritur një status të mirë mjedisor të ujërave detare të Republikës së Shqipërisë; si dhe

iii. informacionin për pamundësinë e arritjes së një statusi të mirë mjedisor përmes zbatimit të masave të miratuara.

2. Strategjia e Mbrojtjes së Mjedisit Detar zbaton një qasje të bazuar në ekosistem për menaxhimin e veprimtarive njerëzore, duke siguruar që presioni i përbashkët i këtyre veprimtarive të jetë brenda niveleve të pajtueshme me arritjen e një statusi të mirë mjedisor dhe të mos ndikojë në aftësinë e ekosistemeve detare për t'iu përgjigjur ndryshimeve të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore, duke mundësuar përdorimin e qëndrueshëm të produkteve dhe shërbimeve detare nga brezat aktualë dhe të ardhshëm.

3. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mjedisin dhe organet përgjegjëse për monitorimin e ujërave detare janë përgjegjëse për hartimin e Strategjisë së Mbrojtjes së Mjedisit Detar të Republikës së Shqipërisë.

4. Për nënrajonet detare nën sovranitetin e Republikës së Shqipërisë mund të hartohet një strategji e vetme apo strategji të veçanta për mbrojtjen e mjedisit detar për çdo nënrajon.

5. Strategjia e Mbrojtjes së Mjedisit Detar të Republikës së Shqipërisë miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të Kryeministrit, brenda 8 vjetësh nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

6. Strategjia e Mbrojtjes së Mjedisit Detar përditësohet pas rishikimit që do të kryhet çdo 6 vjet, duke zbatuar një qasje të koordinuar, në përputhje me nenet 7 e 8 të këtij ligji, në lidhje me elementet e mëposhtme:

a) vlerësimin fillestar dhe përcaktimin e statusit të mirë mjedisor;

b) objektivat mjedisore;

c) programin e monitorimit;

ç) programin e masave.

Neni 6

Fazat që ndiqen për hartimin e Strategjisë së Mbrojtjes së Mjedisit Detar të Republikës së Shqipërisë

1. Fazat që ndiqen për hartimin e Strategjisë së Mbrojtjes së Mjedisit Detar të Republikës së Shqipërisë zbatohen nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mjedisin, organet përgjegjëse për zonat e mbrojtura detare dhe monitorimin e ujërave detare, të cilat bashkëpunojnë me autoritetet kompetente të shteteve me të cilat Republika e Shqipërisë ndan sovranitetin mbi nënrajonet detare, me qëllim sigurimin e një veprimi koherent dhe qasjeje të koordinuar në zbatimin e masave për arritjen e objektivave të përcaktuar në nenin 2 të këtij ligji.

2. Përmes qasjes së koordinuar të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mjedisin, organet përgjegjëse për zonat e mbrojtura detare dhe monitorimin e ujërave detare:

a) kryejnë vlerësimin fillestar të statusit aktual mjedisor të ujërave detare dhe të ndikimit të veprimtarisë njerëzore në statusin e tyre, në përputhje me nenin 8 të këtij ligji, brenda 4 vjetësh nga hyrja në fuqi e këtij ligji;

b) përcaktojnë statusin e mirë mjedisor, në përputhje me nenin 9 të këtij ligji, brenda 4 vjetësh nga hyrja në fuqi e këtij ligji;

c) identifikojnë/përcaktojnë objektivat mjedisore dhe treguesit e duhur për ujërat detare të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me nenin 10 të këtij ligji, brenda 4 vjetësh nga hyrja në fuqi e këtij ligji;

ç) hartojnë programin e monitorimit për vlerësimin e rregullt dhe përditësimin e objektivave mjedisore, në përputhje me nenin 11 të këtij ligji, i cili duhet të vihet në zbatim brenda 6 vjetësh nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

3. Përmes qasjes së përbashkët të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mjedisin, organet përgjegjëse për zonat e mbrojtura detare dhe monitorimin e



ujërave detare ndërmarrin aktivitetet e nevojshme për:

a) hartimin e programit të masave që synojnë arritjen ose ruajtjen e një statusi të mirë mjedisor në ujërat e të dyja nënrajoneve detare, që janë nën sovranitetin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me nenin 12 të këtij ligji, brenda 7 vjetësh nga hyrja në fuqi e këtij ligji;

b) vënien në zbatim të programit të përmendur në shkronjën “a” të kësaj pike brenda 1 viti nga miratimi i Strategjisë së Mbrojtjes së Mjedisit Detar të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me pikën 5 të nenit 5 të këtij ligji.

4. Fazat që ndiqen për hartimin e Strategjisë së Mbrojtjes së Mjedisit Detar të Republikës së Shqipërisë kryhen brenda 8 vjetësh nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

5. Kur statusi i ujërave është aq kritik sa kërkohet ndërmarrja e një veprimi urgjent, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mjedisin, organet përgjegjëse për zonat e mbrojtura detare dhe monitorimin e ujërave detare, si dhe në bashkëpunim me autoritetet kompetente të shteteve të tjera të interesuara me të cilat ndan sovranitetin mbi nënrajonet detare, kryejnë në një kohë më të hershme se afati i përcaktuar në pikën 4 të këtij neni fazat e përcaktuara në këtë nen. Kjo përfshin vënien në zbatim më herët të programeve të masave, si dhe mundësisht masa më të rrepta, me kusht që kjo të mos parandalojë arritjen ose mirëmbajtjen e një statusi të mirë mjedisor në një tjetër nënrajon detar.

Neni 7

Bashkëpunimi rajonal

Për qëllimet e koordinimit me autoritetet kompetente të shteteve me të cilat Republika e Shqipërisë ndan sovranitetin mbi nënrajonet detare I e II, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mjedisin, organet përgjegjëse për zonat e mbrojtura detare dhe monitorimin e ujërave detare, kur është e mundur, mund të përdorin strukturat ekzistuese të bashkëpunimit institucional rajonal, përfshirë Konventën për Mbrojtjen e Mjedisit Detar dhe Zonës Bregdetare të Detit Mesdhe (Konventa e Barcelonës e vitit 1976) dhe 7 protokollet e saj.

Neni 8

Vlerësimi fillestar i ujërave detare

1. Vlerësimi fillestar i ujërave detare të nënrajoneve detare I e II kryhet nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mjedisin, organet përgjegjëse për zonat e mbrojtura dhe monitorimin e ujërave detare, bazuar në të dhënat ekzistuese, kur janë të disponueshme, si dhe duke përfshirë listat treguese të elementeve të ekosistemit, presioneve antropogjene dhe veprimtarisë njerëzore që ka ndikim në ujërat detare, të tilla si:

a) analizë të tipareve dhe karakteristikave thelbësore të statusit aktual mjedisor të këtyre ujërave, mbështetur në listën treguese të elementeve të përcaktuara në përputhje me nenin 18 të këtij ligji, dhe që mbulon tiparet fizike e kimike, llojet e habitateve, tiparet biologjike dhe hidromorfologjike;

b) analizë të presioneve dhe ndikimeve mbizotëruese, përfshirë veprimtarinë njerëzore, në statusin mjedisor të këtyre ujërave, e cila duhet:

i. të bazohet në listat treguese të elementeve të përcaktuara në zbatim të nenit 16 të këtij ligji dhe përfshin një përzierje cilësore e sasiore të presioneve të ndryshme dhe tendencave të dukshme;

ii. të mbulojë ndikimet kryesore kumulative dhe sinergjike; dhe

iii. të marrë parasysh vlerësimet përkatëse, të cilat janë bërë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

c) analizë ekonomike dhe sociale të përdorimit të ujërave detare, si dhe të kostos së degradimit të mjedisit detar.

2. Analizat e përmendura në pikën 1 të këtij neni marrin parasysh elementet që lidhen me ujërat bregdetare, kalimtare dhe ato territoriale, në përputhje me legjislacionin për burimet ujore. Këto analiza marrin në konsideratë ose bazohen në vlerësime të tjera përkatëse, të tilla si ato të kryera në kuadër të zbatimit të konventës rajonale të detit, me qëllim kryerjen e një vlerësimi gjithëpërfshirës të statusit të mjedisit detar.

3. Gjatë përgatitjes së vlerësimeve të statusit të ujërave detare, në zbatim të pikës 1 të këtij neni, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mjedisin, organet përgjegjëse për zonat e mbrojtura



dhe monitorimin e ujërave detare, në përputhje me detyrimet e përcaktuara në nenet 6 e 7 të këtij ligji, ndërmarrin hapa për të siguruar që metodologjitë e zbatuara të jenë në përputhje me metodologjitë e shteteve të tjera me të cilat Republika e Shqipërisë ndan sovranitetin mbi nënrajonet detare I dhe II, si dhe që të merren parasysh ndikimet e tiparet ndërkufitare.

4. Vlerësimi fillestar i statusit të ujërave detare do të kryhet brenda 4 vjetësh nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 9

Përcaktimi i statusit të mirë mjedisor

1. Bazuar në vlerësimin fillestar të statusit të ujërave detare, të hartuar në zbatim të nenit 8 të këtij ligji, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mjedisin, organet përgjegjëse për zonat e mbrojtura detare dhe monitorimin e ujërave detare, në lidhje me ujërat detare të të dyja nënrajoneve detare I e II në Republikën e Shqipërisë, identifikojnë një sërë karakteristikash të statusit të tyre të mirë mjedisor në bazë të karakteristikave cilësore të përcaktuara në zbatim të nenit 18 të këtij ligji.

2. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mjedisin, organet përgjegjëse për zonat e mbrojtura detare dhe monitorimin e ujërave detare, gjatë përcaktimit të statusit të mirë mjedisor të ujërave detare të nënrajoneve detare I dhe II, marrin parasysh listat treguese të elementeve të përcaktuara në zbatim të nenit 18 të këtij ligji dhe në veçanti tiparet fizike dhe kimike, llojet e habitateve, tiparet biologjike dhe hidromorfologjike.

Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mjedisin, organet përgjegjëse për zonat e mbrojtura detare dhe monitorimin e ujërave detare, marrin parasysh edhe presionet apo ndikimet e veprimtarisë njerëzore mbi të dyja nënrajonet detare I e II, duke pasur parasysh listën treguese të përcaktuar në zbatim të nenit 18 të këtij ligji.

3. Karakteristikat e statusit të mirë mjedisor të ujërave të nënrajoneve detare përcaktohen brenda 4 vjetësh nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 10

Përcaktimi i objektivave mjedisorë

1. Bazuar në vlerësimin fillestar të statusit të ujërave detare, të kryer në zbatim të nenit 8 të këtij ligji, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mjedisin, turizmin dhe ministrinë përgjegjëse për akuakulturën, në lidhje me ujërat detare të nënrajoneve detare I dhe II, përcaktojnë objektiva mjedisorë gjithëpërfshirës dhe treguesit e lidhur me to për monitorimin e arritjes së statusit të mirë mjedisor në mjedisin detar. Për përcaktimin e këtyre objektivave merret parasysh lista treguese e presioneve dhe e ndikimeve, si dhe lista treguese e karakteristikave në zbatim të nenit 18 të këtij ligji.

2. Gjatë përcaktimit të objektivave mjedisorë dhe treguesve të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni sigurohet zbatimi i të gjithë objektivave mjedisorë ekzistues të përcaktuar në përputhje me legjislacionin shqiptar, të Bashkimit Evropian dhe atë ndërkombëtar në lidhje me ujërat e nënrajoneve detare I e II, duke siguruar që këta objektiva të jenë të koordinuar, si dhe që ndikimet përkatëse ndërkufitare dhe tiparet ndërkufitare të jenë marrë gjithashtu në konsideratë, për aq sa është e mundur.

3. Objektivat mjedisorë dhe treguesit për monitorimin e arritjeve të tyre përcaktohen brenda 4 vjetësh nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 11

Programi i monitorimit

1. Bazuar në vlerësimin fillestar të statusit të ujërave detare në nënrajonet detare I dhe II, të kryer sipas nenit 8 të këtij ligji, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore në bashkëpunim me autoritetet përgjegjëse për monitorimin e ujërave detare hartojnë një program ose disa programe monitorimi për vlerësimin e vazhdueshëm të statusit mjedisor të këtyre ujërave, duke u mbështetur në listat treguese të elementeve dhe në listën përkatëse të kërkesave të përcaktuara në zbatim të nenit 18 të këtij ligji, si dhe bazuar në objektivat mjedisorë të përcaktuar në zbatim të nenit 10 të këtij ligji.

2. Gjatë hartimit të programit të monitorimit, të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, sigurohet bashkëpunimi në rajon në përputhje me nenin 7 të



këtij ligji, me qëllim harmonizimin e vlerësimit dhe të programeve përkatëse të monitorimit me ato të shteteve me të cilat Republika e Shqipërisë ndan sovranitetin mbi nënrajonet detare I e II, si dhe me legjislacionin që rregullon çështjet që lidhen me habitatet e shpendët e egra, sipas marrëveshjeve ndërkombëtare ku është palë Republika e Shqipërisë.

3. Në përmbushje të këtij detyrimi dhe duke marrë parasysh nevojën për një qasje koherente dhe të koordinuar, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore në bashkëpunim me autoritetet përgjegjëse për monitorimin e ujërave detare marrin masat e nevojshme për të siguruar që metodat për monitorimin e ujërave të të dyja nënrajoneve detare I e II të jenë koherente dhe rezultatet e monitorimit të jenë të krahasueshme me metodat përkatëse të zbatuara dhe rezultatet e arritura nga shtetet e tjera me të cilat Republika e Shqipërisë ndan sovranitetin mbi këto nënrajone detare, duke marrë gjithashtu parasysh ndikimet dhe tiparet ndërkufitare.

4. Programi apo programet e monitorimit të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni janë pjesë e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit dhe vihen në zbatim brenda 6 vjetësh nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

5. Zbatimi i programit apo i programeve të monitorimit, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, sigurohet nëpërmjet programeve vjetore kombëtare të monitorimit të mjedisit.

Neni 12

Programi i masave

1. Strategjia e Mbrojtjes së Mjedisit Detar të Republikës së Shqipërisë përmban programin e masave që duhet të merren për të arritur dhe ruajtur statusin e mirë mjedisor të ujërave detare.

2. Masat e përmendura në pikën 1 të këtij neni:

a) hartohen në bazë të vlerësimit fillestar të miratuar të statusit të ujërave detare, në zbatim të nenit 8 të këtij ligji;

b) planifikohen në mënyrë të tillë që realizimi i tyre të shërbejë për arritjen e objektivave mjedisorë të përcaktuar në zbatim të nenit 10 të këtij ligji;

c) planifikohen brenda afateve të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave, në zbatim të nenit 18 të këtij ligji.

3. Gjatë përcaktimit të masave të përmendura në pikën 1 të këtij neni, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore në bashkëpunim me organin përgjegjës për zonat e mbrojtura detare:

a) marrin në konsideratë masat përkatëse të ndërmarra në bazë të legjislacionit për burimet ujore, si dhe çdo akt tjetër ligjor apo nënligjor, që rregullon trajtimin e ujërave të ndotura urbane, cilësinë e ujërave të larjes dhe marrëveshjet ndërkombëtare përkatëse në të cilat është palë Republika e Shqipërisë;

b) marrin parasysh zhvillimin e qëndrueshëm dhe në veçanti ndikimet ekonomike dhe sociale të masave të parashikuara;

c) sigurojnë që masat të jenë me kosto efektive dhe teknikisht të realizueshme;

ç) kryejnë vlerësimin e ndikimit, duke përfshirë analizën e kostos dhe të përfitimit, përpara përcaktimit të çdo mase të re;

d) marrin në konsideratë ndikimet e zbatimit të programit të masave në ujëra përtej ujërave të tyre detare, me qëllim uljen e rrezikut të dëmtimit dhe, nëse është e mundur, të ketë një ndikim pozitiv në këto ujëra.

4. Programi i masave i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni përfshin gjithashtu masat e mbrojtjes hapësinore, me qëllim:

a) dhënien e kontributit në rrjetet koherente dhe përfaqësuese të zonave të mbrojtura detare; dhe

b) mbulimin në mënyrën e duhur të larmisë së ekosistemeve përbërëse, të tilla si zonat e veçanta të ruajtjes, të përcaktuara në përputhje me legjislacionin për habitatet, zonat e veçanta të mbrojtura të përcaktuara në përputhje me legjislacionin për shpendët e egra, zonat e mbrojtura detare, të përcaktuara së bashku me shtetet e tjera në kuadër të marrëveshjeve ndërkombëtare dhe rajonale në të cilat ato janë palë.

Informacioni përkatës për zonat e veçanta të ruajtjes dhe zonat e veçanta të mbrojtjes në të dyja nënrajonet detare I e II do të vihet në dispozicion të publikut nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore brenda 8 vjetësh nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

5. Programi i masave përmban, ndër të tjera, udhëzime për mënyrën e zbatimit të masave dhe si do të kontribuojnë ato në arritjen e objektivave mjedisorë në zbatim të nenit 10 të këtij ligji.



Neni 13

Përrjashtimet nga detyrimi për të arritur objektivat mjedisorë dhe statusin e mirë mjedisor

1. Programi i masave, i përcaktuar në përputhje me nenin 12 të këtij ligji, mund të identifikojë rastet kur objektivat mjedisorë dhe statusi i mirë mjedisor në ujërat e detit Adriatik dhe të detit Jon të Republikës së Shqipërisë nuk mund të arrihen në çdo aspekt përmes masave të marra dhe brenda afateve kohore në fjalë për shkaqet e mëposhtme:

a) kur veprimi ose mosveprimi nuk është përgjegjësi e autoriteteve kompetente shqiptare;

b) shkaqe natyrore;

c) forca madhore;

ç) shtesat ose ndryshimet e karakteristikave fizike të ujërave detare vijnë si pasojë e veprimeve të ndërmarra për shkak të një interesi publik madhor, i cili tejkalon ndikimin negativ në mjedis, përfshirë çdo ndikim ndërkufitar;

d) kushtet natyrore janë të tilla që nuk lejojnë përmirësimin në kohë të statusit të ujërave detare në fjalë.

2. Njëkohësisht me identifikimin e rasteve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni shqyrtohen edhe pasojat që mund të vijnë nga mosarritja e objektiveve mjedisorë dhe statusi i mirë mjedisor në shtetet e tjera në të dyja nënrajonet detare I e II.

3. Në rastin e pikës 2 të këtij neni, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mjedisin, organet përgjegjëse për zonat e mbrojtura detare dhe monitorimin e ujërave detare marrin masa të posaçme me qëllim parandalimin e përkeqësimit të mëtejshëm të statusit të ujërave detare të prekura nga shkaqet e përcaktuara në shkronjat “b”, “c” dhe “ç” të pikës 1 të këtij neni dhe zbutjen e ndikimit negativ brenda nënrajonëve detare I e II ose ujërave të shteteve të tjera.

4. Në rastin e shkronjës “ç” të pikës 1 të këtij neni, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mjedisin, organet përgjegjëse për zonat e mbrojtura detare dhe monitorimin e ujërave detare marrin masa në mënyrë që ndryshimet dhe shtesat të mos përjashtojnë ose cenojnë në mënyrë të pakthyeshme arritjen e statusit të mirë mjedisor në nënrajonet detare I e II ose në ujërat detare të shteteve të tjera.

5. Masat e posaçme të përcaktuara në pikën 3 të këtij neni, kur është e mundur, përfshihen në programin e masave.

Neni 14

Rastet e mosveprimit

1. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, ministria përgjegjëse për mjedisin, organet përgjegjëse për zonat e mbrojtura detare dhe monitorimin e ujërave detare janë përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e të gjitha elementeve të Strategjisë së Mbrojtjes së Mjedisit Detar të Republikës së Shqipërisë në zbatim të neneve 5 e 6 të këtij ligji. Në rast se pas hartimit të strategjisë vlerësohet se nuk ka rrezik të konsiderueshëm ose kur kostot do të ishin joproporcionale, duke marrë parasysh rreziqet në mjedisin detar dhe me kusht që të mos ketë përkeqësime të mëtejshme, përjashtohet detyrimi për të ndërmarrë masa apo hapa të veçantë. Vlerësimi fillestar i përcaktuar në nenin 6 të këtij ligji kryhet në çdo rast.

2. Nëse për ndonjë prej shkaqeve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, ministria përgjegjëse për mjedisin, organet përgjegjëse për zonat e mbrojtura detare dhe monitorimin e ujërave detare nuk ndërmarrin asnjë hap, do ta bëjnë publik këtë fakt, si dhe do të njoftojnë Këshillin e Ministrave, i cili merr masat t'i paraqesë Komisionit Evropian arsyetimin e nevojshëm ku është mbështetur ky vendim, duke shmangur që arritja e statusit të mirë mjedisor të cenohet në mënyrë të pakthyeshme.

Neni 15

Pjesëmarrja e publikut

1. Gjatë zbatimit të dispozitave të këtij ligji, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore garanton që të gjitha palët e interesit dhe publiku të kenë akses në informacionin mjedisor, sipas legjislacionit përkatës.

2. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore garanton që të gjitha palët e interesit dhe publiku të kenë mundësi për të marrë pjesë në zbatimin e kërkesave të këtij ligji, duke përfshirë, kur është e mundur, organet ekzistuese të menaxhimit ose strukturat e konventës së Barcelonës, si dhe organe të tjera shkencore këshillimore të njohura ndërkombëtarisht.



3. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore organizon konsultime publike në lidhje me Strategjinë e Mbrojtjes së Mjedisit Detar në përputhje me legjislacionin për konsultimin publik.

4. Përveç detyrimit të përmendur në pikën 3 të këtij neni, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore gjatë fazës së përgatitjes së dokumenteve të mëposhtme publikon përmbledhje të shkurtër, me qëllim që t'i japë publikut mundësinë e komenteve për elementet vijuese të Strategjisë së Mbrojtjes së Mjedisit Detar, si dhe të gjitha ndryshimeve për:

a) vlerësimin fillestar të statusit të ujërave detare në përputhje me nenin 8 të këtij ligji dhe përcaktimin e statusit të mirë mjedisor në përputhje me nenin 9 të këtij ligji;

b) objektivat mjedisorë në përputhje me nenin 10 të këtij ligji;

c) programin e monitorimit në përputhje me nenin 11 të këtij ligji;

ç) programin e masave në përputhje me nenin 12 të këtij ligji.

Neni 16

Detyrimi për të raportuar

1. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore publikon të paktën në faqen e saj të internetit si më poshtë:

a) listën e autoriteteve kompetente të ngarkuara për zbatimin e këtij ligji, duke përfshirë informacionin e nevojshëm për to të përcaktuar në zbatim të nenit 18 të këtij ligji, brenda 2 vjetësh nga hyrja në fuqi e këtij ligji;

b) listën e autoriteteve kompetente të ngarkuara për të bashkëpunuar me organizatat ndërkombëtare me të cilat bashkëpunon Republika e Shqipërisë brenda 2 vjetësh nga hyrja në fuqi të këtij ligji;

c) informacionin për vlerësimin fillestar të kryer të statusit të ujërave detare të nënrajoneve detare I e II në përputhje me nenin 8 të këtij ligji;

ç) informacionin për objektivat mjedisorë të ujërave të nënrajoneve detare I e II;

d) informacionin për programin e monitorimit të hartuar në përputhje me nenin 11 të këtij ligji;

dh) informacionin për programin e masave të hartuara në përputhje me nenin 12 të këtij ligji;

e) arsyet për shkaqet e mosveprimit në zbatim të nenit 14 të këtij ligji;

ë) informacionin për detajet e çdo përditësimi të Strategjisë së Mbrojtjes së Mjedisit Detar të Republikës së Shqipërisë, i cili sigurohet t'i dërgohet sekretariatit të konventës së Barcelonës dhe shteteve të tjera që ndajnë me Republikën e Shqipërisë sovranitetin mbi ujërat e nënrajoneve detare I dhe II.

2. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore publikon të paktën në faqen e saj të internetit çdo ndryshim të informacionit që përmbahet në listat e përmendura në pikën 1 të këtij neni brenda 6 muajve nga data e ndryshimit.

3. Në rast se Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mjedisin, organet përgjegjëse për zonat e mbrojtura detare dhe monitorimin e ujërave detare vlerësojnë që një çështje që ka ndikim në statusin mjedisor të ujërave të nënrajoneve detare I e II të Republikës së Shqipërisë nuk mund të trajtohet nga masat e marra nga autoritetet kompetente të Republikës së Shqipërisë, ose nëse ekziston një rast që lidhet me zbatimin e ndonjë politike tjetër të Bashkimit Evropian apo që lind nga zbatimi i një marrëveshjeje ndërkombëtare, njofton Këshillin e Ministrave, i cili merr masat për informimin e Komisionit Evropian, sipas rrethanave, duke paraqitur arsyetimin përkatës.

4. Brenda 3 vjetëve nga botimi i çdo programi masash apo përditësimi të tij, në zbatim të shkronjave “a”, “b”, “c” dhe “ç” të pikës 4 të nenit 15 të këtij ligji, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore përgatit një raport të ndërmjetëm të shkurtuar, i cili përshkruan progresin e arritur në zbatimin e këtij programi.

Neni 17

E drejta për akses dhe përdorim të të dhënave

1. Në bashkëpunim me autoritetet e tjera kompetente, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore garanton përmbushjen e detyrimeve në kuadër të zbatimit të legjislacionit evropian për të drejtën e informacionit gjeohapësinor, të drejtën për akses dhe përdorim të të dhënave, si dhe të informacionit që rezulton nga vlerësimi fillestar i kryer në zbatim të nenit 8 të këtij ligji dhe nga programet e monitorimit të përcaktuara në zbatim të nenit 11 të këtij ligji.



2. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore siguron që dokumentet dhe informacionet e parashikuara në nenet 5, pika 5, 8, pika 4, 9, pika 3, 10, pika 3, 11, pika 1, 12, pika 4, dhe 13, pika 4, t'i vihen në dispozicion Kuvendit të Shqipërisë jo më vonë se 3 muaj pasi ato të bëhen të disponueshme.

3. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore siguron që informacioni nga vlerësimi fillestar i kryer në zbatim të nenit 8 të këtij ligji, dhe nga programet e monitorimit të përcaktuara në zbatim të nenit 11 të këtij ligji, t'i vihet në dispozicion Agjencisë Evropiane të Mjedisit jo më vonë se 6 muaj, pasi këto të dhëna të jenë bërë të disponueshme.

Neni 18

Metodologjia për hartimin e Strategjisë së Mbrojtjes së Mjedisit Detar

1. Për qëllimet e zbatimit të këtij ligji, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore harton metodologjinë për hartimin e Strategjisë së Mbrojtjes së Mjedisit Detar të Republikës së Shqipërisë, në të cilën përfshihen:

a) elementet që duhet të përmbajnë dy fazat që ndiqen për hartimin e Strategjisë së Mbrojtjes së Mjedisit Detar të Republikës së Shqipërisë;

b) lista treguese e elementeve të ekosistemit, të presioneve antropogjene dhe të veprimtarisë njerëzore në ujërat detare;

c) elementet përshkruese cilësore për përcaktimin e statusit të mirë mjedisor të ujërave detare;

ç) elementet që duhet të përmbajë informacioni për autoritetet kompetente;

d) lista treguese e karakteristikave që do të merren parasysh gjatë përcaktimit të objektivave mjedisorë për nënrajonet detare në Republikën e Shqipërisë;

dh) elementet që duhet të përmbajnë programet e monitorimit;

e) elementet që duhet të përmbajnë programet e masave.

2. Metodologjia për hartimin e Strategjisë së Mbrojtjes së Mjedisit Detar të Republikës së Shqipërisë miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të Kryeministrit, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

KREU III DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 19

Nxjerrja e akteve nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 5, pika 5, dhe 18, pika 2, të këtij ligji brenda afatit të përcaktuar në këto nene.

Neni 20

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 8.2.2024.

Shpallur me dekretin nr. 87, datë 26.2.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET

Nr. 87, datë 26.2.2024

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 15/2024, “Për Strategjinë e Mbrojtjes së Mjedisit Detar të Republikës së Shqipërisë”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Bajram Begaj**



LIGJ
Nr. 16/2024

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË LIGJIN NR. 162/2020,
“PËR PROKURIMIN PUBLIK”⁷

Në mbështetje të nenit 78, nenit 81, pika 1, dhe nenit 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI:
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 4, “Përkufizime”, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Pas pikës 5 shtohen pikat 5/1 dhe 5/2 me këtë përmbajtje:

⁷ Ky ligj është përafëruar pjesërisht me:

i. CELEX 32014L0024, Parlamenti dhe Këshilli i Bashkimit Evropian, 28.3.2014, direktiva 2014/24/BE e Parlamentit dhe Këshillit Evropian, e datës 26 shkurt 2014, për prokurimin publik dhe që shfuqizon direktivën 2004/18/KE, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, L 94/65.

ii. CELEX 32014L0025, Parlamenti dhe Këshilli i Bashkimit Evropian, 28.3.2014, direktiva 2014/25/EU e Parlamentit dhe Këshillit Evropian, e datës 26 shkurt 2014, për prokurimin nga entitete që operojnë në sektorët e ujit, energjisë, transportit dhe shërbimeve postare dhe që shfuqizon direktivën 2004/17/KE, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, L 94/243.

iii. CELEX 01989L0665-20140417, direktiva e Këshillit e 21 dhjetorit 1989 për koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me zbatimin e procedurave të rishikimit për dhënien e kontratave të furnizimit publik dhe punëve publike (89/665/KEE), Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, 1989L0665.

iv. CELEX 01992L0013-20140417, direktiva e Këshillit 92/13/KEE e 25 shkurtit 1992 që bashkërendon ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative, në lidhje me zbatimin e rregullave të Komunitetit për procedurat e prokurimit të enteve që veprojnë në sektorët e ujit, energjisë, transportit dhe telekomunikacionit, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, 1992L0013.

“5/1. “Dosja virtuale e operatorit” është seti i dokumenteve të operatorëve ekonomikë, i krijuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik përmes ndërveprimit me sisteme të tjera elektronike dhe/ose dokumente të ngarkuara nga vetë operatori në kuadër të pjesëmarrjes në procedurat e prokurimit, koncesionit/partneritetit publik privat dhe ankandeve publike, pjesë e Sistemit të Prokurimit Elektronik.

5/2. “e-Certis” është sistemi i informacionit, që ndihmon të identifikohen certifikata të ndryshme të kërkuara në procedurat e prokurimit në të gjithë Bashkimin Evropian.”.

2. Pas pikës 13 shtohet pika 13/1 me këtë përmbajtje:

“13/1. “Kërkesat e etiketës” janë kërkesat që duhet të plotësojnë punët, produktet, shërbimet, proceset ose procedurat në fjalë për të marrë këtë etiketë.”.

3. Pika 17 shfuqizohet.

4. Pas pikës 31 shtohet pika 31/1 me këtë përmbajtje:

“31/1 “Ofrues i shërbimit të prokurimit” është një subjekt publik ose privat, vendës ose i huaj, që ofron veprimtari ndihmëse për prokurimin publik;”.

5. Pika 32 riformulohet si më poshtë:

“32. “Operator ekonomik” është çdo person fizik ose juridik, ose ent publik apo grup personash/entesh, përfshirë shoqëritë me sipërmarrje të përkohshme të tyre dhe organizatat jofitimprurëse, të cilat ofrojnë kryerjen e punëve, furnizimin e mallrave ose ofrimin e shërbimeve në treg.”.

6. Pas pikës 33 shtohet pika 33/1 me këtë përmbajtje:

“33/1. “Pasaporta e prokurimit publik” është një tërësi të dhënash që identifikon një procedurë prokurimi dhe përmban numrin e referencës, kodet e Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit, autoritetin/entit kontractor, objektin e prokurimit, vlerën e parashikuar të prokurimit dhe llojin e procedurës së prokurimit.”.

7. Pika 41 riformulohet si më poshtë:

“41. “Sistem i prokurimit elektronik” (SPE) është sistemi i krijuar sipas legjislacionit në fuqi, që përdoret për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, koncesioneve dhe partneritetit publik privat, prokurimeve në fushën e mbrojtjes e të sigurisë dhe të ankandeve publike, sipas



parashikimit në këtë ligj dhe në ligje të tjera të posaçme, i cili ndërvepron me sistemet e tjera.”.

8. Pas pikës 41 shtohen pikat 41/1 dhe 41/2 me këtë përmbajtje:

“41/1. “Sistemi i ankesave elektronike” është një sistem i krijuar sipas legjislacionit në fuqi, që përdoret për kryerjen e ankesave, i cili ndërvepron me sistemet e tjera.

41/2. “Sistemi i menaxhimit të kontratave” është një sistem i krijuar sipas legjislacionit në fuqi për menaxhimin e ndjekjes së zbatimit të kontratave, i cili ndërvepron me sistemet e tjera dhe administrohet nga ministria përgjegjëse për financat.”.

9. Pas pikës 42 shtohet pika 42/1 me këtë përmbajtje:

“42/1. “Urdhri i prokurimit” është akti administrativ i nxjerrë nga autoriteti ose enti kontraktor pas fazës përgatitore të procesit për prokurimin e një objekti të caktuar dhe që konsiderohet momenti i fillimit të procedurës konkrete të prokurimit për këtë objekt.”.

10. Pas pikës 43 shtohet pika 43/1 me këtë përmbajtje:

“43/1 “Veprimtari ndihmëse për prokurimin publik” janë veprimtaritë që konsistojnë në ofrimin e mbështetjes për autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti në format e mëposhtme:

a) nëpërmjet platformës elektronike, që u mundëson autoriteteve ose enteve kontraktore që të japin kontrata publike ose të lidhin marrëveshje kuadër për punë, furnizime ose shërbime;

b) konsulencë për përgatitjen e procedurave të prokurimit publik;

c) përgatitja dhe zhvillimi i procedurave të prokurimit në emër dhe për llogari të autoritetit ose entit kontraktor në fjalë.”.

Neni 2

Në nenin 7, “Përfashtimet e veçanta”, bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Shkronja “i” e pikës 1 ndryshohet si më poshtë:

“i) prokurimin e mallrave, punëve dhe shërbimeve, me vlerë nën kufirin e lartë monetar për nevojat e secilit mision diplomatik dhe post konsullor të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit.”.

2. Pas shkronjës “j” shtohet shkronja “k” me këtë përmbajtje:

“k) lejimin e ofrimit ose të shfrytëzimit të rrjeteve të komunikimeve elektronike publike ose ofrimin publikut të një ose më shumë shërbimeve të komunikimeve elektronike.

Për qëllim të parashikimit të mësipërm, termat “rrjeti i komunikimeve elektronike publike” dhe “shërbim i komunikimeve elektronike” kanë të njëjtën kuptim sipas ligjit për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë.”.

Neni 3

Pika 1 e nenit 15 të ligjit riformulohet si më poshtë:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore mund t’u rezervojnë të drejtën e pjesëmarrjes në procedurat e prokurimit publik operatorëve ekonomikë, qëllimi kryesor i të cilëve është integrimi social dhe profesional i personave në nevojë, si: personat me aftësi të kufizuara, ose grupeve vulnerabil, sipas legjislacionit në fuqi, ose të parashikojnë që këto kontrata të zbatohen në kontekstin e programeve për punësimin, me kusht që të paktën 30% e punonjësve të këtyre operatorëve ekonomikë ose programeve janë punëtorë me aftësi të kufizuara ose punonjës nga grupet vulnerabël.”.

Neni 4

Në nenin 17, “Forma e komunikimit”, bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. I gjithë komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit për zhvillimin e procedurave të prokurimit, kryerjen e ankesave, nënshkrimin dhe zbatimin e kontratës kryhen duke përdorur mjetet elektronike të komunikimit.

Të gjitha veprimet procedurale të autoriteteve ose enteve kontraktore dhe operatorëve ekonomikë, në kuadër të pjesëmarrjes në procedurat që zhvillohen me mjete elektronike, sipas parashikimeve në legjislacionet përkatëse, kryhen në Sistemin e Prokurimit Elektronik. Autoritetet ose entet kontraktore dhe operatorët ekonomikë shkëmbejnë komunikim elektronik me anë të këtij sistemi përmes nënshkrimit elektronik dhe vulës elektronike. Mjetet dhe pajisjet që do të përdoren për komunikimin me mjete elektronike, si



dhe karakteristikat e tyre teknike do të jenë jodiskriminuese, përgjithësisht të disponueshme dhe të ndërveprueshme me produktet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në përdorim të përgjithshëm dhe nuk do të kufizojnë aksesin e operatorëve ekonomikë në procedurën e prokurimit.

Këshilli i Ministrave vendos rastet kur komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit mund të kryhen në formë shkresore.”.

2. Pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Përdorimi i Sistemit të Prokurimit Elektronik për zhvillimin e procedurave sipas këtij ligji dhe ligjeve të tjera nga autoritetet ose entet kontraktore dhe operatorët ekonomikë kryhet kundrejt pagesës. Tarifat dhe mënyra e përdorimit të të ardhurave nga tarifat përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 5

Paragrafi i parë i pikës 1 të nenit 19, “Konflikti i interesit”, ndryshohet si më poshtë:

“Autoritetet ose entet kontraktore duhet të marrin masat e përshtatshme për të parandaluar, identifikuar dhe zgjidhur në përputhje me legjislacionin në fuqi rastet e konfliktit të interesit, që lindin gjatë kryerjes së procedurave të prokurimit dhe zbatimit të kontratës, për të shmangur shtrembërimin e konkurrencës dhe për të garantuar trajtimin e barabartë të të gjithë operatorëve ekonomikë.”.

Neni 6

Në nenin 21, “Autoriteti ose enti kontraktor”, bëhen ndryshimi dhe shtesat e mëposhtme:

1. Në pikën 2 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të garantojë transparencën për çdo procedurë prokurimi, sipas parashikimeve në këtë ligj. Çdo procedurë prokurimi ka një pasaportë prokurimi.”.

2. Pas pikës 5 shtohet pika 5/1 me këtë përmbajtje:

“5/1 Çdo ent, sipas përcaktimit të pikës 1 të nenit 4 të këtij ligji, i cili në strukturën e tij organizative ka më pak se 15 punonjës, do të veprojë si autoritet ose ent kontraktor vetëm për

kryerjen e prokurimeve me vlerë të vogël. Për objektet, vlera e përlogaritur e të cilave tejkalon kufirin e prokurimeve me vlerë të vogël, autoriteti ose enti kontraktor duhet t'i drejtohet organit epror, në rast se ka një të tillë. Ky i fundit vendos për zhvillimin e procedurës nga ai vetë sipas parashikimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në rast se nuk ka një organ epror, autoriteti ose enti kontraktor i drejtohet organit qendror blerës.”.

3. Në pikën 6 fjalët “për zbatimin e pikave 2, 3, 4 dhe 5” zëvendësohet me fjalët “për zbatimin e pikave 2, 3, 4, 5 dhe 5/1”.

4. Pas pikës 6 shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:

“7. Ministri përgjegjës për Administratën Publike mund t'i propozojë Këshillit të Ministrave vendosjen e një mase shpërblymshme për punonjësit e autoriteteve ose enteve kontraktore apo të punonjësve të tjerë të përfshirë në procesin e prokurimit publik.”.

Neni 7

Pas nenit 21 shtohen nenet 21/1 dhe 21/2 me këtë përmbajtje:

“Neni 21/1

Ofruesi i shërbimit të prokurimit

1. Autoriteti ose enti kontraktor me qëllim realizimin e një veprimtarie ndihmëse për prokurimin publik, sipas parashikimeve të nenit 4, pika 43/1, të këtij ligji, mund të kontrakttojë ofrues të shërbimit të prokurimit.

2. Ofruesi i shërbimit të prokurimit e ushtron veprimtarinë e tij bazuar në këtë ligj dhe në aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi.

3. Rregullat e zbatueshme për pagesën e veprimtarive ndihmëse dhe rastet kur kjo pagesë mund të bëhet nga autoriteti ose enti kontraktor apo operatori ekonomik përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Në rastin kur ofruesi i shërbimit të prokurimit kontraktohet për përgatitjen dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit në emër dhe për llogari të autoritetit ose entit kontraktor në fjalë, ai do të ushtrojë kompetencat si autoritet ose ent kontraktor, të parashikuara në kuadrin ligjor për objektin që ka marrë përsipër.



Neni 21/2

**Përzgjedhja e ofruesit
të shërbimit të prokurimit**

1. Subjekti publik që do të kontraktohet nga autoriteti ose enti kontraktor si ofrues i shërbimit, duhet të ketë në fushën e tij të veprimtarisë kryerjen e veprimeve ndihmëse për prokurimin publik, sipas parashikimeve të nenit 4, pika 43/1, të këtij ligji.

2. Autoriteti ose enti kontraktor kontraktin subjekte private me eksperiencë ndërkombëtare, të cilat përzgjidhen me marrëveshje kuadër të zhvilluar nga një autoritet përgjegjës sipas procedurave të parashikuara nga dispozitat e këtij ligji dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi.

Në çdo rast, pavarësisht vlerës së përlogaritur të kontratës, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të hartojë dokumentet e tenderit edhe në gjuhën angleze.

3. Subjekti privat, që do të kontraktohet nga autoriteti ose enti kontraktor si ofrues i shërbimit, në rastin kur është person juridik duhet minimalisht:

- të ketë eksperiencë të mëparshme në ofrimin e shërbimit të prokurimit jo më pak se 3 vjet;
- të ketë staf në fushën e prokurimeve publike me eksperiencë jo më pak se 5 vjet;
- të ketë staf të specializuar me eksperiencë në ofrimin e shërbimit të prokurimit, në fushën e objektit për të cilin do të zhvillohet procedura e prokurimit, jo më pak se 5 vjet;
- të ketë staf të mjaftueshëm sipas roleve përkatëse që parashikohen në rregullat e prokurimit publik për kryerjen e procedurave të prokurimit;
- t'i provojë autoritetit ose entit kontraktor se plotëson kushtet e parashikuara në nenin 76 të këtij ligji.

Për ato veprimtari ndihmëse, që mund të ofrohen nga subjekti privat, person fizik, ky i fundit duhet të plotësojë kërkesat si më sipër, që janë të vlefshme për personin fizik.”.

Neni 8

Në nenin 23, “Kompetencat e Agjencisë së Prokurimit Publik”, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Shkronja “dh” riformulohet si më poshtë:

“dh) monitoron zbatimin e kontratave sipas

kushteve të prokuruar, bazuar në dokumentacionin e administruar gjatë zbatimit të kontratës.”.

2. Në shkronjën “ë” fjalët “për të përfituar kontrata publike” zëvendësohen me fjalët “për të fituar kontratat e prokurimit publik, koncesionit/partneritetit publik privat dhe ankandit publik”.

3. Shkronja “f” riformulohet, si më poshtë:

“f) administron të dhënat e Sistemit të Prokurimit Elektronik.”.

Neni 9

Pas pikës 1 të nenit 24, “Komisioni i Prokurimit Publik”, shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Komisioni i Prokurimit Publik administron të dhënat e Sistemit të Ankesave Elektronike.”.

Neni 10

Pika 2 e nenit 33, “Kufijtë monetarë”, ndryshohet si më poshtë:

“2. Kufijtë monetarë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas parashikimeve të legjislacionit evropian në fushën e prokurimit publik, për sa është e zbatueshme.”.

Neni 11

Pas pikës 10 të nenit 34 shtohen pikat 11 dhe 12 me këtë përmbajtje:

“11. Llogaritja e vlerës limit të kontratës kryhet në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga të dhëna të marra me ndërveprim me sisteme të tjera nëpërmjet Platformës Qeveritare të Ndërveprimit, referuar një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë:

a) në rast se për elemente ose tërësinë e zërave të kontratës ekzistojnë çmime të botuara nga INSTAT-i të 6 muajve të fundit, u referohen këtyre të fundit; dhe/ose

b) në rast se për elemente ose tërësinë e zërave të kontratës nuk ekzistojnë çmime të botuara nga INSTAT-i, sistemi kryen kontrollin e çmimeve referencë të doganës ose të sistemit të fiskalizimit, në përputhje me natyrën e kontratës, objekt prokurimi, të 6 muajve të fundit; dhe/ose

c) në rast se për llogaritjen e vlerës së kontratës autoriteti ose enti kontraktor duhet të bazohet në



vendime të Këshillit të Ministrave, që përcaktojnë rregullat për llogaritjen e vlerës së kontratës, atëherë të dhënat në përputhje me metodologjinë e secilit vendim të Këshillit të Ministrave plotësohen në sistemin e prokurimit elektronik. Sistemi kryen përlllogaritjen e automatizuar të vlerës së kontratës; dhe/ose

ç) nëse nuk ekziston asnjë prej mënyrave të mësipërme, autoriteti ose enti kontraktor i drejtohet studimit të tregut në sistemet elektronike. Operatorët ekonomikë vendës ose të huaj i përgjigjen kërkesës së autoritetit ose entit kontraktor në sistem; dhe/ose

d) autoriteti ose enti kontraktor mund të përzgjedhë çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga ai vetë apo nga autoritete ose ente të tjera kontraktore, përmes kontrollit në sistemin e menaxhimit të kontratave. Kontrolli kryhet në mënyrë të automatizuar nga Sistemi i Prokurimit Elektronik.

12. Në rast se për llogaritjen e elementeve ose tërësinë e vlerës së kontratës ekzistojnë më shumë sesa një prej metodave të mësipërme, sistemi përlllogarit çmimin bazuar në mesataren e çmimeve të propozuara.”.

Neni 12

Pas pikës 3 të nenit 35 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Studimi i tregut kryhet nga autoriteti ose enti kontraktor në Sistemin e Prokurimit Elektronik sipas parashikimeve të bëra në pikën 11 të nenit 34 të këtij ligji.”.

Neni 13

Pas pikës 6 të nenit 36 shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:

“7. Autoriteti ose enti kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike, referuar parashikimeve të mësipërme, kryen verifikim në Sistemin e Prokurimit Elektronik përmes ndërveprimit me sisteme të tjera kombëtare në rast se ekzistojnë standarde kombëtare ose ndërkombëtare në fuqi për mallrat, punët dhe shërbimet. Sistemi duhet të zhvillohet duke përdorur teknologji të avancuar të inteligjencës artificiale dhe procese të robotizuara në përputhje me parashikimet evropiane.”.

Neni 14

Në nenin 41, “Procedurat standarde të prokurimit”, shkronja “P” e pikës 1 shfuqizohet.

Neni 15

Pas pikës 6 të nenit 43, “Procedurë e kufizuar”, shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:

“7. Përfshijmë, për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor argumenton se, për shkak të një gjendjeje urgjence e ka të pamundur respektimin e afatit të përcaktuar në pikat 2 dhe 3 të këtij neni, afatet mund të shkurtohen:

a) për pranimin e kërkesave për pjesëmarrje, jo më pak se 15 ditë nga data në të cilën është publikuar njoftimi i kontratës;

b) për pranimin e ofertave, jo më pak se 10 ditë nga data në të cilën është dërguar ftesa për ofertë.”.

Neni 16

Në shkronjat “a” dhe “c” të pikës 1 të nenit 47, “Procedurë me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”, hiqen fjalët “shërbimit/et të konsulencës”.

Neni 17

Neni 50, “Shërbim konsulence”, shfuqizohet.

Neni 18

Neni 53, “Blerja e përqendruar”, ndryshohet si më poshtë:

“Neni 53

Blerja e përqendruar

1. Këshilli i Ministrave krijon organ qendror blerës për kryerjen e procedurave të prokurimit në emër dhe për llogari të autoriteteve ose enteve kontraktore, që organizohet si institucion publik apo si shoqëri aksionare në pronësi të shtetit dhe kryen procedurat e prokurimit sipas sektorëve përkatës, të përcaktuara në vendimin e krijimit të tij. Organi qendror blerës kryen veprimtari në zbatim të legjislacionit në fuqi për prokurimin publik dhe çdo legjislacioni tjetër të zbatueshëm në fuqi.



Tarifa për kryerjen e veprimtarive ndihmëse për prokurimin publik nga organi qendror blerës, i krijuar sipas kësaj pike, dhe përlllogaritja e saj përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Këshilli i Ministrave mund të ngarkojë për procedura të veçanta prokurimi një autoritet ose ent tjetër kontraktor si organ qendror blerës apo si ofrues i shërbimit të prokurimit që do të zhvillojë procedurën e prokurimit për objekte të caktuara.

3. Kur dy ose më shumë autoritete ose ente kontraktore kanë nevojë për të njëjtat mallra, punë apo shërbime, atëherë ata, nëse marrin një vendim të tillë, mund t'i ngarkojnë njërit prej tyre detyrën e prokurimit të këtyre mallrave, punëve apo shërbimeve në emër të të tjerëve.

4. Kur një procedurë prokurimi kryhet bashkërisht në emër dhe për llogari të të gjitha autoriteteve ose enteve kontraktore të interesuara, ato do të jenë bashkërisht përgjegjëse për përmbushjen e detyrimeve të tyre, në përputhje me këtë ligj. Kjo vlen edhe në rastet kur një autoritet ose ent kontraktor kryen procedurën, duke vepruar në emër të tij dhe për llogari të autoriteteve ose enteve të tjera kontraktore.

5. Kur zhvillimi i një procedure prokurimi nuk kryhet në tërësi në emër dhe për llogari të autoriteteve ose enteve kontraktore të interesuara, këto të fundit do të jenë bashkëpërgjegjëse vetëm për ato pjesë të kryera bashkërisht.

6. Çdo autoritet ose ent kontraktor do të ketë përgjegjësinë e vetme për përmbushjen e detyrimeve të tij në përputhje me këtë ligj në lidhje me pjesët që ai kryen në emër të tij dhe për llogari të tij.”.

Neni 19

1. Pas shkronjës “d” të pikës 1 të nenit 54, “Sistemi dinamik i blerjes dhe ankandi elektronik”, shtohen shkronjat “dh”, “e”, “ë” dhe “f” me këtë përmbajtje:

“dh) autoriteti ose enti kontraktor përcakton kritere për kualifikim në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

e) sistemi gjeneron ftesë automatike për të gjitha subjektet e regjistruara në SPE, kodet e aktiviteteve të veprimtarive të të cilave (Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike) përputhen me objektin e procedurës së prokurimit sipas kodeve të Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit.

ë) në përfundim të afateve kohore, Sistemi i Prokurimit Elektronik, mbështetur në ndërveprimin me sisteme të tjera të Platformës Qeveritare të Ndërveprimit, kryen vlerësimin automatik të plotësimit të kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit të ofertuesve për fazën e parë të parakualifikimit.

f) sistemi dinamik i blerjes dhe ankandi elektronik duhet të zhvillohen duke përdorur teknologji të avancuar të inteligjencës artificiale dhe procese të robotizuara, në përputhje me parimet e përmendura në nenin 3 të këtij ligji dhe me standardet ndërkombëtare evropiane.”.

2. Në paragrafin e pestë të pikës 2 të nenit 54, togfjalëshi “me vendim të Këshillit të Ministrave” zëvendësohet me togfjalëshin “në Rregullat e Prokurimit Publik”.

Neni 20

Pas nenit 54 shtohet neni 54/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 54/1

Katalogu elektronik

1. Autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që ofertat të dorëzohen në formë të katalogut elektronik ose të përmbajnë katalog elektronik.

Këshilli i Ministrave mund të përcaktojë si të detyrueshëm përdorimin e katalogëve elektronikë për objekte të caktuara prokurimi.

2. Përveç ofertave të paraqitura në formë të katalogut elektronik, mund t'i bashkëngjiten edhe dokumente të tjera që plotësojnë ofertën.

3. Katalogun elektronik e harton ofertuesi, me qëllim që të mund të marrë pjesë në procedurë të caktuar të prokurimit publik, në përputhje me specifikimet teknike dhe në formën e përcaktuar nga autoriteti ose enti kontraktor.

4. Katalogu elektronik duhet të jetë në përputhje me kërkesat e zbatueshme për mjetet e komunikimit elektronik, si dhe me të gjitha kërkesat e tjera shtesë të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

5. Nëse autoriteti ose enti kontraktor pranon ose kërkon paraqitjen e ofertave në formën e katalogëve elektronikë, ai është i detyruar:



a) ta deklarojë këtë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi, kur si mjet për ftesë për konkurrim përdoret një njoftim paraprak informacioni;

b) të japë në dokumentet e tenderit të gjithë informacionin e nevojshëm, sipas nenit 17 të këtij ligji, në lidhje me formatin, pajisjen elektronike që përdoret dhe rregullat për lidhjen teknike dhe specifikimet për katalogun.

6. Kur pas dorëzimit të ofertave në formën e katalogëve elektronikë është lidhur një marrëveshje kuadër me më shumë se një operator ekonomik, autoritetet ose entet kontraktore mund të parashikojnë që të bëhet rihapja e konkurrimit për disa kontrata të caktuara mbi bazën e katalogëve të përditësuar. Në këtë rast, autoritetet ose entet kontraktore përdorin një nga metodat e mëposhtme:

a) ftojnë ofertuesit që të ridorëzojnë katalogët elektronikë, të përshtatur sipas kërkesave të kontratës në fjalë; ose

b) njoftojnë ofertuesit se nga katalogët elektronikë që janë dorëzuar synojnë të mbledhin informacionin që nevojitet për të formuar oferta të përshtatura me kërkesat e kontratës në fjalë, me kusht që përdorimi i kësaj metode të jetë shprehur në dokumentet e tenderit, në bazë të të cilave është lidhur marrëveshja kuadër.

7. Kur autoritetet ose entet kontraktore rihapin konkurrimin për kontrata specifike, në përputhje me shkronjën “b” të pikës 6, ata njoftojnë ofertuesit për datën dhe orën në të cilën parashikojnë të mbledhin informacionin e nevojshëm për të formuar oferta të përshtatura me kërkesat e kontratës specifike në fjalë dhe u japin ofertuesve mundësinë për ta konfirmuar ose jo marrjen e informacionit të mbledhur brenda një periudhe kohe jo më shumë se 5 ditë nga marrja e njoftimit.

Përpara se të japin kontratën, autoritetet ose entet kontraktore i paraqesin ofertuesit të interesuar informacionin e mbledhur, në mënyrë që t'i japin atij mundësinë që të kundërshtojë ose të konfirmojë se oferta e formuar në këtë mënyrë nuk përmban asnjë gabim thelbësor. Kundërshtimi ose konfirmimi duhet të bëhet brenda 2 ditëve.

8. Autoritetet ose entet kontraktore mund të japin kontrata bazuar në një sistem dinamik blerjeje, duke kërkuar që ofertat për një kontratë specifike të paraqiten në formën e një katalogu elektronik.

Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të japin kontrata bazuar në një sistem dinamik

blerjeje, në përputhje me shkronjën “b” të pikës 6 dhe pikën 7, me kusht që kjo kërkesë për pjesëmarrje në sistemin dinamik të blerjes të shoqërohet nga një katalog elektronik në përputhje me specifikimet teknike dhe formatin e përcaktuar nga autoriteti ose enti kontraktor. Katalogu plotësohet më pas nga kandidatët, kur ata të informohen për synimin e autoritetit ose entit kontraktor për të formuar oferta nëpërmjet procedurës së përcaktuar në shkronjën “b” të pikës 6.”.

Neni 21

Pika 1 e nenit 74, “Dokumentet e tenderit”, riformulohet si më poshtë:

“1. Autoriteti ose enti kontraktor në hartimin e dokumenteve të tenderit përdor dokumentet standarde sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit publik dhe i vë në dispozicion falas në rrugë elektronike. Autoriteti ose enti kontraktor publikon në Sistemin e Prokurimit Elektronik dokumentet, të cilat gjenerohen automatikisht në përputhje me llojin e procedurës së zgjedhur nga autoriteti ose enti kontraktor, si edhe në përputhje me formën dhe standardin e Bashkimit Evropian.”.

Neni 22

Në nenin 76, “Kriteret detyruese për skualifikim”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 3 bëhen këto ndryshime:

i. Shkronja “c” ndryshohet si më poshtë:

“c) operatori ekonomik është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi.”.

ii. Në shkronjën “e” fjalët “për të cilën është përjashtuar sipas parashikimeve në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 78 të këtij ligji” hiqen.

iii. Në shkronjën “g” fjalët “nga e drejta për të përfituar fonde publike” zëvendësohen me fjalët “nga e drejta për të fituar kontratat e prokurimit publik, koncesionit/partneritetit publik privat dhe ankandit publik”.

iv. Pas shkronjës “g” shtohen shkronjat “gj” dhe “h” me këtë përmbajtje:

“gj) operatori ekonomik nuk ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.



h) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar nuk zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Kategoritë e profesioneve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrisë përgjegjëse për punën.”.

2. Në pikën 7 fjalët “nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit apo koncesionit” zëvendësohen me fjalët “nga e drejta për të fituar kontratat e prokurimit publik, koncesionit/partneritetit publik privat dhe ankandit publik”.

3. Pas pikës 7 shtohet pika 8 me këtë përmbajtje:

“8. Për operatorët ekonomikë të regjistruar në regjistrat tregtarë shqiptarë, Sistemi i Prokurimit Elektronik verifikon automatikisht përmes ndërveprimit me sisteme të tjera përmbushjen e kushteve detyruese për skualifikim.”.

Neni 23

Në nenin 78, “Përrjashtimi për një periudhë të caktuar nga Agjencia e Prokurimit Publik”, shkronja “b” e pikës 1 shfuqizohet.

Neni 24

Në nenin 82, “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti ose enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë:

a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit ose entit kontraktor duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre;

b) dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna.

Në procedurat e prokurimit me faza, dokumentacioni, sipas shkronjave “a” dhe “b” të kësaj pike, u kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.”.

2. Pas pikës 5 shtohen pikat 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11 me këtë përmbajtje:

“6. Për operatorët ekonomikë të regjistruar në regjistrat tregtarë shqiptarë, krijimi dhe plotësimi i formularit përmbledhës të vetëdeklarimit kryhet në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

7. Pavarësisht parashikimeve të pikës 5 të këtij neni, operatorëve ekonomikë të regjistruar në regjistrat tregtarë shqiptarë nuk u kërkohet të paraqesin dokumente mbështetëse ose prova të tjera dokumentare për atë pjesë të informacionit të deklaruar dhe të gjeneruar automatikisht në Sistemin e Prokurimit Elektronik si pjesë e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit nga ndërveprimi me sisteme të tjera elektronike.

8. Operatorët ekonomikë mund të përmbushin kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit edhe nëpërmjet dosjes virtuale të operatorit, e krijuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik përmes ndërveprimit me sisteme të tjera elektronike për ruajtjen e dokumenteve. Dokumentet e dorëzuara si pjesë e dosjes virtuale të operatorit duhet të jenë të gjeneruara nga sisteme të tjera elektronike ose të noterizuara përmes ndërveprimit me sistemin elektronik të Dhomës Kombëtare të Noterisë.

Operatorët ekonomikë janë përgjegjës për përditësimin e të dhënave në mënyrë automatike, për aq sa është e mundur, në dosjen virtuale të operatorit.

9. Për operatorët ekonomikë vendës, Sistemi i Prokurimit Elektronik verifikon automatikisht përmes ndërveprimit me sisteme të tjera përmbushjen e kushteve detyruese për skualifikim dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit për aq sa është e zbatueshme.

10. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti ose enti kontraktor për operatorët ekonomikë të huaj i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor në origjinal ose kopje të noterizuar dokumentet e paraqitura në rrugë elektronike, të cilat nuk mund të gjenerohen automatikisht nga sistemet e tjera me anë të ndërveprimit. Dokumentet e noterizuara para noterëve publikë të Republikës së Shqipërisë dorëzohen *online* në Sistemin e Prokurimit Elektronik përmes ndërveprimit me sistemin elektronik të Dhomës Kombëtare të Noterisë.

Në procedurat e prokurimit me faza, dokumentacioni sipas pikës 5 u kërkohet të gjithë



kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.

11. Autoriteti ose enti kontraktor do të përdorë sistemin *e-Certis* për të marrë informacion për llojet dhe format e provave të përmendura në këtë nen dhe për autoritetet kompetente, që i lëshojnë ato në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian.”.

Neni 25

Pika 5 e nenit 83, “Sigurimi i ofertës”, ndryshohet si më poshtë:

“5. Autoriteti ose enti kontraktor raporton përmes Sistemit të Prokurimit Elektronik pranë Agjencisë së Prokurimit Publik rastet e refuzimit të operatorit ekonomik për nënshkrimin e kontratës, sipas shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni.”.

Neni 26

Paragrafi i dytë i pikës 3 të nenit 92, “Shqyrtimi i ofertave”, numërohet pikë 4.

Neni 27

Në nenin 93 pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët.”.

Neni 28

Në shkronjën “c” të pikës 2 të nenit 96, “Periudha e pritjes”, pas fjalëve “të një marrëveshjeje kuadër” shtohen fjalët “ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara”.

Neni 29

Në pikën 1 të nenit 97, “Njoftimi i fituesit”, togfjalëshi “5 ditë” zëvendësohet me togfjalëshin “7 ditë”.

Neni 30

Në nenin 98, “Anulimi i një procedure prokurimi”, bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

1. Në pikën 4 pas fjalëve “por jo më vonë se 3 ditë nga marrja e vendimit” shtohen fjalët “dhe publikon njoftimin e anulimit”.

2. Pika 5 shfuqizohet.

Neni 31

Në nenin 99 pas shkronjës “f” shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Raporti përmbledhës për procedurën e prokurimit gjenerohet automatikisht nga të dhënat e administruara në rrugë digjitale në Sistemin e Prokurimit Elektronik për procedurën e prokurimit ...”.

Neni 32

Në nenin 103, pika 2, shkronja “ç” riformulohet si më poshtë:

“ç) gjatë tre vjetëve të fundit organizata nuk është shpallur fituese e një kontrate për të njëjtat shërbime të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor që prokuron kontratën.”.

Neni 33

Në kreun XIII, “Konkursi i projektimit”, pika 1 e nenit 104, “Zbatimi”, ndryshohet si më poshtë:

“1. Dispozitat e këtij kreu zbatohen për:

a) konkurset e projektimit, të organizuara si pjesë e një procedure, e cila çon në dhënien e një kontrate publike për shërbime;

b) konkurset e projektimit me çmime ose pagesa të pjesëmarrësve.”.

Neni 34

Neni 109, “E drejta e ankimit”, ndryshohet si më poshtë:

“Neni 109

E drejta e ankimit

1. Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes të ligjshëm në një procedurë prokurimi sipas LPP dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit ose entit kontraktor, për të cilat pretendon se janë në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit ose entit



kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

2. Pas shqyrtimit administrativ, operatorët ekonomikë kanë të drejtën e ankimimit në Gjykatën Administrative të Apelit, në përputhje me nenin 121 të këtij ligji, si dhe në përputhje me rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.”.

Neni 35

Në nenin 110, “Afatet për ankim”, bëhen shtesat e mëposhtme:

1. Në fund të pikës 3 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit të ofertave, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen sipas përcaktimeve në pikën 2 të këtij neni.”.

2. Në pikën 8, në fund të fjalisë së dytë shtohet togfjalëshi “në Sistemin Elektronik të Ankesave”.

3. Pas pikës 8 shtohet pika 9 me këtë përmbajtje:

“9. Sistemi i prokurimit elektronik njofton operatorët ekonomikë në mënyrë automatike për datën e fillimit dhe të përfundimit të afateve të ankimit.”.

Neni 36

Paragrafi i parë i pikës 1 të nenit 111, “Paraqitja e ankesës”, riformulohet si më poshtë:

“Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike.”.

Neni 37

Neni 112, “Veprimet paraprake”, riformulohet si më poshtë:

“Neni 112

Veprimet paraprake

1. Me regjistrimin e ankesës në Sistemin e Ankesave Elektronike dhe publikimin e saj nga Komisioni i Prokurimit Publik, Sistemi i Prokurimit Elektronik në ndërveprim me Sistemin e Ankesave Elektronike pezullon në mënyrë automatike

vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik me nënshkrim dhe vulë elektronike. Sistemi duhet të zhvillohet duke përdorur teknologji të avancuara të inteligjencës artificiale dhe procese të robotizuara për të kryer pezullimin dhe nxjerrjen nga pezullimi automatik i procedurave të prokurimit.

2. Komisioni i Prokurimit Publik, me marrjen e ankesës në përputhje me këtë ligj, publikon në bazën e të dhënave përmes ndërveprimit me sisteme të treta, të dhënat e mëposhtme:

a) për ankimuesin, adresën dhe NUIS-in;

b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës).

3. Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, Komisioni i Prokurimit Publik publikon:

a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit;

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;

c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.

4. Sistemi i Ankesave Elektronike në ndërveprim me Sistemin e Prokurimit Elektronik gjeneron një kod autentifikimi unik, që u vihet në dispozicion operatorëve ekonomikë të interesuar për t’u njohur me atë pjesë të ankesës, për të cilën ngrihen pretendime. Në asnjë rast Komisioni nuk jep akses në informacion të klasifikuar si sekret tregtar.”.

Neni 38

Në fund të pikës 1 të nenit 113 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Paraqitja e argumenteve bëhet në Sistemin e Ankesave Elektronike.”.

Neni 39

Pika 5 e nenit 114, “Trajtimi i ankesës nga autoriteti ose enti kontraktor”, ndryshohet si më poshtë:

“5. Kundër vendimit të autoritetit ose entit



kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 7 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor për procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar dhe brenda 10 ditëve për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, sipas pikës 4 të këtij neni.”.

Neni 40

Pika 2 e nenit 115, “Trajtimi i ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik”, riformulohet si më poshtë:

“2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën për dokumentet e tenderit dhe në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit kur nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon procedurën për pjesën tjetër të ankesës dhe me mbylljen e shqyrtimit të çështjes duhet të shprehet me vendimmarrje deklarative për pjesën e pranuar sipas parashikimeve të shkronjës “ç” të pikës 2 të nenit 118 të këtij ligji, së bashku me vendimmarrje për pjesën tjetër.”.

Neni 41

Shkronja “a” e pikës 2 të nenit 118 ndryshohet, si më poshtë:

“a) të refuzojë ankesën për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj dhe mosrespektimit të afateve të ankimit, sipas parashikimeve të neneve 110 dhe 111 të këtij ligji.”.

Neni 42

Në pikën 2 të nenit 119, “Pavlefshmëria e kontratave”, fjalët “jo sipas parashikimeve” zëvendësohen me fjalët “në kushtet e”.

Neni 43

Në pikën 1 të nenit 122 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Para nënshkrimit të kontratës, autoriteti ose enti kontraktor i kërkon ofertuesit fitues të paraqesë një sigurim kontrate prej 10% të vlerës së saj.

Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor pranon mundësinë e pagesës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor. Përveç kësaj forme të paraqitjes së sigurimit të kontratës, autoriteti ose enti kontraktor, sipas vlerësimit të tij, duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit mundësinë e paraqitjes së sigurimit të kontratës:

- i. në formën e garancisë bankare; ose
- ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente.”.

Neni 44

Në nenin 124, “Detyrimet e autoritetit ose entit kontraktor gjatë zbatimit të kontratës”, bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

1. Pika 2 riformulohet si më poshtë:

“2. Për monitorimin e zbatimit të kontratave të lidhura në përfundim të procedurave me vlerë mbi kufirin monetar të prokurimeve me vlerë të vogël, të cilat kanë kohëzgjatje jo më pak se 6 muaj, autoriteti ose enti kontraktor, nisur nga natyra e objektit të kontratës dhe kohëzgjatja e zbatimit të saj, harton planin e zbatimit të kontratës, duke përfshirë në veçanti çështjet organizative, afatet, çështjet ekonomike e teknike të kontratës së nënshkruar, në përputhje me çdo akt tjetër ligjor.”.

2. Në pikën 3 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Fjalët “brenda 7 ditëve nga nënshkrimi i kontratës dhe në çdo rast para fillimit të zbatimit të saj” zëvendësohen me fjalët “brenda 10 ditëve nga nënshkrimi i kontratës”.

b) Në fund të pikës shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Plani i zbatimit të kontratës duhet të nënshkruhet nga autoriteti ose enti kontraktor dhe operatori ekonomik në Sistemin e Menaxhimit të Kontratave.”.

3. Pika 5 riformulohet si më poshtë:

“5. Autoriteti ose enti kontraktor, në përputhje me planin, ndjek zbatimin e kontratës, administron dokumentacionin e monitorimit dhe harton raportet e monitorimit në Sistemin e Menaxhimit të Kontratave.”.



4. Në pikën 6 fjalët “sipas tipologjive të tyre” hiqen.

Neni 45

Neni 125, “Detyrimet e autoritetit kontraktor ndaj Agjencisë së Prokurimit Publik”, ndryshohet si më poshtë:

“Neni 125

Detyrimet e autoritetit kontraktor ndaj Agjencisë së Prokurimit Publik

1. Në përfundim të zbatimit të një kontrate të lidhur në përfundim të një procedure me vlerë mbi kufirin monetar të prokurimeve me vlerë të vogël, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrim t'i dërgojë Agjencisë së Prokurimit Publik përmes Sistemit të Menaxhimit të Kontratave formularin e raportimit për zbatimin e kontratës jo më vonë se 30 ditë nga data e përfundimit ose zgjidhjes së kontratës.

2. Në formularin e raportimit për zbatimin e kontratës, autoriteti ose enti kontraktor pasqyron të dhëna mbi ecurinë e zbatimit të kontratës, modifikimi/et e kryera, problematikat e hasura gjatë zbatimit të kontratës dhe masat e marra për zgjidhjen e tyre.”.

Neni 46

Pika 3 e nenit 126, “Nënkontraktimi”, riformulohet si më poshtë:

“3. Autoriteti ose enti kontraktor miraton nënkontraktorët e mundshëm përpara lidhjes së kontratës me operatorin ekonomik fitues të kontratës publike, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, pa cenuar parimet e përcaktuara në pikën 4 të këtij neni. Autoriteti kontraktor miraton vetëm nënkontraktorët e mundshëm të deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit nga operatori ekonomik dhe procesi i miratimit kryhet vetëm në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

Verifikimi i përmbushjes së kapaciteteve të nënkontraktorit të propozuar kryhet për aq sa është e aplikueshme nga ky ligj, në të njëjtën mënyrë si për operatorin ekonomik pjesëmarrës.”.

Neni 47

Në nenin 127, “Modifikimi i kontratave gjatë afatit të tyre”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa e mëposhtme:

1. Në shkronjën “a” të pikës 1 fjalët “në kontratën fillestare” zëvendësohen me fjalët “në dokumentet e tenderit për kontratën fillestare”.

2. Shkronja “b” e pikës 1 ndryshohet si më poshtë:

“b) për furnizimin e mallrave, shërbimeve apo kryerjen e punëve në një kontratë që është ende në zbatim nga kontraktori fillestar, të cilat janë bërë të domosdoshme dhe nuk janë përfshirë në dokumentet e tenderit për kontratën fillestare dhe kur zëvendësimi i kontraktorit fillestar:

i. nuk është i mundur për arsye ekonomike apo teknike, sikurse janë kërkesat për zëvendësimin apo ndërveprimin me pajisjen, shërbimet apo instalimet ekzistuese, të prokuruar gjatë procedurës fillestare; si dhe

ii. do të shkaktonte vështirësi të mëdha apo rritje të konsiderueshme të kostove për autoritetin kontraktor.

Në këtë rast, dokumentimi i modifikimeve duhet të përmbajë një argumentim të të gjitha arsyeve se përse furnizimet, shërbimet ose punët janë të domosdoshme, arsyet përse ato nuk janë mbuluar nga kontrata fillestare apo marrëveshja kuadër, si dhe arsyet ekonomike dhe teknike prej të cilave nuk mund të zëvendësohet kontraktuesi fillestar.”.

3. Në shkronjën “c” të pikës 1 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Në këtë rast, dokumentimi i modifikimeve duhet të përmbajë një përshkrim të ndryshimeve, arsyet dhe rrethanat të cilat autoriteti ose enti kontraktor nuk mund t'i parashikonte gjatë dhënies së kontratës fillestare apo të marrëveshjes kuadër, si dhe një shpjegim se përse këto modifikime nuk ndryshojnë natyrën e kontratës ose të marrëveshjes kuadër.”.

4. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Autoriteti ose enti kontraktor, pasi ka modifikuar kontratën apo marrëveshjen kuadër, në përputhje me pikën 1, shkronjat “b” dhe “c”, të këtij neni, duhet të dërgojë për publikim një njoftim për ndryshimin e kontratës gjatë kohëzgjatjes së saj në Buletinin e Njoftimeve Publike, brenda pesë ditëve nga data në të cilën ka bërë modifikimin e kontratës fillestare.”.



5. Pikat 7 dhe 8 ndryshohen si më poshtë:

“7. Menaxhimi i kontratës së prokurimit publik dhe monitorimi i zbatimit të saj mbështetur në raportimin e zbatimit të kontratës kryhet nga autoriteti ose enti kontraktor në Sistemin e Menaxhimit të Kontratave në ndërveprim me Sistemin e Prokurimit Elektronik.

Autoriteti ose enti kontraktor, në përputhje me natyrën e kontratës, mund të përdorë procese të automatizuara dhe inteligjencën artificiale në procesin e monitorimit të zbatimit të kontratës.

8. Pagesat e operatorëve ekonomikë, në zbatim të kontratës, kryhen përmes sistemit të menaxhimit financiar pas miratimit të dokumentacionit përkatës, në përputhje me legjislacionin në fuqi, në Sistemin e Menaxhimit të Kontratave.

Sistemi gjeneron njoftime automatike mbi risqet për kryerjen e pagesave.”.

Neni 48

Në nenin 129, “Procedura e hetimit administrativ”, bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja “ç” e pikës 1 ndryshohet si më poshtë:

“ç) për monitorimin e zbatimit të kontratës së nënshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor nga momenti i nënshkrimit të kontratës dhe jo më vonë se 3 vjet nga përfundimi i zbatimit të saj, bazuar në dokumentacionin e administruar nga autoriteti ose enti kontraktor.”.

2. Shkronjat “a” dhe “c” të pikës 2 ndryshohen si më poshtë:

“a) të kryejë hetime administrative nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik dhe sistemit për menaxhimin e zbatimit të kontratës; dhe/ose

c) të kryejë hetime administrative, duke përfshirë edhe hyrjen në çdo zyrë të institucioneve publike dhe këqyrjen e akteve ose dokumenteve, që kanë lidhje me çështjen që heton.”.

Neni 49

Në shkronjën “c” të pikës 1 të nenit 130, “Veprimet pas përfundimit të hetimit administrativ”, fjalët “nga përfitimi i fondeve publike” zëvendësohen me fjalët “nga e drejta e fitimit të kontratave të prokurimit publik, koncesionit/partneritetit publik dhe privat dhe ankandit publik”.

Neni 50

Pika 1 e nenit 131 ndryshohet si më poshtë:

“1. Refuzimi i autoritetit ose entit kontraktor për të bashkëpunuar me Komisionin e Prokurimit Publik dhe Agjencinë e Prokurimit Publik ose moszbatimi brenda afatit i vendimeve të këtyre të fundit në mënyrë të pajustificuar ngarkon me përgjegjësi titullarin e autoritetit kontraktor dhe dënohet nga këto institucione me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë.”.

Neni 51

Shkronja “I” e pikës 1 të nenit 132, “Kundërvajtjet administrative”, ndryshohet si më poshtë:

“1. mosrespektimi i detyrimeve për administrimin e dokumentacionit të nevojshëm për modifikimin e kontratës publike ose marrëveshjes kuadër, sipas nenit 127 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë.”.

Neni 52

Dispozita kalimtare

1. Organi qendror blerës, i krijuar nga Këshilli i Ministrave sipas pikës 1 të nenit 53 të këtij ligji, merr asistencë teknike nga UNOPS-i, si organizëm ndërkombëtar me eksperiencë në fushën e prokurimit publik për një periudhë 3-vjeçare nga fillimi i veprimtarisë së tij, me qëllim ngritjen e kapaciteteve administrative profesionale.

Për këtë qëllim, organi qendror blerës, brenda fushës së përgjegjësisë së tij, mund të lidhë marrëveshje me UNOPS-in për përfitimin e kësaj asistence. Pagesat e nevojshme për përfitimin e asistencës sipas parashikimeve të përcaktuara në marrëveshje mbulohen nga buxheti i organit qendror blerës.

2. Brenda një periudhë 3-vjeçare nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Këshilli i Ministrave mund të autorizojë institucionet e administratës shtetërore ose publike në nivel qendror të negociojnë drejtpërdrejt dhe të lidhin marrëveshje konsulence me subjekte ndërkombëtare brenda fushës së kompetencës së tyre në fusha me interes strategjik, në drejtim të aplikimit të Inteligjencës Artificiale,



Sigurisë Kibernetike, infrastrukturës kritike dhe luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.

3. Procedurat e prokurimit të nisura përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji do të vijojnë të realizohen sipas parashikimeve të ligjit në fuqi në momentin e fillimit/nisjes së tyre.

4. Procedimet administrative të nisura nga Agjencia e Prokurimit Publik për përjashtimin e operatorëve ekonomikë nga e drejta për të fituar kontrata publike, sipas nenit 78, pika 1, shkronja “b”, të cilat janë në proces në kohën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vijojnë sipas parashikimeve të ligjit në fuqi në momentin e nisjes së tyre.

5. Aktet nënligjore të nxjerra deri në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, që nuk bien në kundërshtim me këtë ligj, do të zbatohen deri në nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji. Çdo akt tjetër nënligjor, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet.

Neni 53

Nxjerrja e akteve nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji ose neneve të veçanta të tij të miratojë aktet nënligjore në zbatim të tij.

Neni 54

Hyrja në fuqi

1. Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

2. Përjashtimisht, nenet 4, 11, 12, 13, 19, 20; neni 21; neni 22, pika 3; neni 24, pika 2; neni 25; neni 35, pika 3, neni 37, pikat 1 dhe 4; neni 44, pikat 2, shkronja “b”, dhe 3; neni 45, paragrafi i parë, togfjalëshi “përmes Sistemit të Menaxhimit të Kontratave”; neni 46; neni 47, pika 5, hyjnë në fuqi në datën e fillimit të funksionimit të Sistemit të Prokurimit Elektronik.

3. Data e fillimit të funksionimit të Sistemit të Prokurimit Elektronik përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave me propozimin e ministrit përgjegjës për digitalizimin dhe telekomunikacionin, pas njoftimit nga institucioni përgjegjës që mbulon fushën e teknologjisë së informacionit për bërjen funksionale të Sistemit të Prokurimit Elektronik.

Miratuar në datën 8.2.2024.

Shpallur me dekretin nr. 88, datë 28.2.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET

Nr. 88, datë 28.2.2024

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 16/2024, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020, Për prokurimin publik”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Bajram Begaj

LIGJ

Nr. 17/2024

PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR. 7651, DATË 21.12.1992, “PËR FESTAT ZYRTARE E DITËT PËRKUJTIMORE”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në nenin 1 të ligjit nr. 7651, datë 21.12.1992, “Për festat zyrtare e ditët përkujtimore”, i ndryshuar, pas shkronjës “g” shtohet shkronja “h” me këtë përmbajtje:

“h) 22 nëntori – Dita e Alfabetit.”.



Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 15.2.2024.

Shpallur me dekretin nr. 89, datë 28.2.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET
Nr. 89, datë 28.2.2024

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 17/2024, “Për një shtesë në ligjin nr. 7651, datë 21.12.1992, ‘Për festat zyrtare e ditët përkujtimore’, i ndryshuar”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Bajram Begaj

URDHËR
Nr. 225, datë 20.2.2024

**PËR DELEGIM KOMPETENCASH PËR
NDJEKJEN E PROCESEVE, LIDHUR ME
USHTRIMIN E PËRGJEGJËSISË SË
ADMINISTRIMIT TË PRONAVE NË
MINISTRINË E MBROJTJES**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar; të nenit 22 e vijues, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Zëvendësministrit të Mbrojtjes, z. Enkelejdi Joti, i ngarkohet të ndjekë proceset, lidhur me

ushtrimin e përgjegjësisë së administrimit të pronave në Ministrinë e Mbrojtjes.

2. Zëvendësministrit të Mbrojtjes, z. Enkelejdi Joti, i delegohet kompetenca për nënshkrimin e urdhrave apo çdo akti tjetër të nevojshëm, në funksion të ushtrimit të përgjegjësisë së administrimit të pronave të Ministrisë së Mbrojtjes.

3. Zëvendësministri të raportojë çdo muaj te ministri i Mbrojtjes mbi ecurinë e proceseve të lidhura me ushtrimin e përgjegjësisë së administrimit të pronave.

4. Autorizimi nr. 2812/1, datë 4.12.2018, shfuqizohet.

5. Ngarkohet zëvendësministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I MBROJTJES
Niko Peleshi

**GJYKATA EVROPIANE E TË
DREJTAVE TË NJERIUT**

**SEKSIONI I TRETË
ÇËSHTJA VJOLA SHPK DHE DE SHPK
KUNDËR SHQIPËRISË**
(Kërkesa nr. 18076/12)

VENDIM
STRASBURG
30 janar 2024

*Ky është vendim përfundimtar, por mund
t'i nënshtrohet rishikimit redaktorial.*

**Në çështjen Vjola sh.p.k. dhe DE sh.p.k
kundër Shqipërisë,**

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur si Komitet i përbërë nga:

Georgios A. Serghides, *president*,
Darian Pavli,
Oddný Mjöll Arnardóttir, *gjyqtarë*,
dhe Olga Chernishova, *zëvendëskancelare e
Seksionit*,

duke pasur parasysh:
kërkesën (nr. 18076/12) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituar në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe



Lirive Themelore të Njeriut (“Konventa”) më 2 mars 2012 nga dy kompani shqiptare, Vjola sh.p.k. dhe DE sh.p.k. (“shoqëritë kërkuese”), të përfaqësuara nga z. J. Daci, avokat i licencuar në Tiranë;

vendimin për të njoftuar Qeverinë e Shqipërisë (“Qeveria”) të përfaqësuar nga ministri i Drejtësisë i atëhershëm z. Y. Manjani dhe më pas z. O. Moçka, Avokat i Përgjithshëm i Shtetit, për kërkesat në lidhje me të drejtën e shoqërive kërkuese për akses në gjykatë, kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore dhe të drejtën për gëzimin e qetë të pronës dhe për të shpallur të papranueshme pjesën e mbetur të kërkesës;

parashtrimet e palëve;

Pas diskutimit me dyer të mbyllura më 9 janar 2024,

merr vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua po në atë datë:

OBJEKTI I ÇËSHTJES

1. Kjo çështje ka të bëjë, kryesisht, me kohëzgjatjen e procesit gjyqësor dhe aksesin në gjykatë në një proces civil në lidhje me pronën.

2. Në vitin 2000, shoqëritë kërkuese lidhën dy kontrata qiraje me Drejtorinë e Shërbimit Pyjor Kavajë (“Shërbimi Pyjor”), duke fituar të drejtën të përdorin dy pyje për një periudhë njëzetepesëvjeçare. Të dyja kontratat u regjistruan në regjistrin e tokave.

3. Në shkurt 2004, një palë e tretë lidhi dy marrëveshje me Ministrinë e Planifikimit të Territorit dhe Turizmit (“Ministria”) për zhvillimin dhe dhënien me qira të një pylli, me qëllim ndërtimin e një fshati turistik. Duket se kjo parcelë toke mbivendoset me dy parcela toke të marra me qira nga shoqëritë kërkuese.

4. Më 18 maj 2004, pala e tretë e prishi rrethimin e parcelës së tokës dhe filloi punimet e ndërtimit.

5. Më 27 maj 2004, shoqëritë kërkuese depozituan një padi civile kundër palës së tretë, sipas neneve 310 dhe 312 të Kodit Civil (“KC”), ku kërkuan që pala e tretë të ndalojë cenimin e posedimit të tyre të ligjshëm të parcelave të tokës në fjalë dhe kthimin e tokës në gjendjen e mëparshme, pagimin e dëmshpërblimit dhe pezullimin e punimeve të ndërtimit. Ata, gjithashtu, kërkuan që paditë të siguroheshin me një masë të përkohshme.

6. Në tetor 2004, ministri urdhëroi Shërbimin Pyjor që të anulonte kontratat e qirasë të lidhura me shoqëritë kërkuese dhe të mbante kontratat e lidhura me palën e tretë.

7. Më 14 shkurt 2005, Gjykata e Rrethit Kavajë (“Gjykata e Rrethit”), pa trajtuar ndonjëherë kërkesën e shoqërive kërkuese për masë të përkohshme, ndërpreu shqyrtimin e çështjes me arsyetimin që shoqëritë kërkuese së pari duhej të kishin kërkuar shfuqizimin e kontratave të lidhura në vitin 2004 ndërmjet palës së tretë dhe ministritë dhe më pas, pushimin e cenimit të posedimit të tyre të ligjshëm të parcelave të tokës.

8. Më 31 maj 2005, gjykata e apelit Durrës e ktheu çështjen në Gjykatën e Rrethit.

9. Më 27 mars 2006 Gjykata e Lartë rrëzoi ankimin e palës së tretë.

10. Më 26 dhjetor 2006, Gjykata e Rrethit rrëzoi padinë civile të shoqërive kërkuese, duke u shprehur që, meqë punimet e ndërtimit kishin përfunduar në maj 2006, shoqëritë kërkuese nuk mund të mbështeteshin më në nenin 312 të KC-së. Ai nen zbatohej vetëm sa kohë që cenimi i posedimit ishte në vazhdim (pra, jo përfundimtar). Shoqëritë kërkuese duhej të kishin depozituar një padi sipas nenit 313 të KC-së. Megjithatë, padia nuk mund të depozitohet meqë kishte mbaruar afati gjashtëmujor i ligjshëm për depozitimin e një padie. Gjykata e Rrethit sugjeroi që, nisur nga rrethanat e reja, shoqëritë kërkuese mund të depozitonin një padi për pagimin e dëmshpërblimit ndaj Shërbimit Pyjor dhe Ministrisë.

11. Më 23 prill 2007, Gjykata e Apelit Durrës la në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor.

12. Shoqëritë kërkuese depozituan një rekurs në Gjykatën e Lartë ku, mes të tjerash, u ankuan për mosshqyrtimin e çështjes nga ana e gjykatave më të ulëta kundrejt rrethanave ekzistuese në momentin e depozitimit të padisë civile.

13. Më 8 korrik 2010, Gjykata e Lartë la në fuqi vendimet e gjykatave më të ulëta. Ajo u shpreh se shoqëritë kërkuese ishin zhveshur nga posedimi prej tyre i parcelave të tokës nga momenti që pala e tretë kishte përfunduar ndërtimin e fshatit turistik. Gjithashtu, gjykata vëren që autoritetet kishin shkëlur në mënyrë të njëanshme kontratat e qirasë të lidhura me shoqëritë kërkuese.

14. Në vitin 2011, shoqëritë kërkuese depozituan një ankim kushtetues. Më 26 shtator 2011, Gjykata Kushtetuese refuzoi ankimin



kushtetues me arsyetimin që kishte të bënte me vlerësimin e provave. Më tej arsyetoi që gjykatat më të ulëta kishin arsyetuar mjaftueshëm vendimet e tyre.

15. Më 19 dhjetor 2011, Shërbimi Pyjor lidhi një kontratë qiraje me një nga shoqëritë kërkuese, Vjola sh.p.k. për dhënie me qira të pjesës së mbetur të tokës.

16. Shoqëria kërkuese Vjola sh.p.k. kishte paguar qiranë deri në vitin 2010, sipas kontratës së qirasë së vitit 1998.

LEGJISLACIONI I BRENDSHËM PËRKATËS

17. Neni 310 i KC-së lexon që poseduesi ka të drejtë të kundërshtojë aty për aty, duke përdorur një mbrojtje të përshtatshme, çdo veprim që ka për qëllim cenimin ose zhveshjen nga posedimi.

18. Sipas nenit 312 të KC-së, personi, që cenohet në posedimin e një sendi, mund të kërkojë brenda gjashtë muajve, pushimin e cenimit të posedimit dhe një vendim të ndërmjetëm që pengon përsëritjen e tij në të ardhmen.

19. Sipas nenit 313 të KC-së, poseduesi, që në mënyrë të paligjshme është zhveshur nga posedimi, ka të drejtë të kërkojë brenda gjashtë muajve, rivendosjen e tij në posedim.

- VLERËSIMI I GJYKATËS

I. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS

A. Kohëzgjatja e procesit gjyqësor

20. Gjykata vëren se kjo kërkesë nuk është haptazi e pabazuar sipas kuptimit të nenit 35 § 3 (a) të Konventës ose e papranueshme bazuar për ndonjë shkak tjetër. Prandaj, ajo duhet të shpallet e pranueshme.

21. Parimet e përgjithshme në lidhje me kohëzgjatjen e procesit gjyqësor përmbledhen në çështjen *Frydlander kundër Francës* ([DHM], nr. 30979/96, § 43, GJEDNJ 2000-VII).

22. Në këtë çështje kohëzgjatja e procesit gjyqësor në përgjithësi ishte shtatë vjet, katër muaj dhe dy ditë, nga të cilat rreth tre vjet dhe dy muaj përpara Gjykatës së Lartë.

23. Në lidhje me atë që ishte në diskutim për shoqëritë kërkuese, Gjykata vëren se kërkesa për cenimin e posedimit të tyre të parcelës objekt kontestimi ndikonte në të drejtat e tyre që lindnin nga kontrata e qirasë dhe kërkon një përgjigje të shpejtë nga gjykatat.

24. Në lidhje me sjelljen e shoqërive kërkuese,

asgjë nuk sugjeron që ato ndikuan në kohëzgjatjen e procesit gjyqësor.

25. Në lidhje me sjelljen e gjykatave kombëtare, Gjykata së pari vëren që Gjykata e Rrethit asnjëherë nuk e trajtoi kërkesën e kërkuesit për një masë të përkohshme. Gjithashtu, procesi përpara Gjykatës së Lartë ishte zgjatur në mënyrë të paarsyeshme, sidomos meqë nuk ishin marrë masa procedurale ndërmjet depozitimit të rekursit nga shoqëritë kërkuese përpara Gjykatës së Lartë dhe miratimit të vendimit të saj. Kjo kontribuoi në kohëzgjatjen e përgjithshme të procesit gjyqësor prej më shumë se shtatë vjetësh, në një mosmarrëveshje që për nga natyra e saj kërkonte shpejtësi.

26. Nga kjo vijon që është shkelur e drejta e shoqërive kërkuese për t'u dëgjuar brenda një afati kohor të arsyeshëm, në kundërshtim me nenin 6 paragrafi 1 të Konventës.

B. Aksesit në gjykatë

27. Në lidhje me të drejtën e aksesit në gjykatë, Gjykata vëren që shoqëritë kërkuese depozituan një padi civile në përpjekje për të mbrojtur posedimin e tokës që ishte objekt i kontratave të qirasë me Shërbimin Pyjor. Shoqërive kërkuese iu dha e drejta të "përdorin" atë tokë për njëzet e pesë vjet. Megjithatë, një pjesë e së njëjtës tokë u dha me qira te një shoqëri tjetër që ndërtoi një fshat turistik në të.

28. Shoqëritë kërkuese depozituan një padi civile për të parandaluar ndërtimin e mëtejshëm nga pala e tretë dhe për të kthyer tokën në gjendjen e mëparshme.

29. Në këto procese, pretendimi i shoqërive kërkuese u rrëzua me arsyetimin që meqë kishte mbaruar ndërtimi, nuk ishte më e mundur që të kërkohej kthimi i tokës në gjendjen e mëparshme, dhe që shoqëritë kërkuese duhej të depozitonin një padi tjetër civile, afati kohor për të cilën kishte mbaruar tashmë. Këto çështje kanë të bëjnë me interpretimin e legjislacionit të brendshëm. Në këtë drejtim, Gjykata përsërit që nuk e ka për detyrë të zëvendësojë interpretimin e legjislacionit të brendshëm nga gjykatat kombëtare me interpretimin e saj, dhe nuk i kërkohet që të trajtojë gabime të faktit apo ligjit të pretenduara të kryera nga gjykatat kombëtare (shihni *Waite dhe Kennedy kundër Gjermanisë* [DHM], nr. 26083/94, § 54, GJEDNJ 1999 I, dhe *Yagtzilar dhe të Tjerë kundër Greqisë*, nr. 41727/98, § 25, GJEDNJ 2001 XII).



30. Në vendimin nëse ishte i lejuar kufizimi i aksesit në gjykatë sipas Konventës, Gjykata do të shikojë, *inter alia*, nëse kërkesit kishin në dispozicion mjete të tjera alternative të arsyeshme për të mbrojtur të drejtat e tyre në mënyrë të efektshme (shihni, për shembull, *Waite dhe Kennedy*, cituar më sipër, § 68; shihni, gjithashtu, për një situatë të ngjashme, *Rogach kundër Ukrainës* (vend.), nr. 42152/10, § 31, 10 dhjetor 2019 [Komiteti]).

31. Prandaj, pyetja kryesore është nëse shoqëritë kërkuuese kishin akses në gjykatë për shqyrtimin e ankesave të tyre nga gjykatat e brendshme. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se mosmarrëveshja filloi me shkeljen e kontratës së qirasë sepse Shteti nuk kishte përmbushur detyrimet e tij kontraktore. Është veçori e zakonshme e së drejtës së kontratave që, nëse nuk është e mundur përmbushja e një kontrate për arsye që i atribuohen njëres prej palëve, pala tjetër mund të kërkojë dëmshpërblim për dëmin e pësuar. Nga kjo vijon që shoqëritë kërkuuese kishin mundësi të kërkon dëmshpërblim nga Shërbimi Pyjor dhe Ministria. Në këto procese gjyqësore, do të ishte vlerësuar masa e dëmit shkaktuar shoqërive kërkuuese për shkak të mospërmbushjes së kontratës së qirasë dhe shoqëritë kërkuuese do të kishin qenë në gjendje të zgjidhnin situatën e tyre. Nuk ka të dhëna që kjo padi nuk do të ishte shqyrtuar nga gjykatat e brendshme.

32. Duke pasur parasysh sa më sipër, nuk mund të thuhet se kufizimi i së drejtës së shoqërive kërkuuese për akses në gjykata pengoi thelbin e së drejtës ose ishte disproporcional për qëllimet e nenit 6 § 1 të Konventës (krahasoni *Waite dhe Kennedy*, cituar më lart, § 73; *A. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 35373/97, § 86, GJEDNJ 2002-X; dhe *Gerdzhikov dhe Château Vallée Des Roses EOOD kundër Bullgarisë* (vend.), nr. 8947/05, § 47, 13 shtator 2011; dhe dalloni me *Cordova kundër Italisë* (n^o 1), n^o 40877/98, § 65, GJEDNJ 2003-I, dhe *Woś kundër Polonisë*, nr. 22860/02, § 108, GJEDNJ 2006-VII). Për rrjedhojë, kjo kërkesë është haptazi e pabazuar dhe duhet të refuzohet në përputhje me nenin 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

II. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 1 TË PROTOKOLLIT NR. 1 TË KONVENTËS

33. Sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1, shoqëritë kërkuuese u ankuan për rezultatin e procesit, në lidhje me pretendimin e tyre për cenimin e posedimit prej tyre të tokës që kishin marrë me qira.

34. Shoqëritë kërkuuese asnjëherë nuk ishin, as nuk pretendojnë të kenë qenë pronarët e tokës në fjalë, por ato kishin lidhur një kontratë qiraje me Shtetin. Gjykata përsërit që qiraja mund të konsiderohet interes pronësie që tërheq mbrojtjen e nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës (shihni, *Stretch kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 44277/98, §§ 32-35, 24 qershor 2003; *Bruncrona kundër Finlandës*, nr. 41673/98, § 79, 16 nëntor 2004; dhe *Bosphorus Hava Yolları Turizm ve Ticaret Anonim Şirketi kundër Irlandës* [DHM], nr. 45036/98, § 140, GJEDNJ 2005 VI). Prandaj, në këtë çështje, cenimi i drejtave të shoqërive kërkuuese të mbrojtura sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1 buron nga fakti që autoritetet e shtetit i dhanë për shfrytëzim shoqërive kërkuuese dhe një shoqërie të tretë të njëjtën parcelë toke.

35. Megjithatë, shoqëritë kërkuuese ngritën vetëm padi civile kundër një pale private për cenimin e posedimit. Këto procese kishin të bënin vetëm me posedimin faktik të tokës në fjalë nga shoqëritë kërkuuese, dhe jo me të drejtën e tyre për qiramarrjen ose ndonjë interes ekonomik që rrjedh nga kjo e drejtë. Prandaj, këto procese gjyqësore nuk ishin vendimtare për cenimin e pretenduar sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës, sepse nuk mund të trajtonin ndonjë çështje, në lidhje me shkeljen nga organet e shtetit të kontratës së qirasë së lidhur ndërmjet shoqërive kërkuuese dhe organeve të shtetit.

36. Nga kjo vijon që kjo kërkesë duhet të shpallet e papranueshme si haptazi e pabazuar sipas kuptimit të nenit 35 § 3 (a) dhe duhet të refuzohet sipas nenit 35 § 4 të Konventës.

ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

37. Shoqëria kërkuuese Vjola sh.p.k. kërkoj 1.550.000 euro (EUR) për dëmin monetar, 150.000 euro (EUR) për dëmin jomonetar dhe 4.000 euro për kosto dhe shpenzime të kryera pranë gjykatave kombëtare dhe Gjykatës.

38. Shoqëria kërkuuese DE sh.p.k. kërkoj 550,000 EUR për dëmin monetar, 250.000 EUR për dëmin jomonetar dhe 4,000 EUR për kosto



dhe shpenzime të kryera pranë gjykatave të brendshme dhe Gjykatës.

39. Qeveria i kundërshtoi këto shuma.

40. Gjykata nuk dallon ndonjë lidhje shkakësore ndërmjet shkeljes së gjetur dhe dëmit monetar të pretenduar; prandaj e refuzon këtë kërkesë. Megjithatë, i cakton çdo shoqërie kërkuuese 1.000 EUR për dëmin jomonetar, plus çdo taksë që mund t'i ngarkohet shoqërisë kërkuuese.

41. Duke pasur parasysh dokumentet përpara saj, Gjykata e vlerëson të arsyeshme që t'i caktojë çdo shoqërie kërkuuese 2000 EUR për të mbuluar shpenzimet e çdo zëri, plus çdo taksë që mund t'i ngarkohet shoqërive kërkuuese.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, ME UNANIMITET,

1. *Shpall* të pranueshme kërkesën në lidhje me kohëzgjatjen e procesit gjyqësor dhe të papranueshme pjesën tjetër të kërkesës;

2. *Vendos* që është shkelur neni 6 § 1 i Konventës, për shkak të kohëzgjatjes së procesit gjyqësor;

3. *Vendos*:

a) Që Shteti i paditur t'i paguajë çdo shoqërie kërkuuese, brenda tre muajve, shumat e mëposhtme, që do të konvertohen në monedhën e Shtetit të paditur me kursin në fuqi në datën e shlyerjes:

i. 1000 (një mijë euro) EUR për dëmin jopasuror, plus çdo taksë që mund t'i ngarkohet çdo shoqërie kërkuuese;

ii. 2000 (dy mijë euro) EUR për kostot dhe shpenzimet, plus çdo taksë që mund t'i ngarkohet çdo shoqërie kërkuuese;

b) nga mbarimi i afatit tremujor të sipërpërmendur deri në shlyerje, interes i thjeshtë të paguhet për shumat e mësipërme sipas normës së njëjtë me normën marxhinale të kreditimit të Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagimit plus tre pikë përqindje;

4. *Rrëzon* pjesën tjetër të kërkesës së kërkuësve për kompensim të drejtë.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 30 janar 2024 sipas rregullit 77 §§ 2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

Olga Chernishova
ZËVENDËSKANCELARE

Georgios A. Serghides
PRESIDENT

VENDIM

Nr. 1, datë 25.1.2024

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj,	kryetare;
Marsida Xhaferllari,	anëtare;
Fiona Papajorgji,	anëtare;
Elsa Toska,	anëtare;
Sonila Bejtja,	anëtare;
Sandër Beci,	anëtar;
Illir Toska,	anëtar;
Genti Ibrahim, i,	anëtar;
Marjana Semini,	anëtare,

me sekretare Enina Kotoni, në datën 21.12.2023, mori në shqyrtim në seancë plenare publike çështjen nr. 1 (Nj) 2023 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Një grup deputetësh të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (jo më pak se një e pesta e deputetëve), përfaqësuar nga avokatët Semir Sali dhe Esmeralda Maillard (Ndoci), me autorizim.

Një grup studentësh të Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Mjekësisë Tiranë, përfaqësuar nga avokatët Semir Sali dhe Esmeralda Maillard, me prokurë të posaçme.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Mimoza Arbi dhe Gazmend Bici, me autorizim.

Këshilli i Ministrave, përfaqësuar nga Herald Jonuzaj, Voltisa Koçi dhe avokatja e shtetit Irma Qosja, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi i nenit 4, pikat 1, shkronja “c”, 2, shkronja “b”, 3, shkronja “b” dhe nenit 5, fjalë e parë, të ligjit nr. 60/2023, datë 21.7.2023, “Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë ‘Mjekësi e përgjithshme’ në institucionet publike të arsimit të lartë”, si të pajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Pezullimi i zbatimit të ligjit nr. 60/2023, datë 21.7.2023, “Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë ‘Mjekësi e përgjithshme’ në institucionet publike të arsimit të lartë”, deri në hyrjen në fuqi të vendimit të Gjykatës Kushtetuese.



BAZA LIGJORE: Nenet 4, 17, 18, 26, 49, 57, 131, pika 1, shkronjat “a” dhe “f” dhe 134, pika 1, shkronjat “c” dhe “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 4 dhe 14, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*) dhe neni 2, i Protokollit nr. 1 të saj; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marjana Semini, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuarve, që kanë kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (*Kuvendi*) dhe Këshillit të Ministrave, që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, mendimet me shkrim të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (*Komisioneri*) dhe të Universitetit të Mjekësisë Tiranë (*UMT*), si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN

I

Rrethanat e çështjes

1. Në datën 21.7.2023, Kuvendi, në bazë të propozimit të Këshillit të Ministrave dhe në zbatim të procedurës së përshpejtuar parlamentare, ka miratuar ligjin nr. 60/2023, “Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë ‘Mjekësi e përgjithshme’ në institucionet publike të arsimit të lartë” (*ligji nr. 60/2023*). Ky ligj është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 123, datë 16.8.2023 dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit të tij.

2. Duke pasur si qëllim ruajtjen e burimeve njerëzore, profesionistëve shëndetësorë në vend, por edhe rritjen e interesit të tyre për të punuar në sektorin shëndetësor publik si pjesë e rritjes së investimeve në shëndetësi, ligji nr. 60/2023, ka parashikuar një mekanizëm përmes të cilit, studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë u ofrohet një trajtim i veçantë, i cili në kuptim të nenit 3, pika 1, të ligjit, përfshin punësimin me prioritet të tyre pas përfundimit të studimeve, si dhe të drejtën për të përfutur nga programet sociale të strehimit.

3. Ky trajtim përfitohet si nga kandidati që pranohet rishtazi në programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë, ashtu edhe nga studenti i vitit të dytë deri në vitin e katërt akademik dhe nga studenti i vitit të pestë ose të gjashtë (*student i ndërmjetëm*) në këtë program, kur pranon të nënshkruajë marrëveshje me ministrinë përgjegjëse për arsimin, ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë dhe institucionin e arsimit të lartë publik. Sipas marrëveshjes, studenti duhet të punojë në profesionin e mjekut pas përfundimit të studimeve për, respektivisht, jo më pak se pesë vjet, tre vjet dhe dy vjet në institucionet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë, si dhe pranon kalimin zyrtarisht të diplomës përkatëse të arsimit të lartë nga institucioni publik i arsimit të lartë, ku ka përfunduar studimet, në institucionin shëndetësor ku punësohet deri në “shlyerjen e detyrimeve për punësim” sipas afatit, përkatësisht pesë, tre dhe dyvjeçar, me të drejtën që pas përmbushjes së detyrimit të punësimit të tërheqë diplomën universitare (*neni 4, pika 1, shkronja “c”, pika 2, shkronja “b”, pika 3, shkronja “b”, i ligjit nr. 60/2023*). Ndërkohë, studenti që nuk pranon të nënshkruajë marrëveshjen sipas përcaktimeve të pikave 2 dhe 3, të nenit 4, paguan vlerën e plotë të kostos së studimeve (*neni 5, i ligjit nr. 60/2023*).

4. Për zbatimin e këtyre masave janë miratuar disa akte nënligjore, përkatësisht vendimi nr. 527, datë 7.9.2023, i Këshillit të Ministrave për përcaktimin e metodologjisë së kostos së studimeve për programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë; vendimi qarkullues nr. 109, datë 6.10.2023, i Senatit Akademik të UMT-së dhe vendimi nr. 62, datë 9.10.2023, i Bordit të Administrimit të UMT-së për miratimin e kostos së studimit të programit të integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e përgjithshme” në UMT. Sipas këtyre akteve rezulton se kostoja e studimit të programit të integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e përgjithshme” është 248,975 (dyqind e dyzet e tetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë për student.

5. Në datën 19.10.2023, një grup deputetësh të Kuvendit, në cilësinë e subjektit kushtetues jo më pak se një e pesta e deputetëve (*kërkuar*), i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë me objekt shfuqizimin e nenit 4, pikat 1, shkronja



“c”, 2, shkronja “b”, 3, shkronja “b” dhe nenit 5, fjalia e parë, të ligjit nr. 60/2023, si dhe pezullimin e zbatimit të tij deri në hyrjen në fuqi të vendimit përfundimtar të Gjykatës.

6. Në datën 20.10.2023, një grup studentësh të Fakultetit të Mjekësisë në UMT, konkretisht shtetasit Anxhela Gjini, Alesia Cara, Diora Hoxha, Argisa Troka, Xhesika Xhebexhiu, Juri Taullau, Sindy Allamani, Isabela Tabaku, Dea Guri, Natali Bliu, Joel Plaku, Mikel Seferi, Reant Kullaj, Brunelio Fejzulla, Viki Zaçlli, Rei Haluli, Feruze Agalliu, Oresti Çaçë, Marjo Rabiaj, Paulo Qesargjoni, Endi Muçi, Arbëri Shehu, Samuel Dërka, Thimi Shkarpa, Kristina Çelanji, Athina Prifti, Almira Tota, Zino Veleshnja, Erdi Podo, Anxhela Miraka, Gani Krrashi, Klevis Gugallja, Flavio Elezi, Ledion Mane, Eugen Lazaj, Igli Hoxhaj, Arlind Kasëmi (*kërkuesi ose një grup studentësh*), i janë drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual me të njëjtin objekt.

7. Me vendimet e datës 8.11.2023, kolegjet e Gjykatës kanë vendosur kalimin e këtyre çështjeve për shqyrtim në seancë plenare publike. Po kështu, duke pasur parasysh natyrën e pretendimeve të parashtruara në kërkesë, si dhe të drejtat kushtetuese të përfshira në këtë çështje, është vlerësuar marrja e mendimit me shkrim nga Komisioneri dhe UMT-ja.

8. Në zbatim të nenit 19, pika 2, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, nenit 1, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000 dhe nenit 57 të Kodit të Procedurës Civile, Mbledhja e Gjyqtarëve, me vendimin e datës 14.11.2023, ka vendosur bashkimin e çështjeve në një çështje të vetme. Me vendim të po kësaj date, Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur edhe pezullimin e zbatimit të ligjit nr. 60/2023, deri në hyrjen në fuqi të vendimit përfundimtar të Gjykatës.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

9. **Kërkuesit** kanë pretenduar se dispozitat ligjore të kundërshtuara cenojnë:

9.1. *Parimin e sigurisë juridike*, të garantuar nga neni 4 i Kushtetutës, pasi studentët që ndjekin programin e integruar të ciklit të dytë në Fakultetin e Mjekësisë në UMT cenohen si pasojë e detyrimeve të parashikuara në dispozitat e kundërshtuara të ligjit nr. 60/2023, pasi me

nënshkrimin e marrëveshjes kërkohet kalimi zyrtarisht i diplomës përkatëse nga institucioni publik i arsimit të lartë në institucionin shëndetësor, ku studentët e diplomuar punësohen deri në shlyerjen e detyrimeve për punësim sipas afateve përkatëse, ndërkohë që ata që nuk pranojnë të lidhin marrëveshjen, kanë detyrimin të paguajnë vlerën e plotë të kostos së studimeve. Studentët e ndërmjetëm kanë pritshmëri për mosrritjen në mënyrë eksponenciale të tarifës së studimit. Të njëjtën pritshmëri kanë edhe studentët me mesatare mbi notën 6 për të përfutur nga tarifa e përgjysmuar e shkollimit. Dispozitat e kundërshtuara kanë sjellë një përkeqësim serioz të situatës ligjore të studentëve që dëshirojnë të ruajnë *status quo*-në. Studentët, sidomos ata që ndjekin vitet e ndërmjetme, i kanë bërë përlllogaritjet mbi bazën e kostos së plotë të studimeve, si dhe mundësive të tyre ekonomike për të përballuar pagesën e tarifës përkatëse çdo vit para se të fillonin studimet. Ndryshimi i papritur i tarifës, duke e pesëfishuar ose dhjetëfishuar atë, cenon edhe *parimin e parashikueshmërisë së ligjit*. Përkeqësimi i situatës ekonomike e juridike të studentëve që nuk dëshirojnë të lidhin marrëveshje nuk i shërben interesit publik, pasi sigurimi i shërbimit shëndetësor nuk do të arrihet nga pagesa e vlerës së plotë të kostos së studimeve për këta studentë, por do të shkojë në zëra të ndryshëm të buxhetit. Po kështu, nuk i shërben interesit publik as kufizimi i tërheqjes së diplomës.

9.2. *Të drejtën për punë dhe atë për arsimim, të garantuara nga nenet 49 dhe 57, të Kushtetutës*, në kundërshtim me kriteret e nenit 17 të Kushtetutës, pasi:

9.2.1. Përveç kriterit të kufizimit me ligj nuk përmbushet asnjë nga kriteret e tjera kushtetuese që lejojnë kufizimin. Ai nuk i përgjigjet as interesit publik, as objektivave të vetë ligjit nr. 60/2023 dhe masat e përdorura janë më të ashpra se sa duhet për të arritur objektivin e kërkuar. Studentëve që refuzojnë të lidhin marrëveshje u cenohet e drejta për arsimim dhe të drejtat e tjera të fituara. Ligjvënësi nuk jep asnjë arsye logjike se përse studentët që duan të ruajnë *status quo*-në duhet të paguajnë koston e plotë të studimit, e cila përbën një sanksion ekonomik, duke rrezikuar uljen e numrit të studentëve që ndjekin programin “Mjekësi e përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë, në favor të institucioneve private



të arsimit të lartë. Ligjvënësi ka rritur tarifën e studimeve deri në koston e plotë të tyre pa një qëllim legjitim.

9.2.2. Kufizimi nuk është në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka diktuar, duke cenuar *parimin e proporcionalitetit*. Objektivi i ligjvënësit nuk është mjaftueshmërisht i rëndësishëm për të justifikuar kufizimin e së drejtës. Parashikimi i nenit 5 të ligjit nuk i përgjigjet objektivit kryesor të tij, që ka të bëjë me sigurimin e stafit mjekësor në periudhë afatgjatë. Nuk ekziston një situatë emergjente dhe nuk ka ulje të numrit të mjekëve në raport me popullsinë. Mjetet e përdorura nuk janë të domosdoshme, që do të thotë se synimi mund të arrihej me mjete të tjera dhe stimuj të tjerë ekonomikë ose socialë, pa cenuar të drejtat themelore të studentëve. Garantimi i shërbimit mjekësor nuk ka asnjë lidhje me pagimin e vlerës së plotë të koston së studimeve, ndaj ndërhyrja nuk është e përshtatshme për realizimin e qëllimit të synuar dhe nuk e ndikon atë. Sanksioni ekonomik i vendosur në nenin 5, të ligjit nr. 60/2023 i detyron studentët në gjendje të vështirë ekonomike që të pranojnë të lidhin marrëveshjen ose ndëshkon studentët që nuk pranojnë ta nënshkruajnë atë, duke rritur në mënyrë eksponenciale tarifën e studimit. Masat nuk janë të lidhura në mënyrë të arsyeshme me objektivin, janë arbitrare, të padrejta dhe të bazuara mbi vlerësime alogjike.

9.2.3. Edhe masa e mbajtjes së diplomës për të mundësuar zbatimin e ligjit është e pajustificueshme, pasi shteti i ka të gjitha mjetet ligjore për të garantuar zbatimin e marrëveshjes së nënshkruar me studentët. E drejta e çdo studenti për të përfituar diplomën pas përfundimit të studimeve është e drejtë themelore që nuk mund dhe nuk duhet të lidhet me suksesin e zbatimit të marrëveshjes, e cila përbën barrë të ligjvënësit dhe është e patransferueshme te individi.

9.3. *Parimin e barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit*, të garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi duke rritur në mënyrë eksponenciale tarifën e studimit për studentët që zgjedhin të mos nënshkruajnë marrëveshjen, neni 5, i ligjit nr. 60/2023 diskriminon indirekt studentët që nuk janë në gjendje ekonomike të paguajnë këtë vlerë, duke i vënë para dy mundësive që bien ndesh me vullnetin e tyre, pra të lidhin marrëveshje ose të ndërpresin studimet. Ky nen do të japë pasoja të papranueshme për sa i përket garancisë së nenit 18

të Kushtetutës për mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të gjendjes ekonomike, pasi studentët në gjendje të vështirë ekonomike do të jenë të detyruar të lidhin marrëveshje për të pranuar (*de facto*) punë të detyruar, ndërkohë që kolegët e tyre do të mund të “shpëtojnë” duke paguar tarifë më të lartë shkollimi. Ligji parashikon diskriminimin pozitiv për studentët që pranojnë të lidhin marrëveshje sipas nenit 4 të tij, ndërkohë që e kundërta ndodh për ata që nuk pranojnë nënshkrimin e saj. Ai diskriminon edhe studentët që përfitojnë aktualisht ulje të tarifës së studimeve për shkak të notave të larta, sikurse studentët që ndjekin studimet në institucionet e arsimit të lartë publik, në raport me ata në institucionet e arsimit të lartë jopublik, të cilët nuk përfshihen në fushën e zbatimit të këtij ligji.

9.4. *Të drejtën për të mos iu nënshtruar punës së detyruar*, të garantuar nga nenet 26 dhe 49, të Kushtetutës dhe neni 4, pika 2, i KEDNJ-së, pasi vënia para zgjedhjes për nënshkrimin e marrëveshjes, sipas nenit 4, të ligjit nr. 60/2023, e studentëve që dëshirojnë të ruajnë *status quo-në* dhe nuk janë ofruar vullnetarisht për nënshkrimin e saj, ose në të kundërt duhet të përballen me vlerën e plotë të koston së studimeve sipas nenit 5 të tij, përbën kërcënim për dënim të çdo lloji për ta. Ky është një rast *par excellence* ku kjo kategori studentësh detyrohet me anë të mjeteve ekonomike për të kryer punë të detyruar kundër vullnetit. Edhe për studentët që nënshkruajnë marrëveshje barra është e shpërpjesëtuar, pasi ata kanë detyrimin për të punuar 2 deri në 5 vjet, në varësi të vitit akademik që ndjekin në momentin e nënshkrimit të saj.

10. ***Subjekti i interesuar, Kuvendi***, ka prapësuar si vijon:

10.1. Pretendimi për cenimin e *parimit të sigurisë juridike* është i pabazuar. Ligji nr. 60/2023, respekton vullnetin e lirë të çdo kandidati ose studenti për të vendosur nëse do të përfitojë nga të drejtat e përcaktuara në këtë ligj me nënshkrimin e marrëveshjes apo do të përballojë tarifën e studimeve deri në nivelin e koston së tyre. E drejta e fituar nga studentët e ndërmjetëm që ndjekin programin e integruar të ciklit të dytë nuk cenohet, pasi tarifata e reja u referohen viteve të ardhshme akademike dhe nuk kanë efekte prapavepruese. Kjo kategori studentësh do të përfshihet si pjesë e zbatimit të ligjit për plotësimin e nevojave për mjekë, me qëllim mbulimin me shërbim



shëndetësor sa më cilësor për qytetarët. Dispozitat e kundërshtuara nuk parashikojnë ndryshim të rregullave gjatë procesit akademik, por ndryshimet janë për të ardhmen, duke mos cenuar të drejtat e fituara me nisjen e vitit akademik për secilën kategori.

10.2. Pretendimi për cenimin e *së drejtës për punë dhe atë për arsimim*, të garantuara nga nenet 49 dhe 57, të Kushtetutës, në kundërshtim me kriteret e nenit 17 të Kushtetutës, është i pabazuar, pasi:

10.2.1. Parashikimet e nenit 55, pika 1 dhe nenit 59, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës janë të lidhura me një të drejtë të rëndësishme dhe themelore të parashikuar në nenin 21 të saj, që është e drejta e jetës. Kujdesi shëndetësor i lidhur me këtë të drejtë nuk është risi e sjellë nga Kushtetuta aktuale, por ka rrënjë të thella në traditën tonë juridike, duke filluar me vendimin nr. 103, datë 15.4.1938, të Mbledhjes së Përgjithshme të Këshillit të Shtetit, e duke vijuar me statutin e vitit 1946 dhe Kushtetutën e vitit 1976. Ligji plotëson kriteret e nenit 17 të Kushtetutës, pasi e drejta për kujdes shëndetësor synon mbrojtjen e së drejtës së jetës, për rrjedhojë shteti ka interes publik që të ndërhyjë në këtë aspekt, pasi ekziston një nevojë mjaft e lartë për të garantuar plotësimin e shërbimeve të shëndetit publik me burime njerëzore. Qëllimi i ligjvënësit gjatë hartimit dhe miratimit të ligjit nr. 60/2023, ka qenë sigurimi i një raportit të drejtë midis kufizimit të vendosur dhe interesit publik.

10.2.2. Për sa i përket *kriterit të proporcionalitetit*, interesi publik në garantimin e shërbimit mjekësor për popullsinë mbizotëron ndaj pritshmërisë së studentëve, që janë në ndjekje e sipër të programit të studimit në mjekësi, për të vijuar edhe kohën e mbetur të studimit me të njëjtin trajtim dhe kushte që kanë pasur deri më tani. Kjo pritshmëri nuk mund të ketë prioritet ndaj interesit të përgjithshëm për sigurimin e shërbimit shëndetësor në tërësi.

10.2.3. Dispozitat e kundërshtuara ndjekin *një qëllim të ligjshëm*. Kërkuesit nuk i referohen ndonjë dispozite konkrete të Kushtetutës për cenimin e thelbit të të drejtave dhe lirive apo përcaktimeve të KEDNJ-së ose për tejkalim të kufizimeve të parashikuara nga kjo e fundit. Asnjëri prej kategorive të studentëve nuk i mohohet e drejta për arsimim, përkundrazi ata ftohen për të përfutur nga trajtimi i veçantë që përbën edhe vetë qëllimin e ligjit. Alternativat që paraqet ligji kanë të bëjnë me

të drejtën e studentit për të zgjedhur nëse dëshiron të përfitojë lehtësitë që krijohen me nënshkrimin e marrëveshjes për të punuar në profesionin e mjekut pas përfundimit të studimeve në institucionet shëndetësore në vend. Dispozitat e ligjit janë hartuar në përputhje me nevojat e diktuar në vend. Shteti garanton arsimin e studentëve në fushën e mjekësisë sipas parashikimeve ligjore, duke mbuluar edhe një pjesë të kostove përkatëse. Ligji garanton punësimin e mjekëve të diplomuar dhe nuk ka cenim në thelbin e së drejtës për punë dhe as tejkalim të kufizimeve të parashikuara në KEDNJ.

10.3. Pretendimi për cenimin e *parimit të barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit* është i pabazuar, pasi përmes dispozitave të kundërshtuara ligjvënësi ka ofruar mundësi të ndryshme zgjedhjeje për të gjithë studentët e arsimit të lartë në mjekësi. Në kundërshtim me sa pretendojnë kërkuesit, secili nga studentët është i lirë të zgjedhë lirisht atë mundësi që i përshtatet më mirë, sipas preferencave të tij. Ofrimi i alternativave për të zgjedhur dhe zgjedhja që do të bëjë çdo student nuk përbën diskriminim.

10.4. Pretendimi për cenimin e *së drejtës për të mos iu nënshtruar punës së detyruar* është i pabazuar, pasi nuk bëhet fjalë për “punë të detyruar”, në kuptim të nenit 26 të Kushtetutës dhe nenit 4, pika 2, të KEDNJ-së. Dispozitat e kundërshtuara garantojnë të drejtën e çdo individi për të zgjedhur lirisht profesionin që dëshiron, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi. Parashikimet e neneve 4 dhe 5, të ligjit nr. 60/2023 përbëjnë kufizim të përligjur, i cili u përgjigjet nevojave dhe interesit të lartë publik për garantimin e ofrimit të shërbimit shëndetësor, si një nga të drejtat themelore të njeriut të përcaktuara në nenet 55 dhe 59, të Kushtetutës. “Punësim” konsiderohet edhe periudha e specializimit afatgjatë, pavarësisht llojit të kuotës së fituar, ku një pjesë e studentëve, përveçse kryejnë specializimin në strukturat shëndetësore përkatëse, duke kontribuar në zhvillimin e tyre profesional, përmbushin edhe detyrimin si periudhë punësimi në Shqipëri.

11. **Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave**, ka prapësuar si vijon:

A) *Për legjitimitimin*

11.1. Grupi i studentëve të Fakultetit të Mjekësisë në UMT nuk legjitimohet, pasi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të



Kushtetutës dhe ligjit nr. 8577/2000. Ky kërkues duhet t'i ngrejë pretendimet në të gjitha shkallët e juridiksionit të zakonshëm, duke iu dhënë mundësi gjykatave të zakonshme që të vlerësojnë nëse dispozitat e kundërshtuara paraqesin probleme kushtetutshmërie, duke referuar më pas çështjen në Gjykatë përmes gjykimit incidental.

B) Për themelin e kërkesës

11.2. Pretendimi për cenimin e *parimit të sigurisë juridike* nuk gjen mbështetje në parashikimet kushtetuese. Ai është i paqartë, pasi mungon parashtrimi i argumenteve për sa i përket përkeqësimit serioz të së drejtës për arsimim dhe punë prej ligjit objekt shqyrtimi, që ka sjellë pasoja që bien ndesh me vetë qëllimin e ligjvënësit, e deformojnë atë ose që dëmtojnë efektivitetin e tyre. Pandemia botërore COVID-19 ka gjeneruar efekte negative, ndaj politikat për rimëkëmbje duhet të rimodelohen. Ligji nr. 60/2023, është hartuar në përputhje me strategjitë kryesore në vend, e konkretisht me qëllimet e politikave në fushat e arsimit, shëndetësisë dhe punësimit sipas Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2022–2023, Strategjisë Kombëtare të Arsimit 2021–2026, Strategjisë Kombëtare të Shëndetësisë 2021–2030, të miratuara me VKM. Tarifa e studimeve, e cila ka qenë rreth 45,000 lekë/vit, me llogaritjen sipas metodologjisë së re bëhet rreth 240,000 lekë/vit, vlerë që i përgjigjet koston së një studenti të Fakultetit të Mjekësisë në buxhetin e shtetit. Ligji është mbështetës për studentët e Fakultetit të Mjekësisë, pasi me nënshkrimin e marrëveshjes ata mund të përfitojnë nga e drejta për të mos paguar detyrimet financiare që lidhen me pagimin e tarifës së studimeve përgjatë viteve që do të ndjekin programin e studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e përgjithshme”, si edhe lehtësi të tjera. Parashikimet ligjore të kundërshtuara respektojnë vullnetin e lirë të studentit për të vendosur vetë nëse do të përfitojë nga të drejtat e përcaktuara në këtë ligj me nënshkrimin e marrëveshjes ose në të kundërt të përballojë tarifën e studimeve deri në nivelin e koston së tyre. Interesi publik në garantimin e shërbimit mjekësor për popullsinë mbizotëron ndaj pritshmërisë së kërkuesve. Kjo pritshmëri nuk mund të ketë prioritet ndaj interesit të përgjithshëm për sigurimin e jetës dhe shërbimit shëndetësor në tërësi.

11.3. Pretendimi për cenimin e *së drejtës për punë dhe atë për arsimim, të garantuara nga nenet 49 dhe 57, të*

Kushtetutës, në kundërshtim me kriteret e nenit 17 të Kushtetutës, është i pabazuar, pasi:

11.3.1. Ligji nr. 60/2023 ndihmon në mbajtjen e talentit vendas në sistemin shëndetësor shqiptar, duke parandaluar largimin e tij jashtë shtetit. *E drejta për arsimim nuk është mohuar*, por është e ndërthurur me detyrime specifike të përkohshme për të mbështetur nevojat në shëndetësi. Dispozitat e kundërshtuara nuk cenojnë thelbin e së drejtës për arsimim, pasi çdo subjekt i tyre ka të drejtën e zgjedhjes nëse dëshiron të përfitojë nga lehtësitë që krijohen me nënshkrimin e marrëveshjes apo në të kundërt t'u përgjigjet detyrimeve që lindin për pagesën e tarifave të studimit. Përmes këtyre dispozitave synohet punësim sa më i shpejtë i studentëve të mjekësisë, duke detyruar institucionet punëdhënëse për respektimin e këtij parashikimi ligjor, i cili në rast mosrespektimi brenda një viti nga momenti i lindjes së të drejtës për punësim për studentët konsiderohet i përmbushur.

11.3.2. Nuk ka cenim të së drejtës së fituar edhe nga studentët e ndërmjetëm, sepse tarifat në rast mosnënshkrimi të marrëveshjes u referohen viteve të ardhshme akademike dhe nuk kanë efekte prapavepruese. Në thelb, dispozitat ligjore kundërshtohen për shkak të vendosjes së një sanksioni të rëndë monetar, që lidhet me aktet nënligjore që kanë përcaktuar vlerën e koston së studimeve, të cilat mund të bëhen objekt shqyrtimi në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm dhe jo në këtë Gjykatë. Ligji nr. 60/2023, ka efekt të përkohshëm, pasi i shtrin efektet e tij për periudhën nga viti akademik 2023–2024 deri në vitin akademik 2027–2028. Nga shteti janë marrë edhe masa të tjera në drejtim të kujdesit shëndetësor, por pavarësisht politikave të zbatuara ka nevojë imediate për të adresuar në mënyrë shteruese fenomenin e largimit të mjekëve nga sistemi dhe nga vendi.

11.3.3. Janë respektuar kriteret e kufizimeve të parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës, pasi ndërhyrja është kryer përmes një ligji të miratuar nga Kuvendi, për interes publik, duke vendosur edhe detyrimet përkatëse. Dispozitat e kundërshtuara synojnë një balancim midis interesave të studentëve dhe atyre të shëndetësisë publike. Interesi publik në garantimin e shërbimit mjekësor për popullsinë mbizotëron ndaj pritshmërisë së kërkuesve, e cila nuk mund të ketë prioritet.



11.4. Pretendimi për cenimin e parimit të barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit është i pabazuar, pasi ligjvënësi ka synuar mbrojtjen e interesit më të lartë publik për të garantuar plotësimin e nevojave për burimeve njerëzore në institucionet shëndetësore. Ligji është në harmoni me parashikimin e nenit 6 të ligjit nr. 10221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, të ndryshuar (ligji nr. 10221/2010) dhe në rastin konkret legjitimohet trajtimi ndryshe i përligjur. Dispozitat e kundërshtuara nuk janë diskriminuese, pasi profesioni i mjekut është i domosdoshëm për interesin publik, që është shëndeti i popullatës. Ato përcaktojnë në mënyrë transparente kriteret që duhen të përmbushen për të përfutur nga trajtimi i veçantë dhe ky përcaktim është detyrim i përgjithshëm, që nuk bazohet në kriteret ekonomike, por në përgjegjësinë ndaj sistemit shëndetësor dhe arsimit mjekësor në vend. Parashikimet ligjore nuk synojnë të diskriminojnë ata studentë që nuk janë në gjendje ekonomike për të paguar, por përcaktojnë një detyrim që është i lidhur me të ardhurat akademike dhe profesionale pas përfundimit të studimeve. Dispozitat e kundërshtuara nuk sjellin trajtim të diferencuar, por parashikojnë kriteret objektive që aplikohen njëlojt për të gjithë studentët, të cilët kanë ende lirinë për të zgjedhur institucionin e tyre të studimit, ndërkohë që ata që nuk dëshirojnë të pranojnë trajtim të veçantë, nuk janë të detyruar të studiojnë në institucione publike. Po kështu, ligji nr. 60/2023 nuk parashikon diskriminim ndaj studentëve të institucioneve jopublike, pasi ai vepron brenda një fushe kompetence të caktuar dhe në kontekstin e nevojave specifike të arsimit publik. Ai mbron dhe krijon kushtet për të realizuar interesin më të lartë publik, duke vepruar me mjetet dhe mekanizmat e duhur ligjorë, në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar. Ka edhe ligje apo akte nënligjore të tjera me natyrë të tillë, ashtu si edhe në shtete të tjera gjegjëse parashikime të ngjashme në legjislacionet e brendshme.

11.5. I pabazuar është edhe pretendimi për cenimin e së drejtës për të mos iu nënshtruar punës së detyruar, pasi dispozitat e kundërshtuara nuk përmbushin asnjë nga kushtet e vendosura nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) për të kualifikuar si punë të detyruar punësimin e studentëve që pranojnë të nënshkruajnë marrëveshjen e parashikuar në nenin 4, të ligjit nr. 60/2023. Këto parashikime nuk janë

nuk janë të padrejta, pasi nuk lidhen as me ndonjë ndëshkim, as me ndonjë karakteristikë personale të studentëve. Ato nuk përbëjnë detyrim shtypës dhe nuk krijojnë asnjë raport të padrejtë me aftësitë dhe mundësitë e studentëve. Plotësimi i kushteve ligjore nuk ka karakter ndëshkues, por sjell mbështetje financiare për ata që regjistrohen ose ndjekin programin e integruar të ciklit të dytë në mjekësi, duke mos rënduar pozitën e tyre ekonomike. Ligji është i orientuar drejt mbështetjes së interesave publikë në shëndetësi, duke siguruar një numër të mjaftueshëm të mjekëve të trajnuar për shërbimin e qytetarëve. Dispozitat ligjore u japin studentëve lirinë për zgjedhjen e kushteve për trajtimin e veçantë dhe detyrimin e punësimit pas përfundimit të studimeve në një mënyrë që respekton lirinë dhe vullnetin e individit.

III

Procesi në gjykimin kushtetues

A. Për vijimin e masës së pezullimit

12. Kërkesit kanë kërkuar edhe pezullimin e zbatimit të dispozitave të kundërshtuara të ligjit nr. 60/2023, deri në dhënien e vendimit përfundimtar nga Gjykata, duke pretenduar se rreziku që studentët të kryejnë një zgjedhje të detyruar për shkaqe që lidhen me gjendjen ekonomike dhe kundër vullnetit të tyre është real dhe pasojat negative që rrjedhin nëse ligji zbatohet janë serioze dhe të pakthyeshme për studentët që dëshirojnë të ruajnë *status quo*-në.

13. Me vendimin e datës 14.11.2023, Mbledhja e Gjyqtarëve, pasi mori në shqyrtim kërkesën, në përputhje me parashikimet e nenit 45 të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur pranimin e saj, duke pezulluar zbatimin e dispozitave të kundërshtuara të ligjit nr. 60/2023, deri në hyrjen në fuqi të vendimit përfundimtar të Gjykatës.

14. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, në prapësimet e datës 11.12.2023, drejtuar Gjykatës, ka kërkuar heqjen e masës së pezullimit, pasi nuk justifikohen kërkesat e nenit 45, të ligjit nr. 8577/2000 dhe kërkesit nuk kanë paraqitur argumente konkrete dhe reale në lidhje me pasojat aktuale që do të duhej të parandaloheshin dhe rrezikun për pasoja të mundshme që vijnë nga zbatimi i dispozitave të kundërshtuara të tilla që prekin interesat e tyre, çka përbën kriterin thelbësor për pezullimin e zbatimit të aktit të kundërshtuar.



15. Subjekti i interesuar, Kuvendi, në seancën plenare publike të datës 21.12.2023, ka paraqitur kërkesë paraprake për heqjen e masës së pezullimit, pasi ajo nuk justifikon kërkesat e nenit 45, të ligjit nr. 8577/2000. Sipas tij, kërkuessit nuk kanë paraqitur argumente konkrete dhe reale në lidhje me menjëhershmerinë dhe pasojat aktuale që do të duhej të parandaloheshin apo rrezikun për pasoja të mundshme që vijnë nga zbatimi i dispozitave të kundërshtuara të ligjit nr. 60/2023. Po sipas Kuvendit, Gjykata duhet të rivlerësojë nevojën për pezullim, pasi kjo mund të sjellë pasiguri juridike në sektorin e shëndetësisë dhe të arsimit mjekësor, si dhe efekte negative në planifikimin dhe funksionimin e sistemit mjekësor.

16. Neni 45, pika 1, i ligjit nr. 8577/2000 parashikon se Gjykata, kryesisht ose me kërkesë të palës, kur vlerëson se zbatimi i ligjit ose i aktit mund të sjellë pasoja që prekin interesa shtetërore, shoqërore ose të individëve, sipas rastit, me vendim të Mbledhjes së Gjyqtarëve ose në seancë plenare urdhëron pezullimin e ligjit ose të aktit. Pezullimi vazhdon derisa vendimi përfundimtar i Gjykatës të hyjë në fuqi. Në kushtet kur pezullimi është një masë e jashtëzakonshme, Gjykata vëren se vendosja e tij lidhet me vlerësimin e pasojave ose efekteve të zbatimit të aktit. Këto pasoja jo vetëm duhet të jenë reale, pra në realizim e sipër, por edhe të rënda, në atë masë që shkojnë tej masës normale të kufizimit, në veçanti në pikëpamje të urgjencës.

17. Bazuar në këtë dispozitë, pasi dëgjoi palët në proces dhe mori në shqyrtim pretendimet e tyre për vijimin e masës së pezullimit, Gjykata, duke pasur parasysh pasojat që mund të vijnë për studentët që ndjekin programin e integruar të ciklit të dytë në Fakultetin e Mjekësisë në UMT nga zbatimi i dispozitave të kundërshtuara, çmoi se ato janë aktuale dhe reale dhe në kuptim të nenit 45, të ligjit nr. 8577/2000, përligjin vijimin e masës së pezullimit të vendosur me vendimin e datës 14.11.2023 të Mbledhjes së Gjyqtarëve.

IV

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

B. Për legjitimimin e kërkuessve

B.1. Për legjitimimin racione personae

B.1.1. Për legjitimimin e një grupi deputetësh

18. Çështjen e legjitimitetit (*locus standi*) Gjykata e ka vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhet

me vënien në lëvizje të një procesi kushtetues. Kushtetuta, në nenin 134, pika 1, të saj, ka përcaktuar në mënyrë shteruese rrethin e subjekteve kushtetuese që legjitimohen të vënë në lëvizje juridiksionin kushtetues.

19. Jo më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit është subjekt i parashikuar në nenin 134, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës dhe nenin 49, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, të cilat i njohin atij të drejtën për nisjen e kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë së ligjit, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “a”, të Kushtetutës. Gjykata ka theksuar se interesi publik i këtyre funksionarëve publikë është i prezumuar, pasi një kërkesë e tyre vë në lëvizje një kontroll abstrakt e objektiv të aktit normativ dhe interesi që kërkohet të mbrohet lidhet me respektimin e parimeve kushtetuese dhe me funksionimin e rregullt të shtetit të së drejtës. Mbrojtja e sistemit normativ dhe parimeve shtetformuese, ndër të tjera, si konstitucionalizmi, shteti i së drejtës, demokracia, dinjiteti njerëzor, barazia sociale, të shpalosura në Kushtetutë, nuk është e kushtëzuar nga një interes subjektiv konkret. Në këtë kuptim, Gjykata pohon se qëllimi i kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve është njëkohësisht edhe parandalimi i pasojave negative që mund të vijnë nga zbatimi i tyre (*shih vendimet nr. 35, datë 15.6.2023; nr. 18, datë 7.7.2022; nr. 55, datë 27.7.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Në këndvështrim të sa më sipër, Gjykata vëren se kërkuessi, një grup prej 30 deputetësh të Kuvendit, në cilësinë e subjektit kushtetues jo më pak se një e pesta e deputetëve, si subjekt i pakushtëzuar nuk ka nevojë të provojë interesin e tij të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të kontrollit abstrakt të pajtueshmërisë me Kushtetutën të dispozitave të ligjit nr. 60/2023, objekt i kësaj kërkesë, për rrjedhojë ai legjitimohet *ratione personae*.

B.1.2. Për legjitimimin e grupit të studentëve

21. Grupi i studentëve të Fakultetit të Mjekësisë, në UMT ka parashtruar se legjitimohet *ratione personae*, pasi është bartës i të drejtave kushtetuese dhe ka interes të drejtpërdrejtë për kundërshtimin e dispozitave objekt të kërkesës, pasi këto të fundit cenojnë në mënyrë reale të drejtat e tyre dhe garancitë e mbrojtura nga Kushtetuta. Në lidhje me legjitimimin *ratione personae* subjektet e interesuara nuk kanë paraqitur asnjë argument.

22. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe



134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur. Në çështjen në shqyrtim kërkesa drejtuar Gjykatës është nënshkruar individualisht nga 37 kërkues që janë studentë të programit të integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e përgjithshme” në UMT, sipas vërtetimeve përkatëse të lëshuara nga dekani i Fakultetit të Mjekësisë në UMT bashkëlidhur kërkesës.

23. Po sipas Gjykatës, bazuar në nenet 49, pika 3, shkronja “e” dhe 71, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000, objekt i ankimit kushtetues individual mund të jetë edhe ligji ose akti normativ. Në këto raste, kërkuesi legjitimohet nëse plotësohen bashkërisht këto kriteret: i. legjitimimi *ratione personae*, në kuptimin që individ i provon se është bartës i së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar, si dhe provon interesin në lidhje me çështjen, pra cenimin e drejtpërdrejtë dhe real të së drejtës kushtetuese; ii. shterimi i mjeteve juridike efektive për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar ose individ i provon se akti i kundërshtuar është drejtpërdrejt i zbatueshëm; iii. legjitimimi *ratione temporis*, në kuptimin që individ ka paraqitur ankim brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit; (iv) legjitimimi *ratione materiae*, në kuptimin që individ i provon se pretendimet e ngritura janë të tilla që bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues, pra të drejtat dhe liritë themelore, që pretendohen se janë cenuar, janë të garantuara në Kushtetutë, si dhe shqyrtimi kushtetues i çështjes mund të rivendosë të drejtën kushtetuese të shkelur (*shih vendimet nr. 38, datë 12.7.2023; nr. 4, datë 21.2.2022; nr. 31, datë 4.10.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Në rastin konkret, Gjykata, bazuar në aktet bashkëlidhur kërkesës, vëren se studentët e Fakultetit të Mjekësisë në UMT nuk janë të organizuar në formën e një organizate në kuptim të

nenit 134, pika 1, shkronja “h”, të Kushtetutës, por ata i janë drejtuar Gjykatës si një grupim individësh. Për rrjedhojë, për qëllime të legjitimitimit të këtij kërkuesi në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, në rastin e pretendimeve për papajtueshmëri të ligjit me Kushtetutën, grupi i studentëve duhet të provojë se është viktimë e shkeljes dhe se zbatimi i dispozitave të ligjit të kundërshtuar cenon interesat e tij, duke sjellë pasojat të drejtpërdrejta dhe reale.

25. Sipas GJEDNJ-së, kërkuesit mund të pretendojnë se janë viktimë të një shkeljeje nëse janë anëtarë të një grupi në rrezik ose që preken drejtpërdrejt nga legjislacioni. Kërkuesi mund të pretendojë se një ligj shkel të drejtat e tij/saj dhe për rrjedhojë është “viktimë”, sipas kuptimit të nenit 34, nëse atij i kërkohet të modifikojë sjelljen e tij ose rrezikon të procedohet për mosrespektim të ligjit (*shih Burden kundër Mbretërisë së Bashkuar (DhM), nr. 13378/05, § 34, ECHR 2008; S.A.S. kundër Francës (DhM), nr.43835/11, datë 1.7.2014, § 57*).

26. Gjykata konstaton se dispozitat e kundërshtuara të ligjit nr. 60/2023, përcaktojnë kriteret për përfitimin e trajtimit të veçantë nëse studentët e Fakultetit të Mjekësisë në UMT pranojnë nënshkrimin e marrëveshjes me pasojë kalimin zyrtarisht të diplomës përkatëse të arsimit të lartë nga institucioni publik i arsimit të lartë, ku studenti ka përfunduar studimet, në institucionin shëndetësor ku punësohet deri në “shlyerjen e detyrimeve për punësim” sipas afatit të përcaktuar. Studentët e Fakultetit të Mjekësisë, të cilët i janë drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues, janë subjekte të të drejtave kushtetuese të pretenduara të cenuara për sa kohë që përfshihen në ato kategori që preken në mënyrë të drejtpërdrejtë nga dispozitat e kundërshtuara. Me fillimin e vitit akademik ata janë vënë përballë zgjedhjes mes nënshkrimit të marrëveshjes dhe përfitimit të trajtimit të veçantë apo pagesës së vlerës së plotë të kostos së studimeve. Parashikimet e dispozitave të kundërshtuara i detyrojnë studentët të modifikojnë sjelljen në situatën në të cilën ndodhen, duke u vënë përballë një zgjedhjeje të re, çka ndikon në interesat e tyre, veçanërisht për ata studentë që nuk kanë mundësi ekonomike, duke u detyruar të pranojnë kushtet e vendosura për kalimin e diplomës deri në përfundimin e afatit të detyruar për punësim. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se për sa kohë që këto parashikime ligjore zbatohen



në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe reale mbi ta, ata mund të pretendojnë se janë viktima të shkeljes, për rrjedhojë grupi i studentëve legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, pasi provon interesin e drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

27. Për sa i përket *kriterit të shterimit të mjeteve juridike efektive*, në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se në rastet e pretendimeve për papajtueshmërinë e ligjeve me Kushtetutën, kërkuksi duhet t'i ketë përdorur të gjitha mjetet juridike në dispozicion për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese që cenon ligji i kundërshtuar jo vetëm formalisht, por edhe në kuptimin substancial. Si rregull, ligji zbatohet përmes akteve të organeve publike ose vendimeve gjyqësore, prandaj individi duhet, së pari, t'i kundërshtojë ato para gjykatave kompetente, duke shteruar të gjitha mjetet juridike që parashikon sistemi ynë juridik. Kjo ka rëndësi edhe për të provuar se kërkuksi është prekur personalisht, drejtpërdrejt dhe realisht. Megjithatë, ligji ka parashikuar edhe rastet kur përmbushja e këtij kriteri është e pamundur (legjislacioni nuk parashikon mjete juridike ose ato janë joefektive). Megjenëse mjeti juridik mund të jetë i ndryshëm, në varësi të llojit të ankimit, efektiviteti i tij vlerësohet jo thjesht nga fakti që është parashikuar me ligj, por edhe nga zbatueshmëria e tij. Karakteristika e zbatimit të drejtpërdrejtë të ligjit lidhet me aftësinë që ka ligji i kundërshtuar për të cenuar në mënyrë po të drejtpërdrejtë të drejtën themelore individuale dhe, për këtë arsye, bëhet fjalë për ato raste kur ligji nuk parashikon nxjerrjen e akteve nënligjore të nevojshme për zbatimin e tij. Kjo nënkupton se ligji i shkakton pasojat e tij ndaj të drejtave kushtetuese individuale pa pasur nevojën e detajimit të rregullave shtesë në formën e akteve nënligjore (*shih vendimet nr. 4, datë 21.2.2022; nr. 31, datë 4.10.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Kërkuksi, grupi i studentëve, ka pretenduar se çdo lloj kundërshtimi gjyqësor i dispozitave të ligjit nr. 60/2023, do të rezultonte joefektiv, pasi edhe nëse do të investonte gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për të kërkuar pezullimin e ligjit nr. 60/2023 dhe dërgimin e tij për gjykim incidental në Gjykatën Kushtetuese, kjo do të rezultonte në humbje kohe, shpërdorim të resurseve gjyqësore, ndërkohë që pranimi i kërkesës për kontroll incidental nuk do të ishte i sigurt. Po kështu,

gjykimi në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm, qoftë edhe me procedurë të përshpejtuar, do të ishte objektivisht i pamundur të përfundonte brenda këtij viti akademik, çka do të sillte pasoja të studentët e vitit të fundit të Fakultetit të Mjekësisë në UMT. Nga ana tjetër, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk mund të pezullojnë ligje dhe akte normative, pasi një prerogativë e tillë i përket vetëm Gjykatës Kushtetuese.

29. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka prapësuar se grupi i studentëve të Fakultetit të Mjekësisë në UMT nuk legjitimohet, pasi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës dhe ligjit nr. 8577/2000. Ai duhet t'i ngrejë pretendimet në të gjitha shkallët e juridiksionit të zakonshëm, duke iu dhënë mundësi gjykatave të zakonshme që të vlerësojnë nëse dispozitat e kundërshtuara paraqesin probleme kushtetutshmërie, duke referuar më pas çështjen në Gjykatë përmes gjykimit incidental.

30. Gjykata vlerëson të theksojë, së pari, se paraqitja e kërkesës për nisjen e kontrollit incidental të normës nuk përbën element të domosdoshëm në këndvështrim të përmbushjes së kriterit të shterimit të mjeteve juridike efektive, megjithatë, si një formë jo e drejtpërdrejtë e aksesit në gjykimin kushtetues, palët në procesin gjyqësor, nëse kanë vënë në lëvizje një të tillë, mund të zgjedhin t'i kërkojnë gjykatës së zakonshme që të investojë Gjykatën Kushtetuese (*shih vendimin nr. 4, datë 21.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Në këndvështrim të sa më sipër, Gjykata vëren se dispozitat ligjore të kundërshtuara të ligjit nr. 60/2023, nuk parashikojnë nxjerrjen e akteve nënligjore të nevojshme për zbatimin e tyre, por ato janë drejtpërdrejt të zbatueshme ndaj kërkuksit, si studentë të Fakultetit të Mjekësisë në UMT, që prej momentit që fillon viti akademik, ku ata vihen përballë zgjedhjes për nënshkrimin e marrëveshjes, në mënyrë që të përfitojnë trajtim të veçantë, ose të pagesës së vlerës së plotë të kostos së studimeve. Këto dispozita janë drejtpërdrejt të zbatueshme nga kërkuksi, grupi i studentëve, duke sjellë pasojat e kundërshtuara kushtetutshmërisht. Në këto kushte, në lidhje me dispozitat ligjore objekt të këtij gjykimi, kërkuksi nuk ka mjete të tjera në dispozicion për të shteruar përveç vënies në lëvizje të kontrollit të pajtueshmërisë së tyre me Kushtetutën, pra paraqitjes së ankimit kushtetues



individual për rivendosjen e të drejtave kushtetuese të pretenduara të cenuara.

B.2. Për legjitimitimin racione temporis

B.2.1. Për legjitimitimin racione temporis të kërkuarit, një grup deputetësh

32. Sipas nenit 50, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e kërkesës për kontrollin e pajtueshmërisë së ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën është 2 vjet nga hyrja në fuqi e aktit. Ligji nr. 60/2023 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 123, datë 16.8.2023 dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit të tij, përkatësisht në datën 31.8.2023, kurse kërkesa është paraqitur në Gjykatë dorazi në datën 19.10.2023, pra brenda afatit ligjor.

B.2.2. Për legjitimitimin racione temporis të kërkuarit, një grup studentësh

33. Sipas kërkuarit cenimi i të drejtave kushtetuese të studentëve është materializuar në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 60/2023, pra në datën 31.8.2023, ose sipas një interpretimi më të gjerë në vështirësi të nenit 4 të ligjit, me fillimin e vitit akademik 2023–2024, pra në datën 2.10.2023.

34. Lidhur me afatin ligjor të paraqitjes së ankimit kushtetues individual, bazuar në nenin 50, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000, ai duhet të paraqitet brenda 4 muajve nga konstatimi i cenimit. Gjykata ka vlerësuar se në rastin e këtij lloji ankimi konstatimi i cenimit si rregull nuk përkon me çastin e hyrjes në fuqi të ligjit ose aktit normativ. Në këto raste afati ligjor llogaritet nga çasti kur akti fillon të prodhojë efekte për kërkuarin ose, thënë ndryshe, kur ndaj tij zbatohet ligji ose akti normativ (*shih vendimin nr. 31, datë 4.10.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

35. Gjykata vëren se ligji nr. 60/2023 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 123, datë 16.8.2023 dhe ka hyrë në fuqi në datën 31.8.2023, pra përpara fillimit të vitit akademik 2023–2024, që sipas urdhrit të ministrit të Arsimit dhe Sportit është data 2.10.2023, dhe pas testimit të detyruar të pranimit për studentët e vitit të parë, i cili, referuar akteve të këtij gjykimi, është zhvilluar në periudhën 14–23.8.2023. Për rrjedhojë, edhe pse studentët që preken nga ky ligj kategorizohen në dy grupe: studentët në vitin e parë të studimeve dhe; studentët e ndërmjetëm, ligji i kundërshtuar ka filluar të sjellë efekte për të gjithë me fillimin e vitit akademik 2023–2024, që përkon me momentin kur, siç është shprehur Gjykata në analizën e legjitimitimit *ratione personae*, janë vënë përballë

zgjedhjes mes nënshkrimit të marrëveshjes dhe përfitimit të trajtimit të veçantë ose pagesës së vlerës së plotë të kostos së studimeve. Duke vlerësuar këtë si momentin nga i cili ka filluar të ecë afati 4-mujor për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, Gjykata vlerëson se është përmbushur edhe kriteri i legjitimitimit *ratione temporis*.

B.3. Për legjitimitimin racione materiae

36. Gjykata vëren se kërkuarit kanë pretenduar cenimin e disa parimeve dhe të drejtave kushtetuese, më konkretisht të parimit të sigurisë juridike, të garantuar në nenin 4 të Kushtetutës, së drejtës për punë dhe së drejtës për arsimim, të garantuara nga nenet 49 dhe 57, të Kushtetutës, në kundërshtim me kriteret e kufizimit të parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës, së drejtës për të mos iu nënshtruar punës së detyruar, të garantuar nga neni 26 i Kushtetutës, si edhe parimit të barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit, të garantuar nga neni 18 i Kushtetutës.

37. Gjykata vëren se pretendimin për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit dhe të mosdiskriminimit, të garantuar në nenin 18 të Kushtetutës, kërkuari e ka bazuar në dallimet, për shkak të gjendjes ekonomike, që, sipas tij, krijohen midis kategorive të ndryshme të studentëve: i. midis studentëve që ndjekin studimet në Fakultetin e Mjekësisë në UMT, e lidhur kjo me pagesën e vlerës së plotë të kostos së studimeve në rast të mosnënshkrimit të marrëveshjes së përcaktuar në nenin 4, të ligjit nr. 60/2023 me studentët që nënshkruajnë marrëveshjen, si edhe ii. midis studentëve që ndjekin studimet në Fakultetin e Mjekësisë në UMT dhe studentëve që ndjekin studimet në institucionet jopublike të arsimit të lartë, për shkak se mbi këta të fundit nuk rëndon detyrimi për nënshkrimin e marrëveshjes. Edhe pse kërkuari ka pretenduar se ky parim cenohet nga dispozitat ligjore objekt kërkesë, në thelb ai e ka lidhur pretendimin me vlerën e kostos financiare të studimeve që duhet të përballojnë studentët që nuk pranojnë të nënshkruajnë marrëveshjen me institucionet shëndetësore publike. Gjykata vëren se metodologjia për përcaktimin e kostove të studimeve dhe vlera e saj nuk përcaktohen nga ligji nr. 60/2023, por janë miratuar me akte nënligjore të organeve të UMT-së, që kanë dalë në zbatim të këtij ligji, por që nuk janë objekt i këtij gjykimi kushtetues dhe për më tepër mund të jenë objekt i kontrollit të juridiksionit të zakonshëm gjyqësor.



Për rrjedhojë, pretendimi për cenimin e nenit 18 të Kushtetutës nuk mund të merret në shqyrtim në këtë gjykim kushtetues.

38. Referuar përmbajtjes së pretendimeve të tjera të parashtruara në kërkesë, Gjykata vëren se ato që lidhen me të drejtën për arsimim, sipas nenit 57 të Kushtetutës, janë mbështetur në cenimin e të drejtave të fituara dhe pritshmërive të ligjshme të studentëve për shkak të ndryshimit të kornizës ligjore që ka qenë në fuqi në kohën kur ata kanë filluar studimet në Fakultetin e Mjekësisë (ligji nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 80/2015)) për studentët e ndërmjetëm, dhe kur kanë vendosur të konkurrojnë për t’u bërë pjesë e atij fakulteti, për studentët e vitit të parë. Për rrjedhojë, këto pretendime do të analizohen në vijim në drejtim të parimit të sigurisë juridike. Kurse pretendimet që kanë të bëjnë me cenimin e së drejtës për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme të zgjedhur ose të pranuar vetë dhe asaj për të mos iu nënshtruar punës së detyruar, për shkak të mënyrës se si janë parashtruar ato, do të shqyrtohen në vijim në kuptim të përmbajtjes së nenit 49, pika 1, të Kushtetutës.

C. Për themelin e pretendimeve

C.1. Për cenimin e parimit të sigurisë juridike

39. Sipas kërkesve, studentët që ndjekin programin e integruar të ciklit të dytë në Fakultetin e Mjekësisë në UMT cenohen si pasojë e detyrimeve të parashikuara në dispozitat e kundërshtuara të ligjit nr. 60/2023, pasi me nënshkrimin e marrëveshjes kërkohet kalimi zyrtarisht i diplomës përkatëse nga institucioni publik i arsimit të lartë në institucionin shëndetësor ku studentët e diplomuar punësohen deri në shlyerjen e detyrimeve për punësim sipas afateve përkatëse. Ata studentë që nuk pranojnë të lidhin marrëveshjen kanë detyrimin të paguajnë koston e plotë të studimeve. Sipas kërkesve, dispozitat e kundërshtuara kanë sjellë një përkeqësim serioz të situatës ligjore të studentëve që dëshirojnë të ruajnë *status quo*-në, sidomos të atyre që ndjekin vitet e ndërmjetme, të cilët i kanë bërë përllogaritjet mbi bazën e kostos së plotë të studimeve, si dhe mundësive të tyre ekonomike për të përballuar pagesën e tarifës përkatëse çdo vit, para se të fillonin studimet. Sipas tyre, përkeqësimi i situatës ekonomike e juridike të studentëve që nuk

dëshirojnë të lidhin marrëveshje nuk i shërben interesit publik dhe as kufizimi i tërheqjes së diplomës.

40. Subjekti i interesuar, Kuvendi, ka prapësuar se qëllimi i ligjvënësit ka qenë sigurimi i një raporti të drejtë midis kufizimit të vendosur dhe interesit publik dhe alternativat e ligjit kanë të bëjnë me të drejtën e vetë studentit për të zgjedhur nëse dëshiron të përfitojë lehtësitë që krijohen me nënshkrimin e marrëveshjes. Sipas tij, duke qenë kjo një masë proporcionale, vetë e drejta për arsimim dhe punë nuk cenohet, pasi shteti garanton arsimin e studentëve në fushën e mjekësisë sipas parashikimeve ligjore, duke mbuluar edhe një pjesë të kostove përkatëse. Në vlerësimin e këtij subjekti e drejta e fituar nga studentët e ndërmjetëm, që ndjekin programin e integruar të ciklit të dytë në Fakultetin e Mjekësisë në UMT nuk cenohet, pasi ndryshimet ligjore zbatohen për të ardhmen, duke mos cenuar të drejtat e fituara me nisjen e vitit akademik për secilën kategori që preket prej tyre.

41. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka prapësuar se çdo student ka të drejtën e zgjedhjes nëse dëshiron të përfitojë nga lehtësitë që krijohen me nënshkrimin e marrëveshjes apo në të kundërt t’u përgjigjet detyrimeve që lindin për pagesën e tarifave të studimit. Sipas tij, nuk ka cenim të së drejtës së fituar nga studentët e ndërmjetëm që ndjekin studimet në këtë program studimi, pasi parashikimet ligjore nuk kanë efekte prapavepruese, ndërkohë që ato synojnë punësimin sa më të shpejtë të studentëve të Fakultetit të Mjekësisë. Sipas këtij subjekti, në rast të mosrespektimit të këtij detyrimi brenda një viti nga momenti i lindjes së të drejtës për punësim, ai konsiderohet i përmbushur dhe studentit të diplomuar, edhe pse nuk pajiset me diplomën dhe suplementin e saj, me përfundimin e procedurave i lind e drejta për punësim në sistemin shëndetësor shqiptar.

42. Sipas nenit 57, pika 1, të Kushtetutës kushdo ka të drejtën për arsimim, kurse sipas pikës 4 të tij arsimi i lartë mund të kushtëzohet vetëm nga kriteret aftësie. Edhe sipas nenit 2, pika 1, të Protokollit Shtesë të KEDNJ-së, askujt nuk mund t’i mohohet e drejta për arsimim (*neni 2, pika 1*). Në këtë drejtim, GJEDNJ-ja ka theksuar se kjo e drejtë, për vetë natyrën e saj, kërkon rregullim nga shteti, rregullim i cili mund të ndryshojë në kohë



dhe vend, në varësi të nevojave të komunitetit dhe të individëve. Është e vetëkuptueshme se një rregullim i tillë nuk duhet të cenojë kurrë thelbin e së drejtës për arsimim dhe as të bjerë ndesh me të drejtat e tjera të parashikuara në Konventë (*shih "Në lidhje me disa aspekte të ligjeve për përdorimin e gjuhëve në arsim në Belgjikë" kundër Belgjikës nr. 1474/62; 1677/62; 1691/62; 1769/63; 1994/63; 2126/64, datë 23.7.1968, § 5 (pjesa "Ligji"); Leyla Şahin kundër Turqisë (DhM), datë 10.11.2005, § 154*).

43. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se e drejta për arsimim është një e drejtë që orientohet nga shteti drejt krijimit, zhvillimit, përcjelljes dhe mbrojtjes së dijeve përmes mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, duke kontribuar në rritjen e standardeve të demokracisë në vend, si dhe zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor etj. Kufijtë ligjorë të rregullimit të kësaj të drejte mund të përcaktohen, rast pas rasti, edhe në varësi të nevojave dhe interesave të përgjithshëm publikë, por duke ruajtur balancën që ndërhyrja në këtë të drejtë të jetë në atë masë sa që të mos ulë në mënyrë të ndjeshme dhe thelbësore ushtrimin e saj.

44. Për sa i përket parimit të sigurisë juridike, Gjykata ka theksuar se ky parim ashtu si edhe mbrojtja e të drejtave të fituara, si dhe e pritshmërive të ligjshme përbëjnë elemente të parimit të shtetit të së drejtës, të sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës. Parimi i sigurisë juridike, përfshin, krahas qartësisë, kuptueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së sistemit normativ edhe besueshmërinë e qytetarëve të shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara. Besueshmëria ka të bëjë me bindjen e individit se nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht ose të jetojë me frikë për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve juridike, të cilat mund të cenojnë jetën e tij private ose profesionale dhe të përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme (*shih vendimet nr. 1, datë 16.1.2017; nr. 15, datë 10.3.2016; nr. 25, datë 28.4.2014, të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, parimi i sigurisë juridike nuk garanton çdo lloj pritshmërie për mosndryshim të një situate të favorshme ligjore dhe ai nuk mund të prevalojë në çdo rast. Kjo do të thotë se nëse paraqitet rasti që një rregullim ligjor ndryshe i një marrëdhënieje ndikohet drejtpërdrejt nga një interes i rëndësishëm publik, me të gjitha elementet e tij thelbësore, ky interes mund të ketë përparësi ndaj parimit të sigurisë juridike. Në këtë

pikëpamje, duhet parë në çdo rast se në çfarë mase dhe deri ku besimi që ka qytetari në situatën e favorshme ligjore paraqitet i rëndësishëm për t'u mbrojtur dhe cilat janë arsyet për një mbrojtje të tillë (*shih vendimet nr. 1, datë 16.1.2017; nr. 37, datë 13.6.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

45. Gjykata vëren se në drejtim të së drejtës kushtetuese për arsimim neni 57, pika 4, i Kushtetutës ka parashikuar se ushtrimi i saj në lidhje me arsimin e lartë kushtëzohet vetëm mbi kritere aftësie. Detyrimet e vendosura në nivel kushtetues janë detajuar nga ligjvënësi, në përputhje me rezervën ligjore, i cili ka parashikuar rregullat dhe kriteret e pranimit në arsimin e lartë, me qëllim materializimin dhe ushtrimin e kësaj të drejte. Në këtë drejtim ligji nr. 80/2015, që ka përcaktuar edhe objektivat kryesorë të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor dhe që synon të garantojë mundësi të barabarta, mbi bazën e meritës, për të gjithë individët që duan të ndjekin studimet në arsimin e lartë (*neni 2*), ka përcaktuar edhe se në përfundim të programit të studimit, sipas nenit 91 të tij, studenti pajiset me diplomën ose certifikatën përkatëse. Elementet përbërëse, forma e diplomës dhe procedurat për regjistrimin përcaktohen nga ministria përgjegjëse për arsimin.

46. Për rrjedhojë, në kohën kur kanë filluar studimet e larta në Fakultetin e Mjekësisë, si edhe kur kanë konkurruar për këtë qëllim studentët që janë subjekt i ligjit nr. 60/2023, kriteret e pranimit dhe rregulli për pajisjen me diplomë në përfundim të programit të studimeve kanë qenë të përcaktuara nga ligji nr. 80/2015, me të cilat ata janë njohur dhe i kanë pranuar si të tilla, ashtu si edhe tarifat e studimit të përcaktuara nga institucioni përkatës i arsimit të lartë.

47. Me ligjin nr. 60/2023, ligjvënësi ka përcaktuar disa rregulla të veçanta për trajtimin e studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë "Mjekësi e përgjithshme" në institucionet publike të arsimit të lartë, duke synuar sigurimin e burimeve njerëzore për kryerjen e shërbimeve të shëndetit publik në institucionet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë (*nenet 1 dhe 2*). Me këtë ligj është parashikuar koncepti i "trajtimin të veçantë" të studentëve të mjekësisë, i cili nuk gjendet në ligjin nr. 80/2015, dhe që përfshin punësimin me prioritet të studentit që ndjek programin e integruar në Fakultetin e Mjekësisë në UMT, si dhe përfitimin nga



programet sociale të strehimit. Ky trajtim i veçantë zbatohet si ndaj studentëve që janë në vazhdim të studimeve të tyre në Fakultetin e Mjekësisë (konkretisht studentët e vitit të dytë deri në vitin e katërt dhe ata të vitit të pestë ose të gjashtë), ashtu edhe ndaj atyre që pranohen në vitin e parë të programit të integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë nëse nënshkruajnë marrëveshjen që lidhet mes tyre dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin e për shëndetësinë dhe institucionit të arsimit të lartë publik, përmes së cilës pranojnë të punojnë në profesionin e mjekut pas përfundimit të studimeve për jo më pak se, përkatësisht, tre, dy dhe pesë vjet, që shoqërohet me kalimin zyrtarisht të diplomës nga institucioni ku kanë përfunduar studimet në institucionin shëndetësor ku punësohen deri në “shlyerjen e detyrimeve për punësim”, e cila mund të tërhiqet pas përmbushjes së këtij detyrimi sipas afateve përkatëse. Sipas nenit 5, të ligjit nr. 60/2023, në rast të mosnënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, studenti paguan vlerën e plotë të kostos së studimeve përkatëse, sipas masës që është miratuar me aktet nënligjore të organeve të UMT-së, e cila rezulton të jetë rritur në krahasim me tarifën që ata kanë paguar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.

48. Bazuar në sa më sipër, Gjykata vëren se, në ndryshim nga parashikimet e ligjit nr. 80/2015, dispozitat e kundërshtuara të ligjit nr. 60/2023, kanë ndryshuar situatën ligjore të studentëve të mjekësisë në drejtim të këtyre elementeve: i. vendosja para zgjedhjes për nënshkrimin e një marrëveshjeje për punësim; ii. në rast të nënshkrimit të marrëveshjes studenti nuk pajiset me diplomë pas përfundimit të studimeve, por ajo mbahet nga institucioni shëndetësor ku ai punësohet, sipas afatit të përcaktuar nga këto dispozita dhe lëshohet vetëm pas “shlyerjes së detyrimeve për punësim”; iii. në rast të mosnënshkrimit të marrëveshjes paguhet kosto e plotë e studimeve e miratuar me akte nënligjore të organeve të UMT-së.

49. Këto ndryshime, në vlerësimin e Gjykatës, përbëjnë një përkeqësim të situatës ligjore të studentëve të mjekësisë, si të atyre të ndërmjetëm, ashtu edhe të studentëve që hyjnë rishtazi në Fakultetin e Mjekësisë në UMT, të cilët nuk janë njohur me këtë situatë dhe nuk e kanë pranuar atë në momentin që kanë vendosur të konkurrojnë

pranë atij fakulteti. Në kuptim të së drejtës për arsimim, siç u theksua më sipër, ligji nr. 80/2015, ka parashikuar përveç kritereve, procedurave dhe rregullave për zhvillimin e programit mësimor, edhe të drejtën për pajisjen me diplomë në përfundim të këtij programi, sipas secilit cikël të studimeve. Thënë kjo, parashikimet ligjore të kundërshtuara që parashikojnë se studentët, në rast të nënshkrimit të marrëveshjes nuk kanë të drejtë të pajisen me diplomë, por kjo e fundit kalohet zyrtarisht nga institucioni i arsimit të lartë në institucionin shëndetësor ku studenti do të punësohet dhe i lëshohet atij vetëm me “shlyerjen e detyrimeve për punësim”, kanë sjellë pasoja negative në të drejtat e fituara të tyre, sipas parashikimeve ligjore të miratuara në kuptim dhe zbatim të së drejtës për arsimim. Përkeqësimi i situatës ligjore të studentëve, duke parashikuar detyrime dhe rregulla të reja, të cilat ata nuk i kanë njohur dhe as nuk i kanë pranuar më parë, nuk përputhet me parimin e sigurisë juridike, për rrjedhojë pretendimi i kërkuar në këtë drejtim është i bazuar.

50. Në vlerësimin e Gjykatës, këto ndryshime ligjore prekin në dukje të drejtën e parashikuar nga neni 49, pika 1, i Kushtetutës, sipas të cilës secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës me punë që e ka zgjedhur ose pranuar vetë, si dhe të zgjedhë vetë vendin e punës (*e drejta për punë*). Për rrjedhojë, në vijim ajo do të ndalet në vlerësimin nëse kjo e drejtë kushtetuese e studentëve është kufizuar dhe nëse arrin në një përgjigje pozitive në këtë drejtim, do të vlerësojë nëse ky kufizim plotëson kriteret e nenit 17 të Kushtetutës.

C.2. Për cenimin e së drejtës për punë

51. Sipas kërkuarësve, kjo e drejtë është kufizuar në kundërshtim me kriteret e nenit 17 të Kushtetutës, pasi nuk i përgjigjet as interesit publik, as objektivave të vetë ligjit nr. 60/2023, masat e përdorura janë më të ashpra se sa duhet për të arritur objektivin e kërkuar dhe kufizimi nuk është në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka diktuar, duke cenuar parimin e proporcionalitetit. Sipas tyre, parashikimi i nenit 5 të ligjit nuk i përgjigjet objektivit kryesor të tij, që ka të bëjë me sigurimin e stafit mjekësor në periudhë afatgjatë dhe sanksioni ekonomik i vendosur nga kjo dispozitë i detyron studentët në gjendje të vështirë ekonomike të pranojnë të lidhin marrëveshjen ose ndëshkon studentët që nuk pranojnë ta



nënshkruajnë atë, duke rritur në mënyrë eksponenciale tarifën e studimit. Në vlerësimin e kërkuesve nuk ekziston një situatë emergjente, pasi nuk ka ulje të numrit të mjekëve në raport me popullsinë dhe mjetet e përdorura nuk janë të domosdoshme, që do të thotë se synimi mund të arrihej me mjete të tjera dhe stimuj të tjerë ekonomikë ose socialë, si dhe ndërhyrja nuk është e përshtatshme për realizimin e qëllimit të synuar. Sipas kërkuesve, masat nuk janë të lidhura në mënyrë të arsyeshme me objektivin, janë arbitrare, të padrejta dhe të bazuara në vlerësime alogjike, ndërkohë që edhe masa e mbajtjes së diplomës për të mundësuar zbatimin e ligjit është e pajustificueshme, pasi shteti i ka të gjitha mjetet ligjore për të garantuar zbatimin e marrëveshjes së nënshkruar me studentët.

52. Subjekti i interesuar, Kuvendi, ka prapësuar se plotësohen kriteret e nenit 17 të Kushtetutës, sepse e drejta për kujdes shëndetësor synon mbrojtjen e së drejtës së jetës, për rrjedhojë shteti ka interes publik që të ndërhyjë në këtë aspekt, pasi ekziston një nevojë mjaft e lartë për të garantuar plotësimin e shërbimeve të shëndetit publik me burime njerëzore. Sipas tij, interesi publik në garantimin e shërbimit mjekësor për popullsinë mbizotëron ndaj pritshmërisë së studentëve. Alternativat që paraqet ligji kanë të bëjnë me të drejtën e studentit për të zgjedhur nëse dëshiron të përfitojë lehtësitë që krijohen me nënshkrimin e marrëveshjes për të punuar në profesionin e mjekut, pas përfundimit të studimeve, në institucionet shëndetësore në vend dhe janë hartuar në përputhje me nevojat e diktuar në vend. Sipas këtij subjekti, ligji garanton punësimin e mjekëve të diplomuar dhe nuk ka cenim në thelbin e së drejtës për punë, për rrjedhojë nuk ka tejkalim të kufizimeve të parashikuara në KEDNJ.

53. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka prapësuar se janë respektuar kriteret e parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës dhe se interesi publik në garantimin e shërbimit mjekësor për popullsinë mbizotëron ndaj pritshmërisë së kërkuesve, e cila nuk mund të ketë prioritet. Sipas tij, ligji ndihmon në mbajtjen e talentit vendas në sistemin shëndetësor shqiptar, duke parandaluar largimin e tij jashtë shtetit dhe përmes dispozitave të kundërshtuara synohet punësim sa më i shpejtë i studentëve të mjekësisë, duke detyruar institucionet punëdhënëse për respektimin e këtij parashikimi

ligjor, i cili, në rast të mosrespektimit brenda një viti nga momenti i lindjes së të drejtës për punësim për studentët, konsiderohet i përmbushur. Sipas këtij subjekti, ligji ka efekt të përkohshëm dhe pavarësisht politikave të zbatuara ka nevojë imediate për të adresuar në mënyrë shteruese fenomenin e largimit të mjekëve nga sistemi dhe nga vendi. Sipas tij, dispozitat ligjore u japin studentëve të drejtën të zgjedhin kushtet për trajtimin e veçantë dhe detyrimin e punësimit pas përfundimit të studimeve në një mënyrë që respekton lirinë dhe vullnetin e individit.

54. Në kuptim të nenit 49, pika 1, të Kushtetutës, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se kjo e drejtë përfshin zgjedhjen e profesionit, vendit të punës, si dhe sistemit të kualifikimit profesional, me qëllim sigurimin e mjeteve të jetesës në mënyrë të ligjshme. Zgjedhja e profesionit, siç parashikohet nga dispozita kushtetuese, është një e drejtë e individit, në kuptimin që ai i përkushtohet një veprimtarie për të siguruar mjetet e jetesës. Kjo e drejtë për të përfutur me punë të ligjshme fiton rëndësi edhe nga pikëpamja sociale, pasi puna si profesion është një vlerë edhe për kontributin që i sjell shoqërisë në tërësi (*shih vendimet nr. 17, datë 23.3.2023; nr. 9, datë 23.3.2010; nr. 20, datë 11.7.2006, të Gjykatës Kushtetuese*).

55. Gjykata vlerëson të theksojë se edhe e drejta për të fituar mjetet e jetesës me punë të zgjedhur dhe pranuar vetë dhe për të zgjedhur vendin e punës, e garantuar nga neni 49, pika 1, i Kushtetutës nuk është absolute dhe ajo mund të jetë objekt i kufizimeve në përputhje me kriteret e nenit 17 të Kushtetutës, i cili lejon kufizimin e të drejtave dhe lirive themelore vetëm me ligj, për interes publik ose mbrojtjen e të drejtave të tjerëve. Po në kuptim të kësaj dispozite, kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë, të mos cenojë thelbin e lirive dhe të drejtave, si dhe të mos tejkalojë kufizimet e parashikuara nga KEDNJ-ja.

56. Gjykata vëren, siç theksoi më sipër gjatë trajtimit të parimit të sigurisë juridike, se me miratimin e ligjit nr. 60/2023, ligjvënësi ka pasur si qëllim të sigurojë burimet njerëzore për kryerjen e shërbimeve të shëndetit publik në institucionet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet përcaktimit të rregullave për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të



studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë (*neni 2*). Koncepti “trajtim i veçantë”, sipas këtij ligji, përfshin punësimin me prioritet të studentit që ndjek programin e integruar në Fakultetin e Mjekësisë në UMT, si dhe përfitimin nga programet sociale të strehimit dhe ai zbatohet si për studentet që janë në vazhdim të studimeve të tyre në Fakultetin e Mjekësisë, ashtu edhe për ata që regjistrohen në vitin e parë të programit të studimeve, me kushtin e nënshkrimit të marrëveshjes me ministrinë përgjegjëse për arsimin, ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë dhe institucionin e arsimit të lartë publik (*neni 4, pika 1, shëronja “c”, pika 2, shëronja “b” dhe pika 3, shëronja “b”, të ligjit nr. 60/2023*) përmes së cilës studenti pranon të punojë në profesionin e mjekut pas përfundimit të studimeve për jo më pak se pesë, tre dhe dy vjet, periudhë gjatë së cilës diploma qëndron pranë institucionit shëndetësor ku punësohet deri në “shlyerjen e detyrimeve për punësim” sipas këtyre afateve. Në rast të mosnënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, *neni 5* i ligjit parashikon se studenti paguan vlerën e plotë të kostos së studimeve përkatëse, e cila miratohet me akte nënligjore.

57. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se parashikimet ligjore të kundërshtuara kanë prekur të drejtat e studentëve të Fakultetit të Mjekësisë në UMT, si të atyre të ndërmjetëm, që kanë filluar dhe vijuar studimet në përputhje me një kornizë tjetër ligjore, ashtu edhe të studentëve që kanë hyrë rishtazi në Fakultetin e Mjekësisë, të cilët nuk i kanë njohur dhe pranuar rregullimet e reja ligjore në momentin që kanë vendosur të zgjedhin këtë profesion, pra të konkurrojnë pranë atij fakulteti. Parashikimi i instrumenteve të reja ligjore që lejon ekzekutimin e skemës së hyrjes në punësim sjell ndërhyrje në të drejtën kushtetuese për të pranuar dhe zgjedhur vetë vendin e punës, në kuptim të *nenit 49* të Kushtetutës, për sa kohë i vendos studentët para zgjedhjes së nënshkrimit të marrëveshjes ose, në të kundërt, pagesës së vlerës së plotë të kostos së studimeve. Në vlerësimin e Gjykatës, në themel të së drejtës kushtetuese për punë qëndron vullneti i individit për të siguruar mjetet e jetesës me punë të zgjedhur ose të pranuar prej tij, vullnet që në këtë rast rezulton të jetë i vesuar për shkak të formulës të përzgjedhur nga ligjvënësi për të vënë në zbatim skemën e re të

punësimit të studentëve të mjekësisë pas përfundimit të studimeve. Kjo ndërhyrje e ligjvënësit përbën kufizim të ushtrimit lirisht të së drejtës së studentëve që pas përfundimit të studimeve të zgjedhin, në përputhje me kualifikimin e tyre profesional, vendin e punës ku dëshirojnë të ushtrojnë profesionin në mënyrën dhe formën që ata vendosin vetë. Për rrjedhojë, detyrimi i studentëve që në rast të lidhjes së marrëveshjes me kohëzgjatje dy, tre dhe pesëvjeçare të punojnë, përgjatë kësaj periudhe, pranë institucionit shëndetësor ku kalohet diploma nga institucioni i arsimit të lartë publik deri në “shlyerjen e detyrimeve për punësim”, përbën kufizim të *nenit 49, pika 1, të Kushtetutës*.

58. Thënë sa më sipër, Gjykata do të vlerësojë në vijim nëse ky kufizim ka respektuar kriteret e *nenit 17* të Kushtetutës, pra nëse është bërë me ligj, për interes publik dhe nëse është respektuar kriteri i përpjesëtimimit midis ndërhyrjes dhe gjendjes që e ka diktuar atë.

59. Në lidhje me *kriterin e parë të kufizimit “vetëm me ligj”*, qëllimi i tij është ofrimi i garancive sa më të plota në rastin e kufizimeve dhe për këtë shkak kompetent duhet të jetë vetëm një organ dhe pikërisht organi më i lartë ligjvënës (*shih vendimet nr. 21, datë 18.4.2023; nr. 4, datë 21.2.2022; nr. 11, datë 9.3.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata vëren se ky kriter është respektuar, pasi ndërhyrja është bërë me ligjin nr. 60/2023, i cili është miratuar nga Kuvendi, sipas procedurave të parashikuara për këtë qëllim.

60. Për sa i përket *kriterit të dytë të kufizimit, për interes publik*, Gjykata ka theksuar se është e vështirë të radhiten në mënyrë shteruese çështjet që përbëjnë interes publik ose të arsyes publike që çojnë në kufizimin e një të drejte themelore, pasi interesi publik duhet kuptuar në sensin relativ, në varësi të situatave të ndryshme që krijohen. Ato mund të renditen vetëm negativisht, pra në aspektin e kufizimit të çdo rasti konkret. Në praktikën kushtetuese është pranuar tashmë se ligjvënësi, parimisht, është i lirë të veprojë brenda hapësirës së tij normuese, duke përcaktuar qartë dhe rast pas rasti qëllimet që kërkon të arrijë (*shih vendimet nr. 20, datë 20.4.2021; nr. 16, datë 1.3.2017; nr. 1, datë 16.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

61. Gjykata vlerëson se, referuar subjekteve të interesuara, Kuvendit dhe Këshillit të Ministrave, interesi publik i evidentuar në çështjen konkrete



është i lidhur drejtpërdrejt me mirëfunksionimin e skemës së kujdesit shëndetësor dhe garantimin e plotësimit të nevojave për burime njerëzore në kryerjen e shërbimeve të shëndetit publik në institucionet shëndetësore, i cili rezulton të jetë i lartë, prandaj ligji është hartuar në përputhje me nevojat e diktura në vend. Gjykata vëren se sipas nenit 55 të Kushtetutës shtetasit gëzojnë në mënyrë të barabartë të drejtën për kujdes shëndetësor dhe sigurim shëndetësor nga shteti, i cili ka detyrimin për të ndërhyrë me qëllim sigurimin e saj për të gjithë qytetarët përmes ofrimit të kujdesit shëndetësor në institucionet e shëndetit publik. Kurse sipas nenit 59, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës, shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, synon edhe standardin më të lartë shëndetësor të mundshëm. Referuar nenit 2, të ligjit nr. 60/2023, ai synon sigurimin e burimeve njerëzore për kryerjen e shërbimeve të shëndetit publik në institucionet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet përcaktimit të rregullave për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se në rastin konkret ka një interes publik që ka justifikuar ndërhyrjen në të drejtën e studentëve për punësim, për sa kohë që me rregullimet ligjore të kundërshtuara synohet të garantohet ofrimi i shërbimit shëndetësor, në kuptim të nenit 55, pika 1, të Kushtetutës, si dhe garantimi i standardeve të shëndetit publik, sipas nenit 59, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës.

62. Në kushtet kur janë përmbushur dy kriteret e mësipërme të kufizimit, Gjykata vlerëson të analizojë kriterin tjetër, atë të *proporcionalitetit të ndërhyrjes*, në thelb të të cilit qëndron ekuilibrimi i drejtë i interesave, vlerësimi objektiv, si dhe shmangia e konfliktit nëpërmjet përzgjedhjes së mjeteve të duhura për realizimin e tyre (*shih vendimet nr. 30, datë 5.7.2021; nr. 20, datë 20.4.2021; nr. 16, datë 1.3.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Për vlerësimin e proporcionalitetit të ndërhyrjes merret në shqyrtim balanca ndërmjet dëmit të shkaktuar individit dhe së mirës së përgjithshme të shoqërisë, masa e mbrojtjes nga arbitrariteti që ofrojnë procedurat ligjore, si dhe mundësia e shtetit për të përdorur mënyra a mjete të tjera për të arritur qëllimin. Shteti, brenda mundësive, duhet të kufizojë ndërhyrjen në minimum, duke kërkuar

zgjidhje alternative dhe, përgjithësisht, duke u përpjekur t'i arrijë qëllimet në mënyrë sa më pak të dëmshme nga pikëpamja e të drejtave të njeriut (*shih vendimin nr. 17, datë 23.4.2010, të Gjykatës Kushtetuese*). Masat mund të jenë të shumëllojshme, por ajo që ka rëndësi në këtë rast është që thelbi i këtij aktiviteti të individit të mos cenohet deri në atë masë sa të bëhet i pamundur ushtrimi i tij (*shih vendimet nr. 37, datë 1.12.2022; nr. 52, datë 5.12.2012; nr. 18, datë 14.5.2003, të Gjykatës Kushtetuese*).

63. Parimi i proporcionalitetit imponon evidentimin e nevojës reale të ndërhyrjes në të drejtat individuale në një situatë konkrete (*shih vendimet nr. 20, datë 20.4.2021; nr. 1, datë 16.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Përveç kësaj, përdorimi i këtyre mjeteve duhet të jetë i domosdoshëm, çka do të thotë se synimi nuk mund të arrihet me mjete të tjera. Domosdoshmëria lidhet edhe me përdorimin e mjeteve më pak të dëmshme për subjektet që u cenohen të drejtat dhe liritë. Në drejtim të nënkriterit të domosdoshmërisë, në vlerësimin e Gjykatës kufizimi është jokushtetues nëse provohet se ka mjete të tjera të disponueshme që do të ishin në mënyrë të qartë efektive për arritjen e qëllimit, por, në të njëjtën kohë, edhe më pak kufizuese të të drejtave dhe lirive themelore. Po kështu, ndërhyrja për kufizimin e një të drejte ose lirie të bëhet me mjete të përshtatshme që i përgjigjen drejt qëllimit që synohet të arrihet. Për sa i përket nënkriterit të përshtatshmërisë, masa e ndërmarrë si kufizuese e së drejtës duhet të sjellë efektin e duhur dhe të realizojë synimin për të cilin është përzgjedhur (*shih vendimet nr. 70, datë 27.12.2023; nr. 30, datë 5.7.2021; nr. 16, datë 1.3.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

64. Gjykata thekson se ajo nuk ka kompetencë të analizojë nëse masa e ndërhyrjes është më e drejta dhe më e duhura për arritjen e qëllimit të synuar, por detyrë e saj është të vlerësojë nëse ligjvënësi ka respektuar kufijtë kushtetues të hapësirës së tij vlerësuese. Sipas standardeve të saj jurisprudenciale, Gjykata mban në konsideratë prezumimin e pajtueshmërisë së aktit normativ me Kushtetutën, derisa palët t'i provojnë asaj të kundërtën (*shih vendimet nr. 30, datë 2.11.2022; nr. 5, datë 27.1.2017; nr. 52, datë 26.7.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

65. Në kuptim të nënkriterit të nevojës, që kërkon lidhjen e arsyeshme mes kufizimit dhe gjendjes që kërkon ndërhyrje, Gjykata vëren se, siç ka theksuar më sipër në drejtim të interesit publik



të ndërhyrjes, qëllimi i miratimit të ligjit nr. 60/2023, është garantimi nga shteti, për shtetasit e tij, i gëzimit në mënyrë të barabartë të të drejtave që burojnë nga neni 55 i Kushtetutës. Situata faktike e evidentuar në kohën e miratimit të këtij ligji, e provuar edhe gjatë këtij gjykimi dhe që lidhet me problematikat në drejtim të raportit të numrit të mjekëve dhe popullsisë, është rrethanë që bën të qartë ekzistencën e nevojës për të vepruar nga ana e ligjvënësit në miratimin e ligjit nr. 60/2023, e cila është e tillë që justifikon kufizimin e së drejtës për punë të garantuar nga neni 49, pika 1, i Kushtetutës.

66. Në drejtim të nënkriterit të domosdoshmërisë, Gjykata vëren se punësimi me prioritet i mjekëve të sapodiplomuar sipas nenit 4, të ligjit nr. 60/2023, kushtëzohet: *së pari*, me punësimin në institucionet shëndetësore brenda vendit dhe, *së dyti*, me punësimin me afat për një periudhë dy, tre ose pesëvjeçare, që përcaktohet nga viti akademik në cilin është duke kryer studimet studenti që pranon të lidhë marrëveshjen me institucionin shëndetësor. Sipas fjalisë së parë të nenit 6 të këtij ligji, studenti që përfundon programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë dhe ka nënshkruar marrëveshje sipas përcaktimeve të këtij ligji punësohet me prioritet në institucionet shëndetësore nga momenti i lindjes së të drejtës për punësim.

67. Gjatë gjykimit rezultoi se numri i përgjithshëm i mjekëve që ofrojnë shërbim në sistemin shëndetësor është 5400, që në raport me numrin e popullsisë i takon 1.93 mjekë për çdo 1000 banorë. Numri i pozicioneve vakante për mjekë është 482, numri i mjekëve në moshë pensioni është 213 dhe numri i mjekëve që largohen çdo vit jashtë vendit është rreth 200. Bazuar në të dhënat e mësipërme, sikurse është deklaruar në seancë edhe nga subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, rezultojnë se janë 1000 vende vakante për mjekë dhe aktualisht vendet vakante për mjekë të përgjithshëm në sistemin shëndetësor janë 4% e numrit total të personelit mjekësor në kujdes parësor. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se parashikimi ligjor që rregullon skemën e punësimit të studentëve të rinj që diplomohen, me qëllim që ata të punësohen dhe të shërbejnë në shërbimin shëndetësor publik për të siguruar nevojat e popullsisë në të gjithë vendin, në mënyrë

që qytetarët të gëzojnë në mënyrë të barabartë të drejtën për kujdes shëndetësor, është një masë që konsiderohet e domosdoshme për arritjen e synimit të ligjvënësit. Skema e re e hyrjes në punësim e studentëve të mjekësisë pas përfundimit të studimeve rezulton të ketë qenë mënyra për të zgjidhur situatën me të cilën po përballej sistemi shëndetësor në vend dhe për të garantuar zbatimin e nenit 55 të Kushtetutës. Gjykata ka theksuar se lidhur me jokushtetutshmërinë e pretenduar argumentet e parashtruara duhet të jenë bindëse, për t'i dhënë mundësi asaj të vlerësojë nëse zgjidhjet e aplikuara shkelin normat dhe vlerat kushtetuese (*shih vendimet nr. 30, datë 2.11.2022; nr. 5, datë 27.1.2017; nr. 52, datë 26.7.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim edhe nga vetë kërkesit, në lidhje me mundësitë reale për të miratuar ndonjë skemë tjetër të punësimit, nuk u evidentua ndonjë masë ose skemë tjetër që mund të përdorej në këtë drejtim, e cila mund të sillte të njëjtin efekt të dëshiruar dhe që do të ishte efiçiente për përmbushjen e qëllimit të synuar dhe, nga ana tjetër, më pak ose aspak kufizuese e të drejtave të studentëve. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se masa e kundërshtuar plotëson edhe kërkesën e të genit e domosdoshme.

68. Për sa i përket nënkriterit të përshtatshmërisë së masës, Gjykata vlerëson të analizojë nëse kohëzgjatja e masës së punësimit të detyruar plotëson këtë kriter, pra nëse ajo pritë të sjellë efektin e duhur dhe të realizojë synimin për të cilin është përzgjedhur. Sipas dispozitave ligjore të kundërshtuara, konkretisht nenit 4, të ligjit nr. 60/2023, detyrimi shtrihet që nga studentët e vitit të parë të Fakultetit të Mjekësisë për një afat pesëvjeçar, i cili është i pritshëm të zbatohet jo më shpejt se viti 2029, kur ata përfundojnë ciklin e studimeve sipas programit mësimor dhe të përfundojë jo më vonë se viti 2034, kur ata shlyejnë detyrimin sipas marrëveshjes së nënshkruar me institucionin e shërbimit publik. Për studentët e vitit të pestë ose të gjashtë që pranojnë të nënshkruajnë marrëveshjen e punësimit prioritar, zbatimi i kësaj skeme është e pritshme të fillojë jo më shpejt se viti 2024, kurse për studentët e tjerë të ndërmjetëm, të vitit të dytë deri në vitin e katërt, ajo pritë të zbatohet jo më shpejt se viti 2026. Gjykata vëren se pavarësisht se ligji ka efekt të përkohshëm, pasi sipas dispozitës kalimtare (*neni 9*) ai i shtrin efektet në periudhën nga viti akademik 2023–2024



deri në vitin akademik 2027–2028, duke marrë parasysh këtë formulë të zbatimit të kësaj skeme, rezulton se masa e parashikuar nga ligjvënasi aktualisht prek pesë breza studentësh në mënyrë të plotë ose të pjesshme, bazuar kjo në vitin e studimeve në të cilin ndodhen aktualisht dhe për një periudhë kohore të gjatë, e cila, në vlerësimin e Gjykatës, nuk është e përshtatshme në lidhje me urgjencën e ndërhyrjes legjislative në drejtim të efekteve të pritshme të saj. Për më tepër, kohëzgjatja e masës së punësimit sipas kësaj skeme për periudhën pesëvjeçare është gati e barabartë me kohëzgjatjen e plotë të ciklit të studimeve për programin e integruar gjashtëvjeçar.

69. Gjykata vlerëson se subjektet e interesuara, edhe pse kishin barrën e provës në këtë drejtim, nuk arritën të provojnë se kjo masë është e përshtatshme, duke e lidhur atë me efektet e pritshme aktuale që kanë sjellë nevojën e ndërhyrjes dhe me pasojat e saj në kohë, në drejtim të efekteve të pritshme për të ardhmen, pra se afati i kohëzgjatjes së kësaj mase, e përcaktuar në varësi të viteve të studimit në të cilat ndodhen studentët e ndërmjetëm ose ata që kanë fituar të drejtën për të filluar studimet para hyrjes në fuqi të ndryshimeve ligjore të kundërshtuara, është mjeti më i përshtatshëm për të siguruar nevojat e popullatës për kujdes shëndetësor. Gjykata më sipër ka konstatuar raportin e numrit të mjekëve në raport me popullatën, raport ky që u vlerësua se krijon vështirësi në sigurimin e skemës së kujdesit shëndetësor dhe garantimin e të drejtave të shtetasve për të përfutur këtë kujdes nga shteti në mënyrë të barabartë. Gjatë këtij gjykimi rezultoi, gjithashtu, se ka pasur rritje graduale të numrit të kuotave të çelura për çdo vit për programin e studimit “Mjekësi e përgjithshme” në UMT, duke arritur rreth 500 të tilla brenda vitit 2024. Edhe sipas vendimit nr. 17, datë 10.3.2023, të senatit akademik të UMT-së, numri i kuotave të pranimit për vitin akademik 2023–2024 në fakultetin “Mjekësi e përgjithshme”, programi “Master i Shkencave”, është 464. Referuar fakteve të rezultuara gjatë këtij gjykimi, prurjet nga UMT-ja për mjekë të diplomuar vit pas viti, në periudhën që shtrihen efektet e këtij ligji, janë më të mëdha se nevojat aktuale për të punësuar mjekë të përgjithshëm në vendet vakante, të cilat mund të plotësohen nga studentët e diplomuar përafërsisht brenda dy-tre vjetëve. Pavarësisht këtyre masave që

janë duke u marrë dhe që synojnë të sigurojnë qëllimin e ligjvënësit të evidentuar më sipër, subjektet e interesuara nuk kanë arritur të justifikojnë se në çfarë mënyre lidhja e marrëveshjeve dhe mbajtja e diplomës deri në “shlyerjen e detyrimeve për punësim”, sipas afateve ligjore, për studentët që përfundojnë studimet në Fakultetin e Mjekësisë do të sjellë efektin e dëshiruar, ndërkohë kur numri i vendeve vakante në sistemin shëndetësor është 1000, ndërsa numri i kuotave për studentë në Fakultetin e Mjekësisë është rreth 500 në vit.

70. Po kështu, Gjykata vëren se praktika e punësimit të mjekëve brenda vendit për nevoja të tij është zbatuar për periudha të përkohshme, në mënyra të ngjashme, edhe në vende të tjera, si Suedia, Spanja, Danimarka, Kazakistani ose Afrika e Jugut, por në ndryshim nga parashikimet e nenit 4 të ligjit nr. 60/2023, afati nuk rezulton të ketë tejkaluar gjysmën e kohëzgjatjes së studimeve. Në ndryshim nga këto raste të ngjashme, raporti në rastin e Shqipërisë rezulton të jetë, duke iu referuar afatit pesëvjeçar të punësimit në raport me gjashtë vjetët e studimit, në masën 83%.

71. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se dispozitat e kundërshtuara, konkretisht parashikimet e nenit 4 të ligjit nr. 60/2023, në pjesën që parashikojnë afatet për punësim pas përfundimit të studimeve, sjellin kufizim të së drejtës kushtetuese të studentëve për të zgjedhur vendin e punës, të garantuar nga neni 49, pika 1, i Kushtetutës. Në kuptim të testit të proporcionalitetit, skema e zgjedhur është më e ashpër sesa ishte e nevojshme për arritjen e qëllimit të synuar në raport me rrethanat që e kanë diktuar atë. Detyrimi i studentëve për të zgjedhur mes nënshkrimit ose jo të marrëveshjes, me pasojën që në rast të nënshkrimit diploma kalohet zyrtarisht në institucionin shëndetësor ku punësohen deri në “shlyerjen e detyrimeve për punësim” ka çuar në mohim tërësor të së drejtës për të zgjedhur vendin e punës, sipas kushteve dhe kriterëve me të cilat studentët janë njohur dhe i kanë pranuar në momentin që kanë nisur studimet apo kanë konkurruar për këtë qëllim.

72. Duke u nisur nga premisa që afatet e përcaktuara nga neni 4, i ligjit nr. 60/2023, nuk janë proporcionale, si dhe duke pasur parasysh se afati pesëvjeçar i parashikuar në pikën 1, shkronjat “b” dhe “c” të këtij neni është gati i njëjtë me vetë



kohëzgjatjen e studimeve, ashtu edhe duke marrë në konsideratë eksperiencat e ngjashme të vendeve të tjera, Gjykata vlerëson të rishikohet ky afat deri në një kufi jo më të gjatë sesa tre vjet. Po kështu, ligjvënësi duhet të rishikojë me qëllim që të garantojë parimin e proporcionalitetit të ndërhyrjes edhe afatet e tjera tre dhe dyvjeçare të përcaktuara respektivisht në pikën 2, shkronjat “a” dhe “b” dhe pikën 3, shkronjat “a” dhe “b”, të nenit 4, të ligjit nr. 60/2023.

73. Sipas nenit 48 të ligjit nr. 8577/2000, kur ka lidhje midis objektit të kërkesës dhe akteve të tjera normative vendos për çdo rast Gjykata. Në kuptim të kësaj dispozite, Gjykata vlerëson se, në kuadër të testit të proporcionalitetit, cenimi i të drejtave kushtetuese të garantuara nga nenet 49, pika 1, dhe 57 të Kushtetutës vjen edhe për shkak të mungesës së parashikimeve ligjore në nenin 6 të ligjit nr. 60/2023, në drejtim të: i. kriterëve objektive të punësimit me prioritet; ii. trajtimit financiar në kuadër të sigurimit të mjeteve të nevojshme të jetesës, sipas nenit 49, pika 1, të Kushtetutës; iii. përllogaritjes së pagesës së periudhës në pritje në kohëzgjatjen e detyrimit për punësim, nëse shteti nuk iu siguron vend pune studentëve, sepse ata gjatë vitit të parë të pritjes nuk kanë mundësi punësimi tjetër, meqenëse nuk e disponojnë ende diplomën dhe, për rrjedhojë, dëmtohen nga masa e parashikuar.

74. Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë që paraqet për funksionimin e shtetit të së drejtës shmangia e boshllëkut ligjor, por edhe funksionin e saj si ligjvënës negativ për garantimin e kushtetutshmërisë, e cila në respektim të parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve nuk mund të ndërhyjë në kompetencat e ligjbërësit për të normuar rregullimin e drejtë të dispozitave ligjore (*shih vendimet nr. 4, datë 15.2.2021; nr. 31, datë 19.11.2003, të Gjykatës Kushtetuese*). Në kuptim të nenit 76, pika 5, të ligjit nr. 8577/2000, duke qenë se mungesa e parashikimeve të mësipërme përbën boshllëk ligjor, si pasojë e të cilit kanë ardhur pasoja negative në të drejtat themelore të studentëve të Fakultetit të Mjekësisë, Gjykata vlerëson se ato duhet të plotësohen nga ligjvënësi në përputhje me arsyetimin e këtij vendimi, duke përcaktuar ai vetë çështjet dhe parimet që duhet të zbatohen në këtë rast, brenda një afati që konsiderohet të caktohet tre muaj nga hyrja në fuqi e vendimit.

75. Për rrjedhojë, deri në miratimin e

rregullimeve të reja ligjore nga ligjvënësi nënshkrimi i marrëveshjes së parashikuar në nenin 4, pika 1, shkronja “c”, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3 shkronja “b”, të ligjit nr. 60/2023, nuk mund të realizohet deri në momentin e hyrjes në fuqi të afateve të reja ligjore, të cilat duhet të respektojnë kriteret e nenit 17 të Kushtetutës.

76. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuarve për cenimin e së drejtës për arsimim, të garantuar nga neni 57 i Kushtetutës të lidhur me parimin e sigurisë juridike, si dhe për cenimin e së drejtës për të zgjedhur vetë vendin e punës, të garantuar nga neni 49, pika 1, i Kushtetutës, janë pjesërisht të bazuara, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa pranohet pjesërisht.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “a” dhe 134, pikat 1, shkronjat “c” dhe “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 dhe 76, pika 5, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.

2. Shfuqizimin e fjalëve “5 (pesë) vjet” në nenin 4, pika 1, shkronja “b”, “5-vjeçar” në nenin 4, pika 1, shkronja “c”, “3 (tre) vjet” në nenin 4, pika 2, shkronja “a”, “3-vjeçar” në nenin 4, pika 2, shkronja “b”, “2 (dy) vjet” në nenin 4, pika 3, shkronja “a”, “2-vjeçar” në nenin 4, pika 3, shkronja “b”, të ligjit nr. 60/2023, “Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë”.

3. Konstatimin e ometimit ligjor në nenin 6, të ligjit nr. 60/2023, “Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë”, lidhur me mungesën e kriterëve objektive të punësimit me prioritet, trajtimin financiar në kuadër të sigurimit të mjeteve të nevojshme të jetesës, si dhe



përlogaritjen e pagesës së periudhës në pritje në kohëzgjatjen e detyrimit për punësim.

4. Detyrimin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë që të miratojë ndryshimet e nevojshme ligjore brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

5. Heqjen e masës së pezullimit të zbatimit të ligjit nr. 60/2023, “Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë ‘Mjekësi e përgjithshme’ në institucionet publike të arsimit të lartë”.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 25.1.2024.

Shpallur më 26.2.2024.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Sandër Beci, Marjana Semini, Genti Ibrahim, Ilir Toska

Anëtarë pjesërisht kundër: Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja, Elsa Toska

MENDIM PJESËRISHT KUNDËR

1. Në gjykimin kushtetues të vënë në lëvizje nga kërkuesit, 30 deputetë të Kuvendit (jo më pak se 1/5-ta e deputetëve) dhe 37 studentë të Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Mjekësisë së Tiranës (UMT), me objekt shfuqizimin e disa dispozitave të ligjit nr. 60/2023, “Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë ‘Mjekësi e Përgjithshme’ në institucionet publike të arsimit të lartë”, jam pjesërisht kundër qëndrimit të shumicës, pasi vlerësoj se kërkesa duhej të ishte pranuar tërësisht. Në mbështetje të nenit 132, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 8, të ligjit nr. 8577/2000, që parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin përfundimtar të Gjykatës, parashtroj në vijim argumentet që mbështesin qëndrimin tim.

2. Ligji nr. 60/2023, ka për qëllim sigurimin e burimeve njerëzore, profesionistëve në institucionet e shërbimit shëndetësor në vend nëpërmjet përcaktimit të rregullave për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë (neni 2), por edhe rritjen e interesit të tyre për

të punuar në sektorin shëndetësor publik si pjesë e rritjes së investimeve në shëndetësi. Në funksion të këtij qëllimi, ai u ofron këtyre studentëve trajtim të veçantë, në aspektet e punësimit me prioritet pas përfundimit të studimeve dhe të përfitimit nga programet sociale të strehimit (neni 3, pika 1).

3. Kërkuesit kanë kundërshtuar nenin 4, pikat 1, shkronja “c”, 2, shkronja “b”, 3, shkronja “b”, si dhe nenin 5, fjalë e parë, të ligjit nr. 60/2023. Neni 4 parashikon se trajtim të veçantë përfitojnë: i. kandidati që pranohet në programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë (pika 1, shkronja “c”); ii. studenti i vitit të dytë deri në vitin e katërt akademik (pika 2, shkronja “b”); iii. studenti i vitit të pestë ose të gjashtë në këtë program (pika 3, shkronja “b”), kur pranojnë kalimin zyrtarisht të diplomës përkatëse të arsimit të lartë nga institucioni publik i arsimit të lartë, ku ka përfunduar studimet, në institucionin shëndetësor ku punësohet, deri në shlyerjen e detyrimeve për punësim, sipas afateve, përkatësisht 5-vjeçar, 3-vjeçar dhe 2-vjeçar, me të drejtën që pas përmbushjes së detyrimit të punësimit kandidati të tërheqë diplomën universitare. Ndërsa neni 5 parashikon se studenti që nuk pranon të nënshkruajë marrëveshjen për të punuar në një institucion shëndetësor në vend, publik ose privat, nga data e lindjes të së drejtës për punësim me ministrinë përgjegjëse për arsimin, ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë dhe institucionin e arsimit të lartë publik, sipas përcaktimeve të pikave 2 dhe 3 të nenit 4 të këtij ligji, paguan vlerën e plotë të kostos së studimeve (fjalë e parë).

4. Në përfundim të gjyimit, shumica ka vendosur të shfuqizojë vetëm afatet prej pesë, tre dhe dy vjet të detyrimit për punësim, të parashikuara respektivisht në nenin 4, pikat 1, shkronjat “b” dhe “c”, 2, shkronjat “a” dhe “b”, si dhe 3, shkronjat “a” dhe “b”, të ligjit nr. 60/2023, me arsyetimin se ato kufizojnë të drejtën e studentëve për të zgjedhur dhe pranuar vendin e punës, të garantuar nga neni 49, pika 1, i Kushtetutës. Sipas shumicës, ndonëse ndërhyrja është vendosur me ligj dhe ka interes publik, ajo nuk është proporcionale, pasi skema e zgjedhur është më e ashpër sesa ishte e nevojshme për arritjen e qëllimit të synuar në raport me rrethanat që e kanë diktuar atë (shih paragrafët 57, 59, 61 dhe 71 të vendimit).



5. Nuk pajtohem me këtë qëndrim të shumicës, pasi ajo, në thelb, pranon se skema ligjore e zgjedhur e punësimit me prioritet është në përputhje me Kushtetutën, por i duhet modifikuar vetëm kohëzgjatja e detyrimit për punësim, duke e shkurtuar atë (*shih paragrafin 72 dhe 76 të vendimit*). Përkundër këtij qëndrimi, vlerësoj se, në tërësi, mekanizmi ligjor i punësimit me prioritet të studentit që ndjek programin e integruar të studimit të ciklit të dytë për mjekësi në institucionet publike, nuk respekton parimin e proporcionalitetit të ndërhyrjes që ai bën në të drejtat themelore për të zgjedhur ose pranuar vetë vendin e punës dhe për arsimim, të garantuara nga nenet 49, pika 1 dhe 57, të Kushtetutës.

6. Për sa i takon vlerësimit të parimit të proporcionalitetit në ndërhyrjet që kufizojnë të drejtat dhe liritë themelore, Gjykata ka zhvilluar disa kritere: i. nëse objektivi i ligjvënësimit është mjaftueshmërisht i rëndësishëm për të justifikuar kufizimin e së drejtës; ii. nëse masat e marra janë të lidhura në mënyrë të arsyeshme me objektivin, ato nuk mund të jenë arbitrare, të padrejta ose të bazuara mbi vlerësime alogjike; iii. nëse mjetet e përdorura nuk janë më të ashpra se sa duhet për të arritur objektivin e kërkuar - sa më të mëdha efektet e dëmshme të masës së përzgjedhur, aq më tepër duhet të jetë i rëndësishëm objektivi për t'u arritur, në mënyrë që masa të justifikohet si e nevojshme. Proporcionaliteti i një kufizimi vlerësohet rast pas rasti, duke pasur parasysh që kriteret e mësipërme të mos analizohen veç e veç, por të gërshetuara me njëra-tjetrën (*shih vendimet nr. 21, datë 18.4.2023; nr. 20, datë 20.4.2021; nr. 33, datë 8.6.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Gjatë gjykimit kushtetues të çështjes ka rezultuar se ligji nr. 60/2023 është miratuar për të garantuar ofrimin e kujdesit shëndetësor. Ky i fundit përbën jo vetëm një objektiv social të parashikuar nga neni 59, pika 1, shkronja "c", i Kushtetutës, por edhe një të drejtë themelore të garantuar nga neni 55 i saj. Subjektet e interesuara, Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave, kanë parashtruar se ligji u përgjigjet nevojave të diktura në vend lidhur me mungesat e burimeve njerëzore, sfidave për t'i mbajtur burimet ekzistuese në qendrat shëndetësore, si dhe për të motivuar profesionistët e shëndetit për të vazhduar punën në Shqipëri, me qëllim garantimin e shërbimit mjekësor për popullsinë. Këshilli i Ministrave, në seancën plenare

të datës 21.12.2023, ka deklaruar se për 4 vjetët e ardhshme është e pritshme të jenë rreth 1000 pozicione vakante në sektorin e shëndetësisë.

8. Në këto rrethana dhe bazuar në kriteret e zhvilluara nga jurisprudenca kushtetuese, çështja që shtrohet për zgjidhje përpara Gjykatës ishte analiza e kujdesshme e situatës për të identifikuar përmasën e nevojës për mjekë të rinj që duhet të ushtrojnë profesionin në Shqipëri, logjikën dhe ndershmërinë e mekanizmit ligjor "*marrëveshje përpara pranimit në programin e studimit për të ushtruar profesionin në Shqipëri dhe në rast mospranimit, me sanksion pagimin e kostos së plotë të studimeve në arsimin publik*", si dhe ashpërsinë e këtij mekanizmi.

9. Fillimisht duhet evidentuar se, siç shënohet në relacionin shoqërues, nisma për miratimin e ligjit është ndërmarrë nga Këshilli i Ministrave pa qenë pjesë e programit vjetor analitik të projektakteve për vitin 2023, të miratuar me vendimin e datës 27.12.2022. Programi vjetor i projektakteve është një prej instrumenteve të parashikuar nga legjislati në fuqi (*shih nenin 27, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave" dhe pikat 2, shkronja "ç", 7, 8, 9 dhe 10 të rregullores së miratuar me vendimin nr. 584, datë 28.8.2003, të ndryshuar*), bazuar në rolin kushtetues të Këshillit të Ministrave për të përcaktuar drejtimit e përgjithshme të politikës shtetërore (*neni 100 i Kushtetutës*). Nga ana tjetër, në relacionin shoqërues të projektligjit është shënuar se nisma është në përputhje me programin politik të Këshillit të Ministrave të miratuar me vendimin nr. 68/2021, datë 17.9.2021, të Kuvendit, si dhe me disa strategji kombëtare, sikurse ajo për zhvillim dhe integrim (2022–2030), e arsimit (2021–2026), si dhe e shëndetësisë (2021–2030). Megjithatë, në asnjë prej këtyre dokumenteve programore dhe strategjike nuk rezulton të jetë parashikuar një nismë e tillë ligjore, por ato përmbajnë vetëm angazhime të përgjithshme për përmirësimin e burimeve njerëzore me qëllim ofrimin e shërbimeve cilësore.

10. Në vijim, Këshilli i Ministrave, bazuar në nenin 83, pika 2, të Kushtetutës i ka propozuar Kuvendit që shqyrtimi dhe miratimi i projektligjit të bëhet me procedurë të përshpejtuar, për shkak të nevojës emergjente që ai paraqet për miratimin dhe hyrjen në fuqi, përpara fillimit të procedurave për aplikimin dhe regjistrimin e kandidatëve për studentë në fushën e mjekësisë për vitin akademik 2023–2024 (*shih fagen 11 të relacionit shoqërues të*



projektligjii). Mbi bazën e këtij propozimi Kuvendi ka miratuar ligjin nr. 60/2023, me procedurë të përsheptuar parlamentare në seancën plenare të datës 21.7.2023.

11. Për sa më lart, kjo nismë është përfshirë në kalendar pa planifikim, si dhe është hartuar dhe miratuar me urgjencë. Kjo do të thotë se ka munguar vlerësimi logjik dhe analiza e përshtatshme e nevojës faktike – përmasa e largimit të profesionistëve të fushës së mjekësisë jashtë vendit, përfshirë këtu edhe ndikimin që mund të ketë në këtë nevojë numri i mjekëve të diplomuar në institucionet e arsimit privat që operojnë në vend, si dhe mundësia e përdorimit të alternativave të tjera më pak kufizuese për t'i u përgjigjur nevojës faktike.

12. Ligji nr. 60/2023 i shtrin efektet në periudhën nga viti akademik 2023–2024 deri në vitin akademik 2027–2028 (*neni 9*), pra përmes tij preken 10 breza studentësh, të cilët detyrohen të ushtrojnë profesionin në Shqipëri pas përfundimit të studimeve. Bëhet fjalë për 5 breza të plotë studentësh me nga 6 vjet, për aq sa është kohëzgjatja e plotë e ciklit të studimeve për programin e integruar të studimit “Mjekësi e Përgjithshme”, ndërsa 5 breza studentësh preken pjesërisht sipas vitit në të cilin ndodhen aktualisht deri në përfundimin e programit (*shih paragrafin e dytë të pikës 5 të përgjigjes së dhënë me shkrim nga Këshilli i Ministrave me shkruesin e datës 5.1.2024*). Në kontekst të përmbajtjes dhe qëllimit të ligjit është e qartë që kategoria e individëve që preken përfshin studentët dhe mjekët e rinj që janë në profesion deri 5 vjet pas diplomimit.

13. Gjatë gjykimit kushtetues ka rezultuar se në sistemin shëndetësor ofrojnë shërbim 5400 mjekë, që nënkupton 1.93 mjekë për çdo 1000 banorë (*shih faqen 6, paragrafi i tretë, të relacionit shoqërues të projektligjii*). Aktualisht, sistemi shëndetësor ka 4 % pozicione vakante (482) mjekë, 213 mjekë janë në moshë pensioni, ndërsa çdo vit largohen jashtë vendit rreth 200 mjekë (*shih pikën 1 të përgjigjes së dhënë me shkrim nga Këshilli i Ministrave me shkruesin e datës 5.1.2024*). Për sa i takon moshës së mjekëve që largohen jashtë vendit dhe llojit të arsimit të ndjekur prej tyre (publik ose privat), në gjykim nuk u paraqitën të dhëna. Nga ana tjetër, për t'i u përgjigjur situatës së largimit të mjekëve, në Universitetin e Mjekësisë Tiranë ka pasur rritje graduale të numrit të kuotave të çelura për çdo vit

për programin e studimit “Mjekësi e Përgjithshme”, duke arritur në 464 të tilla brenda vitit 2024 (*shih vendimin nr. 17, datë 10.3.2023, të Senatit Akademik të UMT-së*).

14. Nga analiza e këtyre të dhënave konstatohet lehtësisht se gjendja e burimeve njerëzore në sistemin shëndetësor nuk mund të cilësohet si nevojë emergjente, siç kanë parashtruar subjektet e interesuara. Duhet theksuar se fenomeni i largimit jashtë vendit i të rinjve të mirëarsimuar dhe të kualifikuar, i njohur edhe si ikja e trurit (*brain drain*), është tepër shqetësues, por ai duket se ekziston në të gjithë rajonin e Ballkanit.⁸ Megjithatë, ky fenomen vendas dhe rajonal nuk mund të thjeshtohet duke e adresuar atë si një çështje që ka lidhje vetëm me sektorin e mjekësisë ose vetëm me mjekët që studiojnë dhe diplomohen në programet e arsimit publik. Madje subjekti i interesuar, Kuvendi pohoi në gjykim se tendenca dhe fryma që mbizotëron tek të rinjtë shqiptarë, pa përjashtuar edhe studentët e mjekësisë, është ajo e largimit jashtë vendit. Po kështu, largimi i mjekëve të sapodiplomuar jashtë vendit nuk është një situatë që u krijua në mënyrë të beftë, që të gjente të papërgatitura autoritetet politikëbërëse dhe vendimmarrëse në Shqipëri.

15. Në këndvështrim të sa më sipër dhe duke mbajtur në konsideratë se Shqipëria është një vend në zhvillim, që është prekur nga lëvizjet demografike të popullsisë, përfshirë edhe lëvizjen e lirë jashtë vendit të të rinjve dhe profesionistëve, vlerësoj se në gjykim nuk u provua që nevoja për mjekë të rinj të ketë përmasa emergjente të atij niveli që të justifikonte miratimin e një mekanizmi ligjor kaq të ashpër. Nga ana tjetër, pranimet në programet e studimit nga UMT-ja vit pas viti janë në rritje dhe duket se janë më të larta sesa numri i mjekëve që largohen (*shih paragrafin 13 më sipër*). Për më tepër, duket se në situatën në fjalë nuk janë përfshirë treguesit që gjenerohen nga universitetet private të mjekësisë, të cilat kanë kuota vjetore të planifikuara dhe numër të konsiderueshëm mjekësh të rinj që diplomohen vit pas viti.

16. Nën këtë optikë, çmoj se subjektet e interesuara nuk arritën të shpjegojnë në mënyrë të arsyeshme dhe bindëse në gjykim se përse kjo situatë u vlerësua prej tyre emergjente në atë masë

⁸ <https://www.gmfus.org/news/reversing-brain-drain-western-balkans>



që të diktonte hartimin e një ligji “emergjent”, jashtë programit legjislativ dhe me procedurë të përsheptuar. Po kështu, nuk duket që vlerësimi për ndërmarrjen e një nisme të tillë të ketë qenë logjik dhe i ndershëm, pasi ai i detyron studentët, përfshirë edhe ata që janë me mundësi të kufizuara financiare familjare dhe personale, të nënshkruajnë një marrëveshje me pasoja financiare për ta. Në këtë kuptim, tarifa e studimit në arsimin publik është shumëfishuar duke u barazuar me kostot e studimit. Konkretisht, kostoja/tarifa e studimit aktualisht llogaritet në 248,975 lekë për student (*shih paragrafin 4 të vendimit*) nga 45,000 lekë që ka qenë. Kjo vlerë është shumë e lartë dhe e kthen “marrëveshjen përpara pranimit në programin e studimit për të ushtruar profesionin në Shqipëri” në vetvete në sanksion ekonomik, pasi i detyron studentët që të pranojnë ta nënshkruajnë ose ndëshkon ata që nuk pranojnë ta nënshkruajnë atë, duke u hequr atyre mundësinë e zgjedhjes.

17. Nga ana tjetër, pretendimi i subjekteve të interesuara se ky mekanizëm është analog me atë të Shkollës së Magjistraturës është i pabazuar, pasi ky i fundit i ofron kandidatit që gjatë periudhës së ndjekjes së programit të formimit fillestar të përfitojë një bursë shkollimi, e cila përllogaritet me përqindje mbi pagën bruto fillestare të tij, të cilën ai është i detyruar ta kthejë tërësisht ose 50%, në rastet e parashikuara shprehimisht në ligj (*shih nenin 19, të ligjit nr. 96/2016, datë 6.10.2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenin 267, të ligjit nr. 115/2016, datë 3.11.2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar*). Kjo do të thotë se kandidatët për magjistratë përfitojnë bursë shkollimi dhe detyrohen të kthejnë eventualisht vetëm bursën e përfituar, përkundër detyrimit të studentëve të mjekësisë për t’u sanksionuar me kostot e studimit.

18. Nën këtë analizë, rezulton se detyrimi në fjalë aplikohet vetëm ndaj studentëve të mjekësisë në institucionet e arsimit publik dhe në një masë të tillë që nuk është në raport të drejtë me nivelin e jetesës. Kjo barrë bëhet akoma edhe më e ndjeshme, nëse mbahet në konsideratë se ligjvënasi për të bërë të zbatueshëm ligjin ka vendosur edhe ndalimin e tërheqjes së diplomës. Në këtë kontekst, çmuj se mekanizmi ligjor, në tërësi, nuk është rrjedhojë e një vlerësimi logjik dhe e bën raportin midis tij dhe nevojës të shpërpjesëtuar dhe në atë masë që e shndërron atë në arbitrar dhe të padrejtë.

19. Për rrjedhojë, mbështetur në argumentet e mësipërme, vlerësoj se Gjykata duhet të kishte pranuar kërkesën e kërkuarve dhe të vendoste shfuqizimin e dispozitave ligjore, sipas objektit.

Anëtare: Marsida Xhaferllari

MENDIM PJESËRISHT KUNDËR

1. Në çështjen objekt gjykimi kam votuar për pranimin e kërkesës sipas objektit, ndaj dhe në vijim do të paraqes argumentet mbi të cilat mbështetet ky qëndrim.

2. Shumica ka arritur në konkluzionin e shfuqizimit vetëm të fjalëve që parashikojnë afatet ligjore për punësim pas përfundimit të studimeve, në dispozitat objekt kundërshtimi, për shkak të mosrespektimit të parimit të proporcionalitetit, në drejtim të nëntestit të përshtatshmërisë. Sipas saj, afatet e përcaktuara nga neni 4, i ligjit nr. 60/2023 nuk janë proporcionale, si dhe duke pasuar parasysh se afati pesë vjeçar, i parashikuar në pikën 1, shkronjat “b” dhe “c” të këtij neni, është gati i njëjtë me vetë kohëzgjatjen e studimeve, dhe duke marrë në konsideratë eksperiencat e ngjashme të vendeve të tjera, ajo vlerëson që të rishikohet ky afat deri në një kufi jo më të gjatë sesa tre vjet. Po kështu ligjvënasi duhet të rishikojë me qëllim që të garantojë parimin e proporcionalitetit të ndërhyrjes edhe afatet e tjera tre dhe dy vjeçare të përcaktuara në pikën 2, shkronjat “a” dhe “b” dhe pikën 3, shkronjat “a” dhe “b”, të nenit 4, të ligjit nr. 60/2023 (*shih paragrafin 72 të vendimit*). Ndërsa në vlerësimin tim, në vetvete masa ndërhyrëse legjislative, pra punësimi me detyrim në sistemin mjekësor publik pas diplomimit të studentëve të mjekësisë dhe pagesa e kostove të studimit në rast mospranimit të nënshkrimit të kontratës për punësim, nuk plotëson kriterin kushtetues të proporcionalitetit, në drejtim të secilit prej nënkritereve të testit të proporcionalitetit, përkatësisht nevojës, domosdoshmërisë dhe përshtatshmërisë, të analizuara së bashku ose veç e veç.

3. Në parim, në gjykimin tim, zbatimi i ligjit objekt shqyrtimi imponon një barrë të tepruar mbi studentët dhe në këtë mënyrë dështon në arritjen e një ekuilibri të drejtë midis interesit publik për mbrojtjen e shëndetit publik dhe ofrimit të kujdesit mjekësor, nga njëra anë, dhe interesit të studentëve



për arsim publik dhe së drejtës për punë të ligjshme e që duhet ta zgjedhin vetë, nga ana tjetër.

4. Referuar çështjes konkrete, rezulton se Kuvendi, në bazë të propozimit të Këshillit të Ministrave dhe në zbatim të procedurës së përshtepitur parlamentare, ka miratuar ligjin nr. 60/2023. Ky ligj ka parashikuar një mekanizëm përmes së cilit studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë u ofrohet një trajtim e veçantë, i cili, në kuptim të nenit 3, pika 1, të ligjit, përfshin punësimin me prioritet të tyre pas përfundimit të studimeve, si dhe të drejtën për të përfutur nga programet sociale të strehimit. Ky trajtim përfitohet si nga kandidati që pranohet rishtazi në programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë, ashtu edhe nga studenti i vitit të dytë deri në vitin e katërt akademik dhe nga studenti i vitit të pestë ose të gjashtë (*student i ndërmjetëm*) në këtë program, kur pranon të nënshkruajë marrëveshje me ministrinë përgjegjëse për arsimin, ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë dhe institucionin e arsimit të lartë publik. Sipas marrëveshjes, studenti duhet të punojë në profesionin e mjekut pas përfundimit të studimeve për, respektivisht, jo më pak se pesë vjet, tre vjet dhe dy vjet, në institucionet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë, si dhe pranon kalimin zyrtarisht të diplomës përkatëse të arsimit të lartë nga institucioni publik i arsimit të lartë, ku ka përfunduar studimet, në institucionin shëndetësor ku punësohet deri në shlyerjen e detyrimeve për punësim sipas afatit, përkatësisht, 5-vjeçar, 3-vjeçar dhe 2-vjeçar, me të drejtën që pas përmbushjes së detyrimit të punësimit të tërheqë diplomën universitare (*neni 4, pika 1, shëronja “c”, pika 2, shëronja “b”, pika 3, shëronja “b”, i ligjit nr. 60/2023*). Ndërkohë studenti që nuk pranon të nënshkruajë marrëveshjen sipas përcaktimeve të pikave 2 dhe 3 të nenit 4, paguan vlerën e plotë të kostos së studimeve (*neni 5 i ligjit nr. 60/2023*).

5. Kërkuesit në lidhje me këto parashikime ligjore, të cilat i kundërshtojnë si në cenim të së drejtës për arsim dhe së drejtës për punësim, kanë pretenduar se për ndërhyrjen nuk ekziston një situatë emergjente, që të ketë ulje të numrit të mjekëve në raport me popullsinë. Mjetet e përdorura nuk janë të domosdoshme, që do të

thotë se synimi mund të arrihej me mjete të tjera. Garantimi i shërbimit mjekësor nuk ka asnjë lidhje me pagimin e vlerës së plotë të kostos së studimeve, ndërhyrja nuk është e përshtatshme për realizimin e këtij qëllimi, si dhe nuk e influencon atë. Objektivi i ligjvënësit nuk është mjaftueshmërisht i rëndësishëm për të justifikuar kufizimin e së drejtës (*shih paragrafin 9.2. të vendimit*).

6. Po në këtë drejtim, Kuvendi ka prapësuar se kriteret për vendosjen e kufizimit sipas nenit 17 të Kushtetutës janë plotësuar. E drejta për kujdes shëndetësor synon mbrojtjen e së drejtës së jetës, për rrjedhojë shteti ka interes publik që të ndërhyjë në këtë aspekt. Qëllimi i ligjvënësit gjatë hartimit dhe miratimit të ligjit nr. 60/2023 ka qenë sigurimi i një raporti të drejtë midis kufizimit të vendosur dhe interesit publik. Për sa i përket *kriterit të proporcionalitetit*, interesi publik në garantimin e shërbimit mjekësor për popullsinë mbizotëron ndaj pritshmërisë së studentëve, që janë në ndjekje e sipër të programit të studimit në mjekësi, për të vijuar edhe kohën e mbetur të studimit me të njëjtin trajtim dhe kushte që kanë pasur deri më sot (*shih paragrafët 10.2.1. dhe 10.2.2. të vendimit*). Edhe subjekti i interesuar, KM-ja, ka prapësuar se pandemia botërore COVID-19 ka gjeneruar efekte negative, ndaj politikat për rimëkëmbje duhet të rimodelohen. Ligji objekt shqyrtimi është hartuar në përputhje me strategjitë kryesore në vend, e konkretisht me qëllimet e politikave në fushat e arsimit, shëndetësisë dhe punësimit (*shih paragrafin 11.2. të vendimit*).

7. Lidhur me kufizimet e të drejtave themelore kushtetuese, Gjykata ka një jurisprudencë të konsoliduar, sipas së cilës për vlerësimin e proporcionalitetit të ndërhyrjes merret në shqyrtim balanca ndërmjet dëmit të shkaktuar individit dhe së mirës së përgjithshme të shoqërisë, masa e mbrojtjes nga arbitrariteti që ofrojnë procedurat ligjore, si dhe mundësia e shtetit për të përdorur mënyra a mjete të tjera për të arritur qëllimin. Shteti, brenda mundësive, duhet të kufizojë ndërhyrjen në minimum, duke kërkuar zgjidhje alternative dhe, përgjithësisht, duke u përpjekur t'i arrijë qëllimet në mënyrë sa më pak të dëmshme nga pikëpamja e të drejtave të njeriut (*shih vendimin nr. 17, datë 23.4.2010, të Gjykatës Kushtetuese*). Përdorimi i këtyre mjeteve duhet të jetë i domosdoshëm, çka do të thotë se synimi nuk mund të arrihet me mjete të tjera.



Domosdoshmëria lidhet edhe me përdorimin e mjeteve më pak të dëmshme për subjektet që u cenohen të drejtat dhe liritë. Po kështu, ndërhyrja për kufizimin e një të drejte ose lirie të bëhet me mjete të përshtatshme që i përgjigjen drejt qëllimit që synohet të arrihet (*shih vendimet nr. 30, datë 5.7.2021; nr. 20, datë 20.4.2021; nr. 16, datë 1.3.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Po sipas Gjykatës, për vlerësimin e proporcionalitetit duhen mbajtur në konsideratë disa nënkritere: i. nëse objektivi i ligjvënësit është mjaftueshmërisht i rëndësishëm për të justifikuar kufizimin e së drejtës; ii. nëse masat e marra janë të lidhura në mënyrë të arsyeshme me objektivin, ato nuk mund të jenë arbitrare, të padrejta ose të bazuara mbi vlerësime alogjike; iii. nëse mjetet e përdorura nuk janë më të ashpra se sa duhet për të arritur objektivin e kërkuar, sa më të mëdha efektet e dëmshme të masës së përzgjedhur, aq më tepër duhet të jetë i rëndësishëm objektivi për t'u arritur, në mënyrë që masa të justifikohet si e nevojshme (*shih vendimet nr. 20, datë 20.4.2021; nr. 11, datë 9.3.2021; nr. 33, datë 8.6.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Përveç sa më lart, kjo Gjykatë mban në konsideratë prezumimin e pajtueshmërisë së aktit normativ me Kushtetutën, derisa palët t'i provojnë asaj të kundërtën. Kjo do të thotë se lidhur me jokushtetutshmërinë e pretenduar argumentet e parashtruara duhet të jenë bindëse, për t'i dhënë mundësi kësaj Gjykate të vlerësojë nëse zgjidhjet e aplikuara shkelin normat dhe vlerat kushtetuese (*shih vendimet nr. 30, datë 2.11.2022; nr. 5, datë 27.1.2017; nr. 52, datë 26.7.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Ndërsa, në vështrim të kontrollit kushtetues të respektimit të parimit të proporcionalitetit është thelbësore të theksohet se nuk i takon Gjykatës të përcaktojë nëse mjeti i përzgjedhur është mënyra më e përshtatshme, më e arsyeshme ose e duhura, por roli i saj është të kontrollojë nëse përmbajtja e vetë dispozitës normative është e pajtueshme me të drejtat, liritë dhe parimet themelore kushtetuese (*shih vendimin nr. 55, datë 21.7.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Në vështrim të standardeve të sipërpërmendura, në rastin konkret duhet analizuar nëse kërkuesit arritën ta përmbysin prezumimin e kushtetutshmërisë së normave ligjore të kundërshtuara në raport me tri nënkriteret e ndërhyrjes: i. nevojës; ii. domosdoshmërisë, iii. përshtatshmërisë. Në këtë drejtim, pyetjet që duhej

të merrnin përgjigje në këtë gjykim ishin: A ishte e nevojshme në momentin e marrjes së nismës ligjore dhe miratimit të ligjit ndërhyrja përmes detyrimit për punësim të studentëve të mjekësisë pas diplomimit? A ishte ky mjet ndërhyrës më pak i ashpri referuar jo vetëm afateve detyruese të punësimit nga 2, 3 dhe deri në 5 vjet, por edhe detyrimit për pagimin e kostos së studimit të 5 brezave studentorë, në rast se ata nuk pranojnë të nënshkruajnë marrëveshjen përkatëse? A kishte mjete të tjera për të arritur objektivin e synuar, dhe a u shqyrtuan alternativat e tjera nga ligjvënësi? A do të sjellë rezultate konkrete ky mjet për realizimin e objektivit të synuar?

11. Duke iu referuar dokumenteve të administruara në gjykim, kërkuesit paraqitën shkresën nr. 3697/1, të datës 17.10.2023, të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me të cilën i kthehet përgjigje organizatës “Qëndresa Qytetare” dhe deklarohet se “aktualisht, vendet vakante për mjekë të përgjithshëm në sistemin shëndetësor janë 4% e numrit total të personelit mjekësor në kujdes parësor. Plotësimi i 4% të vendeve vakante në sistem shëndetësor është një proces dinamik dhe nuk ka krijuar mungesë të ofrimit të shërbimit shëndetësor të aksesueshëm dhe pranë vendbanimit për qytetarët”. Ndërsa, sipas parashtrimeve të subjekteve të interesuara në seancë plenare rezultoi se numri i përgjithshëm i mjekëve që ofrojnë shërbim në sistemin parësor shëndetësor është 5400.

12. Po kështu, referuar shkresës nr. 5288/10, të datës 5.1.2024, të Këshillit të Ministrave, numri i pozicioneve vakante për mjekë është 482, numri i mjekëve në moshë pensioni është 213 dhe numri i mjekëve që largohen çdo vit jashtë vendit është rreth 200, pasi kërkojnë të pajisen me certifikatë të sjelljes së mirë, tipike për ata që kërkojnë të largohen nga vendi, pra rreth 895 vende vakante. Ndërkohë, po sipas këtij subjekti të interesuar, ka pasur rritje graduale të numrit të kuotave të çelura për çdo vit për programin e studimit “Mjekësi e përgjithshme” në UMT, duke arritur rreth 500 të tilla brenda vitit 2024.

13. Për sa më lart, në çështjen në gjykim, nga kërkuesit, përmes shkresës së sipërcituar, u përmbys prezumimi i nevojës aktuale për ndërhyrjen legjislative përkatëse, pasi nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale pranohet se plotësimi i 4% të vendeve vakante për mjekë të përgjithshëm në sistem shëndetësor është një



proces dinamik dhe nuk ka krijuar mungesë të ofrimit të shërbimit shëndetësor të aksesueshëm dhe pranë vendbanimit për qytetarët.

14. Po në drejtim të nevojës, 4% vende vakante nga numri total i 5400 mjekëve në kujdes parësor (në terma konkretë 216 vende vakante), nuk justifikon nevojën reale të marrjes së masës kufizuese objekt kundërshtimi në një kategori të zgjeruar prej 5 brezash, kur edhe prurjet nga UMT-ja për mjekë të diplomuar vit pas viti, në periudhën që shtrihen efektet e këtij ligji, janë më të mëdha se nevojat aktuale për të punësuar mjekë të përgjithshëm në vendet vakante. Konkretisht, ndërhyrja legislative prek një kategori studentësh që u përkasin vitit të parë deri në vitin e gjashtë të studimeve. Po ashtu, ndërhyrja legislative prek studentët e vitit të parë që do të pranohen në sistemin universitar çdo vit, duke filluar nga viti akademik 2023–2024 deri në vitin akademik 2027–2028, pra 5 breza studentësh, që në varësi të numrit të kuotave të pranimit ndër vite mund të arrijnë, rreth 2500 studentë gjithsej, nëse pranimet do të jenë rreth 500 kuota në vit, sikundër pranimet për vitin akademik 2023–2024, referuar vendimit nr. 17/2023, të senatit akademik të UMT-së. Në këto kushte, vlerësoj se subjekti i interesuar nuk ka dhënë argumente se situata faktike e evidentuar në kohën e miratimit të ligjit objekt kundërshtimi për ekzistencën e nevojës, mbështetet në vlerësime të mjaftueshme për zbatim të kufizimit në të gjithë kategorinë e zgjeruar të studentëve të mjekësisë, (5 breza të plotë studentësh me nga 6 vjet shkollim dhe 5 breza studentësh që preken pjesërisht, sipas vitit të studimit ku ndodhen deri në përfundim të programit). Në këtë drejtim, nuk pajtohem me argumentet e shumicës, se situata faktike e evidentuar në kohën e miratimit të këtij ligji, e provuar edhe gjatë këtij gjykimi dhe që lidhet me problematikat në drejtim të raportit të numrit të mjekëve dhe popullsisë, është rrethanë që bën të qartë ekzistencën e nevojës për të vepruar nga ana e ligjvënësit në miratimin e ligjit nr. 60/2023, e cila është e tillë që justifikon kufizimin në të drejtën për punë, të garantuar nga neni 49, pika 1, i Kushtetutës, (*shih paragrafin 65 të vendimit*). Kjo pasi në vlerësimin tim, problematikat e evidentuara në gjykim në drejtim të raportit të numrit të mjekëve dhe popullsisë, lidhen me një nevojë të përhershme për përmirësimin e kujdesit shëndetësor dhe cilësisë së shërbimit shëndetësor, si e drejtë

kushtetuese me natyrë progresive dhe nuk janë rrethana të tilla që mund të argumentonin nevojën aktuale dhe reale për plotësim të vendeve vakante ekzistuese për mjekë të përgjithshëm në sistemin shëndetësor, përmes masës kufizuese legislative objekt kundërshtimi.

15. Po ashtu, duke argumentuar më lart se nuk ka ekzistuar nevoja aktuale si kusht paraprak për ndërhyrjen legislative, në vlerësimin tim nuk plotësohet as domosdoshmëria. Megjithatë, edhe në drejtim të domosdoshmërisë nuk u provua se kjo ishte masa më pak e ashpër, në kuptimin që edhe nëse ndërhyrja detyruese për vitet e punësimit të ishte i vetmi mjet për arritjen e objektivit, ai lidhet në mënyrë të paarsyeshme me detyrimin për pagimin e kostove për ata studentë të mjekësisë që nuk e pranojnë, duke e kthyer masën në tërësi të ashpër. Në këtë drejtim, nga subjektet e interesuara nuk u provua se përse nuk u analizua paraprakisht jo detyrimi për pagimin e kostove për shkollim për ata studentë mjekësie që nuk e pranojnë atë detyrim, por edhe mjete të tjera alternative si p.sh. nxitja dhe mbështetja përmes pagimit të shpenzimeve personale të shkollimit nga ana e shtetit për ata studentë të mjekësisë që do të pranonin punësimin me detyrim. Sa studentë të prekur nga ky ligj, potencialisht mund të pranonin detyrimin përkatës lidhur me punësimin me detyrim, nëse shteti do u merrte përsipër shpenzimet personale të jetesës? Sa mundësi financiare kishte shteti në këtë aspekt? Kjo, pasi në vlerësimin tim, punësimi me detyrim sipas viteve përkatëse, duke mos e kombinuar me pagesën e kostos së studimit në rast mospranimi të nënshkrimit të kontratës, mund të rezultonte si një masë më pak të ashpër sa i përket ekuilibrit të interesave publike për ofrimin e kujdesit mjekësor, nga njëra anë, dhe interesit të studentëve për arsim publik dhe së drejtës për punë të ligjshme e që duhet ta zgjedhin vetë, nga ana tjetër. Ndaj, në këtë drejtim, nuk pajtohem me shumicën, sipas së cilës, edhe nga vetë kërkuessit, në lidhje me mundësitë reale për të miratuar ndonjë skemë tjetër të punësimit, nuk u evidentua ndonjë masë ose skemë tjetër që mund të përdorej në këtë drejtim, e cila mund të sillte të njëjtin efekt të dëshiruar dhe që do të ishte eficiente për përmbushjen e qëllimit të synuar dhe, nga ana tjetër, më pak ose aspak kufizuese e të drejtave të studentëve. Në këto kushte, ajo vlerëson se masa e kundërshtuar



plotëson edhe kërkesën e të qenit e domosdoshme. (shih paragrafin 67 të vendimit).

16. Për më tepër, në drejtim të përshtatshmërisë nuk rezulton dokumentacion paraprak dhe analizë mbështetëse e mjaftueshme që masa mund të sjellë rezultat, pra të jetë efektive. Në vlerësimin tim, qëllimi thelbësor i ndërhyrjes në të drejtat themelore me ligj, për t'i kufizuar ato për shkak të një nevoje publike, është arritja e objektivave të synuar, ndaj edhe efektiviteti merr rëndësi kryesore në kuadër të kontrollit kushtetues të parimit të proporcionalitetit. Në këtë aspekt, raporti që shoqëronte projektligjin në Komisionin e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë nisej nga premisa të pabazuara dhe jo të mbështetura në fakte konkrete. Sipas këtij raporti, parashikohej se *“...50% e studentëve do të pranojnë të nënshkruajnë marrëveshjen”*. Po sipas raportit, *“...në rast se të gjithë studentët nuk do ta pranojnë marrëveshjen dhe do të paguajnë koston e plotë të studimeve, efekti financiar do të jetë..., por sipas këtij skenari që asnjë student nuk do të pranojë të nënshkruajë marrëveshjen për qëndrim 2-5 vjeçar në Shqipëri është skenar jo realist”*.

17. Për sa më lart, nuk rezultoi e mbështetur me të dhëna dhe analiza paraprake se si është vlerësuar se 50% e studentëve do ta pranojnë marrëveshjen dhe në hipotezën që të gjithë të paguajnë koston e studimit dhe mos ta nënshkruajnë atë, që mund të mos jetë dhe aq situatë jorealiste, cila do të ishte një masë tjetër sipas Këshillit të Ministrave për plotësimin e mungesave për mjekë në sistemin shëndetësor. Edhe në seancë gjyqësore, pyetjes nëse të gjithë studentët e prekur nuk do të pranonin të nënshkruanin kontratën, çfarë alternative do të kishte për plotësimin e vendeve vakante, Këshilli i Ministrave, si subjekt i interesuar, iu përgjigj se do të merreshin masa të tjera, duke mos i konkretizuar se cilat janë ose cilat do të ishin (shih procesverbalet e seancës gjyqësore). Në kuptim të testit të përshtatshmërisë, sipas të cilit masa që ka kufizuar të drejtën duhet të sjellë efektin e duhur dhe të realizojë synimin për të cilin është përzgjedhur, nuk u provua se kjo masë është bazuar mbi vlerësime logjike, që mund të realizonte objektivin e synuar me kufizim më pak të ashpër, ndaj edhe në këtë drejtim kjo ndërhyrje nuk plotëson standardet e efektivitetit dhe të racionalitetit.

18. Në përfundim, vlerësoj se dispozitat ligjore objekt kundërshtimi nuk respektojnë të drejtën për

arsim dhe të drejtën për punësim të studentëve të mjekësisë, si rezultat i ndërhyrjes joproportionale të ligjvënësit, referuar nenit 17 të Kushtetutës dhe jurisprudencës së konsoliduar të kësaj Gjykate, ndaj dhe kërkesa duhej pranuar në tërësi.

Anëtare: Elsa Toska

MENDIM PJESËRISHT KUNDËR

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes nr. 1 (Nj) 2023 të Regjistrat Themeltar, që i përket kërkesës së një grupi deputetësh të Kuvendit (jo më pak se një e pesta e deputetëve) dhe një grupi studentësh, me objekt: *“Shfuqizimin e nenit 4, pikat 1, shkronja “c”, 2, shkronja “b”, 3, shkronja “b” dhe nenit 5, fjalia e parë të ligjit nr. 60/2023, “Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë”, si dhe pezullimin e tij deri në hyrjen në fuqi të vendimit përfundimtar të Gjykatës”, ndaj qëndrim pjesërisht të ndryshëm nga shumica për sa i përket zgjidhjes së kësaj çështjeje, pasi vlerësoj se duhej të ishte vendosur pranimi i plotë i kërkesës, duke parashtruar argumentet si më poshtë vijojnë.*

2. Në datën 21.7.2023, Kuvendi, në bazë të propozimit të Këshillit të Ministrave dhe në zbatimit të procedurës së përsheptuar parlamentare, ka miratuar ligjin nr. 60/2023, i cili është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 123, datë 16.8.2023 dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit të tij. Ky ligj ka parashikuar një mekanizëm përmes së cilit studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë u ofrohet një trajtim e veçantë, i cili, në kuptim të nenit 3, pika 1, të ligjit, përfshin punësimin me prioritet të tyre pas përfundimit të studimeve, si dhe të drejtën për të përfutur nga programet sociale të strehimit.

3. Ky trajtim përfitohet si nga kandidati që pranohet rishtazi në programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë, ashtu edhe nga studenti i vitit të dytë deri në vitin e katërt akademik dhe nga studenti i vitit të pestë ose të gjashtë (*student i ndërmjetëm*) në këtë program, kur pranon të nënshkruajë marrëveshje me ministrinë përgjegjëse për arsimin, ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë dhe institucionin e arsimit të lartë publik. Sipas marrëveshjes, studenti duhet të



punojë në profesionin e mjekut pas përfundimit të studimeve për, respektivisht, jo më pak se pesë vjet, tre vjet dhe dy vjet, në institucionet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë, si dhe pranon kalimin zyrtarisht të diplomës përkatëse të arsimit të lartë nga institucioni publik i arsimit të lartë, ku ka përfunduar studimet, në institucionin shëndetësor ku punësohet deri në shlyerjen e detyrimeve për punësim sipas afatit, përkatësisht, 5-vjeçar, 3-vjeçar dhe 2-vjeçar, me të drejtën që pas përmbushjes së detyrimit të punësimit të tërheqë diplomën universitare (*neni 4, pika 1, shërkronja "c", pika 2, shërkronja "b", pika 3, shërkronja "b", i ligjit nr. 60/2023*). Ndërkohë studenti që nuk pranon të nënshkruajë marrëveshjen, sipas përcaktimeve të pikave 2 dhe 3 të nenit 4, paguan vlerën e plotë të kostos së studimeve (*neni 5, i ligjit nr. 60/2023*).

4. Kërkuesit kanë pretenduar se dispozitat e kundërshtuara të ligjit nr. 60/2023, kanë cenuar disa parime dhe të drejta kushtetuese, më konkretisht parimin e sigurisë juridike, të garantuar në nenin 4 të Kushtetutës, të drejtën për punë dhe të drejtën për arsimim, të garantuara nga nenet 49 dhe 57, të Kushtetutës, në kundërshtim me kriteret e kufizimit të parashikuara në nenin 17, të Kushtetutës, të drejtën për të mos iu nënshtruar punës së detyruar, të garantuar nga neni 26 i Kushtetutës, si edhe parimin e barazisë para ligjit, të garantuar nga neni 18 i Kushtetutës. Në lidhje me parimin e barazisë përpara ligjit jam dakord me qëndrimin e shumicës se ky pretendim është i lidhur me vlerën e kostos financiare të studimeve që duhet të përballojnë studentët që nuk pranojnë të nënshkruajnë marrëveshjen me institucionet shëndetësore publike, metodologjia dhe vlera e të cilës nuk përcaktohen nga ligji nr. 60/2023, por janë miratuar me akte nënligjore të organeve të UMT-së që nuk janë objekt i këtij gjykimi kushtetues (*shih paragrafin 37 të vendimit*).

5. Në lidhje me pretendimet e tjera të kërkesës, që lidhen me të drejtën për arsimim, sipas nenit 57 të Kushtetutës, shumica ka vlerësuar se janë mbështetur në cenimin e të drejtave të fituara dhe pritshmërive të ligjshme të studentëve për shkak të ndryshimit të kornizës ligjore që ka qenë në fuqi në kohën kur ata kanë filluar studimet në Fakultetin e Mjekësisë (ligji nr. 80/2015), për studentët e ndërmjetëm, dhe kur kanë vendosur të konkurrojnë për t'u bërë pjesë e atij fakulteti, për studentët e vitit të parë. Për rrjedhojë, ajo ka

vlerësuar t'i analizojë këto pretendime në vijim në drejtim të parimit të sigurisë juridike. Kurse pretendimet që kanë të bëjnë me cenimin e së drejtës për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme të zgjedhur ose pranuar vetë dhe asaj për të mos iu nënshtruar punës së detyruar, për shkak të mënyrës se si janë parashtruar ato, shumica ka vlerësuar t'i shqyrtojë në kuptim të përmbajtjes së nenit 49, pika 1, të Kushtetutës (*shih paragrafin 38 të vendimit*).

6. Në vijim, pasi ka gjetur shkelje të parimit të sigurisë juridike, për shkak se dispozitat e kundërshtuara kanë sjellë pasoja negative të të drejtave të fituara të studentëve, sipas parashikimeve ligjore të miratuara në kuptim dhe zbatim të së drejtës për arsimim, shumica ka vlerësuar se këto ndryshime ligjore prekin në dukje të drejtën për punë të parashikuar nga neni 49 i Kushtetutës, ndaj në vijim është ndalur në vlerësimin nëse kjo e drejtë kushtetuese e studentëve është kufizuar dhe nëse janë respektuar kriteret e nenit 17 të Kushtetutës (*shih paragrafin 50 të vendimit*). Edhe në këtë pjesë të vendimit bashkohem me qëndrimin e shumicës, ashtu si bashkohem edhe me qëndrimin se në rastin konkret ndërhyrja e ligjvënësit nuk ka respektuar kriteret kushtetuese të kufizimit. Ajo që më ndan nga arsyetimi i shumicës është shkak për të cilin ajo ka vendosur të shfuqizojë dispozitat e kundërshtuara nga kërkuesit.

7. Shumica e ka vlerësuar të drejtën për punë në bazë të kriterëve të nenit 17 të Kushtetutës, e më konkretisht duke ia nënshtruar atë testit kushtetues për të parë nëse: i. ndërhyrja është bërë vetëm me ligj; ii. ekziston interesi publik; iii. është respektuar parimi i proporcionalitetit midis ndërhyrjes dhe gjendjes që e ka diktuar atë.

8. Në lidhje me kriterin e parë të kufizimit, në rastin konkret nuk vihet në diskutim respektimi i tij për sa kohë ndërhyrja është bërë me ligjin nr. 60/2023, i cili është miratuar nga Kuvendi, sipas procedurave të parashikuara për këtë qëllim (*shih paragrafin 59 të vendimit*).

9. Më tej, në analizë të kriterit të dytë të kufizimit, atij për interes publik, qasja ime ndryshon nga ajo e shumicës. Gjykata ka theksuar se është e vështirë të radhiten në mënyrë shteruese çështjet që përbëjnë interes publik ose të arsyes publike që çojnë në kufizimin e një të drejte themelore, pasi interesi publik duhet kuptuar në sensin relativ, në



varësi të situatave të ndryshme që krijohen. Ato mund të renditen vetëm negativisht, pra në aspektin e kufizimit të çdo rasti konkret. Në praktikën kushtetuese është pranuar tashmë se ligjvënësi, parimisht, është i lirë të veprojë brenda hapësirës së tij normuese, duke përcaktuar qartë dhe rast pas rasti qëllimet që kërkon të arrijë (*shih vendimet nr. 20, datë 20.4.2021; nr. 16, datë 1.3.2017; nr. 1, datë 16.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Sipas shumicës, referuar subjekteve të interesuara, Kuvendit dhe Këshillit të Ministrave, interesi publik i evidentuar në çështjen konkrete është i lidhur drejtpërdrejt me mirëfunksionimin e skemës së kujdesit shëndetësor dhe garantimin e plotësimit të nevojave për burime njerëzore në kryerjen e shërbimeve të shëndetit publik në institucionet shëndetësore, i cili rezulton të jetë i lartë, prandaj ligji është hartuar në përputhje me nevojat e diktura në vend. Shumica ka vlerësuar se sipas nenit 55 të Kushtetutës shtetasit gëzojnë në mënyrë të barabartë të drejtën për kujdes shëndetësor dhe sigurim shëndetësor nga shteti, i cili ka detyrimin për të ndërhyrë me qëllim sigurimin e saj për të gjithë qytetarët përmes ofrimit të kujdesit shëndetësor në institucionet e shëndetit publik. Kurse sipas nenit 59, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës, shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, synon edhe standardin më të lartë shëndetësor të mundshëm. Referuar nenit 2 të ligjit nr. 60/2023, ai synon sigurimin e burimeve njerëzore për kryerjen e shërbimeve të shëndetit publik në institucionet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet përcaktimit të rregullave për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë. Për rrjedhojë, shumica ka vlerësuar se në rastin konkret ka një interes publik që ka justifikuar ndërhyrjen në të drejtën e studentëve për punësim, për sa kohë që me rregullimet ligjore të kundërshtuara synohet të garantohet ofrimi i shërbimit shëndetësor, në kuptim të nenit 55, pika 1, të Kushtetutës, si dhe garantimi i standardeve të shëndetit publik, sipas nenit 59, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës (*shih paragrafin 61 të vendimit*).

11. Sipas kërkuësve, ligjvënësi ka rritur tarifën e studimeve deri në koston e plotë të tyre pa një qëllim legjitim. Detyrimi për të paguar vlerën e plotë të koston së studimeve për studentët që

preferojnë të ruajnë *status quo*-në nuk i përgjigjet objektivit kryesor të tij, që ka të bëjë me sigurimin e stafit mjekësor në periudhë afatgjatë. Edhe kufizimi i marrjes së diplomës nuk i shërben interesit publik dhe e drejta e studentëve për të përfituar diplomën është një e drejtë themelore që nuk mund të lidhet me suksesin e marrëveshjes. Në vlerësimin tim ky pretendim i kërkuësve është i bazuar dhe në rastin konkret, në ndryshim nga përfundimi i arritur nga shumica, interesi publik nuk është i justifikuar pasi masat e përdorura janë më të ashpra se sa duhet për të arritur objektivin e kërkuar, duke cenuar kështu të drejtën kushtetuese të studentëve për arsim.

12. Referuar parashtimeve me shkrim dhe atyre të paraqitura në seancë plenare publike nga subjektet e interesuara, rezulton se numri i përgjithshëm i mjekëve që ofrojnë shërbim në sistemin shëndetësor është 5400, që në raport me numrin e popullsisë i takon 1.93 mjekë për çdo 1000 banorë. Numri i pozicioneve vakante për mjekë është 482, numri i mjekëve në moshë pensioni është 213 dhe numri i mjekëve që largohen çdo vit jashtë vendit është rreth 200. Bazuar në të dhënat e mësipërme, sikurse është deklaruar në seancë edhe nga subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, rezultojnë 1000 vende vakante për mjekë. Aktualisht, vendet vakante për mjekë të përgjithshëm në sistemin shëndetësor përbëjnë vetëm 4% të numrit total të personelit mjekësor në kujdes parësor. Ndërkohë që ka pasur rritje graduale të numrit të kuotave të çelura për çdo vit për programin e studimit “Mjekësi e përgjithshme” në UMT, duke arritur rreth 500 të tilla brenda vitit 2024. Këto të dhëna janë referuar edhe nga vetë shumica në vendimin e saj, bazuar në sa kanë parashtruar subjektet e interesuara (*shih paragrafin 69 të vendimit*).

13. Në analizë të këtyre të dhënave, duke mbajtur në konsideratë përqindjen e ulët të vendeve vakante për mjekë (vetëm 4%), si dhe numrin e lartë të studentëve që studiojnë në këtë fushë të shëndetit publik, vlerësoj se bazuar vetëm në këto statistika situata aktuale nuk paraqitet e tillë, pra që të ketë qenë në atë masë emergjente që të përkthehet në një interes publik të shtuar posaçërisht, gjë që do ta bënte të nevojshme një ndërhyrje të tillë dhe do të justifikonte masa me natyrë ligjore dhe miratimin e skemave të tilla për të plotësuar nevojat e popullatës në kuptim të nenit



55 të Kushtetutës. Detyrimi kushtetues që i ngarkohet shtetit për të garantuar shërbimin e shëndetit publik të shtetasve, të cilin ata duhet ta gëzojnë në mënyrë të barabartë, mbetet i tillë në çdo moment, me përjashtim të rasteve kur ngrihet në një nivel emergjence siç ishte situata e pandemisë globale COVID-19 apo në raste të situatave të jashtëzakonshme, të cilat do të justifikonin në kuadër të një interesi publik akoma me akut edhe ndërhyrjen me masa kufizuese të kësaj natyre.

14. Po kështu, çmoj se shteti mund të merrte masa të tjera efektive për të siguruar shërbimin shëndetësor në vend dhe për të evituar largimin e mjekëve jashtë vendit, duke e bërë më tërheqëse ofertën e punës, sipas mundësive të vetë ekzekutivit në këto drejtime punësimi. Mundësia për marrjen e masave të tjera efektive është pranuar në seancë plenare publike edhe nga përfaqësuesi i Këshillit të Ministrave, kur është pyetur se si do të sigurohej shërbimi shëndetësor në vend nëse të gjithë studentët e Fakultetit të Mjekësisë në UMT nuk do të pranonin të lidhnin marrëveshjet, por do të pranonin pagesën e vlerës së plotë të kostos së studimeve. Ndaj mendoj se në një situatë të tillë, ku, referuar asaj që u soll në vëmendje të Gjykatës nga vetë ky subjekt i interesuar, gjendemi përpara një përqindjeje të ulët vakancash në sistemin shëndetësor përkundrejt nevojave për shërbimin publik, e për më tepër nuk jemi përpara situatave pandemiko-globale ose të jashtëzakonshme, të cilat do të kërkonin ndërhyrje të tilla e të menjëhershme në kufizime, vlerësoj se ligjvënësi i kishte të gjitha mundësitë të analizonte ndërhyrje alternative me të buta në këtë drejtim.

15. Në përfundim, në bazë të analizës së mësipërme, vlerësoj se në situatën që kriteri i parashikuar nga neni 17 i Kushtetutës, pra ai i ndërhyrjes për interes publik, nuk është plotësuar në rastin konkret, kërkesa e kërkuësve duhej të ishte pranuar vetëm për këtë shkak për sa kohë që mungesa e këtij kriteri bënte të panevojshme analizën e kriterëve vijuese që parashikon kjo normë kushtetuese, që lidhen me proporcionalitetin e ndërhyrjes.

Anëtare: Sonila Bejtja

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, me vendimin nr. 482, datë 19.6.2023, vendosi heqjen e plotë të zotësisë juridike për të vepruar të shtetasit Sokrat Jazi, i datëlindjes 6.9.1984, lindur në Molisht Berat, si dhe caktimin si kujdestar dhe përfaqësues ligjor të tij shtetasin Hajri Jazi, për të kryer çdo veprim në emër dhe për llogari të tij.

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, me vendimin nr. 289, datë 20.4.2022, vendosi kufizimin e së drejtës për të vepruar të shtetasit Admir Kollçaku, i datëlindjes 15.2.1986, lindur në Kuçovë dhe banues në fshatin Magjatë, si dhe caktimin si kujdestar shtetasin Ilir Kollçaku, për pjesëmarrje dhe asistim në nënshkrimin nga ana e tij të kontratave apo çdo akti tjetër juridik të njëanshëm apo të dyanshëm me persona të tretë apo institucione shtetërore, si dhe të drejtën e tij për të votuar.

KËRKESË

Shtetasja Adelina Banushi kërkon, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, shpalljen të zhdukur të shtetasit Ermal Banushi, lindur në Cërrik, i datëlindjes 11.1.1981, dhe banues në lagjen “Haxhisa” deri në momentin e largimit nga Shqipëria, me atësi Festim dhe me amësi Zenepe, si dhe shpalljen të zhdukur të shtetasit Renald Banushi, lindur në Cërrik, i datëlindjes 17.9.1983, dhe banues në lagjen “Haxhisa” deri në momentin e largimit nga Shqipëria, me atësi Festim dhe me amësi Zenepe dhe caktimin e znj. Adelina Banushi si kujdestar për pjesën e pasurisë së tyre.

KËRKUESE

Adelina Banushi

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006



Çmimi 368 lekë